Food and Agriculture Organization of the United Nations

South Eastern Europe
SWG RRD
Regional Rural Development Standing Working Group

POLITIKA BUJQËSORE DHE INTEGRIMI EVROPIAN NË EVROPËN JUGLINDORE

2015



POLITIKA BUJQËSORE DHE INTEGRIMI EVROPIAN NË EVROPËN JUGLINDORE

Redaktuar nga Tina Volk, Emil Erjavec dhe Kaj Mortensen

Published by arrangement with the
Food and Agriculture Organization of the United Nations
by the Regional Rural Development Standing Working Group

Budapest, 2015

Ky dokument fillimisht është në gjuhën angleze nga Organizata Bujqësore dhe Ushqimit të Kombeve të Bashkuara me titull "Agricultural Policy and European Integration in Southeastern Europe. " Ky përkthim në gjuhën shqipe u realizua nga Grupi Permanent i Punës për Zhvillim Rural Rajonal. Në rast të mospërputhjevem do të përdoret gjuha origjinale.

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë dokument informues nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë së Kombeve të Bashkuara (FAO), në lidhje me statusin ligjor ose zhvillimor të ndonjë vendi, territori, qyteti ose zone apo të autoriteteve të tij, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tij. Përmendja e kompanive specifike apo produkteve të prodhuesve, të licencuara ose jo nuk do të thotë se këto janë vlerësuar apo rekomanduar nga FAO si më tëpreferuara krahasuar me kompaniapo produkte të tjera të natyrës së ngjashme që nuk janë përmendur.

Pikëpamjet e shprehura në këtë material informues janë ato të autorëve, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo politikat e FAO-s.

ISBN 978-92-5-008612-5

© Grupin e Përhershëm të Punës për Zhvillimin Rural Rajonal (SWG), 2015 (Albanian translation)
© FAO, 2014 (English edition)

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

338.43.02(4-12)"2014"(047)
338.43.02(4-672)"2014"(047)

POLITIKA bujqësore dhe integrimi evropian në Evropën Juglindore
[Електронски извор] / redaktuar nga Tina Volk, Emil Erjavec dhe Kaj Mortensen. - Текст, илустр. - Shkup : Grupin e përhershëm të punës për zhvillimin rural rajonal, 2015

Начин на пристап (URL): www.seerural.org. - Превод на делото: Agricultural policy and european integration in Southeastern Europe. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 04.03.2015. - Библиографија: стр. [191]. - Содржи и: Aneksi

ISBN 978-608-4760-16-0

а) Аграрна политика - Југоисточна Европа - 2014 - Извештаи б) Аграрна политика - Европска унија - 2014 - Извештаи
COBISS.MK-ID 98178826

Përmbajtja

Parathënie

Falënderime

Pjesa A ASPEKTET RAJONALE 9

Kapitulli A.I OBJEKTIVAT DHE QASJA Richard Eberlin, Katalin Ludvig[*], Irena Dzimrevska, Katerina Spasovska[**],Emil Erjavec..... 10

1. Detyrat integruese dhe zhvilluese të politikës bujqësore 10
3. Projekti i rrjetëzimit dhe kërkimi i FAO-s dhe SWG-së 13
4. Orientimi bazë dhe përmbajtja e studimit..... 14

Kapitulli A.II ANALIZA NDËRVENDORE E BUJQËSISË DHE POLITIKËS BUJQËSORE NË VENDET E EVROPËS JUGLINDORE NË KRAHASIM ME BASHKIMIN EVROPIAN Tina Volk, Miroslav Rednak[*], Emil Erjavec..... 16

1. Hyrje 16
2. Metodologjia..... 17
5. Konkluzione 44

Kapitulli A.III ANALIZA E HENDEQEVE DHE REKOMANDIME Emil Erjavec, Kaj Mortensen, Tina Volk, Miroslav Rednak[***], Richard Eberlin, Katalin Ludvig[****] 49

1. Motivimi dhe fokusi 49
3. Mbështetja analitike e politikave efikase 66

Kapitulli B.I BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË SHQIPËRI 72

Edvin Zhllima, Grigor Gjeci, Drini Imami[*]..... 72

1. **Hyrje** 72
2. Bujqësia 73
3. Politika bujqësore – një pamje e përgjithshme dhe krahasime..... 75
4. Diskutime dhe konkluzione..... 79

Kapitulli B.II BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE..... 84

NË BOSNJE & HERCEGOVINË Sabahudin Bajramović, Aleksandra Nikolić[*], Jakub Butković ... 84

1. Hyrje 84
2. Bujqësia 86
3. Politika bujqësore 90

Pritet që ndalimi i përkohshëm i procesit të integrimit evropian të BiH nuk do të sjellë përjashtimin nga grupi i republikave ish-jugosllave në rrugën drejt BE-së, e cila do të sillte dëme të mëdha politike, ekonomike dhe sociale. Ndoshta njoftimi i qasjes së ndryshme të BE-së në BiH është një shenjë se BiH ka akoma shans për t'u bërë një vend kandidat i BE-së në të ardhmen e afërt dhe për të filluar procesin e negociatave, në të cilin politika bujqësore do të marrë një vend shumë të rëndësishëm. 105

KapitulliB.III BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NE KROACI Ornella Mikuš..... 108

1. Hyrje 109
2. Bujqësia 110
3. Politika bujqësore 114
4. Diskutime dhe konkluzione 118

Kapitulli B.IV BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË KOSOVË* Iliriana Miftari, Halit Hoxhaj 122

1. Hyrje 123
2. Profili i Bujqësisë 123
3. Situata e përgjithshme e politikave bujqësore 127
4. Diskutime dhe konkluzione 134

Kapitulli B.V BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË ISH REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË Dragi Dimitrievski*, Ana Kotevska*, Ivana Janeska Stamenkovska*, Emelj Tuna*, Marina Nacka 137

1. Hyrje 138
2. Bujqësia 138
3. Politika bujqësore 144
4. Diskutime dhe konkluzione 148

Kapitulli B.VI BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË MAL TË ZI Milan Marković 153

1. Hyrje 153
2. Bujqësia 154
3. Politika bujqësore 159
4. Diskutime dhe konkluzione 163

Kapitulli B.VII BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË SERBI Natalija Bogdanov, Vesna Rodić 173

1. Hyrje 173
2. Bujqësia 174
3. Politika bujqësore 181
4. Diskutime dhe konkluzione 186

PARATHËNIE

Vendet e rajonit të Evropës Juglindore (SEE) shprehën synimin e tyre për t'u integruar në Bashkimin Evropian (BE) në mënyrë që të krijojnë një rajon më të qëndrueshëm, më të bashkuar dhe më të begatë. procesi i integrimit në BE duhet të nxisë stabilitetin politik dhe zhvillimin socio-ekonomik dhe të qëndrueshëm në rajon. Kandidatët e SEE dhe vendet kandidate potenciale, e shohin integrimin si një mundësi për të nxitur një zhvillim paqësor nëpërmjet bashkëpunimit ekonomik, politik dhe kulturor si brenda rajonit ashtu edhe me shtetet anëtare të BE-së.

Megjithatë, procesi i integrimit në BE është një procedurë mjaft komplekse, që përfshin krijimin e institucioneve të reja dhe zbatimin e një sërë reformave të politikave. Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit bujqësor në vendet e SEE-së në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal, është thelbësore që procesi i reformave të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë, rritjen e tregtisë rajonale dhe nxitjen e rehabilitimit të zinxhirëve ushqimorë. Për realizimin me sukses të procesit të reformave dhe për të siguruar një integrim më gradual, është i rëndësishëm zhvillimi i rrjeteve dhe mekanizmave të forta për dialog midis politikëbërësve dhe komunitetit kërkimor rreth fushave më të rëndësishme të politikave.

Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO) vendosi në bashkëpunim të ngushtë me Grupin e Përhershëm të Punës për Zhvillimin Rural Rajonal (SWG), për të zbatuar projektin *"Riorganizimi i politikave të zhvillimit bujqësor dhe ruraltë vendeve të SEE për anëtarësim në BE"*, për të lehtësuar krijimin e rrjeteve dhe mekanizmave në ndihmë të ketij projekti. Qëllimi i projektit është forcimi i bashkëpunimit midis politikëbërësve dhe komunitetit kërkimor në mënyrë që të krijojë një ambient efektiv politikëbërje dhe për të ndihmuar në procesin e integrimit. Ky libër përbën një nga rezultatet kryesore të projektit. Libri i është i përkushtuar në analizën e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural të vendeve të SEE-së në funksion të pranimit të tyre në BE.

Kjo është një punë unike në rajon, e cila është hartuar në bashkëpunim të ngushtë midis politikëbërësve dhe institucioneve kërkimore në vendet e SEE-së. Pritet që kjo punë të japë një kontribut të çmuar për hartimin e politikave, si dhe një bazë të fortë për bashkëpunim të ardhshëm dhe dialog dinamik të vazhdueshëm ndërmjet politikëbërësve dhe institucioneve kërkimore.

FAO dhe SWG shpresojnë që në të ardhmen do të bëhen përpjekje për të ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet konstruktive të krijuara midis politikëbërësve dhe institucioneve kërkimore për të zhvilluar një kulturë të politikëbërjes së mirë-informuar dhe të qëndrueshme.

Vladimir Rakhmanin

Assistent Drejtor i Përgjithshëm
Përfaqësues Rajonal për Evropën dhe Azinë Qëndrore

Boban Ilic

Sekretar i Përgjithshëm i SWG-së

FALËNDERIME

Ekipi përgjegjës i FAO-s dëshiron të falënderojë të gjithë pjesëmarrësit për punën intensive dhe bashkëpunuese gjatë projektit. Në veçanti, ne dëshirojmë të falënderojmë Boban Iliç, Sekretarin e Përgjithshëm të SWG-së dhe ekipin e Sekretariatit të SWG-së për ndihmën dhe bashkëpunimin e ngushtë në zbatimin e projektit.

Ekipi i FAO-s dëshiron të falënderojë në mënyrë të sinqertë Menaxheren e Projektit Rajonal, Irena Dzimrevska. Ne vlerësojmë ekspertizën dhe këshillat e paçmueshme të Komisionit Drejtues të Projektit, përkatësisht Emil Erjavec, Kaj Mortensen, Miro Rednak, Katerina Spasovskadhe Tina Volk.

Një falenderim i veçantë shkon për anëtarët e Ekipeve Lokale të Kërkimit dhe Bordeve Këshillimore Kombëtare, në mënyrë specifike për Sabahudin Bajramovic, Natalija Bogdanov, Aleksandar Bogunovic, Dragomir Devic, Dragi Dimitrievski, Grigor Gjeçi, Halit Hoxhaj, Milan Markoviç, Iliriana Miftari, Ornella Mikus, Jelena Prorok, Valentina Stojanovoc - Tufa, Irina Vukçeviç dhe Edvin Zhllima. I jemi mirënjohës gjithashtu Oliver Pop Arsov për aktivitetin mbështetës dhe organizativ.

LISTA E AKRONIMEVE

Shkurtesa	Përshkrimi
AB	Buxheti i Bujqësisë
AE	Agro-mjedisore
AL	Shqipëria
APM	Instrumenti për matjen e Politikave Bujqësore
ARDA	Agjensia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Shqipëri)
ARDP	Programipër Zhvillimin Bujqësor dhe Rural(Kosovë)
AWU	Njësi pune vjetore
BH	Bosnje dhe Hercegovina
BE	Bashkimi Evropian
CAP	Politikat e Përbashkëta Bujqësore
CBS	Byroja Kroate e Statistikave
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
CNCT	Nomenklatura e Kombinuar e Tarifave Doganore
CT	Tarifë doganore
EU CAP	Politikat e Përbashkëta Bujqësore të Bashkimit Evropian
EU-27	27 Vendet e Bashkimit Evropian
EUR	Monedha Evropiane
EUROSTAT	Zyra Statistikore e Komuniteteve Evropiane
FADN	Rrjeti i të Dhënave Kontabile të Fermave
FAFS	Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencës Ushqimore, Universiteti i Sarajevës.
FAO	Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit e Shteteve të Bashkuara
FbiH	Federata e Bosnje dheHercegovinës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GAO	Prodhimi Bujqësor Bruto
GoA	Qeveria Shqiptare
GVA	Vlera e Shtuar Bruto
HACCP	Analiza e riskut dhe pikat kritike të kontrollit
HNV	Vlera natyrore të larta
HR	Kroacia
I&R	Identifikimi dhe Regjistrimi
IACS	Sistemi i Administrimit dhe Kontrollit të Integruar
IHD	Investimet e Huaja Direkte

INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPA	Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit
IPARD	Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural
ISARD	Strategjia Ndër-sektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Shqipëri)
KAS	Agjensia Kosovare e Statistikave
KE	Këshilli Evropian
LAG	Grupet Lokale të Veprimit
LARD	Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillim Rural (Maqedoni)
LFA	Zonat më pak të favorizuara
LPIS	Sistemi i Identifikimi të Parcelave të Tokës
LSU	Njësi blegtorale
MADA	Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore
MAFRD	Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural (Kosovë)
MAFWE	Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave (Maqedoni)
MAFWM	Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave (Serbi)
MARD	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Mali i Zi)
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (Shqipëri)
MEI	Ministria e Integrimit Evropian (Kosovë)
ME	Mali i Zi
MIDAS	Zhvillimi Institucional dhe Forcimi i Bujqësisë së Malit të Zi
MK	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
MOFTER	Ministriae Tregtisë së Jashtme dhe Çështjeve Ekonomike (BiH)
MONSTAT	Zyra Statistikore e Malit të Zi
MSP	Mbështetja e çmimeve të tregut
MTE	Vlerësim afatmesëm
NARDS	Strategjia Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Maqedoni)
NP	Plani Kombëtar
NSDI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Shqipëri)
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OPEC	Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPS	Pariteti i fuqisë blerëse
RS	Serbia
SAA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

SEE	Evropa Juglindore
SESMARD	Mbështetje për Zbatimin e Rekomandimeve të Rishikuara në mënyrë Funksionale (BiH)
SO	Prodhimi standard
SORS	Zyra Statistikore e Republikës së Serbisë
SSO	Zyra Shtetërore e Statistikave (Maqedoni)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UAA	Sipërfaqe Bujqësore e Përdorur
UNDP	Programi Zhvillimor i Shteteve të Bashkuara
WTO	Organizata Botërore e Tregtisë
XK	Kosova

Pjesa A
ASPEKTET RAJONALE

Kapitulli A.I

OBJEKTIVAT DHE QASJA

Richard Eberlin[*], Katalin Ludvig[*], Irena Dzimrevska[**], Katerina Spasovska[**],Emil Erjavec[***]

Vendet e Evropës Juglindore (SEE)[1] kanë bërë progres të konsiderueshëm drejt stabilitetit, reformave ekonomike dhe integrimit evropian, i cili është një nga sfidat më thelbësore politike dhe ekonomike në rajon. Në Samitin e Zagrebit në Nëntor të vitit 2000, liderët e Bashkimit Evropian (BE) dhe vendet e SEE-së konfirmuan angazhimin e tyre të plotë për Procesin e Stabilizim dhe Asociimit (SAP), të udhëhequr nga BE-ja[2], si dhe anëtarësimin e plotë në BE. Vendet janë aktualisht të ndarë në tri grupe; Kroacia - është anëtare e BE-së që nga 1 korriku i vitit 2013; Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria – janë vende kandidate[3] për anëtarësim në BE; dhe Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova [4] - janë vende kandidate potenciale për anëtarësim në BE. Në këtë kontekst, përmbushja e kritereve të BE-së për anëtarësim është vendimtare.

1. Detyrat integruese dhe zhvilluese të politikës bujqësore

Vendet e SEE kanë identifikuar qartazi integrimin evropian si një prioritet politik, duke përcaktuar, ndër të tjera, reformat e politikave bujqësore dhe nevojën për modernizimin e bujqësisë. Procesi i pranimit përfshin jo vetëm rritjen e aftësisë konkurruese përgjatë të gjithë zinxhirëve agro-ushqimorë, por më gjerësisht, duke adoptuar një model mjaft të ndryshëm të politikës bujqësore, pra më kërkues në aspektin konceptual, administrativ dhe financiar. Bujqësia dhe politika bujqësore e SEE-së ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga strukturat dhe proceset e BE-së. Për këtë arsye reformat janë të nevojshme për ta orientuar atë me strukturatligjore dhe institucionale të BE-së dhe për të integruar sektorin bujqësor të vendit në tregun e përbashkët të BE-së në mënyrë më efikase. Aspektet e ndryshme të këtyre reformave dhe modernizimet e kërkuara janë reflektuar në një proces të plotë integrimi dhe negociatash:

i) ***Harmonizimi ligjor*** i katër rregullave kryesore të Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) (Pagesat direkte, Organizimi i tregjeve të përbashkëta, Zhvillimi rural, Rregullat

---

* Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara(FAO).

** Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SWG).

*** Universiteti i Ljubljanës, Fakulteti i Bioteknologjisë, Slloveni.

1 Evropa Juglindore (SEE) është njërajon gjeografik dhe politik që shtrihet kyesisht nëGadishullin e Ballkanit. Vendet e përfshira mund të ndryshojnë shumë për shkak të konsideratave të ekonomisë politike të vëzhguesve. Shtetet sovrane që janë përfshirë në këtë studim janë, Shqipëria, Bosnja & Herzegovina, Kroacia, Kosova*, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Ky nënrajon i SEE quhet gjithashtu Ballkani Perëndimor.

2 SAP është një strategji e lidhur dukshëm me perspektivën e anëtarësimit në BE dhe është përshtatur me nivelin e zhvillimit të secilit prej vendeve në fjalë. Në këmbim të ofrimit të perspektivës së aderimit dhe asistencës - për të arritur atë - vendet e rajonit kanë marrë përsipër përmbushjen e kërkesave politike dhe ekonomike të përcaktuara për të gjithë kandidatët (Kriteret e Kopenhagenit).

3 Këshilli Evropian i dha statusin e kandidatit Maqedonisë në Dhjetor 2005, Malit të Zi në Dhjetor 2010, Serbisë në Mars 2012 dhe Shqipërisë më 27 Qershor 2014.

4 Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozicioneve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe opinionin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Këtej e tutje referuar si " Kosovë".

financiare). Vendi duhet të jetë në gjendje të zbatojë këto rregullore në ditën e parë të anëtarësimit;megjithatë harmonizimi ligjor para aderimit nuk është i detyrueshëm.

ii) ***Përmirësimi i kapaciteteve zbatuese***. Institucionet përgjegjëse për harmonizimin ligjor dhe zbatimin e rregullave të EU CAP duhen të forcohen ose në disa raste duhen themeluar duke qenë se mungojnë. Zbatimi i mbështetjes para-aderimit për bujqësi dhe zhvillim rural IPARD shërben si një provë e kapacitetit zbatues të vendit.

iii) ***Reformat e politikave dhe rregullimet ekonomike***. Zinxhiri agro-ushqimor dhe ekonomitë rurale duhet të modernizohen dhe të përgatiten për një "ulje të butë", në kuadrin e CAP pas aderimit. Si rrjedhojë, objektiv kryesor duhet të jetë rritja e konkurrencës dhe ofrimi i alternativave për të gjeneruar të ardhura për banorët në zonat rurale. Për më tepër, para anëtarësimit janë të nevojshme reforma të rëndësishme të politikës bujqësore, në mënyrë që të përgatiten përfituesit e masave të PPB-së dhe administrata zbatuese për punën në kuadrin institucional dhe ekonomik të politikës bujqësore të BE-së.

iv) ***Negociatat e aderimit***. Përfshin një përmbledhje të çështjeve të mësipërme, si dhe negociatat mbi periudhat e tranzicionit ose, në disa raste të rralla, negociatat për përjashtime të përhershme nga kuadri ligjor i BE-së. Bujqësia është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e paketës financiare për secilin vend kandidat,e cila kërkon një punë intensive dhe përgatitje të vazhdueshme.

Një nga hapat më të mëdha është pranimi dhe zbatimi i dokumentit ligjor të BE-së (Acquis Communitaire) si për bujqësinë, zhvillimin rural edhe për çështje të tjera (si peshkimi, siguria ushqimore, etj.), fushatë cilat përfaqësojnë rreth 40 përqind të totalit të Acquis. Prandaj, sfida më e madhe në procesin e ardhshëm të negociatave është kapitulli 11 (Bujqësia dhe Zhvillimi Rural), Kapitulli 12 (Peshkimi), dhe Kapitulli 13 (Siguria Ushqimore). Për shkak të sfidave dhe interesave të përbashkëta, vendet në rajon janë duke kërkuar bashkëpunim më të ngushtë me njëri-tjetrin në nivele politike dhe teknike. Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SWG)[5] paraqitet si një kornizë e rëndësishme institucionale për bashkëpunim në fushën e politikës së zhvillimit bujqësor dhe rural.

Sektori i bujqësisë, edhe pse pesha e tij në ekonomi ka rënë që nga viti 2000, ende luan një rol relativisht të rëndësishëm në rajonin e SEE-së si për vlerën e shtuar edhe për punësimin. Duke qenë se bujqësia e mbijetesës mbizotëron ende në pjesën më të madhe të rajonit, ky sektor siguron një nivel minimal të sigurisë ushqimore dhe stabilitetit social-ekonomik në zonat rurale. Prandaj sektori ka një funksion të rëndësishëm si një zbutës social dhe ekonomik për ekonomitë rurale. Në anën tjetër, politikëbërësit po përballen me një numër sfidash, si për shembull konkurrenca e ulët në sektorin e bujqësisë, përdorimi i pamjaftueshëm i potencialeve të prodhimit bujqësor dhereduktimi i popullsisë në zonat rurale.

Krahas çështjeve të sipërpërmendura, integrimi evropian mbetet sfida kryesore në kuadër të kontributit që ofron në zgjidhjen e këtyre problemeve të zhvillimit. Niveli i përafrimit të politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural të vendeve të SEE-së me standardet e BE-së është i ndryshëm dhe varet nga statusi i vendeve në marrëdhënie me BE-në dhe vullneti i tyre për reformimin dhe modernizimin e politikës së brendshme. Shumica e vendeve të SEE-së tashmë kanë zbatuar disa instrumente të politikës së zhvillimit bujqësor dhe rural të CAP-like (Kroacia[6] si një vend anëtar që nga Korriku 2013 tashmë është duke zbatuar plotësisht CAP), ndërsa vendet e tjera janë duke

[5] SWG është organizata ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, anëtare të së cilës janë ministritë e bujqësisë nga vendet e Evropës Juglindore. Më shumë informacion gjeni në faqen e internetit të SWG:seerural.org

[6] Kroacia përfundoi negociatat për anëtarësim në 30 qershor 2011 dhe më 9 dhjetor 2011 nënshkroi traktatin. Procesi i ratifikimit nga parlamentet e të 27 shteteve anëtaretë BE-së është arritur në fund të qershorit 2013; kështu Kroacia u anëtarësua në BE në 1 korrik 2013.

finalizuar dhe diskutuar korniza të reja strategjike për forcimin e procesit të integrimit dhe futjen graduale të politikës CAP-like. Një nga avantazhet e kësaj situate të larmishme është se vendet të cilat janë më të avancuara në procesin e integrimit dhe harmonizimit në BE mund të ndajnë përvojën e tyre të vlefshme me të tjerët, në mënyrë që të krijojnë sinergji për përshpejtimin e procesit të integrimit dhe zhvillimit të zonave rurale në të gjithë rajonin.

2. Punë më e fortë analitike për një politikë bujqësore më të mirë

Përgjegjësia për zbatimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural i përket ministrive të bujqësisë të vendeve të SEE-së, ku shumë shpesh kapaciteti administrativ është i kufizuar, jo vetëm në lidhje me përvojën në trajtimin e procesit të harmonizimit të BE-së. Kjo situatë e vështirë është rënduar edhe më tej për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme dhe të shpejta në strukturën organizative të ministrive dhe ndryshimeve të shpeshta në burimet njerëzore.

Pavarësisht tendencës pozitive në mbështetjen buxhetore qeveritare për zhvillimin bujqësor dhe rural në rajon, këto fonde shpesh nuk përdoren në mënyrë efikase. Për më tepër, në disa vende nuk ka një strategji të qartë afatgjatë të zhvillimit rural. Politikëbërja ka qenë shpesh e diktuar nga konsiderata politike afatshkurtra të drejtuara nga grupet e lobimit ose përkatësitë politike; politikëbërjes i ka munguar një orientim i qëndrueshëm ndaj politikave të CAP në BE, dhe është në një masë të kufizuar, në përputhje me politikat e zhvillimit bujqësor dhe rural të BE-së.

Megjithatë duket qartë se vendimmarrësit politikë janë gjithnjë në kërkim për këshilla në ekonominë bujqësore dhe analizën e politikave mbi faktin se si të përballen me krizat e reja ekonomike dhe me strukturë sociale në zonat rurale të SEE-së. Problemet dhe kërkesat e reja për anëtarësim në BE dhe vështirësitë e ristrukturimit të bujqësisë kërkojnë gjurmim të ideve dhe koncepteve të reja për përballjen me pengesat në rritje të bujqësisë dhe zonave rurale. Rrjedhimisht, materiale të besueshme dhe të mbledhura sistematikisht mund të përmbushin hendekun e njohurive dhe të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të përmendura më lart, duke ofruar rekomandime të politikave.

Përveç kësaj, institucione akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, universitete dhe organizata zhvillimi kanë përpunuar për rajonin një gamë të gjerë analizash, raportesh dhe studimesh, duke përfshirë rekomandimet e politikave. Megjithatë, në shumë raste këto dokumente dhe njohuri nuk janë marrë parasysh gjatë hartimit të politikave.

Shumë ekonomistë bujqësorë dhe studiues të tjerë që punojnë në këtë fushë kanë vuajtur faktin se politikëbërësit janë skeptikë në lidhje me dobinë e studimit, që do të thotë se nuk ka marrëdhënie të qëndrueshme ndërmjet ministrive dhe studiuesve. Ky hendek kritik vjen edhe prejfaktit se shumica e akademikëve nuk kanë traditë dhe aftësi për të shkruar materiale analizuese operacionale të politikave, të cilat hartuesit e politikave mund t'ipërdorin për një politikëbërje të bazuar në fakte. Kjo ndodh edhe për shkak se studiuesit dhe politikëbërësit shpesh kanë pikëpamje dhe përceptime të ndryshme ndaj informacionit, fakteve dhe gjuhëve. Çështje të rëndësishme që ndikojnë në bashkëpunimin midis tyre përfshijnë mungesën e besimit dhe respektit të ndërsjellët, pikëpamje tëndryshme mbi përdorimin e rezultateve të studimit, i cili rezulton si mungesë edialogut, si dhe të kuptuarit e realitetit të ekonomisë politike.

Pra, ekziston një problem i përbashkët në rajon, pavarësisht nga statusi individual i aderimit të secilit vend: mungesa e dialogut midis hartuesve të politikave dhe studiuesve, nga njëra anë, dhe mungesa e një baze të dhënash të besueshme dhe të mirësistemuara, e cila të mbledhë të gjitha materialet me interes, të dhënat dhe analizat për qasjen dhe lehtësinë e përdorimit për politikëbërësit. Kjo situatë kontribuon në hendekun kritik që pengon integrimin në BE dhe kryerjen e politikave bujqësore moderne "bazuar në fakte".

3. Projekti i rrjetëzimit dhe kërkimi i FAO-s dhe SWG-së

Pavarësisht kësaj situate, të gjitha qeveritë e vendeve të pranuara të SEE-së janë angazhuar për përafrimin e politikave të tyre bujqësore me CAP, në mënyrë që të modernizojnë dhe përmirësojnë konkurrueshmërinë e sektorëve të tyre bujqësorë. Për këtë arsye, FAO dhe SWG bashkuan forcat përtë adresuar çështjet e mësipërme dhe për të formuluar dhe zbatuar bashkërisht projektin "*Riorganizimi i politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural të vendeve të SEE-së për anëtarësim në BE*"[7] që synojnë arritjen e një koordinimi më të ngushtë, dhe në afatin e gjatë, një marrëdhënieje më të qëndrueshme ndërmjet hartuesve të politikave dhe institucioneve kërkimore apo kërkuesve individualë që merren me analizën e politikave bujqësore dhe ndikimin e tyre në sektorin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural[8]. Për më tepër, projekti gjithashtu synon koordinimin më të ngushtë dhe shkëmbimin e pikëpamjeve midis vendeve të SEE-së, e cila është thelbësore për një vendimmarrje dhe administrim efektiv, dhe për një proces të përshpejtuar anëtarësimi.

Projekti ka ndihmuar në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e studimit të qëndrueshëm dhe profesional dhe shkëmbimin e pikëpamjeve mbi ekonominë dhe politikat bujqësore në kontekstin e procesit të integrimit në BE, veçanërisht rëndësinë e shkëmbimit të informacionit dhe përvojave midisnëpunësve të lartë civilë në ministritë e bujqësisë së vendeve të SEE-së dhe studiuesve duke krijuar një bashkëpunim aktiv në nivel kombëtar dhe rajonal. Projekti ka krijuar një marrëdhënie të qëndrueshme dhe ka dhënë mbështetjedhe rekomandime për hartimin e politikave. Kjo do të çojë përfundimisht në përmirësimin e formulimit të politikave, monitorimin më efikas, vlerësimin e ndikimit dhe planifikimin më të mirë të mbështetjes buxhetore të sektorit dhe në këtë mënyrë politika të riorganizuara të zhvillimit bujqësor dhe rural të vendeve të SEE-së për anëtarësimin në BE.

Aktorët kryesorë të projektit ishin ministritë e bujqësisë të vendeve pjesëmarrëse, në veçanti departamentet dhe njësitë që merren drejtpërdrejt me krijimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural, si dhe analizën e politikave përkatëse.

Grupi i dytë i aktorëve ishin institucionet akademike dhe kërkimore dhe universitetet në rajonin e SEE-së që kanë kapacitet analitik të ekonomisë bujqësore.

Grupi i tretë i aktorëve përbëhej nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë të tjerë që merren me çështjet e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural. Përfituesi indirekt duhet të jetë popullsia rurale në vendet pjesëmarrëse, veçanërisht përfituesit e masave të zhvillimit bujqësor dhe rural të cilat përftohen si rezultat i përmirësimit të politikëbërjes.

Zbatimi i projektit ka pasur tri elemente kryesore: a) nxitja e bashkëpunimit midis politikëbërësve dhe studiuesve në fushën e politikës bujqësore, b) krijimi i një baze të dhënash të politikës bujqësore me sistemimin dhe klasifikimin e transfertave buxhetore të harmonizuara, dhe c) analizën e henqeve duke rekomanduar veprime të politikave për të kapërcyer sfidat. Çështjet kryesore të analizuara në vend dhe në rajon, ishin: 1) karakteristikat kryesore dhe sfidat e zhvillimit bujqësor, 2) tiparet kryesore të politikës bujqësore, dhe 3) mangësitë kryesore në fushën e politikave dhe hartimin e procesit të integrimit evropian.

Qasja kryesore e përdorur ishte duke nxitur partneritete ndërmjet akademikëve dhe stafit të ministrisë nëpërmjet seminareve dhe shpërndarjes së raporteve analitike kombëtare dhe rajonale.

---

[7] TCP/RER/3403; Fillimi Shtator 2012 dhepërfundimi Tetor 2014.

[8] Në takimin e 5-të të Ministrave të Bujqësisë nga Evropa Juglindore (mbajtur në Republikën e Maqedonisë më 11 Nëntor 2011), ministrat dhe kryetarët e delegacioneve të Ministrive të Bujqësisë të vendeve anëtare dhe vëzhguese të SWG-së arritën në përfundimin se ata "mirëpresin dhe janë të angazhuar për të mbështetur një bashkëpunim të fortë dhe produktiv në të gjitha fushat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, duke përfshirë bashkëpunimin midis universiteteve, institucioneve akademike dhe të fakulteteve të bujqësisë nga Evropa Juglindore me qëllim rritjen e kapacitetit për të analizuar në mënyrë objektive sfidat e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe performancëne politikave."

Kjo është bërë përmes analizave dhe krahasimit të statistikave bujqësore, duke përfshirë përgatitjen dhe kontrollin e grupeve të të dhënave, dhe një analizë krahasuese duke përdorur të dhënat në dispozicion nga vendet e SEE-së dhe 27 vendeve anëtare të BE-së. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit u zhvillua dhe implementua një fushatë ndërtimi kontaktesh dhe rrugësh bashkëpunimi. Fushata synoi aktorët kryesorë dhe përfituesit e drejtpërdrejtë të vendeve pjesëmarrëse (institucionet publike dhe akademike, shoqërinë civile dhe publikun në tërësi).

Qëllimi i projektit nuk ishte vetëm për të mbledhur dokumente gjerësisht të publikuara, por edhe për të marrë literaturë jozyrtare dhe materiale pune. Prandaj, fushata e krijimit të kontakteve dhe rrugëve të bashkëpunimit është fokusuar në përhapjen e qëllimeve të projektit dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e mbledhjes së një informacioni dhe të dhënave sa më të plota, përpjekje kjo e kryer edhe me ndihmën e të huajve (grupet e interesit, të cilët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit).

Për këtë qëllim portali "Agricultural Policy Plus"[9], i lidhur me faqen e internetit të SWG-së[10], është projektuar për të lehtësuar bashkëpunimin. Të gjitha palët e interesuara mund të ngarkojnë dokumentet dhe informacionin në faqen përkatëse të internetit. Kjo solli në një burim vazhdimisht në rritje të informacionit, i cili më pas është përpunuar dhe përcaktuar si i përshtatshëm për shqyrtim të mëtejshëm.

Disa seminare ishin të kombinuara me Forumin Vjetor të Politikave Bujqësore[11] dhe Takimin Vjetor Punues të Ministrave të Bujqësisë nga Evropa Juglindore[12], dhe takime të tjera të SWG-së. Kjo ofroi një platformë të shkëlqyer për shpërndarjen e rezultateve të projektit dhe mësimet e nxjerra dhe rritjen në mënyrën më efikase të ndërgjegjësimit të aktorëve dhe audiencës së gjerë.

4. Orientimi bazë dhe përmbajtja e studimit

Ky studim përmbledh rezultatet kryesore të projektit të sipërpërmendur FAO/SWG, me theks të veçantë në:

1. Prezantimin e gjendjes dhe tendencave të bujqësisë dhe politikës bujqësore në vendet e Evropës Juglindore, sidomos në krahasim me BE-në;
2. Përpjekjen për të identifikuar hendeqet kombëtare dhe rajonale në politika, duke u fokusuar në modernizimin dhe harmonizimin e politikave bujqësore me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së;
3. Përcaktimin e parimeve kyçe të politikës bujqësore të cilat do të mbështesin procesin e integrimit evropian të vendeve të Evropës Juglindore (një koncept rajonal dhe udhërrëfyes drejt reformave dhe korrigjimeve politike);
4. Identifikimin e çështjeve kryesore dhe sfidat që kërkojnë ndërhyrjet politike mbi bazën e kësaj analize.

Autorët e këtij studimi synuan veçanërisht në arritjen e pikave të mëposhtme:

[9] www.app.seerural.org
[10] www.seerural.org
[11] Forumi i Politikave Bujqësore synon mbështetjen e procesit të zbatimit të politikave bujqësore dhe rurale BE-like në vendet e SEE-së, duke u fokusuar veçanërisht në integrimin dhe harmonizimin e sektorit bujqësor dhe rural me BE-në. Qëllimi i Forumit është edhe nxitja e bashkëpunimit në çështjet e zhvillimit të bujqësisë midis vendeve të SEE-së dhe të mbështesë kërkime mbi çështjet e bujqësisë dhe të zhvillimit rural në drejtim të përmirësimit të bazës së informacionit për vendimmarrje politike. Përfaqësues nga Ministritë e Bujqësisë të vendeve të SEE-së, Komisioni Evropian, organizatat e ndryshme ndërkombëtare (të tilla si FAO, GIZ, CEI, JRC, IPTS, RCC) zakonisht marrin pjesë në këtë event.
[12] Qëllimet e këtij takimi janë të sigurojnë bashkëpunim konstruktiv dhe të përhershëm midis ministrive të Bujqësisë në nivel politik brenda fushave të përgjegjësive të tyre në proceset në vazhdën e integrimit në BE.

5. Theksimin e nevojës për analiza të qenësishme, të plota dhe sistematike të politikave bujqësore dhe bashkëpunim efikas midis vendimmarrësve dhe akademikëve;
6. Ndihmë në mbështetjen e vendimmarrjes duke ofruar analiza dhe parime themelore për reformatdhe korrigjimet në politikat bujqësore.

Studimi është i ndarë në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë (A) janë paraqitur analiza dhe përfundime që prekin fusha të ndryshme. Pas prezantimit vjen Kapitullin A.II *"Analiza krahasuese e bujqësisë dhe politikës bujqësore në vendet e Evropës Juglindore, në krahasim me Bashkimin Evropian"*, - i cili ofron sfondin metodologjik dhe disa nga tiparet e spikatura të rajonit të Evropës Juglindore. Kapitulli A.III *"Analiza e hendeqeve dhe rekomandimet e politikave",* ofron analiza krahasuese të hendekut të politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural krahasuar me CAP, midis vendeve apo rajoneve specifike, duke përdorur dokumentet përkatëse të politikave të mbledhura dhe të vëna në dispozicion në kuadër të projektit (shikoni faqen e internetit të APP-së). Një nga mjetet kryesore që përdoret në këtë proces është Instrumenti i Matjes së Politikave Bujqësore, i cili u zhvillua në kuadër të projektit kërkimor të BE-së që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe politikën bujqësore në Evropën Qendrore dhe Lindore (projekt FP7 me shkurtesën Agri-policy).

Pjesa e dytë (B) është një paraqitje e kapitujve të veçantë në nivel vendi, duke ofruar tendencat kryesore dhe analizat e situatës për bujqësinë dhe kryesisht të fokusuara në prezantimin e zhvillimit të politikave bujqësore e transfertave buxhetore, të cilat çojnë edhe në disa përfundime në lidhje me sfidat kryesore për politikëbërësit në nivel kombëtar (Kapitujt BI-B.VII).

Kapitulli A.II

ANALIZA NDËRVENDORE E BUJQËSISË DHE POLITIKËS BUJQËSORE NË VENDET E EVROPËS JUGLINDORE NË KRAHASIM ME BASHKIMIN EVROPIAN

Tina Volk[*], Miroslav Rednak[*], Emil Erjavec[**]

1. Hyrje

Bujqësia në vendet e Evropës Juglindore (SEE) është shumë e larmishme në aspektin e kushteve natyrore dhe strukturore, gjendjes së zhvillimit dhe potencialeve të shumta të prodhimit. Sektori mbart komponentë të spikatur historikë dhe socialë, si dhe rëndësi të madhe ekonomike për zhvillimin rural. Në këto vende ka mangësi të dukshme strukturore dhe teknologjike. Një faktor tjetër i rëndësishëm është rënia e popullsisë në zonat rurale, e cila ka përparuar me hapa alarmante, veçanërisht në pjesën qendrore të rajonit.

Të dhëna të mira statistikore janë baza e një vështrimi të përgjithshëm dhe analitik të bujqësisë.Të dhënat nga vendet individuale ndryshojnë shumë në qëllimin dhe cilësinë e tyre. Me përjashtim të Kroacisë, e cila tashmë është një anëtare e BE-së, asnjë vend i Evropës Juglindore nuk ka harmonizuar plotësisht me standardet e BE-së statistikat e veta bujqësore. Prandaj, krahasimet e drejtpërdrejta të të dhënave dhe treguesve midis vendeve janë shpesh të diskutueshme.

Politika bujqësore evendeve të rajonit, në konceptin e saj, u analizua për herë të parë në një kontekst rajonal disa vite më parë (Volk, 2010). Rezultatet paralajmëruan një mungesë të burimeve, e ndryshim të shpejtë të drejtimeve, politikë në kundërshtim me atë të BE-së, por mbi të gjitha, vështirësi në mbledhjen e të dhënave si pasojë e transparencës së dobët në zbatimin e politikave bujqësore në rajon. A ka ndryshuar situata që nga ajo periudhë? Si kanë ndikuar në procesin e projektimit dhe zbatimit të politikave bujqësore krizat ekonomike dhe vendimi i vendeve për të hyrë në BE?

Ky kapitull i është dedikuar kryesisht prezantimit të treguesve kryesorë bujqësorë që janë të rëndësishëm për monitorimin dhe analizat e politikave bujqësore. Këta tregues janë gjithashtu të krahasuar në nivelet rajonale dhe të BE-së me anë të analizës krahasuese me qëllim të identifikimit të karakteristikave, ndryshimeve dhe hendeqeve kryesore që kërkojnë ndërhyrjen publike. Edhe pse databaza e varfër publike në rajon kufizon shtrirjen e mundshme të analizave të tilla, ato gjithsesi janë të dobishme në diskutimin e orientimit të politikave bujqësore dhe aftësinë e bujqësisë për integrimin ekonomik në BE.

Analiza ndër-vendore bazohet në kuptimin e bujqësisë dhe politikës bujqësore në vendet e SEE-së siç paraqitet në pjesën e dytë të studimit (Kapitulli B.I - B.VII) dhe është zgjeruar me disa analiza të tjera shtesë, duke pasur parasysh kufizimet e imponuara nga disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave. Vëmendje e veçantë iu kushtua politikës bujqësore në vendet e SEE-së në krahasim me

[*] Instituti Bujqësor i Sllovenisë, Ljubljana, Departamenti i Ekonomisë Bujqësore.
[**] Universiteti i Ljubljanës, Fakulteti Bioteknik, Slloveni.

politikat bujqësore të BE-së gjatë periudhës së programimit dhe të disa anëtarëve prej raundit të fundit të zgjerimit të BE-së deri para çastit të anëtarësimit.

Analiza sasiore e politikës bujqësore është kryer duke përdorur një model të përmirësuar APM (Rednak dhe Volk, 2010, Rednak et al., 2013). APM (Instrumenti për Matjen e Politikave Bujqësore) është klasifikimi i njëtrajtshëm i mbështetjes buxhetore bujqësore e cila mundëson një përcaktim të mirë sasior dhe krahasim të synimit dhe strukturës së matjeve të politikës bujqësore midis vendeve të SEE-së me BE-në. Qëllimi kryesor i këtij instrumenti është t'i përgjigjet pyetjeve në lidhje me orientimin themelor të politikës bujqësore në vendet e SEE-së, të masave kryesore dhe format e tyre të implementimit, në mënyrë që të bëjë të mundur diskutimin rreth mangësive të politikave bujqësore (në kapitullin A.III), si dhe rekomandimet për përmirësime efektive dhe plotësimin e kërkesave të BE-së.

Kapitulli fillon me prezantimin e burimeve të të dhënave dhe metodologjisë, duke përshkruar qasjet dhe kufizimet kryesore. Pjesa kryesore përqendrohet në analizën krahasuese të bujqësisë dhe politikës bujqësore brenda rajonit dhe me BE-në. Kapitulli mbyllet me një përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe diskutim mbi rëndësinë e disponueshmërisë dhe cilësisë së të dhënave për analizim të politikave.

2. Metodologjia

Pasqyra krahasuese e situatës së bujqësisë midis vendeve në Shqipëri, Bosnje & Hercegovinë, Kroaci, Kosovë*[13], Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi është e bazuar në të dhënat statistikore të mbledhura nga ekspertët kombëtarë (dhe përdoren edhe në raportet e vendeve të paraqitura në pjesën e dytë e librit)[14]. Burimet kryesore të të dhënave ishin shtetërore (ose nën-kombëtare), zyra statistikore dhe institucionet e tjera që kanë të bëjnë me statistikat bujqësore në këto vende. Në këtë kuadër, vetëm disa statistika kryesore të përgjithshme bujqësore dhe tregtare u mblodhën përperiudhën 2005-2012 (Statistikat e SEE-së, 2014). Në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore jo të gjitha grupet standarde të të dhënave mbi bujqësinë janë të disponueshme (struktura e fermës, prodhimi bujqësor, çmimet, llogaritë ekonomike). Metodologjitë statistikore ende ndryshojnë sipas vendeve dhe shumica nuk janë të theksuara ende me rregullat dhe përkufizimet e Eurostat. Prandaj, kriteri kryesor për zgjedhjen e treguesve krahasues të përdorur në analizë ishte se për këto tregues egzistojnë të dhëna për të gjithë ose shumicën e vendeve të SEE-së dhe se këta tregues ofrojnë të paktën krahasueshmërinë minimale ndërmjet vendeve të SEE-sëme të dhënat e BE-së. Për BE-në u përdorën të dhënat nga bazat e të dhënave të publikuara nga Eurostat (EUROSTAT, 2014).

Meqenëse bazat e të dhënave janë më së shumti të paplota dhe besueshmëria dhe krahasueshmëria e të dhënave mbetet në diskutim, treguesit e zgjedhur mbulojnë vetëm disa statistika bazë me qëllim për të paraqitur të paktën profilin kryesor të bujqësisë në vendet e SEE-së.

Për të kryer analizën sasiore të mbështetjes buxhetore për bujqësinë, ekspertët kombëtarë përpiluan për të gjithë vendet e SEE-së bazat e të dhënave të masave të politikës bujqësore (APM) (Databaza APM e SEE-së, 2013). Në këto baza të dhënash është mbledhur në nivelin më të detajuar të mundshëm i gjithë informacioni në dispozicion në lidhje me masat e politikës bujqësore, së bashku me transfertat buxhetore të ekzekutuara në një vit të caktuar. Për Malin e Zi, databaza APM-së përmban fonde të planifikuara në vend të pagesave të kryera realisht (mungojnë të dhënat për fondet e paguara). Analiza mbulon kryesisht periudhën 2008-2012, edhe pse për disa vende të SEE-së bazat e të dhënave për APM-në u hartuan për një periudhë më të gjatë kohore.

---

[13] Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozicioneve mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe opinionin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

[14] Shikoni më shumë në kapitujt B.I-B.VII.

Në bazat e të dhënave për APM-në masat e politikës bujqësore janë të sistemuara dhe klasifikohen sipas një formati të përbashkët (uniform), i cili mundëson analiza cilësore dhe sasiore të politikave bujqësore të zbatuara midis vendeve. Klasifikimi përdor si një pikë themelore fillestare konceptin aktual të BE-së bazuar në shtyllat e politikës bujqësore, e kombinuar kjo me klasifikimin e OECD-së. Koncepti i programit të BE-së (shtyllat, boshtet) është zbatuar në nivele më të larta të agregimit të masave, ndërsa kriteret e OECD-së për formimin e grupeve ose nëngrupeve sipas shtyllave individuale dhe në veçanti për përcaktimin e nivelit më të ulët të klasifikimit (titujt kryesorë). Kështu, APM lejon një analizë themelore të transfertave buxhetore për bujqësinë edhe sipas klasifikimit OECD PSE dhe anasjelltas.

Klasifikimi APM është ndërtuar mbi një parim hierarkik ku niveli i parë përcakton shtyllën e politikës bujqësore, niveli i dytë përcakton kategorinë, dhe çdo nivel pasues përcakton një nën-kategori të një niveli të mëparshëm. Një sistem hierarkik lejon një analizë në nivele të ndryshme saktësie. Në këtë dokument, të dhënat janë analizuar deri në tre nivele dhe në disa raste deri në nivelin e katërt të klasifikimit. Nomenklatura e klasifikimit deri në nivelin e katërt tregohet në Tabelën A.II-1

Sipas klasifikimit APM, të gjitha matjet e politikës bujqësore janë të grupuara në tre shtylla kryesore: (i) masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesit; (ii) masat e zhvillimit strukturor dhe rural dhe (iii) masa të përgjithshme në lidhje me bujqësinë. Përveç këtyre tri shtyllave, klasifikimi gjithashtu përfshin seksionin *Transferta të ndryshme në bujqësi*. Disa grupe të tjera të ngjashme "të të ndryshmeve" ekzistojnë gjithashtu në nivele më të ulëta të klasifikimit për artikujt për të cilët nuk ka në dispozicion informacion të mjaftueshëm për t'i ndarë ato në kategoritë përkatëse.

Shtylla e parë e APM-së –***Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesit*** – përfshin vetëm ato masa të cilat ndikojnë të ardhurat e prodhuesve bujqësorë dhe përgjithësisht nuk janë të lidhura me kufizime specifike për sa i përket teknikave të prodhimit dhe vendndodhjes së fermës. Në nivelin pasues, masat e shtyllës së parë ndahen më tej në dy grupe të tjera: *masat e mbështetjes së tregut* dhe *masat e mbështetjes direkte të prodhuesve*.

Shpenzimet buxhetore për *masat e mbështetjes së tregut* përfshijnë masat me të cilat politikat influencojnë ofertën dhe kërkesën në tregun vendas dhe kështu në mënyrë indirekte edhe çmimet e produkteve. Shpenzimet buxhetore në lidhje me këto masa ndahen në tre grupe,përkatësisht:*subvencionet e eksportit*, *ndërhyrjet në treg* dhe *mbështetja e konsumatorit.*

Masat e mbështetjes direkte të prodhuesit ndahen më tej në dy grupe të mëdha. Grupi i parë– *Pagesat direkte dhe subvencionet për inputet variable* – përmban të gjitha format e *pagesave të rregullta direkte të prodhuesit*, të cilat ndahen akoma më tej sipas kriterit të zbatimit (mbi prodhimin, sipërfaqe/krerë bagëti aktuale, kriteri fiks, kritere të tjera) dhe *subvencionet për inputet variable*, të cilat ndahen më tej bazuar në dy lloje inputesh (farëra, karburante, plehra, sigurime, etj.) Grupi i dytë - *Pagesat për fatkeqësitë dhe kompensime të tjera për prodhuesit* –përfshijnë pagesa për të cilat prodhuesit kanë të drejtë të aplikojnë vetëm në raste të ndodhisë në rrethana të caktuara. Këto janë pagesa të jashtëzakonshme dhe jepen kryesisht pas ndodhisë së specifikuar, ndërsa grupi i parë i masave planifikohet paraprakisht dhe jepet rregullisht.

Shtylla e dytë e APM –***Masat e zhvillimit strukturor dhe rural*** – është e strukturuar në tre grupe kryesore: *Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor*, *Përmirësimi i mjedisit dhe zonave rurale, dhe Mbështetja e ekonomisë dhe popullsisë rurale*. Grupet ndjekin pak a shumë strukturën e sistemit të politikës së zhvillimit rural 2007-2013.

Grupi i parë – *Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor* – ndahet në tre nën-grupe masash në hapin e parë, me kriterin kyesor të ndarjes të cilat përcaktojnë ata që synohet të mbështeten. Nën-grupi *Mbështetje e ristrukturimit në ferma* bashkon masat përfituese të të cilave janë ndërmarrje bujqësore individuale. Grupi *Mbështetje për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor* i

referohet sektorit bujqësor në një kuptim më të gjerë, ndërsa grupi i tretë përmban masat që mbështesin ristrukturimin e sektorit pyjor në lidhje me zhvillimin rural.

Grupi i dytë përfshin masat që synojnë *përmirësimin e mjedisit dhe natyr*ës. Nën-grupi i parë i këtij boshti - *Pagesa me objektiva mjedisore dhe peisazhi për prodhuesit*- është i përbërë nga pagesa dhënë për prodhuesit bujqësorë për të kompensuar kostot e larta ose të ardhurat e ulëta për shkak të kushteve më pak të favorshme natyrore për prodhimin bujqësor (nën-grupi *pagesa për fermerët në zonat me probleme natyrore*), për shkak të kufizimeve mjedisore (nën-grupi *pagesa për fermerët në zonat e mbrojtura*) dhe për shkak të një angazhimi vullnetar agro-mjedisor që shkon përtej standardeve të detyrueshme (nën-grupi *pagesa për agro-mjedisin dhe mirëqenien e kafshëve për fermerët*). Grupi i dytë i këtij boshti - pagesat mjedisore të palidhura në mënyrë direkte me bujqësinë - përfshin pagesat me objektiva mjedisore të cilat nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me prodhuesit bujqësor, të tilla si pagesat mjedisore të pylltarisë.

Boshti i tretë përfshin masa që *mbështesin ekonominë dhe popullsinë rurale*. Ky bosht është i përbërë nga tre grupe, nga të cilët i pari - *Mbështetje për popullsinë rurale lidhur direkt me fermat* - përfshin masa të tilla si mbështetje për diversifikimin e aktiviteteve jo-bujqësore në fermë. Grupi i dytë - *Mbështetje e përgjithshme për ekonominë dhe popullsinë rurale* - përfshin masa të tilla si krijimi i biznesit, infrastrukturës dhe shërbimeve rurale, rinovimin e fshatrave dhe masa të ngjashme, dhe grupi i tretë - *Ndërtimi i kapaciteteve lokale (LEADER)* përmes aftësive të blerjes, animacioneve, përgatitjes dhe zbatimit të strategjive të zhvillimit lokal.

Tabela A.II-1: Klasifikimi APMi mbështetjes buxhetore për bujqësinë

MASAT E MBËSHTETJES SË TREGUT DHE MBËSHTETJES DIREKTE PËR PRODHUESIT
Masat e mbështetjes së tregut (Subvencione për eksportet; Ndërhyrjet në treg; Kostot operacionale të pasurive publike; Mbështetja e konsumatorit; të tjera)
Masa e mbështetjes direkte për prodhuesit
Pagesat direkte dhe subvencionet për inuptet variable
Pagesat direkte për prodhuesit (Bazuar në: prodhimin; sipërfaqen aktuale/kafshët; ndarja e kritereve fikse; të tjera Subvencione për inpute variable(farëradhe fidane; mbarështimi i kafshëve; karburante; plehra dhe pesticide; interesa; sigurime; shërbime në fermë; të tjera)
Pagesat e fatkeqësive dhe kompensime të tjera për prodhuesit (bazuar në: prodhim; sipërfaqe/krerë; për shterimin e burimeve; për blerje inputesh; të tjera)
Të ndryshme–mbështetje direkte e prodhuesit
MASA TË ZHVILLIMIT STRUKTUROR DHE RURAL
Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor
Mbështetje e ristrukturimeve në fermë
Mbështetje e investimeve në fermë (të përgjithshme; kulturat e përhershme për hektar; përmirësimi i tokës; ujitje; konsolidimi i tokës; të tjera)
Mbështetje të tjera ristrukturimi në fermë (Nxitja e fermerëve të rinj; përshtatje me standardet e kërkuara; pjesmarrja e fermerëve në skemat e cilësisë ushqimore; të tjera)
Mbështejta e ristrukturimit Agro-ushqimor
Mbështetje e përgjithshme për sektorin bujqësor (përmirësimi i infrastrukturës lidhur me bujqësinë; pensioni i parakohshëm; të tjera)
Mbështetje për përpunimin, marketingun dhe promovimin e e ushqimit; marketingu; grupet e prodhimit; të tjera)
Mbështetje për pyjet
Të ndryshme (konkurrueshmëria)
Përmirësimi i mjedisit dhe zonave rurale
Pagesa me objektiva mjedisore dhe peisazhi për prodhuesit
Pagesa për fermerët në Zonat mëPak të Favorizuara -LFA (bazuar në; prodhim; në sipërfaqe; krerë; të tjera)
Pagesa për fermerët në Zonat e Mbrojtura -PA (bazuar në; prodhim; në sipërfaqe; krerë të tjera)
Pagesa për agro-mjedisin dhe mirëqenien e kafshëve për fermerët -AE (bazuar në: prodhim; sipërfaqe/krerë; kritere të tjera; kriteri jo të bazuara në mallra; pyllëzimi iparë)
Pagesa mjedisore ta palidhura direkt me bujqësinë
Mbështetja e ekonomisë dhe popullsisë rurale
Mbështetja e popullsisë rurale e lidhur direkt me bujqësinë (mbështetje për diversifikimin e aktivitete jo-bujqësore në

		fermë; *të tjera*)
		Mbështetje e përgjithshme për ekonominë dhe popullsinë rurale (krijimi dhe zhvillimi i biznesit ; infrastruktura rurale dhe zhvillimi i fshatrave; *të tjera*)
		Ndërtimi i kapaciteteve lokale (LEADER)
	Masa të ndryshme për zhvillimin rural	
MASA TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE MË BUJQËSINË		
	Kërkim, zhvillim, shërbime këshillimore dhe ekspertësh (kërkim dhe zhvillim; ekstension; infrastrukturë lidhur me arsimin profesional; shërbimet e ekspertëve)	
	Siguria ushqimore dhe kontrolli i cilësisë(kontrolli veterinar; kontrolli i shëndetit të bimevë; kontrolli i cilësisë)	
	Masa të tjera të përgjithshme (fermerë dhe organizata të tjera jo-fitimprurëse; sisteme informacioni; asistencë teknike; *të tjera*)	
MASA TË NDRYSHME TË POLITIKËS BUJQËSORE		

Shtylla e tretë APM - ***Masa të përgjithshme në lidhje me bujqësinë*** - përfshin masa të cilat kanë për qëllim mbështetjen e shërbimeve publike që lidhen me bujqësinë, të tilla *si kërkimi, zhvillimi, shërbime këshillimore dhe ekspertize, sigurinë ushqimore dhe të kontrollit të cilësisë* (masat veterinare dhe fitosanitare, politika e cilësisë, etj.) dhe masa të tjera të përgjithshme mbështetëse të parashikuara në bujqësinë kolektive.[15]

Për të mundësuar krahasimin e politikave bujqësore të SEE-së me vendet e BE-së baza e të dhënave APM u krijua për BE-në dhe për disa shtete të reja anëtare. Të dhënat për BE-në u morën kryesisht nga baza e të dhënave OECD PSE/CSE (2014), i cili është i vetmi burim i rregullt të dhënash në dispozicion të publikut, ku mund të gjendet pak a shumë informacioni i plotë i mbështetjes buxhetore për bujqësinë e BE-së; kryesisht të dhëna për fondet e dhëna nga buxheti i BE-së (të dhënat e Komisionit Evropian), i cili është në dispozicion të publikut sistematikisht, si një rregull që i referohet vetëm masave të politikës sipas Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) dhe fondet e dh*ëna* nga buxheti i Komunitetit. Në këto baza të dhënash nuk janë përfshirë fondet për masat e politikës së bashkë-financimit nga buxhetet kombëtare (dhe nën-kombëtare), si dhe financimin e masave tërësisht nga buxhetet kombëtare (ndihma shtetërore). Baza e të dhënave OECD PSE/CSE përmban të dhëna vetëm për nivelin e BE-së. Përveç kësaj, për Republikën eÇekisë, Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë, Estoninë dhe Slloveninë, të cilat gjithashtu janë anëtare të OECD-së, janë në dispozicion të dhëna të plota për periudhën para vitit 2004, vit ky kur këto vende u anëtarësuan në BE.

Sipas metodologjisë së OECD PSE/CSE, shumica, por jo të gjitha masat e politikës bujqësore të cilat janë zbatuar në BE, konsiderohen si mbështetje për bujqësinë. Në bazën e të dhënave të OECD-së nuk janë të përfshira disa masa të zhvillimit rural që kanë fillesë nga periudha e programimit 2007-2013, të tilla si: mbështetja në lidhje me pylltarinë (përmirësimin e vlerës ekonomike të pyjeve, grup pagesat mjedisore në lidhje me pyjet), ekonomia dhe popullsia rurale (krijimin dhe zhvillimi i biznesit, nxitja e aktiviteteve turistike, shërbimet themelore për ekonominë dhe popullsinë rurale; rinovimi dhe zhvillimi i fshatit, ruajtja dhe përmirësimi i trashëgimisë rurale), ndërtimi i kapaciteteve lokale (Leader) dhe asistenca teknike. Fondet buxhetore për këto masa janë shtuar në bazën e të dhënave EU APM, duke përdorur të dhënat e disponueshme të Komisionit në kuadër të raporteve vjetore të monitorimit të zhvillimit rural (KE, 2014) të plotësuara nga fondet që përfaqësojnë bashkë-financimin kombëtar të masave individuale (pjesë të ndryshme sipas masës dhe Shtetit Anëtar) .

Sipas kritereve të OECD-së, mbështetja për bujqësinë në formën e subvencioneve të eksportit ndikon çmimet e tregut të marra nga prodhuesit, duke krijuar një hendek të çmimeve që është kapur nga mbështetja e çmimeve të tregut (MSP), dhe nuk shfaqen midis transfertave buxhetore në bujqësi. Për sa kohë ne nuk ishim në gjendje për të marrë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme nga subvencionet e eksportit për BE-në, si dhe për shtetet anëtare të përzgjedhura

[15] Për më shumë informacion metodologjik rreth instrumentit APM shikoni Rednak et al. (2013).

për të gjitha vitet e përdorura për krahasim me SEE-në, për këtë krahasim subvencionet e eksportit u përjashtuan nga databaza APM e vendeve të SEE-së.

Për krahasimin e mbështetjes buxhetore për bujqësinë midis vendeve të SEE-së dhe BE-së, u zgjodhën vitet 1999 dhe 2012. Të dhënat për vitin 1999 tregojnë politikën bujqësore në BE dhe vendet e reja anëtare të zgjedhura pesë vjet para anëtarësimit dhe të dhënat për vitin 2012 tregojnë politikën bujqësore të BE-së në periudhën e zbatimit të programit.

Niveli dhe përbërja e mbështetjes buxhetore për bujqësinë në vendet e SEE-së dhe BE janë krahasuar duke përdorur tregues të përafërt.Treguesi i përafërt bazë që përdoret për krahasim është vlera absolute e mbështetjes buxhetore për bujqësinë në euro (në total dhe sipas grupeve të masave), pjesëtuar me totalin e sipërfaqes bujqësore të shfrytëzuar. Ky tregues ofron një pasqyrë fillestare të rëndësishme për sa i përket disponueshmërisë së fondeve buxhetore për bujqësinë në një vend dhe është tregues i kapacitetit të politikës bujqësore për të ndikuar në zhvillimin e bujqësisë. Megjithatë, ky tregues mund të jetë problematik për shkak të përbërjes së ndryshme të përdorimit të tokës (pjesë më e ulët ose më e lartë e kullotave ekstensive në strukturën e përdorimit të tokës, tregues për potencialin e prodhimit). Një tjetër vështirësi në përdorimin e sipërfaqes bujqësore për të llogaritur treguesit për përcaktimin e niveleve të mbështetjes është se të dhënat për tokën bujqësore nuk janë të harmonizuara metodologjikisht ndërmjet vendeve të SEE-së dhe me BE-në. Të dhëna plotësisht të krahasueshme për sipërfaqen bujqësore të përdorur dhe mbështetjen e çmimeve të tregut janë të disponueshme vetëm për Kroacinë, Serbinë dhe Malin e Zi (bazuar në anketën e strukturës së fermave, si në EU-27), ndërsa për Shqipërinë, Bosnje & Hercegovinën, Kosovën* dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, sipërfaqja bujqësore është një përafrim bazuar në të dhënat në dispozicion nga statistikat e rregullta vjetore të përdorimit të tokës (shikonipërshkrimin në nënkapitullin e mëposhtmëm A.II.3). Megjithatë, këto përafrime me shumë mundësi janë të mbivlerësuara, duke çuar në nënvlerësim të treguesit të nivelit të mbështetjes për hektar.

Në çdo rast, llogaritjet e niveleve të përafërta të mbështetjes duhet të bëhen me kujdes. Roli i mbështetjes në bujqësi më shumë mundësi do të ilustrohej më mirë duke krahasuar shumën e mbështetjes me vlerën totale të prodhimit bujqësor, por për fat të keq, ne nuk ishim në gjendje të merrnim të dhëna të besueshme për të gjitha vendet.

3. Bujqësia në krahasim - përmbledhje e karakteristikave kryesore

3.1 Bujqësia në ekonomi

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në ekonomitë kombëtare të të gjitha vendeve të SEE-së. Në vitin 2012, përpjesa e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit në vlerën e shtuar kombëtare bruto (GVA) varionte nga 5 përqind për Kroacinë në 21.3 përqind për Shqipërinë, e cila është shumë më e lartë se mesatarja e EU-27 (1.7 përqind). Vetëm Kroacia renditet përpara Rumanisë dhe Bullgarisë, ndërsa për të gjitha vendet e tjera të SEE-së pjesa që zë bujqësia në vlerën e shtuar bruto është më e lartë se në çdo vend anëtartë BE-së.

Figura A.II-1: Kontributi i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit në vlerën e shtuar bruto totale (në %), 2012, SEE dhe BE



Burimi: EUROSTAT, Statistikat eSEE

Marrëdhënie të ngjashme mund të gjenden kur merret në konsideratë punësimi në këto sektorë. Sipas Anketave të Forcës së Punës, punësimi në bujqësi, pylltari dhe peshkim llogaritet rreth 14 përqind e punësimit total në Kroaci, 55 përqind në Shqipëri dhe midis 17 dhe 24 përqind në vendet e tjera të SEE-së. Midis shteteve anëtare të BE-së vetëm Rumania (29 përqind), renditet përpara të gjithë vendeve të SEE-së, me përjashtim të Shqipërisë. Në mesataren eEU-27 kjo përqindje është shumë më e ulët (5 përqind).

Përqindja më e lartë e bujqësisë në GVA dhe punësim në krahasim me BE-në është e lidhur ngushtë me nivelin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik. Të gjithë vendet e SEE-sëkanë ende të ardhura për frymë më të ulëta se mesatarja e shteteve anëtare të EU 27 (e matur nga PBB, qoftë kjo e matur me çmimet aktuale të tregut qoftë në terma të paritetit standard të fuqisë blerëse). Në vitin 2012, Kroacia (15 600 EUR për frymë në PPS), në 61 përqind ishtemë afër me nivelin mesatar të EU-27 (25 600 EUR për frymë), ndërsa sipas të dhënave të disponueshme për vendet e tjera të SEE-së, PBB-ja për frymë qëndron në rreth 30 përqind (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina) deri në 35 përqind (Serbia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) të mesatares së EU-27.

3.2 Përdorimi i tokës

Në të gjitha vendet e rajonit, potenciali natyror për prodhim bujqësor është shumë i larmishëm, duke variuar nga fushat pjellore dhe luginat e lumenjve,tek sipërfaqet malore, kodrinore dhe gurishtore jo shumë produktive. Disponueshmëria dhe përdorimi i tokës për bujqësi ndryshon sipas vendeve.

Në vendet e SEE-së korniza në lidhje me përdorimin aktual të tokës bujqësore është larg të qënite saktë. Përjashtimi i vetëm është Kroacia, ku statistikat bujqësore janë tashmë më të harmonizuara. Në vende të tjera, të dhënat për përdorimin e tokës bazohen kryesisht në regjistra, të cilat nuk janë të azhornuar rregullisht. Në disa vende (Bosnje & Hercegovinë, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia, Kosova*), përveç sipërfaqes totale të tokës, regjistrohet gjithashtu edhe toka djerrë dhe e pakultivuar, por vetëm për tokë të punueshme. Në vitet e fundit, përqindja

e tokës së punueshme të papërdorur ishte 7 përqind në Serbi, rreth 9 përqind në Kosovë*, mbi 30 përqind në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi dhe afërsisht 50 përqind në Bosnjë & Hercegovinë. Pritet që të ekzistojë një diferencë midis sipërfaqes së përdorur tëregjistruar dhe sipërfaqes së përdorur aktualisht edhe për kategori të tjera të përdorimit të tokës bujqësore. Megjithatë, kjo nuk është e regjistruar në statistikat e rregullta të përdorimit të tokës. Në vendet në të cilat toka e punueshme nuk është kategoria mbizotëruese (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi), informacioni i siguruar nga statistikat e rregullta vjetore të përdorimit të tokës i referohet më shumë sipërfaqes disponueshmepër bujqësinë sesa sipërfaqes bujqësore të përdorur aktualisht.

TabelaA.II-2: Toka bujqësore sipas kategorisë kryesore të përdorimit të tokës sipas statistikave vjetore të përdorimittë tokës (në 1 000 ha), 2012, SEE

	AL	BA	XK	MK	ME	RS	HR [1]
Tokë e punueshme	409	1 006	254	414	45	3 282	904
Nga e cila tokë djerrë dhe e pakultivuar	:	476	24	137	14	219	-
Kultura të përhershme	78	109	7	35	16	293	79
Kullota të përhershme	505	1 048	97	817	451	1 478	346
Tokë tjetër bujqësore	213	-	-	1	3	27	3
Tokë bujqësore, në total	**1 204**	**2 163**	**358**	**1 268**	**515**	**5 053**	**1 331**

Shënim: [1]Sipërfaqe bujqësore e përdorur

Burimi: Statistikat e SEE

Të dhënat mbi përdorimin e tokës bujqësore të disponueshme për vendet në të cilat është kryer Anketa e Strukturës së Fermës sipas metodologjisë së Eurostat në vitet e fundit (Mali i Zi, Serbia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) tregojnë se diferenca midis tokës bujqësore të regjistruar në statistikat vjetore dhe sipërfaqja bujqësore e përdorur aktualisht nga fermat bujqësore mund të jetë mjaft e madhe. Në Serbi, toka bujqësore e përdorur matur nga censusi i bujqësisë (2012) përbën rreth 70 përqind të totalit të tokës bujqësore (77 përqind të tokës së punueshme, 64 përqind të kulturave të përhershme, si edhe 48 përqind të kullotave të përhershme). Në Kroaci, një reduktim i ngjashëm u regjistrua në vitin 2005, kur Kroacia përshtati statistikat e saj për përdorimin e tokës me BE-në (sipërfaqja bujqësore totale ra me rreth 40 përqind, toka e punueshme u reduktua me 22 përqind, kulturat e përhershme me 37 përqind, dhe kullotat e përhershme me 65 përqind dhe që atëherë, të gjitha të dhënat e përdorimit të tokës bujqësore për Kroacinë i referohen sipërfaqes bujqësore të shfrytëzuar). Në Mal të Zi, sipas censusit të bujqësisë kryer në vitin 2010, vetëm 43 përqind e sipërfaqes totale të tokës bujqësore regjistruar atë vit në kuadrin e statistikave të përdorimit të tokës u përdor realisht nga fermat bujqësore (14 përqind etokës së punueshme, 28 përqind ekulturave të përhershme, si dhe 47 përqind e kullotave të përhershme). Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ky dallim është shumë i madh, ku sipas të dhënave paraprake nga Anketa e Strukturës së Fermave në vitin 2013 sipërfaqja bujqësore e përdorur përfaqëson vetëm 25 përqind të totalit të tokës bujqësore (afro 60 përqind të sipërfaqes totale të tokës së punueshme, 114 përqind të sipërfaqes me kultura të përhershme, 50 përqind e livadheve dhe vetëm 1 përqind e kullotave). Sipas informacionit në dispozicion, Anketa e Strukturës së Fermave në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nuk ka marrë parasysh kullotat shtetërore të cilat përdoren zakonisht për kullotje sezonale të të imtave dhe të gjedhit[16].

Në BE, vetëm sipërfaqja bujqësore e përdorur realisht nga ekonomitë bujqësore regjistrohet rregullisht. Prandaj, për krahasim me BE-në, për Kroacinë, Maline Zi dhe Serbinë u përdorën të dhëna për sipërfaqën bujqësore të përdorur (UAA) nga anketat e strukturës së fermave, ecila është plotësisht e krahasueshme me anketën e strukturës së fermave me bazë UAA për BE-në. Për

[16] Kullotat shtetërore jepen me koncesion për kullotje sezonale për fermerët në bazë të numrit të krerëve të kullotura dhe jo për sipërfaqe të përdorur. Prandaj, nuk ka prova të qarta në lidhje me sipërfaqen e kullotave realisht të përdorura nga fermerët.

vendet e tjera të SEE-së, një përafrim i sipërfaqes bujqësore të përdorur është bërë në bazë të të dhënave të disponueshme. Për Bosnje dhe Hercegovinën dhe Kosovën* për të përafruar UAA sipërfaqja e tokës së punueshme e papërdorur është zbritur nga sipërfaqja totale bujqësore. Për Shqipërinë, të dhënat për tokën bujqësore të përdorur nga ekonomitë bujqësore të mbuluara nga anketat e rregullta vjetore janë konsideruar të jenë më afër UAA-së se sa sipërfaqja totale bujqësore. Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, të dhënat e anketës së strukturës së fermës për tokën e punueshme të përdorur aktualisht, kulturat e përhershme dhe livadhet, janë marrë nga anketa e strukturës së fermës, ndërsa sipërfaqja e kullotave në përdorim është vlerësuar bazuar në të dhënat mbi kullotat totale nga statistikat e rregullta të përdorimit të tokës dhe kombinuar me vlerësimin se e njëjta pjesë e sipërfaqes totale të kullotave është përdorur (50 përqind), ashtu siç rezulton për livadhet nga anketa e strukturës së fermave.

TabelaA.II-3: Sipërfaqe bujqësore e përdorur; SEE dhe EU-27

	AL[1] (2012)	BA[2] (2012)	XK[2] (2012)	MK[3] (2013)	ME[4] (2010)	RS[4] (2012)	HR[4] (2010)	EU-27[4] (2010)
Sipërfaqe bujqësore e përdorur (1 000 ha)	**980**	**1 687**	**334**	**688**	**221**	**3 437**	**1 316**	**174 499**
Përpjesa e UAA në sipërfaqen totale (%)	34	33	31	27	16	44	23	40
Përpjesa e tokës sëpunueshme nëUAA (%)	41	31	69	34	3	74	68	59
Përpjesa e kulturave të përhershme në UAA (%)	8	7	2	6	2	5	6	6
Përpjesa e kullotave të përhershme në UAA (%)	51	62	29	60	95	21	26	35

Shënime: [1]përafrim (të dhëna nga anketa vjetore e ekonomive familjare)
[2]përafrim (të dhëna të rregulluara nga statistikat vjetore të përdorimit të tokës)
[3]përafrim (të dhëna nga Anketa e Strukturës së Fermës për tokën e punueshme bujqësore përdorur realisht)
[4]të dhëna nga Anketa e Strukturës së Fermës (Censusi i bujqësisë)

Burimi: Statistikat e SEE-së, EUROSTAT

Duke marrë parasysh të dhënat mbi tokën bujqësore në dispozicion, shumica e vendeve të SEE-së kanë potencial tepër të lartë natyror për bujqësinë. Megjithatë, në qoftë se konsiderohet vetëm potenciali aktiv matur nga sipërfaqja bujqësore e përdorur për banor, situata shfaqet disi ndryshe.

Figura A.II-2: Sipërfaqe bujqësorepër 1 000 banorë (në hektar), 2010, SEE dhe BE



Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Në krahasim me BE-në, vetëm Serbia ka një pozicion të favorshëm ku si sipërfaqja totale bujqësore e përdorurpër banor (0.48 ha) ashtu edhe toka e punueshme për banor (0.35 ha), janë më të larta

se mesatarja e EU-27 (respektivisht 0.35 ha dhe 0.21 ha,). Ky tregues erendit Serbinë pranë tre vendeve anëtare të BE-së me sipërfaqe bujqësore për banor më të lartë (afër Francës dhe Hungarisë). Për Kroacinë, këta dy tregues (përkatësisht 0.30 ha dhe 0.20 ha), janë të përafërt me mesataren e EU-27, duke e pozicionuar Kroacinë diku nga mesi i të gjitha shteteve anëtare të BE-së. Për sa i përket sipërfaqes bujqësore për banor, Bosnja dhe Hercegovina (0.44 ha), Mali i Zi (0.36 ha), Shqipëria (0.35 ha) dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (0.33 ha) janë mbi mesataren e EU-27, ndërsa për sa i përket tokës së punueshme për banor të gjitha këto vende, si dhe Kosova* janë nën mesataren e BE-së ku Mali i Zi zë vendin e fundit me vetëm 0.01 ha tokë të punueshme për banor.

Edhe pse situata në lidhje me përdorimin e tokës bujqësore në vendet e SEE-së nuk është e qartë, në bazë të të gjitha të dhënave në dispozicion, mund të vlerësohet se një pjesë e madhe e tokës bujqësore nuk shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore. Pjesa e tokës bujqësore të papërdorur duket të jetë e lartë në të gjitha kategoritë e përdorimit të tokës, por sidomos në kategorinë e kullotave të përhershme, më së shumti në kullotat malore më pak produktive të cilat mbizotërojnë në strukturën e kullotave në të gjitha vendet e SEE-së dhe ende janë kryesisht të menaxhuara dhe në pronësi të shtetit.

3.3 Struktura e fermës

Për Kroacinë, Malin e Zi, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbinë janë të mundësueshme të dhëna mbi strukturën e fermës, të krahasueshme me BE-në. Në Bosnje & Hercegovinë u mblodh vetëm informacion i kufizuar prej censusit pilot të kryer në vitin 2010 për fermat bujqësore dhe strukturën e tyre. Për Shqipërinë dhe Kosovën* disa të dhëna të pjesshme mbi strukturën e fermës mblidhen çdo vit me anë tëanketimeve (me mostër të përcaktuar) të kryera rregullisht tek fermat bujqësore.

Një karakteristikë kryesore e të gjitha vendeve të SEE-së është madhësia e vogël mesatare e fermave duke filluar nga më pak se 3 ha në Kosovë*, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Bosnje & Hercegovinë dhe Shqipëri, në rreth 5 ha në Mal të Zi, Serbi dhe Kroaci. Në vendet e SEE-së ferma mesatare është pothuajse tre (Kroaci) deri dhjetë herë më e vogël (*Kosovë) në përmasa krahasuar me EU-27 (14.5 ha për fermë në 2010). Kosova*, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Bosnje dhe Hercegovina dhe Shqipëria, janë pozicionuar vetëm përpara Maltës, ndërsa madhësia mesatare e fermave në Mal të Zi, Serbi dhe Kroaci është renditur përpara Qipros dhe Rumanisë.

Figura A.II-3: Sipërfaqja bujqësore e përdorurmesatare për fermat bujqësore (në ha), 2010, për SEE dhe EU



Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Madhësia e vogël mesatare e fermave është kryesisht pasojë e një strukture të fragmentuar me një përqindje të lartë të fermave me deri në 10 ha të UAA. Në Kosovë* vetëm rreth 1 përqind e fermave operojnë në sipërfaqe bujqësore më të madhe se 10 ha, duke zënë vetëm 10 përqind të sipërfaqes bujqësore totale të përdorur. Strukturë e ngjashme e fermës mund të gjendet edhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në Mal të Zi, Serbi dhe Kroaci situata është paksa më e mirë, me pjesën e fermave me 10 ha ose më shumë që përbëjnë midis 5 përqind (Mali i Zi), dhe 11 përqind (Kroacia) të numrit total të fermave, dhe zënë nga 57 përqind (Serbi), në 71 përqind (Mali i Zi) të të gjithë sipërfaqes bujqësore të përdorur (UAA). Në mesataren e BE-së përqindja e sipërfaqes bujqësore të përdorur në ferma me mbi 10 ha është afërsisht 90 përqind e totalit të sipërfaqes.

Tabela A.II-4: Pjesa e fermave dhe sipërfaqes së kultivuar nga fermat me madhësi deri në 10 ha UAA, në SEE dhe EU-27

	Ferma Bujqësore			Sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar		
	Deri në 2 ha	**Deri në 5 ha**	**Deri në 10 ha**	**Deri në 2 ha**	**Deri në 5 ha**	**Deri në 10 ha**
Kosovë* (2012)	80%	96%	99%	45%	76%	90%
IRJe Macedonisë (2013)	78%	94%	98%	:	:	:
Mali i Zi (2010)	73%	89%	95%	10%	21%	29%
Serbia (2012)	48%	77%	92%	8%	25%	43%
Kroacia (2010)	53%	76%	89%	8%	21%	37%
EU-27 (2010)	**49%**	**69%**	**80%**	**2%**	**7%**	**12%**

Burimi: EUROSTAT, Statistika të SEE

Sidomos në Mal të Zi, por edhe në Serbi dhe Kroaci, një pjesë mjaft e madhe e sipërfaqes bujqësore të përdorur (përkatësisht 40 përqind, 24 përqind dhe 19 përqind), është nën përdorim nga një numër shumë i vogël (nën 1 përqind) i fermave të mëdha që i përkasin klasës së madhësisë prej 100 ha dhe më shumë. Këto lloj fermash, janë të organizuara si shoqëri dhe janë themeluar nëpërmjet procesit të privatizimit të fermave të mëparshme kolektive. Kjo tregon strukturën tipike të dyfishtë të fermave bujqësore me ferma të vogla familjare në njërën anë dhe ferma mjaft të mëdha në anën tjetër. Brenda BE-së, struktura të ngjashme të dyfishta mund të gjenden në Qipro, Rumani, Poloni, Greqi, Itali dhe Lituani.

Figura A.II-4: Përbërja e sipërfaqes bujqësore të përdorur sipas klasifikimeve të madhësisë së fermës, 2010, në SEE dhe BE



Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE-së

3.4 Prodhimi dhe rendimenti

Në shumicën e vendeve të SEE-së prodhimi bimor dominon prodhimin bujqësor. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kontributi i prodhimit bimor në prodhimin e përgjithshëm bruto të të mirave bujqësore është 75 përqind; në Serbi, Bosnjë dheHercegovinë dhe Kroaci mbi 60 përqind dhe në Kosovë* dhe Mal të Zi rreth 55 përqind. Vetëm në Shqipëri kjo përqindje është 50 përqind.

TabelaA.II-5: Peshae prodhimit bimor dhe blegtoral në prodhimin e përgjithshëm të të mirave bujqësore, 2012, nëSEE dhe EU-27

	AL	BA (2010)	XK	MK	ME (2011)	RS	HR	EU-27
Prodhimi bimor	50%	63%	55%	75%	53%	62%	64%	56%
Prodhimi blegtoral	50%	37%	45%	25%	47%	38%	36%	44%

Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Përsa i përket prodhimit bimor, në të gjitha vendet e SEE-së drithërat janë kultura fushore më e rëndësishme për sipërfaqe të mbjellë. Këtu përjashtim bën Mali i Zi, ku patatet dominojnë prodhimin bimor. Në Kroaci dhe Serbi, përveç drithërave, një përqindje relativisht të lartë zënë bimët industriale (farërat fajore, panxhar sheqeri), ndërkohë që në të gjitha vendet e tjera rëndësi më të madhe pas pas drithërave, marrin perimet. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, duhani është gjithashtu midis të mirave kryesore bujqësore. Në shumicën e vendeve të SEE-së frutat (duke përfshirë rrushin) përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të prodhimit bimor.

Për sa i përket prodhimit të kafshëve, mbarështimi i gjedhit (prodhimi i qumështit dhe mishit të viçit) duket të jetë nënsektori kryesor në shumicën e SEE-së,ndjekur nga prodhimi i mishit të derrit në Kroaci dhe Serbi dhe nga mbarështimi i të imtavenë vendet e tjera të SEE-së.

Duke marrë parasysh të dhënat e disponueshme, të cilat nuk ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi evolucionin e vëllimit të prodhimit bujqësor për të gjitha vendet e SEE-së, duket se në përgjithësi, prodhimi bujqësor ka mbetur në nivele modeste që prej vitit 2005 ose ka pësuar një rënie të lehtë. Është gjithashtu evidente se në të gjitha vendet e SEE-së prodhimi bimor luhatet në mënyrë të konsiderueshme nga viti në vit, kryesisht si pasojë e kushteve të ndryshueshme të motit. Vetëm Shqipëria tregon prirje të qartë rritëse si në prodhimin bimor ashtu edhe në prodhimin blegtoral.

Vetëm prodhimi i frutave (duke përfshirë rrushin) dhe perimeve është rritur në vitet e fundit në shumicën e vendeve të SEE-së. Prodhimi i patates është rritur ndjeshëm vetëm në Mal të Zi dhe prodhimi i duhanit në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Prodhimi blegtoral në përgjithësi tregon stanjacion apo dinamikë rënëse. Të dhënat e gjedhit janë rritur vetëm në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa në Kosovë* i vetmi zhvillim pozitiv që prej vitit 2005 është vënë re tek numri i të imtave. Në Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë zhvillimet pozitive janë të dukshme vetëm në sektorin e shpendëve (si në prodhim mishi ashtu edhe në prodhim vezësh).

Në pjesën më të madhe të vendeve të SEE-së, rendimentet mesatare janë rritur në mënyrë konstante. Përgjatë periudhës 2007-2012, rendimenti mesatar igrurit u rrit ndjeshëm në Kroaci dhe Shqipëri (rreth 30 përqind) ndjekur nga Bosnja dhe Hervegovina dhe Serbia (rreth 20 përqind). Rendimenti i grurit ndryshon shumë midis vendeve.

Figura A.II-5: Rendimenti i grurit të zakonshëm (tonë/ha), 2010-2012 mesatare, në SEE dhe BE



Burimi: EUROSTAT, Statistika te SEE

Rendimentet më të larta të grurit regjistrohen në Kroaci, duke arritur në rreth 90 përqind të mesatares së EU-27. Në vendet e tjera të SEE-së,rendimentet e grurit shkojnë nga 55 përqind në 66 përqind (si në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*), dhe nga 70 përqind në 75 përqind (në Serbi e Shqipëri) të mesatares së EU-27. Në Shqipëri dhe Serbi rendimenti mesatar i grurit (rreth 4 t/ha) i rendit këto vende në treshen e dytë të të gjitha Shteteve Anëtare të BE-së, pranë Polonisë, Hungarisë dhe Lituanisë.

Në prodhimin shtazor, hendeku midis vendeve të SEE-së dhe EU-27 është shumë më i madh në krahasim me rendimentet e grurit dhe rendimentin e bimëve në përgjithësi. Edhe pse të gjitha vendet e SEE-së regjistruan rritje të konsiderueshme në rendimentin e qumështit që nga viti 2005 (nga rreth 40 përqind në Kroaci, në rreth 30 përqind në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, rreth 20 përqind në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri dhe 10 përqind në Mal të Zi), vetëm Kroacia është renditur përpara Bullgarisë dhe Rumanisë, në rreth 70 përqind të mesatares së EU-27. Ndërkohë, rendimentet e qumështit në të gjitha vendet e tjera të SEE-së janë më të ulëta se në çdo shtet anëtar të BE-së. Në Mal të Zi, Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë rendimenti i qumështit është rreth 40 përqind e EU-27. Kjo diferencë është paksa më e zbutur për ishRepublikën Jugosllave të Maqedonisë (45 përqind e EU-27) dhe Serbinë (50 përqind e EU-27).

Figura A.II-6: Rendimenti i qumështit të lopës (ton për lopë qumështi); 2012, SEEdhe BE



Shënim: Për Shqipërinë prodhimi total i qumështit u pjestua me numrin total të lopëve (nuk ka të dhëna mbi lopët e qumështit).

Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Në përgjithësi rendimentet e ulëta tregojnë se produktiviteti total i faktorëve dhe niveli teknologjik në shumicën e nën-sektorëve të bujqësisë në përgjithësi është ende mjaft i ulët. Kjo është e lidhur ngushtë me fragmentizimin e fermave dhe nivelin e ulët të specializimit. Rendimenti shumë i ulët në prodhimin e qumështit, në të gjitha vendet e SEE-së mundet deri diku t'i atribuohet pjesërisht ndarjes së paqartë midis lopëve të qumështit dhe lopëve të tjera, pasi shumica e lopëve përdoren për të dyja qëllimet, për prodhimin e mishit dhe qumështit.

3.5 Çmimet bujqësore

Indekset e çmimeve të prodhuesve për prodhimin bujqësor total në pesë vende të SEE-së për të cilat këto të dhëna janë të disponueshme, tregojnë kryesisht karakteristika të përgjithshme të ngjashme me EU-27 (rritje e lartë në vitet 2007-2008, ulje në vitin 2009 dhe tendenca rritëse gjatë viteve të fundit), por me luhatje më intensive përgjatë periudhës, ndikuar kryesisht nga ndryshimet në çmimet e prodhimeve bimore. Në periudhën 2005-2012 çmimet e prodhimit bujqësor janë rritur në terma realë në të gjitha vendet, me përjashtim të Kosovës*, me normëmesatare më të lartë të rritjes të regjistruar në Serbi dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë çmimet e prodhimit bimor dhe blegtoral kanë shfaqur një tendencë rritëse. Ndërsa në Serbi dhe në vende të tjera të SEE-së vetëm çmimet e prodhimit bimor janë rritur në terma realë që nga viti 2005, ndërkohë që çmimet e prodhimit blegtoral përgjithësisht u luhatën nën nivelin e çmimeve të vitit 2005. Kosova* regjistroi norma rënëse në terma reale si të çmimeve të prodhimit bimor ashtu dhe atij blegtoral.

FiguraA.II-7: Indekset e çmimeve bujqësore të prodhuesit (deflatuar; 2005=100), 2005-2012, SEE dhe EU-27



Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Për shkak të mangësisë së të dhënave dhe mungesës së harmonizimit për çmimet absolute të shitjes së prodhimeve bujqësore në të gjithë vendet e SEE-së si dhe shtetet anëtare të BE-së, krahasimi i niveleve të çmimeve midis vendeve është i mundur vetëm për një grup të kufizuar të produkteve bujqësore. Të dhënat më të plota dhe të krahasueshme mbi çmimet absolute mund të gjenden për grurin dhe qumështin e lopës, të cilat janë edhe produkte të rëndësishme ekonomike për të gjitha vendet përkatëse.

Figura A.II-8: Çmimet e shitjes së grurit të butë (EUR/ton), 2010-2012 mesatare, SEE dhe BE



Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Çmimet absolute të prodhimit të grurit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme sipas vendeve. Çmimet më të ulëta të grurit midis vendeve të SEE-së dhe po ashtu në krahasim me shtetet anëtare të BE-së janë të regjistruara në Serbi (rreth 10 përqind më pak se mesatarja e EU-27) dhe Kroaci (-5 përqind), dhe më e larta në Shqipëri (+40 përqind) dhe Kosovë* (+25 për qind). Çmimet e grurit janë relativisht të larta edhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (20 përqind më të larta se mesatarja e EU-27), ndërsa Bosnja dhe Hercegovina është renditur diku nga mesi. Vlerësimet e ngjashme në lidhje me nivelin e çmimeve nga SEE dhe në krahasim me BE-në janë të vlefshme edhe për misrin, dhe për Serbinë dhe Kroacinë edhe për farërat vajore.

Tabela A.II-6: Çmimet mesatare të prodhuesit për disa produkte të rëndësishme bujqësore (EUR/ton), 2010-2012 mesatare, në SEE dhe BE

	AL	BA	XK	MK	ME	RS	HR	BE maskimum	-BE minimum
Grurë i zakonshëm	260.4	187.9	233.3	219.2	:	164.3	177.5	225.5	166.3
Misër	258.1	195.2	270.0	209.8	:	160.7	171.4	221.2	162.8
Luledielli	:	:	:	:	:	367.0	377.3	420.0	353.3
Sojë	:	388.0	:	:	:	377.3	370.9	395.0	327.4
Patate	220.2	260.8	303.3	303.6	:	231.0	190.4	471.4	118.4
Speca	327.7	295.4	583.3	269.1	:	394.0	714.3	:	:
Domate	337.4	235.6	610.0	434.9	:	521.0	747.2	747.6	262.1
Viça	:	1 762.0	2 143.3	1 086.7	:	1 752.7	1 907.3	2 359.3	1 032.8
Mish viçi (viçat)	:	2 633.1	:	1 674.2	:	2 577.7	2 769.6	:	:
Mish derri	:	1 538.6	2 120.0	1 562.0	:	1 347.7	1 280.6	2 080.8	973.1
Mish qingji	:	2 190.9	2 320.0	2 523.8	:	1 830.7	4 151.3	:	:
Qumësht lope	364.0	275.6	297.7	288.6	:	258.0	330.0	423.2	242.3

Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Për sa i përket patateve, çmimet më të ulëta janë regjistruar në Kroaci, e ndjekur nga Shqipëria dhe Serbia. Në Bosnjë dhe Hercegovinë si dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ku patatet janë një kulturë më e rëndësishme se në vendet e tjera të SEE-së, niveli i çmimeve është më i lartë. Ky nivel çmimi i rendit këto dy vende në treshen e parë në krahasim me shtetet anëtare të BE-së, me çmime që janë dyfishi i çmimeve në krahasim me Poloninë dhe Holandën, vende këto me çmimin më të ulët të patates në BE.

Çmimet e prodhuesit për domatet dhe specat, si përfaqësuese të perimeve, i cili është një sektor i rëndësishëm në të gjitha vendet e SEE-së (me përjashtim të Kroacisë), ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme sipas vendit. Bosnja dhe Hercegovina, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Shqipëria janë vendet e SEE-së me nivelet më të ulëta të çmimeve të domateve dhe specave, ndjekur nga Serbia. Në të gjitha këto vende, çmimet e prodhuesit për domaten janë të krahasueshme me nivelet e çmimeve të Shteteve Anëtare të BE-së që kanë çmimet më të ulta të domates së fushës (renditur midis Polonisë dhe Greqisë).

Figura A.II-9: Çmimet e shitjes së qumështit të papërpunuar të lopës (EUR/ton),mesatarja 2010-2012, në SEE dhe BE



Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Çmimet më të ulëta të shitjes së qumështit të papërpunuar të lopës si midis vendeve të SEE-së ashtu edhe krahasuar me shtetet anëtare të BE-së janë në Serbi (rreth 20 përqind më të ulëta se mesatarja e EU-27). Çmime të ulëta (rreth 10 përqind deri në 15 përqind nën çmimin mesatar të qumështit në EU-27), janë regjistruar edhe për Bosnje dhe Hercegovinën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën*, ndërsa Kroacia dhe Shqipëria janë renditur pranë vendeve me çmimet më të larta të qumështit në BE (dhe më lartë se mesatarja eEU-27). Midis vendeve të SEE-së, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina janë vendet me çmimet më të ulëta të prodhimit edhe për produktet e tjera kryesore blegtorale. Këto dy vende kanë çmimet më të ulëta të mishit të qingjit midis vendeve të SEE-së; çmimi i viçave është i ulët vetëm në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe çmimet e mishit të derrit janë më të ulëta vetëm në Kroaci. Krahasuar me BE-në, të gjithë vendet e SEE-së kanë çmime mjaft të ulëta prodhimi për mishin e qingjit, çmime relativisht të larta të mishit të derrit, dhe me përjashtim të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, edhe çmime mjaft të larta prodhimipër gjedhin.

Pas analizimit të grupeve të produkteve, vlerësimi i përgjithshëm është se vetëm në Serbi çmimet e prodhuesit për shumicën e të mirave bujqësore në përgjithësi janë mëtë ulëta krahasuar me vendet e rajonit, si dhe me shumicën e shteteve anëtare të BE-së. Nga ana tjetër, nivelet e çmimeve të prodhuesit në Shqipëri dhe Kosovë* duket të jenë ndër më të lartat në rajon dhe të përafërta me Vendet Anëtare të BE-së që kanë çmimet më të larta. Vendet e tjera të SEE-së janë diku në mes, me çmime më të ulëta të regjistruara vetëm për një grup shumë të kufizuar të produkteve bujqësore (drithëra, farëra vajore në Kroaci, disa perime në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe mishit të qingjit në Bosnje & Hercegovinë).

3.6 Tregtia agro-ushqimore

Në të gjitha vendet e SEE-së sektori agro-ushqimor është një kontribues i rëndësishëm në tregtinë e jashtme totale të të mirave të vendit, si për eksportet edhe për importet. Në vitin 2012, pesha e eksporteve agro-ushqimore ndaj totalit të eksporteve të të mirave varionte nga 5 përqind (Shqipëri), në 24 përqind (Serbi), ndërsa importet agro-ushqimore kanë kontribuar në8 përqind (Serbi) deri në 25 përqind (Mali i Zi) ndaj totalit të importeve. Këto pesha janë më të mëdha se sa në EU-27 (që si tek eksportet ashtu edhe tek importet kontribuojne në më pak se 7 përqind).

Tabela A.II-7: Pesha e produkteve agro-ushqimore në totalin e tregtisë së jashtmetë të mirave, 2012, në SEE dhe EU-27

	AL	BA	XK	MK	ME	RS	HR	EU-27
Kontributi në eksport	5.4%	7.9%	7.7%	15.2%	15.5%	23.7%	12.9%	6.6%
Kontributi në import	15.8%	15.8%	23.0%	13.4%	25.0%	7.7%	12.2%	6.5%

Burimi: EUROSTAT, Statistikat e SEE

Serbia është eksportuesi i vetëm neto i produkteve agro - ushqimore nga të gjitha vendet e SEE-së dhe bilanci tregtar i saj është përmirësuar ndjeshëm që prej vitit 2005. Eksportet agro-ushqimore po rriten me një normë më të lartë se importet edhe në vendet e tjera të SEE-së, përveç Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, duke rezultuar në një raport të përmirësuar eksport/import. Megjithatë, defiçitet tregtare janë duke u rritur në mënyrë konstante.

Tabela A.II-8: Tregtia Agro-ushqimore (milionë EUR), në SEE

	Eksportet		Importet		Bilanci tregtar		Raporti Eksport/Import	
	2005	2012	2005	2012	2005	2012	2005	2012
Kroacia	740.0	1 239.9	1 299.0	1 970.7	-559.0	-730.9	57.0	62.9
Shqipëria	41.9	82.9	369.1	618.4	-327.2	-535.5	11.4	13.4
Bosnje& Herzegovina	117.9	317.4	1 006.2	1 426.3	-888.3	-1 108.8	11.7	22.3
Kosova*	7.8	20.6	285.6	572.7	-277.8	-552.1	2.7	3.6
IRJ eMaqedonisë	274.4	470.3	340.1	672.9	-65.7	-202.6	80.7	69.9
Mali i Zi[1]	37.4	56.7	312.7	443.4	-275.3	-386.7	12.0	12.8
Serbia	731.7	2 094.2	622.0	1 137.8	109.7	956.4	117.6	184.1

Shënime: [1]Të dhënat e vitit 2007 në vend të 2005,
Burimi: Statistikat e SEE

Raportet e mbulimit të eksporteve ndaj importeve ndryshojnë sipas vendit, me raportinmë të ulët në Kosovë* (rreth 4 përqind në vitin 2012), e ndjekur nga Mali i Zi dhe Shqipëria (rreth 13 përqind) tek një raport më i lartë në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (70 përqind) dhe Kroaci (63 përqind). Bosnja dhe Hercegovina është duke treguar përmirësimin më të dukshëm në këtë tregues nga viti 2005, por ende eksportet agro-ushqimore të këtij vendi mbulojnë më pak se 25 përqind të importeve.

Në pjesën më të madhe të SEE-së eksportet përfaqësohen kryesisht nga lëndë të para dhe produkte (të përpunuara) me vlerë të shtuar të vogël. Në përbërjen e eksporteve agro-ushqimore, produkte të ndryshme renditen midis kategorive më të rëndësishme të eksportit në varësi të karakteristikave të çdovendi.

Përbërja më e larmimshme e eksporteve mund të gjendet në Kroaci ku pesha e produkteve ushqimore të përpunuara është më e lartë se në vendet e tjera të SEE-së. Në vitin 2012, Kroacia ka shënuar përqindjen më të lartë të eksporteve të sheqernave dhe ëmbëlsirave dhe përbërësve të ndryshëm të ngrënshëm, pasuar nga drithërat të cilat së bashku përfaqësuan rreth një të tretën e totalit të eksporteve. Gjithashtu, në Bosnje dhe Hercegovinë grupi kryesor i tarifave të eksportit janë sheqernat dhe ëmbëlsirat (edhe pse nuk ka prodhim të panxharit të sheqerit në vend), ndërsa vendi i dytë i takon produkteve të qumështit, ndjekur nga yndyrnat dhe vajrat. Këto tri grupe përbënin rreth 45 përqind të totalit të eksporteve agro-ushqimore. Një përqindje e njëjtë e tre grupeve tarifore të para është shënuar edhe në Serbi me drithërat që janë e mira më e rëndësishme e eksportit e ndjekur nga frutat dhe pijet. Në të gjitha vendet e tjera të SEE-së raporti i tre grupeve të para tarifore ndaj totalit të eksporteve agro-ushqimore është më i lartë se 50 përqind, duke filluar nga rreth 51 përqind në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në rreth 70 përqind në Kosovë*.

Vera dhe pijet e tjera kanë peshën më të lartë në eksportet agro-ushqimore në Malin e Zi (mbi 40 përqind) dhe Kosovë* dhe janë të rëndësishme edhe për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ku duhani është produkti kryesor i eksportit. Shqipëria është vetmi vend ku farërat vajore dhe nënproduktet e mishit janë dy kategoritë më të mëdha të eksporteve (llogaritur më shumë se 50

përqind e eksporteve totale të produkteve agro-ushqimore), përfaqësuar kryesisht nga produkte niche të tilla si bimëdhe farëra mjekësore dhe eterovajore, si dhe këmbë bretkose.

Tabela A.II-9: Përbërja eksporteve agro-ushqimore sipas tre grupeve të para tarifore, 2012, në SEE

AL	BA	XK	MK	ME	RS	HR
(CNCT 12) Farëra vajore 25.0%	(CNCT 17) Sheqerna dhe ëmbëlsira 18.5%	(CNCT 22) Pije, Pije të distiluara, uthull 34.4%	(CNCT 24) Duhan 24.4%	(CNCT 22) Pije, Pije të distiluara, uthull 41.0%	(CNCT 10) Drithëra 24.9%	(CNCT 17) Sheqerna dhe ëmbëlsira 12.6%
(CNCT 16) Preparate mishi 22.8%	(CNCT 04) Prodhime bulmetore, vezë, mjalt 15.1%	(CNCT 11) Produktet e industrisë bluajtse 26.3%	(CNCT 22) Pije, Pije të distiluara, uthull 15.2%	(CNCT 02) Mish 7.7%	(CNCT 08) Fruta dhe arra të ngrënshme 13.8%	(CNCT 21) Preparate të ndryshme të ngrënshme 10.5%
(CNCT 07) Përime të ngrënshme 9.3%	(CNCT 15) Yndyrna dhe vajra 12.2%	(CNCT 07) Përime të ngrënshme 8.8%	(CNCT 07) Perime të ngrënshme 10.9%	(CNCT 19) Pije, Pije të distiluara, uthull 6.8%	(CNCT 22) Pije, Pije të distiluara, uthull 8.0%	(CNCT 10) Preparate të drithërave 9.8%

Burimi: Statitsikat e SEE

Përbërja e importeve agro-ushqimore është shumë më e larmishme sesa eksportet. Mishi dhe preparatet e mishit, drithërat dhe preparatete drithërave, si dhe pijet dhe duhani, janë ndër grupet më të përfaqësuara në importet e të mirave agro-ushqimore në vendet e SEE-së. Në Shqipëri dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë kategori të rëndësishme të importit janë vajrat , ndërsa në Serbi ndër grupet kryesore të importit janë frutat .

Për pjesën më të madhe të vendeve të SEE-së vendet e tjera të rajonit (SEE) dhe EU-27 janë partnerët kryesorë tregtarë, duke zënë pjesën më të madhe të importeve dhe eksporteve të të mirave agro-ushqimore. Për sa i përket eksporteve, në vitin 2012, me përjashtim të Shqipërisë dhe Serbisë, vendet e tjera brenda rajonit renditen përpara EU-27, duke përfaqësuar nga 50 përqind (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), në mbi 80 përqind (Kosova*) të eksporteve totale agroushqimore. Shqipëria regjistron deri tani përqindjen më të lartë të eksporteve drejtEU-27 (71 përqind në vitin 2012), e ndjekur nga Serbia (50 përqind). Për sa i përket importeve, vendet e rajonit janë partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Malit të Zi dhe Bosnje & Hercegovinës. Për Shqipërinë, Serbinë dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë importimi i të mirave agro-ushqimore me origjinë nga EU-27 zënë pjesën më të madhe të importeve. Kosova* importon të mira agro-ushqimore kryesisht nga vendet të cilat nuk janë pjesë e EU-27 apo SEE-së.

TabelaA.II-10: Ndarja rajonale e tregtisë agro-ushqimore (%), 2012, SEE

	Eksportet			Importet		
	EU-27	SEE	Tjetër	EU-27	SEE	Tjetër
Shqipëria	70.7	20.7	8.6	51.7	13.8	34.5
Bosnje& Herzegovina	19.1	77.0	3.9	40.0	54.5	5.5
Kosova*	15.5	80.6	3.9	35.5	17.6	46.9
IRJe Maqedonisë	39.6	47.1	13.4	45.3	31.0	23.7
Mali i ZI	8.4	74.9	16.7	27.1	64.5	8.4
Serbia	50.1	40.7	9.2	44.5	22.5	3.4
Kroacia	:	:	:	:	:	:

Burimi: Statistikat e SEE

Përveç Serbisë që ka një bilanc tregtar pozitiv, qoftëedhe me EU-27, secili prej vendeve të tjera kanë një defiçit buxhetor me EU-27 i cili tregon tendenca rritëse.

4. Shtrirja dhe struktura e mbështetjes bujqësore

4.1 Kuadri institucional

Kornizat institucionale të politikës bujqësore në vendet e SEE-së janë mjaft të ngjashme (shikoniKapitujt B.I-B.VII). Ministritë e bujqësisë të secilit vend janë instancat më të larta. Këto insitutcione zakonisht kanë pushtet mbi pyjet dhe, në disa raste, edhe mbi menaxhimin e ujit. Megjithatë, ndryshe nga BE, politika tregtare dhe masat e tregut të brendshëm nuk janë kompetencë e këtyre ministrive; përkundrazi, ato janë pjesë e politikave të integruara ekonomike për të cilat janë përgjegjëse ministritë e ekonomisë apo tregut. Në disa vende zbatohen dhe financohen në nivel rajonal dhe lokal një shumëllojshmëri instrumentash të politikës (p.sh. Vojvodina në Serbi, kantonet në Federatën e Bosnjes). Për zbatimin e politikës bujqësore, vendet e SEE-së janë në procesin e formimit të agjensive të pagesave që do të merren edhe me mbështetjen e para-anëtarësimit në BE (IPARD).

Baza ligjore e politikës bujqësore është zakonisht një ligj i përgjithshëm që përcakton objektivat, mekanizmat, instrumentet dhe zbatimin e politikës bujqësore. Në të gjitha vendet e SEE-së janë duke u miratuar gradualisht në legjislacionin e bujqësisë parimet dhe mekanizmat e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së. Zbatimi i politikës bujqësore është i bazuar në rregulloret vjetore, ndërsa programimi është një proces që përfshin strategjitë afat-mesme të zhvillimit bujqësor dhe rural dhe programe operative kombëtare. Numri dhe struktura e dokumenteve ndryshon nga vendi në vend.Ngjashmërisht, në të gjithë vendet e SEE-së këto dokumente janë të gjitha dokumente të rëndësishme politike që marrin vëmendje të madhe publike dhe se ato janë duke ndjekur gjithnjë e më shumë konceptet e BE-së në temat, objektivat, masat dhe qasjene përgjithshme të ndjekur. Shpesh, ato janë të përgatitura me ndihmën e projekteve të donatorëve dhe ekspertëve ndërkombëtarë. Megjithatë, se si vihen në zbatim të gjitha këto dokumente, është një tjetër çështje.

4.2 Shpenzimet buxhetore totale për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale

Niveli i mbështetjes buxhetore për bujqësinë

Në vendet e SEE-së, me përjashtim të Kroacisë (dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë), niveli i mbështetjes buxhetore totale për bujqësinë është shumë i ulët në krahasim me EU-27. Në vitin 2012, mbështetja buxhetore për hektar e sipërfaqes bujqësore të përdorur (UAA) arriti në rreth 25 euro në Shqipëri (më e ulëta nga të gjitha), 50 euron ë Bosnjë & Hercegovinë, 70 euro në Kosovë*, Mal të Zi dhe Serbi, dhe me rreth 150 euro në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ky është reflektim i një buxheti relativisht të ulët duke marrë parasysh sipërfaqen totale bujqësore në këto vende dhe tregon potencialin mjaft të kufizuar të këtyre vendeve për të adresuar çështjet e zhvillimit.

FiguraA.II-10: Totali i shpenzimeve buxhetore për sektorin agro-ushqimor në zonat rurale [1] (EUR/ ha UAA), në SEE dhe BE



Shënim: [1]Suvencionet për eksportet nuk përfshihen

Burimi: Databazat APM të vendeve të SEE-së, Databaza OECD PSE/CSE, KE

Në një farë mënyre, nuk është çudi: në qoftë se niveli aktual i mbështetjes buxhetore në vendet e SEE-së krahasohet me nivelet e mbështetjes para anëtarësimit në disa shtete të reja anëtare (Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Polonia, Sllovenia, Sllovakia), mund të shihet se pesë vjet përpara anëtarësimit situata tek këto të fundit ishte mjaft e ngjashme me situatën aktuale në vendet e SEE-së.

Është fakt që në ekonomitë në tranzicion më pak të zhvilluara, buxheti i bujqësisë zakonisht është modest, edhe për shkak të prioritetit të çështjeve të tjera (sociale dhe ekonomike), dhe kjo ndodh ngjashmërisht edhe për vendet e SEE-së. Megjithatë duhet theksuar se Kroacia është një përjashtim i qartë. Ajo është ekonomikisht vendi më i zhvilluar nga të gjitha vendet e SEE-së dhe nga viti 2013 është edhe anëtare eBE-së, dhe bujqësia e saj u mbështet nga fonde shumë më të larta buxhetore se vendet e tjera të SEE-së, qoftë edhe para anëtarësimit.

Figura A.II-11: Ecuria e totalit të shpenzimeve buxhetore për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale[1], 2008-2012 (2012=100), në SEE dheEU-27



Shënim: [1]Suvencionet për eksportet nuk përfshihen

Burimi: Databazat APM të vendeve të SEE, Databaza OECD PSE/CSE, KE

Në zhvillimin e mbështetjes për bujqësine mund të vërehen disa modele të ndryshme. Në Shqipëri dhe Serbi ka luhatje të konsiderueshme në nivelet e mbështetjes, ndërsa në Kosovë* dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë shfaqen trende të forta pozitive. Një rënie e lehtë në vitet e fundit është regjistruar në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi dhe Kroaci.

Figura A.II-12: Evoluimi i shpenzimeve totale buxhetore për sektorin agro-ushqimor dhe zonatrurale[1], 1999-2003 (indeksi, 2003=100), EU-15 dhe disa vende anëtare



Shenim: [1]Suvencionet për eksportet nuk përfshihen

Burimi: Databaza OECD PSE/CSE

Në disa ShteteAnëtare të BE-së, në periudhën para-anëtarësimit, mbështetja buxhetore për bujqësinë tregoi në përgjithësi një trend rritës. Përshtatja me politikën e BE-së në mënyrë të paevitueshme çon në rritjen e shpenzimeve buxhetore. Qeveritë zakonisht i kushtojnë vëmendje të veçantë bujqësisë; ata dëshirojnë të përgatisin prodhuesit për një treg të vetëm, të rrisin thithjen e fondeve para dhe pas anëtarësimit në BE, dhe nganjëherë të përmirësojnë pozitën e tyre në negociatat e anëtarësimit.

Kriza e rëndë ekonomike që ka goditur vendet e SEE-së në vitet e fundit e ka bërë të parashikueshme - dhe në disa raste të paevitueshme – vështirësinë e rritjes së burimeve buxhetore bujqësore. Kriza ekonomike ndoshta është edhe një nga arsyet kryesore për luhatjet apo ecurinë në nivele modeste të mbështetjes buxhetore në disa nga vendet e SEE-së.

Përbërja e mbështetjes buxhetore për bujqësinë

Përbërja e mbështetjes buxhetore për bujqësinë varion në mënyrë të konsiderueshme sipas vendeve. Në përgjithësi, mund të vërehet se sa më i madh buxheti total, aq më e madhe edhe pjesa e fondeve për masat e mbështetjes direkte të prodhuesve dhe tregut (masat e Shtyllës së parë). Pra, pjesa e kësaj shtylle të politikës është relativisht e lartë në Serbi, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kroaci. Në këto vende, kjo përqindje është më e lartë se në BE dhe më e lartë se sa ishte në shtetet e reja anëtare përpara anëtarësimit.

Do të duket sikur të gjitha vendet e SEE-së i kanalizojnë të gjitha shtesat në buxhetin e bujqësisë pothuajse tërësisht në prodhim direkt dhe mbështetje të të ardhurave për fermerët.

Masat e zhvillimit strukturor dhe rural (Shtylla e dytë) dhe masat e përgjithshme mbështetëse për bujqësinë (Shtylla e tretë) zakonisht renditen pas mbështetjes së prodhimit, me përjashtim të Kosovës* dhe Shqipërisë,por shumat aktuale në këto dy vende janë shumë të ulëta.

Veçanërisht në Shqipëri por edhe në Kosovë*, një pjesë e konsiderueshme e fondeve për masat e mbështetjes bujqësore sigurohet nga donacione të cilat fokusohen më së shumti në zhvillimin rual.

Figura A.II-13: Shpenzimet buxhetore totale për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale sipas shtyllave të APM[1], në SEE dhe BE



Shenim: [1]Subvencionet për eksportet nuk përfshihen,
Burimi: Databazat APM të SEE-së, Databaza OECD PSE/CSE, KE

4.3 Masat e mbështetjes direkte të prodhuesve dhe tregut

Në kuadër të shtyllës së parë të politikës bujqësore, përqindja më e madhe e fondeve deri tani i takon masave mbështetëse direkte të prodhuesve. Në vitin 2012, disa masa mbështetëse të tregut (ndërhyrje duke blerë), kanë ekzistuar vetëm në Kroaci (3 përqind e fondeve të totalit të shtyllës së parë), Bosnjë dhe Hercegovinë (3 përqind) dhe Mali i Zi (6 përqind). Kjo na çon në përfundimin se politika e çmimeve të tregut nuk është e rëndësishme në rajon, i cili në një farë mënyrë është i kuptueshëm nga fakti që shumica e vendeve janë importuese neto të ushqimit, ndërsa këto masa janë më tipike për vendet me teprica ushqimore (dhe pa një politikë të gjerë të pagesave direkte), siç ishte rasti iBE-së para vitit 1992. Në këtë mënyrë analiza e detajuar është fokusuar vetëm në pjesën e shtyllës së parë që është e lidhur me masat e mbështetjes direkte të prodhuesve.

Figura A.II-14: Mbështetja direkte e prodhuesve sipas grupit të masave, SEE dhe BE



Burimi: Databazat APM të SEE-së, Databaza OECD PSE/CSE, KE

Nivelet dhe sidomos struktura e masave të mbështetjes direkte të prodhuesve variojnë në mënyrë të konsiderueshme midis vendeve. Në Shqipëri, fondet për këtë grup të masave janë shumë modeste (më pak se 2 euro për ha). Në Kosovë*, Bosnje & Hercegovinë dhe Mal të Zi, këto fonde janë më të larta, por qëndrojnë nën nivelin e 30 EUR për ha. Pesë vite para anëtarësimit, në Republikën e Çekisë, Poloni dhe Estoni janë përdorur nivele të ngjashme të ulëta të mbështetjes. Niveli i mbështetjes direkte të prodhuesve në Serbi është rreth 60 euro për ha e cila është e krahasueshme me atë tëSllovakisë dhe Sllovenisë. Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me rreth 110 euro, është e krahasueshme me Hungarinë pesë vjet para anëtarësimit. Sërisht bën përjashtim Kroacia me rreth 260 euro për hektar,ku mbështetja direkte për hektar e prodhuesve është dukshëm më e lartë se sa ajo që ofrohej në shtetet e reja anëtare në periudhën e para-anëtarësimit.

Shumica e vendeve në rajon tregojnë një ecuri pozitive të fondeve për masat mbështetëse direkte të prodhuesve në vitet më të fundit (me disa luhatje, veçanërisht në Serbi dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë). Këto janë edhe fondet që kontribuan më së shumti me evoluimin e përgjithshëm të buxhetit për bujqësinë. Është interesante të theksohet se në Kroaci pesë vjet para anëtarësimit (2008), niveli i mbështetjes direkte për hektar e tejkaloi mesataren e BE-së: më pas,prej vitit 2010, kjo mbështetje ka qenë në rënie për të arritur nivelin e krahasueshëm të BE-së në vitin 2012.

Figura A.II-15: Ecuria e shpenzimeve (EUR/ha UAA) dhe përbërja e masave të mbështetjes direkte të prodhuesve (%), në SEEdhe BE



Burimi: Databazat APM të SEE-së, Databaza OECD PSE/CSE, KE

Përbërja e masave të mbështetjes direkte të prodhuesve në përgjithësi nuk ka ndryshuar shumë përgjatë viteve. Pjesa më e madhe i takon formave të ndryshme të pagesave direkte për prodhuesit. Përjashtimi i vetëm është Serbia, ku në vitet e kaluara pjesa më e madhe e pagesave ishin në formën e subvencioneve për inputet variable.

Krahasuar me vendet e BE-së, të gjitha vendet e SEE-së kanë strukturë mjaft të ndryshme të pagesave direkte. Pagesat direkte për prodhimin (garantimi i çmimeve), metodë kjo e vjetër në BE, është shumë e zakonshme në Bosnje& Hercegovinë dhe në ish-Republikën Jugosllave të

Maqedonisë. Në Mal të Zi dhe Kosovë*, e në vitin e fundit edhe në Serbi, shumica e pagesave ka pasur formën e pagesave mbi sipërfaqe dhe për krerë bagëti të lidhura me mallra specifikë, formë e cila në BE ka qenë zbatuar në shkallë më të gjerë përpara reformës së CAP në vitin 2003. Nga ana tjetër, pagesat e përgjithshme në bazë të të drejtave historike, të cilat tani në BE përfaqësojnë më shumë se 70 përqind të masave të mbështetjes direkte të prodhuesve, deri më tani janë paraqitur vetëm në Kroaci në vitin e fundit para anëtarësimit. Krahasimi i shpërndarjes së fondeve të mbështetjes direkte të prodhuesve sipas grupmallrave dhe mallrave paraqet rezultate interesante.

Tabela A.II-11: Shpërndarja e fondeve për masat e mbështetjes direkte për prodhuesit sipas grupmallrave dhe mallrave, 2012, në SEE

AL	BA	XK	MK	ME	RS	HR
Dele dhe Dhi 70%	Qumësht 54%	Grurë 46%	Duhan 27%	Gjedhi 33%	Të gjitha bimët e arave 43%	Të gjitha bimët 55%
Qumësht 17%	Të gjitha bimët e arave8%	Qumësht 25%	Dele dhe Dhi 15%	Qumësht 31%	Të gjitha bimët 34%	Të gjitha produktet 14%
Produkte të tjera shtazore 6%	Gjedhi 8%	Dele dhe Dhi 16%	Rrush 14%	Dele dhe Dhi 19%	Qumësht 14%	Gjedhi 10%
Gjedhi 2%	Grurë 4%	Misër kokërr 7%	Të gjitha bimët e arave 13%	Bimë 14%	Të gjitha prodhimet blegtorale 8%	Qumësht 6%
Perime 2%	Derra 3%	Produkte shtazore 4%	Gjedhi 10%	Patate 2%		Pagesa të përgjithshme 5%
Vaj ulliri 2%	Perime 3%	Luledielli 1%	Qumësht 7%	Duhan 1%		Dele dhe Dhi 3%
	Fruta 3%		Perime 6%			Duhan 2%
	Bimët foragjere 3%		Pigs 2%			Derra 1%
	Shpendë 2%		Produkte të tjera shtazore 2%			Panxhar sheqeri 1%
	Te gjitha produktet 2%		Perime 1%			Bimë foragjere 1%
	Të tjera 9%		Të tjera 3%			Të tjera 1%

Burimi: Databaza APM e SEE

Në Shqipëri, Bosnjë & Hercegovinë dhe Mal të Zi, shumica e fondeve janë shpërndarë për sektorin e kafshëve; në Kosovë*, të dy sektorët janë mbështetur në mënyrë pothuajse të barabartë, dhe në Serbi, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe Kroaci, shumica e fondeve janë të destinuara për prodhimin bimor. Një strukturë e tillë mund të shpjegohet pjesërisht nga ndryshimet në strukturat e prodhimit. Kjo vjen ndoshta për shkak të prioriteteve të ndryshme të politikës bujqësore të çdo vendi.

Diferencë e madhe midis vendeve mund të gjendet edhe në numrin e mallrave dhe grupeve të mallrave që janë duke u mbështetur. Ky numër është veçanërisht i lartë në Bosnje & Hercegovinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Kroaci. Në shumicën e vendeve të SEE-së një mbështetje e tillë është dhënë edhe për mallrat të cilat në BE nuk janë mbështetur nga pagesat direkte (p.sh. derrat dhe shpendët). Përpara anëtarësimit, Kroacia reduktoi numrin e produkteve të mbështetura në mënyrë të konsiderueshme. Përveç kësaj, një pjesë e madhe e pagesave specifike u zëvendësuan pak e nga pak me pagesa më pak specifike ose të përgjithshme (të gjitha pagesa për prodhimin bimor). Për shkak të numrit të madh të skemave të ndryshme të pagesave direkte

në shumicën e SEE-së, fondet në dispozicion janë shumë të shpërndara gjë e cila ndikon në efektivitetin e tyre dhe rrit barrën administrative.

Një pyetje interesante është se si mbështejta direkte shpërndahet midis prodhuesve bujqësorë. Disa ekspertë kombëtarë kanë raportuar se në disa raste, kriteret për ndarjen e fondeve tek prodhuesit janë të tilla që vetëm një numër i vogël i fermave mund t'i plotësojë ato. Si rregull, kriteret favorizojnë prodhuesit më të mëdhenj dhe në disa raste ata që prodhojnë për blerësit e organizuar (bulmetore, thertore, industria e blojës).

Një nga karakteristikat kryesore të politikës së mbështetjes direkte e të gjitha vendeve të SEE-së është paqëndrueshmëria e saj. Figura A.II-16 tregon nivelet absolute të pagesave direkte sipas vendit dhe sektorit për pesë vjet rresht. Për çdo vend të SEE-së, paraqiten pesë mallra apo grupmallra që kanë marrë më shumë fonde. Grafikët mund të mos jenë tepër të qartë, por lejojnë një lexim të lehtë të luhatjeve të niveleve të pagesave ndër vite. Ka shumë arsye për ndryshime të tilla të konsiderueshme në mbështetjen direkte të sektorëve kyç, duke filluar nga vonesa e pagesave nga viti në vit tek skemat e ndryshuara të pagesave. Megjithatë, këto luhatje janë të pafavorshme për prodhuesit. Përveç ndikimit direkt në të ardhurat e tyre, këto luhatje vështirësojnë planifikimin e zhvillimit afatgjatë.

Figura A.II-16: Pagesat direkte sipas grupmallrave me të përfaqësuara (milionë EUR), 2008-2012, në SEE



Burimi: Databazat APM të SEE-së

4.4 Masat e zhvillimit strukturor dhe rural

Siç shihet nga struktura e përgjithshme e transfertave buxhetore në bujqësi (Figura A.II-13), fondet për masat e zhvillimit strukturor dhe rural janë dukshëm më të ulëta se ato për mbështetje direkte të prodhuesve në shumicën e SEE-së. Në vitin 2012, fondet e përgjithshme për këtë shtyllë të politikës arritën në rreth 20 euro për hektar në shumicën e vendeve, e cila është vetëm rreth 10 përqind e nivelit të arritur në EU-27 në të njëjtin vit. Një situatë e ngjashme është vërejtur në Poloni dhe Estoni pesë vjet para anëtarësimit. Megjithatë, në Sllloveni, Republikën e Çekisë dhe Sllovaki, buxheti i para-anëtarësimit për masat e zhvillimit strukturor dhe rural ishte shumë më i lartë se sa është tani në vendet e SEE - 50 deri 70 EUR për ha, e cila është e krahasueshme vetëm me Kroacinë në vitin 2012. Veçanërisht në Serbi këto fonde ishin shumë të ulëta (vetëm 6 euro për ha në vitin 2012).

Figura A.II-17: Masat e zhvillimit strukturor dhe rural – përbërja sipas grupit të masave, në SEE dhe BE



Burimi: Databazat APM të SEE-së, Databaza OECD PSE/CSE, KE

Është e rëndësishme të theksohet se shumica e vendeve nuk kanë përjetuar rritje të dukshme në fondet për masat e zhvillimit strukturor dhe rural në vitet e fundit. Vetëm Kosova* (deri në 2009) dhe Mali i Zi janë karakterizuar nga trende pak a shumë rritëse. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë tregojnë luhatje ndër vite, ndërsa Serbia ka përjetuar rënie.

Figura A.II-18: Ecuria e shpenzimeve (EUR/ha UAA) dhe përbërja e masave të zhvillimit strukturor dhe rural (%), në SEE dhe BE



Burimi: Databazat APM të SEE-së, Databaza OECD PSE/CSE, KE

Veçanërisht në vitet e fundit, pjesa më e madhe e fondeve nga kjo shtyllë e politikave i përkasin grupit të masave të destinuara për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë, ndërsa dy

aspekteve të tjera të politikës së zhvillimit rural (p.sh. mjedisi dhe ekonomia dhe popullsia rurale), u është kushtuar më pak vëmendje. Kjo ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga BE-ja, ku pjesë pothuajse e barabartë e fondeve për këtë shtyllë të politikës (rreth 40 përqind) janë përkushtuar tekrritja e konkurrueshmërisë dhemasat e lidhura me mjedisin.

Në vendet e SEE-së, përgjatë viteve janë zbatuar masa të ndryshme mbështetëse. Në vitin 2012, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Kroacia ua dedikuan shumicën e fondeve mbështetjes së investimeve në fermë, kryesisht për investime në plantacione të bimëve shumëvjeçare. Në Shqipëri dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, mbështetja e përgjithshme për sektorin e bujqësisë përbëhej në pjesën më të madhe ose pothuajse e gjitha në formën e investimeve në infrastrukturën e ujitjes dhe menaxhimin e ujit. Të gjitha vendet e tjera të SEE-së ndanë një pjesë të fondeve për mbështetjen e përpunimit të ushqimit, si dhe marketingun e promovimin përgjatë të paktën një viti, por vlerat kanë qenë relativisht të ulëta, me përjashtim të Kroacisë.

Fondet e dedikuara për përmirësimin e mjedisit dhe zonave rurale janë të papërfillshme në shumicën e vendeve të SEE-së. Nga ana tjetër, në vitin 2012, mesatarja e BE-së ishte rreth 70 euro për ha për këtë grup të masave në formën e pagesave për fermerët në zonat më pak të favorizuara, si dhe pagesat për agro-mjedisin dhe mirëqenien e kafshëve. Vetëm Kroacia kishte disa pagesa të konsiderueshme të këtij lloji (rreth 15 euro për ha). Në vendet e tjera të SEE-së, pati përpjekje vetëm për të bërë pagesa të caktuara mjedisore, kryesisht në formën e mbështetjes për bujqësinë organike dhe të burimeve gjenetike lokale.

Problemi më sfidues nga pikëpamja e zhvillimit të balancuar territorial të SEE-së, është mungesa e masave për të mbështetur zonat më pak të favorizuara (LFA). LFA-të përfaqësohen fuqishëm në të gjitha vendet e SEE-së dhe si rregull përballen edhe me probleme serioze demografike dhe sociale (rënie e popullsisë, varfëria rurale).

Fondet për mbështetjen e ekonomisë dhe popullsisë rurale janë gjithashtu modeste. Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia financuan disa projekte infrastrukturore në zonat rurale, si dhe investime për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në fermë (p.sh. turizmi rural). Në vende të tjera, praktikisht nuk ka pasur masa të tilla. Kjo nuk do të kishte kaq shumë rëndësi në qoftë se zonat rurale do të përkraheshin siç duhej nga masat e politikës rajonale. Megjithatë, në vendet e SEE-së kjo nuk ndodh. Pavarësisht se nuk ka patur ndonjë analizë të plotë të çështjes, ekspertët kombëtarë dëshmojnë për problemet në këtë fushë; është fakt se çështjet e zhvillimit bujqësor nuk mund të zgjidhen pa përpjekje shumë intensive për të rritur mundësitë e punësimit të popullsisë rurale në aktivitete jobujqësore.

4.5 Masat e mbështetjes së përgjithshme

Në shumicën vendeve të SEE-së të dhënat mbi masat e mbështetjes së përgjithshme nuk janë të besueshme dhe në disa vende edhe të paplota (Serbi). Masat e mbuluara nga kjo shtyllë e politikave, të tilla si mbështetje e përgjithshme të shërbimeve tëkërkimit, zhvillimit, dhe këshillimit për bujqësinë, financimi publik i masave në fushën e sigurisë ushqimore dhe cilësisë së ushqimit (masat veterinare dhe fitosanitare) dhe masa të tjera të një karakteri të përgjithshëm janë më së shumti të papërfillshme në krahasim me shtylla të tjera të politikave bujqësore. Në BE shumë prej këtyre masave i përkasin ndihmës së shtetit dhe nuk financohen nga buxheti i Komunitetit. Për më tepër edhe në BE fondet për këtë shtyllë të politikave janë në përgjithësi relativisht të ulëta (rreth 30 euro për ha).

Figura A.II-19: Masa të përgjithshme mbështetëse, 2012, në SEEdhe BE



Burimi: Databazat APM të SEE-së, Databaza OECD PSE/CSE, KE

Në shumicën e vendeve të SEE-së, siguria ushqimore dhe kontrolli i cilësisë merr pjesën më të madhe të fondeve në këtë shtyllë të politikave. Këto pjesë janë veçanërisht të larta në Kosovë*, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kroaci dhe Shqipëri. Në Bosnjë & Hercegovinë, dhe Mal të Zi përveç sigurisë ushqimore dhe kontrollit të cilësisë, edhe përqindja e buxhetit për shërbime këshillimi, zhvillimi, këshillimi dhe ekspertize është relativisht e lartë. Megjithatë, duke marrë parasysh buxhetin total modest për masat e përgjithshme, të gjitha këto shërbime mbështeten me vlera mjaft të ulëta. Në të gjitha vendet, shumica e fondeve është përdorur për financimin e institucioneve që ofrojnë shërbime ekstensioni dhe këshillim ekspertësh.

Deri tani, ndryshimet në fondet për shërbimet ekzistojnë kryesisht për shkak të rritjes së fondeve për çështjet e sigurisë ushqimore, pjesërisht detyruar nga procesi i integrimit evropian dhe nevoja për rritjen e kapaciteteve institucionale për të përmbushur standardet e BE-së në këtë fushë. Fondet buxhetore për gjenerimin e dijes dhe transferimit të saj tek prodhuesit bujqësorë në përgjithësi nuk janë në rritje (me përjashtim të Kosovës*) duke treguar ndërgjegjësimin e dobët për rëndësinë e dijes në zhvillimin e bujqësisë.

5. Konkluzione

Bazuar në analiza empirike, karakteristikat kryesore të bujqësisë dhe politikës bujqësore të vendeve të SEE-së krahasuar me vendet e BE-së mund të përmblidhen në mënyrë të përgjithshme në konstatimet e mëposhtëme:

Bujqësia

- Bujqësia në të gjitha vendet e SEE-së ka rëndësi shumë më të madhe ekonomike se në vendet anëtare të BE-së, fakt i cili reflektohet në kontributin në GVA (5-21 përqind) dhe në punësim (14-55 përqind) si edhe në tregtinë e jashtme. Bujqësia është gjithashtu një faktor i rëndësishëm në sigurimin e ekuilibrit social pasi punëson një pjesë të madhe të popullsisë rurale.
- Karakteristikat gjeografike në vendet e SEE-së janë shumë të ndryshme; burimet natyrore për bujqësinë janë të shumëfishta në Serbi e cila ka pjesë më të madhe të tokës bujqësore

(ndaj sipërfaqes totale) krahasur me vendet e tjera të SEE-së apo pjesën më të madhe të vendeve anëtare tëBE-së,si edhe më shumë tokë bujqësore(veçanërisht tokë të punueshme) për frymë.

- Potencialet e prodhimit natyror janë përdorur pjesërisht në vendet e SEE-së. Të dhënat e disponueshme tregojnë lënien djerrë të një pjese të lartë të tokës së punueshme (10-50 përqind) si edhe mospërdorim ose përdorim të dobët të kullotave, sidomos kullotave me produktivitet të ulët. Kullotat kanë rëndësi të veçantë në Mal të Zi dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, si edhe në Bosnje dhe Hercegovinë.
- Tipike për të gjitha vendet e SEE-së është struktura duale e fermave ku mbizotërojnë fermat bujësore me madhësitë vogël. Madhësia mesatare e fermës (1.5-5.6 ha) është e krahasueshme vetëm me vende shumë të vogla në BE (të gjithë vendet e SEE-së renditen midis Maltës dhe Sllovenisë). Fermat e vogla mbizotërojnë në numrin total në të gjitha vendet e SEE-së, dhe në Shqipëri, Kosovë* dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisëato përfaqësojnë gjithashtu pjesën dominuese në sipërfaqen bujqësore të përdorur. Në Mal të Zi, Kroaci dhe Serbi, përveç fermave të vogla familjare, ka edhe një numër të vogël fermash shumë të mëdha që zënë një përqindje të konsiderueshme të sipërfaqes bujqësore totale (20-40 përqind).
- Prodhimi bimor zë pjesën më të madhe të prodhimit bujqësor total (50-74 përqind). Volumi i prodhimit bujqësor varion shumë nga viti në vit pa ndonjë trend të dukshëm (përveç Shqipërisë prodhimi i së cilës po rritet). Rendimentet mesatare të kulturave kryesore si dhe qumështit janë ndjeshëm nën nivelin e EU-27.
- Çmimet e produkteve bujqësore në vendet e SEE-së më së shumti ndjekin zhvillimet e çmimeve në BE, duke treguar se tregjet e tyre bujqësore janë relativisht të hapura. Nivelet e çmimeve të prodhimit të produkteve bujqësore bazë në përgjithësi janë më të ulëta në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë dhe relativisht të larta në Shqipëri dhe Kosovë*. Krahasuar me BE-në, çmimet e prodhimit bimor janë disi më konkuruese, ndërsa çmimet e prodhimeve blegtorale janë më të larta se në shumicën e Shteteve Anëtare të BE-së.
- Me përjashtim të Serbisë, të gjitha vendet e SEE-së janë importues neto të produkteve bujqësore. Sufiçiti i tregtisë së jashtme të Serbisë ka qënë duke u rritur në vitet e fundit (me nja raport të mbulimit eksport/import afërsisht 200 përqind), duke treguar një bilanc tregtar pozitiv në pjesën më të madhe të grupeve të produkteve agro-ushqimore. Bilanci tregtar është mjaftnegativ në Kosovë*, Mal të Zi, Shqipëri dhe Bosnje & Hercegovinë, me një raport mbulimi eksport/import prej 5-22 përqind dhe defiçitare në pothuajse të gjitha produktet agro-ushqimore. Në Kroaci dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, raporti i mbulimit të importeve me eksporte është mjaft më i lartë (rreth 60 dhe 75 përqind respektivisht). Kroacia ka sufiçit tregtar në një numër më të madh produktesh se Ish Repulbika Jugosllave e Maqedonisë. Produktet me origjinë bimore dominojnë eksportet e të gjitha vendeve të SEE-së. Për të gjitha vendet e SEE-së marrëdhëniet tregtare më të rendësishme janëbrenda rajonit dhe tregtia me BE-në.

Politikat bujqësore

- Në vitet e fundit, të gjitha vendet e SEE-së kanë adaptuar dokumente strategjik afatgjatë ose afatshkurtër, në të cilat u vendosën prioritetet dhe objektivat për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në përgjithësi dokumentet programuese janë pak a shumë të harmonizuara me parimet e BE-së.
- Në pjesën më të madhe të vendeve të SEE-së, fondet buxhetore për bujqësinë variojnë ndjeshëm nga viti në vit, por përgjithësisht me trende pozitive. Nivelet e përgjithshme të mbështetjes buxhetore për hektar të tokës bujqësore të përdour ndryshon sipas vendeve (nga rreth 25 EUR për ha në Shqipëri në 150 EUR në Ish Republikën Jugosllave të

Maqedonisë, dhe380 EUR në Kroaci). Në shumicën e vendeve (përveç Kroacisë) këto nivele janë shumë më të ulëta krahasuar me nivelin aktual të EU-27 (rreth 480 EUR për ha).

- Në përbërjen e fondeve buxhetore totale për bujqësinë, në shumicën e vendeve të SEE-së (përveç Shqipërisë dhe Kosovës*) mbështetja direkte për prodhuesit zë pjesën më të madhe (40-90 përqind). Forma më mbizotëruese e mbështetjes direkte e zbatuarnë shumicën e vendeve të SEE-së janë pagesa të lidhura me produkte të caktuara për sipërfaqe ose për krerë bagëti. Mbështetja direkte është zbatuar edhe në formën e kompensimit të çmimeve (dominuese në Bosnje dhe Hercegovinë, të rëndësishme edhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë) dhe subvencioneve për inpute variable. Mbështetja direkte e prodhuesit përfaqëson gjithashtu pjesën më të madhe në strukturën e buxhetit bujqësor të EU-27 (rreth 60 përqind), por shumica e fondeve janë paguar si pagesa fikse të palidhura me prodhimin. Niveli relativ i mbështetjes direkte (rreth 280 euro për hektar e UAA) është shumë më i lartë se në vendet e SEE-së (nga më pak se 5 euro për ha në Shqipëri në rreth 110 euro për ha në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe 260 euro për ha në Kroaci).
- Në vendet e SEE-së, niveli i fondeve buxhetore për mbështetjen e zhvillimit strukturor dhe rural (nga më pak se 10 euro për ha të UAA në Serbi në rreth 35 euro për ha në Kosovë*, dhe 80 euro për ha në Kroaci), përgjithësisht është nën nivelin e fondeve për masën e shtyllës së parë. Sipas kësaj shtylle (të dytë) të politikave, shumica e fondeve (75-100 përqind) janë përdorur për përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit agro-ushqimor duke siguruar mbështetje për investimet në fermë, infrastrukturën e vaditjes, menaxhimit të ujërave, si dhe masa të ngjashme. Masat e lidhura me mjedisin dhe masa që synojnë mbështetjen e ekonomisë dhe popullsisë rurale janë zbatuar në shkallë të ulët në SEE (me përjashtim të Kroacisë). Në EU-27, të tre grupet bazë të masave (konkurrenca, mjedisi, zonat rurale) janë të përfaqësuara në mënyrë më të barabartë (43 përqind, 42 përqind, 15 përqind), dhe niveli relativ i mbështetjes për këtë shtyllë të politikave (rreth 165 euro për ha) është shumë më i lartë se në çdo vend të SEE-së.
- Financimi i shërbimeve të përgjithshme për bujqësinë përfaqëson pjesën më të vogël të buxhetit bujqësor total në të gjitha vendet e SEE-së, dhe po ashtu niveli relativ i fondeve të caktuara për këtë shtyllë të politikës është modest. Këto fonde janë përdorur pjesërisht për financimin e shërbimeve veterinare dhe fitosanitare dhe pjesërisht për mbështetjen e kërkimit, ekstensionit, shërbimeve të ekspertëve dhe ngritjen e përmirësimin e institucioneve nëbujqësi.
- Në përgjithësi, mund të thuhet se politika bujqësore e zbatuar në vendet e SEE-së nuk është në përputhje me politikën aktuale bujqësore në BE në çdo aspekt (përveç Kroacisë, tashmë anëtare e BE-së). Nga ana tjetër, niveli relativ i mbështetjes buxhetore, si dhe përbërja e tij, është mjaft i krahasueshëm me atë që është regjistruar në disa shtete të reja anëtare në periudhën para anëtarësimit në BE (1999), por prej asaj kohe CAP është reformuar në mënyrë të konsiderueshme.
- Rregulloret vjetore që udhëheqin zbatimin e politikave bujqësore si dhe analiza e mbështetjes buxhetore në bujqësi tregojnë se politika aktuale bujqësore e vendeve të SEE-së karakterizohet kryesisht nga një qasje në bazë prodhimi dhe sektori. Pra prodhimi dhe prodhuesit bujqësorë janë shqetësimi kryesor përpolitikëbërjen, ndërsa elementet e tjera të zinxhirëve agro-ushqimorë, si dhe çështjet e mjedisit dhe çështje të përgjithshme të zhvillimit rural, zakonisht kanë vëmendje më të dobët.

Komentet përfundimtare për çështjen e të dhënave

Kur adresohen rezultatet e analizës krahasuese midis vendeve, duhet marrë në konsideratë fakti se në mënyrë që të sigurohet një kornizë e qartë në lidhje me bujqësinë dhe politikat bujqësore në

këtë rajon nevojitet një sasie madhe e të dhënave dhe informacionit, por kjo ende nuk është e disponueshme ose besueshmëria e këtij informacioni është i diskutueshëm.

Në të gjitha vendet e SEE-së, me përjashtim të Kroacisë, e cila tashmë është anëtare e BE-së, përmirësimi dhe harmonizimi i statistikave bujqësore sipas kërkesave të BE-sëështë në proces . Për Kroacinë, harmonizimi i statistikave bujqësore ka qenë një pikë referimi për fillimin e negociatave në bujqësi për anëtarësim në BE. Edhe pse në vitet e fundit është arritur një progres në të gjitha vendet e SEE-së, ka ende shumë për t'u bërë në mënyrë që statistikat bujqësore të jenë plotësisht të harmonizuara me BE-në. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka përparuar më shumë në këtë fushë, ndërkohë që statistikat bujqësore në Shqipëriduket të jenë më pak të besueshme.

Statistikat e përdorimit të tokës janë ndër fushat më problematike statistikore në të gjitha vendet e SEE-së. Të dhënat mbi përdorimin aktual të tokës nuk janë të qarta as në vendet në të cilat anketa e strukturës së fermës është kryer në përputhje me rregullat e BE-së (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia). Në këto vende, ka një mospërputhje të madhe midis të dhënave nga statistika të rregullta vjetore të përdorimit të tokës e cila është ende baza për vlerësimin e prodhimit bimor dhe sipërfaqes bujqësore të përdorur, regjistruar nga anketa e strukturës së fermës. Kjo diferencë tregon se të dhënat aktuale mbi prodhimin bimor (dhe rendimentet mesatare), nuk janë plotësisht të besueshme në çdo vend të SEE-së. Disa vende ende nuk kanë të dhëna të besueshme (dhe të ngjashme), ndërsa disa të tjera nuk kanë asnjë të dhënë në fusha të tjera të rëndësishme të statistikave bujqësore. Të tilla fusha janëstatistikat e strukturës së fermës në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*, prodhimi blegtoral në Kosovë* dhe Bosnje dhe Hercegovinë, statistikat e çmimeve në Mal të Zi dhe Shqipëri). Statistikat bujqësore primare të plota dhe të besueshme (prodhimi, çmimet) janë gjithashtu një parakusht për përpilimin e llogarive ekonomike për bujqësinë, i cili në vendet e SEE-së ende mungon (Shqipëri, Serbi, Malii Zi, Bosnje dheHercegovinë).

Për sa i përket mbështetjes buxhetore për bujqësinë, problemi kryesor është se të dhënat mbi pagesat e kryera realisht nuk mblidhen dhe prezantohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në çdo vend. Informacioni publikisht i disponueshëm është më së shumti i kufizuar në programe për mbështetje financiare për bujqësinë si një dokument ligjor për zbatimin e politikës bujqësore në një vit të caktuar. Të dhënat mbi fondet e paguara përgjithësisht nuk janë publike prandaj përpjekje të mëdha nevojiten për të siguruar të dhëna të plota të detajura në nivelin e nevojshëm për të bërë krahasime ndërmjet vendeve dhe peridudhave të caktuara.

Në këtë kontekst, një nga çështjet kryesore për t'u adresuar është përmirësimi i statistikave bujqësore dhe baza e të dhënave që regjistrojnë zbatimet e masave të politikave. Të dhënat e besueshme dhe të harmonizuara janë një parakusht për një bujqësi solide dhe monitorim dhe programim të qëndrueshëm të politikave bujqësore të cilat mund të përdoret më pas edhe për programimin dhe zbatimin e politikave.

Referencat

EC. 2014. Rural development in the European Union – Statistical and economic information. Directorate General for Agriculture, European Commission, Brussels. http://ec.europa.eu/agriculture/statistics/rural-development/index_en.htm.

EUROSTAT. 2014. Statistics. Eurostat. Luxembourg. http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/themes.

OECD PSE/CSE Database. 2014. Producer and Consumer Support Estimates database. OECD, Paris. http://www.oecd.org/chile/producerandconsumersupportestimatesdatabase.htm.

Rednak, M. & Volk, T. 2010. Agricultural policy measures template – A tool for classifying and analysing agricultural policy measures. In: VOLK, T. (ed.). *Agriculture in the Western Balkan countries*, (Studies on the agricultural and food sector in Central and Eastern Europe, vol. 57). Halle (Saale): Leibniz-Institut für Agrarentëicklung in Mittel- und Osteuropa (IAMO), 219-245.

Rednak, M., Volk, T. & Erjavec, E. 2012. Does accession to European Union substantially change the economic situation in Croatian agriculure: impact assessment for key production sectors on the basis of static deterministic farm revenue modelling. *Agricultura*, [Print ed.], vol. 9, no. 1/2, p. 39-47.

Rednak, M., Volk, T. & Erjavec, E. 2013. A tool for uniform classification and analyses of budgetary support to agriculture for the EU accession countries. *Agricultural Economics Review*, vol. 14, no. 1, p. 76-96.

SEEs APM Databases. 2014. Agricultural Policy Measures Databases compiled for Albania, Bosnia and Herzegovina, Croatia, Kosovo*, The former Yugoslav Republic of Macedonia, Montenegro and Serbia under the FAO/SWG project "Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession" (unpublished data).

SEEs Statistics. 2014. Agricultural statistics databases compiled for Albania, Bosnia and Herzegovina, Croatia, Kosovo*, Macedonia, Montenegro and Serbia under the FAO/SWG project "Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession". http://app.seerural.org/agricultural-statistics/.

Volk, T. (ed.). 2010.Agriculture in the Western Balkan countries, (Studies on the agricultural and food sector in Central and Eastern Europe, vol. 57). Halle (Saale): Leibniz-Institut für Agrarentëicklung in Mittel- und Osteuropa (IAMO), 245 p. http://www.iamo.de/dok//sr_vol57.pdf.

Kapitulli A.III

ANALIZA E HENDEQEVE DHE REKOMANDIME

Emil Erjavec[*], Kaj Mortensen[**], Tina Volk[***], Miroslav Rednak[***], Richard Eberlin[***], Katalin Ludvig[****]

1. Motivimi dhe fokusi

Ky studim ofron një pamje të përgjithshme sistematike të situatës dhe trendeve në bujqësi dhe politikat bujqësore të vendevetë Evropës Juglindore (SEE). Panorama e përgjithshme vendos theks të veçantë në krahasimin midis treguesve kryesor të politikave në rajon, si edhe me bujqësinë dhe Politikat e Përbashkëta Bujqësore (CAP) të Bashkimit Evropian (BE). Një analizë e hollësishme e vendeve përkatëse prezantohet në pjesën e dytë të studimit (Kapitujt BI-B.VII). Pjesa e parë e studimit ofron një analizë të plotë krahasuese midis vendeve (Kapitulli A.II), duke bërë të mundur identifikimin e disa tipareve të përbashkëta të bujqësisë së rajonit dhe zhvillimin e rekomandimeve për t'i dhënë formë politikës bujqësore në të ardhmen.

Ky kapitull tenton të përshkruajë hendeqet që përcaktojnë procesin e zhvillimit dhe integrimit të bujqësisë në vendet e SEE-së, dhe të adresojë rekomandime për politikën bujqësore në rajon. Kushtet natyrore specifike, strukturat e fermave, rrethanat historike, dhe situata të ndryshme ekonomike dhe politike kanë rezultuar në diferenca të rëndësishme midis vendeve, dhe mbase akoma më tej midis rajoneve brenda një vendi. Gjithashtu shkalla e integrimit Evropian ndryshon ndjeshëm midis vendeve përderisa rajoni i vëzhguar përfshin anëtare të BE-së (Kroacinë) si edhe vende kandidate (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë) dhe vende kandidate potenciale në BE (Bosnje dheHercegovinën, Kosovën*[17]) duke rezultuar në sjellje dhe nevoja të ndryshme për sa i përket adaptimit të parimeve dhe mekanizmave të CAP.

Gabimi më i zakonshëm që bëjnë vendet kandidate gjatë procesit të integrimit është se vendimet për të integruar disa nga instrumentet kryesorë të politikës për të qenë gati për zbatimin e CAP merren në një fazë shumë të vonuar të procesit të integrimit, çka i bën vendet të paafta për të përfituar në mënyrë të plotë nga këto masa të politikës në çastin e anëtarësimit. Kjo situatë është reflektim i dinamikës politike dhe kontekstit ekonomik, si dhe fakti se qëllimi – adaptimi i CAP - është një objektiv i lëvizshëm. Megjithatë, përvoja nga zgjerimet e fundit të BE-së tregon se vendet kandidate duhet të miratojnë dhe zbatojnë vendime të rëndësishme strategjike në lidhje me adaptimin e CAP para se procesi i negociatave të finalizohet. Është gjithashtu e qartë se sa më shpejt të ndërmerren dhe zbatohen vendime të tilla aq më i përgatitur do të jetë vendi për pjesëmarrje të plotë në CAP.

[*] Universiteti i Ljubjanës, Fakulteti Bioteknik, Slloveni.

[**] KFM Consult.

[***] Insituti Bujqësor i Sllovenisë, Ljubljana, Departamenti i Ekonomiksit Bujqësor

[****] Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Shteteve të Bashkuara (FAO).

[17] Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozicioneve mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe opinionin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Qëllimi i kësaj pjese të parë të kapitullit është të identifikojë hendeqet kryesore dhe të sigurojë parime kyç të qarta, të thjeshta dhe operacionale të politikës së ardhshme bujqësore të cilat janë përgjithësisht të vlefshme për rajonin. Këto parime duhet të mbështesin përgatitjen e planeve të detajuara të veprimit për modernizimin e politikave bujqësore kombëtare dhe strategjinë për harmonizimin e instrumenteve të politikave me CAP.

Është ambicie e pjesës së parë së këtij kapitulli ndërtimi i një qasje strategjike për të vjelë maksimumin nga procesi i integrimit. Gjithashtu, në periudhën e para-anëtarësimit, vendet e pranuara do të mund të përfitojnë nga instrumentet e përzgjedhura të politikave të BE-së që mund të jenë të dobishme për të sjellë në afatin e shkurtër për realizimin e prioriteteve kombëtare të politikave në lidhje me zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale, dhe në afatin e gjatë, përgatitjen e bujqësisë vendase për pranimin dhe rritjen e kapaciteteve për thithje fondesh pas anëtarësimit.

Rekomandimet janë të bazuara në analiza, ekspertiza të autorëve kombëtarë, si dhe në bashkëpunimin midis komunitetit kërkimor dhe ministrive të bujqësisë të vendeve përkatëse.[18]Rekomandimet janë bazuar në parimet themelore për politikëbërje strategjike të mirë në përputhje me ciklin e politikave dhe konceptin e politikëbërjes bazuar në evidenca. Ato gjithashtu theksojnë rëndësinë e kushteve solide të kornizave dhe identifikimit të masave më të rëndësishme të politikave në këtë drejtim.

Një nga qëllimet e kësaj politike është që të demonstrojë rëndësinë e bashkëpunimit solid ndërmjet politikëbërësve dhe ekonomiksit bujqësor akademik në mbështetjen e procesit të vendimmarrjes në politikën bujqësore të vendeve të SEE-së. Diskutimi i kësaj çështjeje përbën pjesën e dytë të kapitullit që ka të bëjë me analizën e hendeqeve dhe zhvillimin e rekomandimeve për mbështetjen më efikase të analizës së politikave. Historia e zgjerimeve të mëparshme të BE-së tregon se një proces efikas i integrimit evropian në fushën e bujqësisë kërkon *politikë të bazuar në evidenca*; pra ndërmarrja e politikave publike të mbështetura mbi evidenca objektive dhe studime shkencore rigoroze që identifikojnë masat dhe praktikat efektive të politikave. Kapitulli përfundon me rekomandime rreth përmirësimit të efikasitetit të institucioneve mbështetëse që kryejnëanaliza. Sigurimi i të dhënave dhe analizave të qëndrueshme, krahasimeve të politikave, rikonceptimit të reformës, dhe vlerësimit të ndikimit të propozimeve dhe zgjidhjeve të ndryshme, si brenda vendit ashtu edhe në komunikim me institucionet evropiane dhe shtetet anëtare, është vendimtare për suksesin e procesit të integrimit dhe modernizimit të politikës bujqësore. Kapitulli përfundon me komentet përfundimtare.

2. Parimet e politikës moderne bujqësore –qasja rajonale e SEE-së

2.1 Sfidat kryesore të zhvillimit bujqësor

Krijimi i një standardi përvlerësimin e hendeqeve në bujqësi dhe zonat rurale nuk është një detyrë e thjeshtë. Qëllimet janë shpesh subjekt i nocioneve të ndryshme që janë të vështira për t'u realizuar në një kontekst të dhënë. Hendeqet për këtë arsye janë nxjerrë gjatë përpilimit të këtij studimi. Këto hendeqe janë identifikuar duke iu referuar kryesisht studimeve specifike të vendeve dhe diskutimeve me zyrtarë nga ministritë e interesuara dhe ekspertët kërkimorë kombëtarë.

Bujqësia renditet akoma ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë kombëtare në vendet e SEE-së, me kontribute të rëndësishme për stabilitetin ekonomik dhe social. Megjithatë, roli i saj nuk është një promovuese e zhvillimit ekonomik më shumë se sa një faktor zbutës isituatës sociale në

[18] Rekomandimet bazohen në përvojat e vendeve të pranuara nga raundi i fundit i zgjerimit të BE-së (2004-2013, sidomos Kroacisë), me negociatat e BE-së dhe me reformat e miratuara gjatë periudhës së përgatitjes së anëtarësimit. Ato janë të bazuara edhe në diskutimet e shumta që autorët kanë mbajtur pas vitit 2003, ndërkohë që në rajon ishin duke u hartuar strategjitë kombëtare të zhvillimit bujqësor .

këtë kohë krize ekonomike që mbizotëron në rajon. Produktiviteti i faktorëve në rajon është dukshëm më i ulët se mesatarja e BE-së, më së shumti për shkak të procesit të ngadaltë të konsolidimit të fermave dhe përdorimit pa efikasitet të faktorëve të prodhimit. Në veçanti, braktisja e disa rajoneve të caktuara nga popullsia dhe përthithja e forcës së tepërt të punës në bujqësi nga sektorë të tjerë, është një çështje e rëndësishme për zhvillimin e zonave bujqësore dhe rurale në shumicën e vendeve të SEE-së. Zinxhirët agro-ushqimorë po hasin probleme në krijimin e institucioneve të tregut, krijimin e zinxhirëve të marketingut dhe të shpërndarjes, në arritjen e standarteve të BE-së siç janë standartet e cilësisë, atyre veterinare, të shëndetit dhe higjienës, si dhe standardet fito-sanitare.

Konkluzioni i përgjithshëm i analizës është se në vitet e fundit është bërë progres në zhvillimin e bujqësisë në rajonin e Evropës Juglindore. Megjithatë, mbetet shumë për të përgatitur sektorët përkatës bujqësorë për presionet konkurruese të ekonomisë bashkëkohore botërore dhe për pranimin në BE, një arritje kjo e fundit e cila është në fokus të këtij studimi. Sfidat kryesore për zhvillimin e bujqësisë janë të përmbledhura në 11 pikat e mëposhtme.

Burimet

1. Kufizimet natyrore dhe potenciali itokës së papërdorur

Rajoni i SEE-së karakterizohet nga një pabarazi veri-jug për sa i përket potencialit të zhvillimit bujqësor. Baseni i Danubit në veri ka një nga potencialet më të mira bujqësore në Evropë, ndërkohë që potencialet që shfaqin vargmalet Dinarike, të cilat shtrihen përgjatë gjithë rrugës për në Mesdhe, është i shfrytëzuar vetëm në zona të caktuara përgjatë lumenjve dhe për produkte të caktuara. Potenciali natyror nuk shfrytëzohet plotësisht në pjesën veriore të rajonit, por shfrytëzimi i pakët i këtyre potencialeve është akoma më i theksuar në rajonet qendrore dhe jugore, të cilat përfshijnë disa zona të shpopulluara, të lëna djerrë, madje edhe të braktisura. Situata u rëndua edhe më shumë nga konfliktet në vitet 1990', dhe në disa zona, shpopullimi dhe braktisja e bujqësisë kanë avancuar në një shkallë të pakthyeshme. Këto zona janë veçanërisht kullota të përhershme, me potencial për rritjen e blegtorisëpor edhe prodhimin ekstensiv të frutave dhe pylltarisë. Sfida kryesore për këto zona është që në një masë të madhe ato janë zona me kufizime natyrore (zonat malore) dhe infrastrukturë të dobët.

2. Kufizimet e faktorit kapital dhe burimenjerëzore

Rajoni i SEE-së është një rajon i populluar në mënyrë të pabarabartë. Edhe pse është e vështirë për të siguruar një vlerësim të përgjithshëm, ka prova që popullsia e fermës është relativisht e vjetër dhe fuqia punëtore ka nivel të ulët arsimor, çka është një pengesë shtesë për zhvillimin. Infrastruktura e kapitalit (ndërtesa dhe makineri) është gjithashtu relativisht e vjetëruar dhe në fusha të caktuara shumë e vjetëruar. Për të modernizuar prodhimin në këto fusha kërkohen investime të konsiderueshme, ndërkohë që disa zona kanë kryer investime kapitale dhe kanë organizuar mirëzinxhirin agro-ushqimor duke arritur suksese në prodhimin bimor. Prodhimi blegtoral është përgjithësisht në rënie. Industria e bulmetit, megjithëse shumë e rëndësishme, bazohet në burime gjenetike jo optimale dhe mbi të gjitha në të ushqyerit e dobët të kafshëve. Kjo industri ka dështuar për të arritur produktivitet më të lartë dhe rezerva më të mëdha, pavarësisht mbështetjes së konsiderueshme.

3. Fragmentimi i tokës dhe struktura bimodale e fermës

Historia e zhvillimit, trashëgimisë dhe reformave të tokës në periudhën socialiste dhe tranzitore ka çuar në kushte veçanërisht të pafavorshme të reflektuara në madhësinë e fermës dhe të fragmentimit të tokës. Fermat e vogla dominojnë, në disa zona edhe në formën e fermave të subsistencës që nuk kanë burime për prodhim ekonomikisht të qëndrueshëm. Në shumë raste parcelat e fragmentuara të tokës paraqesin vështirësi shtesë, siç është rasti i tokave minerare, e cila ka rezultuar në braktisjen e prodhimit apo edhe banimit në disa zona, sidomos në rajonet karstike

(më afër Adriatikut) dhe, në një shkallë më të vogël, në zonat malore.Tregu i tokës në këto zona nuk është duke funksionuar.

Nga ana tjetër, në zonat më të favorizuara fushore, ekziston një rritje e pabarazisë midis fermave të vogla familjare, të cilat janë inferiore në madhësi dhe efikasitet, dhe fermave të mëdha ish-socialiste, tashmë të privatizuara dhe të transformuara në kompani të mëdha. Edhe pse numri i këtyre kompanive është i kufizuar, ato kanë tendencë për të zgjeruar më tej madhësinë e tyre të tokës dhe të dominojnë prodhimin bujqësor në rajonet ku ato janë të pranishme, duke kërcënuar ekuilibrin dhe stabilitetin shoqëror.

Prodhimi dhe produktiviteti

4. Produktiviteti i ulët dhe hendeqet teknologjike

Produktiviteti i ulët është një problem i nënvlerësuar në rajon. Hendeku teknologjik që ndikon në të gjitha aspektet e prodhimit është mëse i prekshëm. Sigurisht, ka edhe disa objekte dhe ferma të nivelit shumë të lartë, por këto shërbejnë vetëm për të nxjerrë në pah zhvillimin në përgjithësi të kufizuar të rajoneve në të gjithë treguesit kryesorë të produktivitetit (rendimentet, produktiviteti i punës dhe kapitali). Situata është më e mirë në veri sesa në jug. Në pjesët veriore prodhimi bimor tejkalon edhe prodhimin blegtoral në aspektin e produktivitetit dhe të teknologjisë. Ky i fundit tregon një hendek që reflekton nevojën për njohuri dhe shërbime më të mira publike dhe private të transferimit të dijes. Transferimi i njohurive si dhe mungesa e kapitalit janë ndër sfidat më serioze për t'u marrë në konsideratë.

5. Përqendrim dhe specializim i ulët i prodhimit

Rajoni karakterizohet kryesisht nga bujqësia për mbijetesë, si dhe përqendrim dhe specializim i ulët i prodhimit. Kjo situatë mund të ketë implikime të dobishme shoqërore në fusha të caktuara gjatë krizës ekonomike duke vepruar si një zbutës i papunësisë, por shqetësimi i vërtetë është se nuk ka shenja të rëndësishme të ndryshimeve strukturore që do t'i mundësonin fermave të vogla një zhvillim dhe rritje graduale, përqendrim dhe specializim, dhe si rezultat arritjen e një pozite më të mirë në treg dhe rritje të mirëqenies. Ka shembuj të rritjes, por ato janë duke shfaqur anomali, të tilla si fermat familjare të mbarshtimit të derrave që përdorin ushqim të shtrenjtë për kafshët apo fermat bulmetore që bazohen në barin e blerë, çka është mjaft e pakonceptueshme në ekonomitë më të zhvilluara. Në këtë drejtim,prodhimi blegtoral ka mbetur prapa prodhimit bimor, icili është më efikas.

6. Performancë relativisht e dobët e prodhimit

Të gjithë faktorët kufizues të lartpërmendur nënkuptojnë se prodhimi total bujqësor dhe aktiviteti individual i prodhimit është i pakënaqshëm. Megjithatë, ekzistojnë diferenca të konsiderueshme midis vendeve, rajoneve dhe sektorëve. Arsyet për këtë performancë të dobët janë të ndryshme dhe jo të lehta për t'u menaxhuar në periudhën afatshkurtër dhe pa ndryshime thelbësore në fokusin e strategjive kombëtare dhe masave politike. Sfidat kanë të bëjnë në veçanti me trajtimin e nivelit të ulët të njohurive dhe edukimine fermerëve, shërbimeve të dobëta të ekstensionit dhe shërbime financiare rurale të dobëta për të lehtësuar futjen e metodave moderne të prodhimit dhe investimeve në teknologji të reja.

Sfidat gjithashtu kanë të bëjnë me sektorin e përpunimit, e cili karakterizohet nga performancë relativisht e dobët e tregut dhe kosto të larta transaksioni për shkak të fragmentimit dhe nivelit të ulët të integrimit në zinxhirëve të vlerave. Kjo situatë e bën të vështirë sigurimin e një oferte të përshtatshme për shitësit lokalë dhe rajonalë për shkak se produktet nuk janë konkurruese as në çmim as në cilësi në lidhje me produktet e importuara, madje edhe në rastet kur pritet që vendet e SEE-së të mbulojnë plotësisht nevojat e veta, duke pasur parasysh potencialin e tyre (p.sh. mish, perime).

Sfidat kryesore në këtë drejtim do të jenë përmirësimi i funksionimit të zinxhirit të vlerave për sa i përket reduktimin të kostove të transaksioneve dhe përmirësimit të cilësisë së produktit nëpërmjet inovacionit dhe investimeve në teknologji të reja. Për më tepër, sfidë do të jetë përmirësimi i përgjegjshmërisë së zinxhirit të furnizimit për të siguruar një transferim efektiv të sinjaleve nga tregjet për përpunuesit dhe prodhuesit primar nëpërmjet inovacionit dhe transferimit të njohurive dhe bashkëpunimit të fortë midis sektorit privat dhe institucioneve kërkimore.

Zinxhiri i furnizimit agro-ushqimor

7. Agrobiznes i dobët

Analizat tregojnë se trajtimi i pasvjeljes dhe përpunimi i lëndëve të para në produktet ushqimore përfundimtare është një hallkë e dobët në prodhimin bujqësor dhe sistemin e tregjeve të vendeve të SEE-së. Shembuj nga vende të tjera, ndonjëherë edhe brenda rajonit, tregojnë se blerja e prodhimeve bujqësore në bazë të marrëveshjeve kontraktuale midis fermerëve dhe përpunuesve/bizneseve të shumicës, të cilat përfshijnë kërkesa për plotësimin e standarteve sasiore dhe cilësore, funksionon si një faktor i rëndësishëm nxitës për zhvillimin e bujqësisë. Vetëm disa aktorë në rajon përmbushin standartet e zinxhirëve modernë agro-ushqimorë. Veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara së fundmi kanë filluar të themelohen agrobiznesi, industritë e prodhimit të ndërmjetëm dhe prodhimit përfundimtar si dhe institucionet specifike të financave. Është shqetësuese që shumë biznese nuk përpiqen për të ndërtuar sisteme të qëndrueshme dhe të integruara furnizimi në bazë të lëndëve të para lokale, por preferojnë të importojnë materiale vetëm për arsye ekonomike afatshkurtra.

Ndërsa në pamje të parë ky nuk është një problem në vetvete, përvoja tregon se është e dëmshme për zhvillimin e prodhimit lokal, si në aspektin e sasisë ashtu edhe të cilësisë, apo dhe gjurmueshmërinë dhe besimin e konsumatorit. Mosbesimi në prodhimin dhe marketingun e ushqimit ndaj produkteve vendase rezulton jo vetëm nga mentaliteti i agrobiznesit, por edhe nga mungesa e vullnetit dhe pamundësia e prodhuesve për të hyrë në marrëdhënie të detyrueshme – si grupet e prodhuesve apo marrëveshjet kontraktuale - dhepër të kalitur lidhje reciproke brenda industrisë.

Histori suksesi në rajon tregojnë se problemi i vërtetë është zhvillimi i marrëdhënieve të besueshme me prodhuesit bujqësorë lokalë dhe rajonalë. Marrëveshjet afatgjata të prodhimit të ushqimit karakterizohen nga zinxhirë të mirë-përcaktuar të furnizimit, të mbështetura në produkte dhe aktivitete lokale si dhe forcimin dhe ruajtjen ebesimit midis aktorëve në zinxhirin e furnizimit, përfshirë këtu konsumatorët vendas dhe të huaj.

8. Integrim i dobët horizontal dhe vertikal

Organizimi i dobët i prodhimit në zinxhirët agro-ushqimorëështë një aspekt shqetësues i bujqësisë së vendeve të SEE-së, e cila ka një traditë të gjatë të kooperativave bujqësore - një ide e dobësuar dhe dëmtuar me forcë gjatë periudhës socialiste. Edhe pse ka raste të bashkëpunimit të mirë përmes kooperativave dhe integrimit horizontal (integrimi horizontal i vërtetë, i cili është baza e bujqësisë në botën e zhvilluar), praktika duket e paaftë të krijohet në një shkallë më të gjerë. Organizimi i prodhuesve në grupe prodhuesish apo kooperativa është shumë i kufizuar për shkak të rezistencës së fortë nga prodhuesit bazuar në përvojën e kaluar. Kooperativat janë kryesisht ose ekonomikisht të parëndësishme, ose të kufizuara tek blerja e lëndëve të para dhe furnizimi me inpute.

Prodhuesit e mirë janë në gjendje të sigurojnë lidhjete tyre me konsumatorët apo përpunuesit, dhe rrjedhimisht jo domosdoshmërisht kanë interes t'i bashkohen një kooperative ose grupi prodhuesish. Gjithsesi, megjithëse mund të duket se prodhuesit nuk mund të përfitojnë nga bashkimi me prodhues ekonomikisht më të dobët, këta të fundit përfaqësojnë akoma një pjesë të madhe të furnizimeve të tregut që tregothen në kushte që mund të jenë të dëmshme për

prodhuesit më të zhvilluar. Pra sfida kryesore është promovimi i avantazheve, edhe për prodhuesit e mirë, të organizimit më të mirë të furnizimit përmes bashkëpunimit dhe planifikimit të prodhimit për të menaxhuar si sasinë edhe cilësinë, dhe nëpërmjet përqendrimit të furnizimit të forcojnë pozitën negociuese .

Integrimi vertikal është shumë i kufizuar për shkak të mungesës së besimit midis furnizuesve dhe blerësve dhe mungesës së transparencës së tregut. Sjellja individualiste e prodhuesve bujqësorë është po ashtu e dukshmenë krijimin e marrëdhënieve të përhershme të biznesit me industrinë përpunuese. Marrëdhëniet e tilla janë të pranishme vetëm në disa sektorë (p.sh. mbarështimi i pulave, pjesërisht në sektorin e bulmetit), por jo në atasektorë ku pritej më shumë; domethënë, në prodhimin e frutave dhe perimeve. Mbetet sfidë përmirësimi i funksionimit të tregut nëpërmjet transparencës më të mirë në lidhje me çmimet e tregut dhe kërkesat e konsumatorit dhe sigurimi i kushteve të qëndrueshme ligjore dhe administrative për rregullimin e detyrimeve kontraktuale.

Çmimet dhe tregtia

9. Konkurrueshmëria me cilësi dhe çmime të ulëta

Analizat e çmimeve kanë treguar se vetëm aktivitete të caktuara të prodhimit në disa vende janë mjaftueshëm konkuruese në çmime për të rritur volumin e biznesit, por edhe në këto raste, mundësia për zhvillim është e kufizuar për shkak të strukturave të pamjaftueshme të tregut dhe ekonomitë e dobëta të shkallës. Të rrallë janë prodhuesit që arrijnë të tregtojnë produktet e tyre jashtë rajonit të SEE-së. Rrjedhimisht, eksportet janë minimale dhe shumica e eksporteve qëndron brenda rajonit. Megjithatë, veçanërisht shqetësues është ndikimi në konkurrueshmëri i cilësisë së ulët dhe ndryshueshmërisë së cilësisë. Përtej disa shembujve pozitivënë këtë fushë, mungesa e gjurmueshmërisë, standarteve të produktit, dhe trajtimit dhe përpunimit pasvjeljes i kërkuar nga sektori modern me pakicë dhe tregtia e jashtme, mbeten pengesa serioze për zhvillimin e mëtejshëm. Çështje të cilësisë së produktit, duke përfshirë përmirësimin teknologjik dhe zhvillimin e specialiteteve të cilësisë së lartë, nuk njihen mjaftueshëm.

10. Varësia nga tregtia e jashtme

Me përjashtim të Serbisë, të gjitha vendet e SEE-së janë importuese neto të ushqimit, disa madje në një masë që i bën ato irracionale në këndvështrimin makroekonomik. Aktualisht, varësia e lartë nga importet nuk është një kërcënim për sigurinë ushqimore përderisa sektori i zhvilluar i shitjes me pakicë importon nga vendet e tjera, sidomos nga vendet më të zhvilluara të rajonit (p.sh. Serbia dhe Kroacia). Megjithatë, varësia e lartë në importe mbetet një tregues shqetësues i bujqësisë dhe zinxhirëve agro-ushqimorëtë pazhvilluar, e cila është problematike, veçanërisht për shkak se vendet nuk janë duke shfrytëzuar potencialet e tyre natyrore dhe njerëzore. Me përjashtim të disa vendeve, prodhimi i ushqimit nuk është njohur zyrtarisht si një prioritet kombëtar, dhe aty ku është, realizimi i potencialeve nuk është shumë i qartë.

Karakteristikat rurale dhe rajonale

11. Ikja e popullsisë, gjendja e dobët sociale dhe prania e varfërisë rurale

Tiparet e vendbanimeve në Evropën Juglindore janë duke përjetuar ndryshime dramatike. Një numër i madh fshatrash, ndërtesash industriale dhe banimi të përhapura në pjesën më të madhe të rajonit janë braktisur ose ka të ngjarë të braktisen gjatë dekadës së ardhshme. Periudha tranzitore post-socialiste ishte veçanërisht e dëmshme në këtë drejtim, sidomos për shkak të rrënimit të modelit të mëparshëm të aktiviteteve të decentralizuara industriale dhe të përpunimit ushqimor. Humbjet në zhvillimin ekonomik bujqësor dhe rrënimi i përgjithshëm e la shumicën e popullsisë rurale të paaftë për të gjetur një punë në lokalitete duke larguar fuqinë punëtore nga këto zona. Kjo nga ana tjetër ka çuar në rrëzimin e bujqësisë me kohë të pjesshme që më parë ishte një kontribues i rëndësishëm në ekonominë rurale.

Varfëria rurale është një çështje reale në zonat rurale të Evropës Juglindore. Faktorët e lartpërmendur kontribuojnë për ekzistencën e saj dhe të kufizimit të punësimit në zonat rurale. Shumica e pjesës më dinamike dhe të aftë të popullsisë po braktis këto zona, duke kontribuar në degradimin social dhe ekonomik dhe rritjen e varfërisë.

Ka zona që shfaqin një farë progresi, por atojanë pak dhe nuk duhet të fshehin faktin se shpopullimi është në rritje në disa zona të Evropës Juglindore. Shumica e zonave rurale në rajon janë të paprivilegjuara dhe nuk kanë perspektiva afatmesme të qenësishme. Zhvillimi rural si i tillë mungon. Përkufizimi evropian i zhvillimit rural nuk është i vlefshëm për vendet e SEE-së ku zhvillimi rural nuk është i mbështetur nga iniciativat dhe kohezioni i duhur rajonal. Varfëria rurale dhe shpopullimi kërkojnë vëmendje të veçantë dhe veprim vendimtar të qeverisë për të frenuar ose ndryshuar situatën. Sfida kryesore është nxitja e krijimit të veprimtarive ekonomike shtesë në këto zona duke zhvilluar potencialin e pashfrytëzuar në dispozicion në aspektin e burimeve natyrore dhe humanelokale.

***

Nga kjo analizë rrjedh fakti se sektori bujqësor dhe zonat rurale të Evropës Juglindore kanë nevoja të konsiderueshme zhvillimi. Modernizimi dhe zhvillimi i bujqësisë dhe zhvillimetpërkatëse të aktiviteteve ekonomike rurale kanë potencial për të përmirësuar ndjeshëm perspektivat e këtyre zonave dhe duhet të bëhet thelbi i të gjitha planeve strategjike për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në rajon. Çështjet e diskutuara më lartë çojnë në identifikimin e objektivave kryesore të politikave të ardhshme të zhvillimit bujqësor dhe rural, si më poshtë:

a. **Përmirësimi i kushteve të kuadrit të përgjithshëm;**
b. **Reforma të menaxhimit të tokës;**
c. **Përmirësimi dhe stabilizimi i tëardhurave;**
d. **Inovacion dhe transferim efikasi dijes;**
e. **Modernizimi i bujqësisë dhe sektorëve agro-ushqimorë;**
f. **Integrim më i mirë horizontal dhe vertikal i prodhuesve dhe përpunuesve;**
g. **Përdorimi dhe mbrojtja më efikasee burimeve natyrore;**
h. **Eleminimi i varfërisë rurale dhe problemeve të fermerëve të vegjël;**
i. **Një qasje më e balancuar territoriale.**

Realizimi i këtyre objektivave është i mundur vetëm me përmirësim të ndjeshëm në kushtet e kuadrit të përgjithshëm për bujqësinë dhe zonat rurale dhe një politikë solide dhe e qëndrueshme e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Teoria dhe praktika tregojnëqë vendet me kushte të dobëta të kuadrit të përgjithshëm përftojnë efekt të kufizuar, madje edhe në prani të programeve gjithëpërfshirëse strategjike dhe mbështetjes bujare buxhetore. Paqëndrueshmëria politike, pragmatizmi apo rezistenca për ndjekjen dhe zbatimin e masave dhe qëllimeve strategjike, kanë krijuar një nivel paparashikueshmërie për fermerët dhe bizneset që mund të rrezikojë seriozisht zhvillimin e këtyre sektorëve. Transparenca ligjore dhe zbatimi i ligjit (duke përfshirë marrëdhënienme informalitetin), krijimi i sistemeve efikasetë kreditimit rural dhe respektimi i detyrimeve kontraktuale janë njëlloj të rëndësishme për zhvillimin e sektorëve agro-ushqimorëdhe zonave rurale dhe mund të përshpejtojnë ndryshimet strukturore dhe realizimin e objektivave .

Kushtet e strukturave mbulojnë një gamë të gjerë të fushave të politikës, të cilat nuk janë vetëm në duart e vendimmarrësve bujqësorë. Megjithatë, ato janë thelbësore në hartimin e politikave bujqësore moderne. Sigurimi i kushteve të përshtatshme të kuadrit të përgjithshëm nga bashkëpunimi ndër-qeveritar për sektorin bujqësor dhe zonat rurale, është rrjedhimisht një parakusht i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në planet strategjike kombëtare.

2.2 Hendeqet e politikës aktuale

Deri në çfarë mase ka qenë e suksesshme politika aktuale bujqësore e vendeve të Evropës Juglindore në adresimin e sfidave të sipërpërmendura të bujqësisë dhe zonave rurale si dhe në realizimin e objektivave? Politikat bujqësore të vendeve të SEE-së dhe karakteristikat e tyre kryesore janë përshkruar në pjesën B dhe përmblidhen tek sfidat në kapitullin A.III-2.1 më sipër. Disa nga karakteristikat dhe sfidat kryesore janë vlerësuar më me hollësi në këtë kapitull për të lehtësuar kuptimin e rekomandimeve të mëvonshme.

Realizimi i dobët i programeve të politikave

Lidhja më e dobët në politikataktuale bujqësore në vendet e SEE-së është niveli i ulët i realizimit të planeve strategjike. Masat dhe pagesat buxhetore aktuale shpesh ndryshojnë nga aktivitetet e planifikuara strategjike. Analiza tregon një mungesë të përgjithshme të qëndrueshmërisë në politikat bujqësore të vendeve tëSEE-së. Kjo pjesërisht mund t'i atribuohet krizës së gjatë ekonomike në rajon, e cila duket e vështirë për t'u kapërcyer, por edhe paqëndrueshmërisë politike të disa vendeve. Kjo situatë e bën të vështirë arritjen e qëllimeve të caktuara. Vendet e SEE-së pa dyshim vuajnë nga mungesa e një politike të qëndrueshme bujqësore, si dhe e një strategjie të vërtetë reformash dhe përshtatjesh me kërkesat e BE-së. Megjithë dallimet midis vendeve, është akoma e përhapur në përgjithësi një qasje pragmatike ad-hoc në përcaktimin emasave.

Një mungesë vazhdimësie dhe paqëndrueshmërie në veprimet e vendimmarrësve politikësi dhe menaxhimi i lartë në ministritë përkatëse, është tipike në politikën bujqësore të vendeve të SEE-së. Kjo situatë e ka bërë të vështirë sigurimin e një shërbimi publik efikas për të zbatuar ciklin e politikave dhe hartimin e politikave të bazuara në evidenca. Kjo nuk është specifikenëhartimin e politikave bujqësore në vendet e SEE-së, por është ende një tipar i rëndësishëm në aspektin institucional të menaxhimit të politikave bujqësore i cili meriton vëmendje të veçantë.

Dokumentet strategjike për politikën bujqësore në vendet e SEE-së zakonisht përfshijnë çështje të ngjashme si ato mbi çështjet e zhvillimit të diskuatuara më lartë, megjithëse me theks të ndryshëm. Dokumentet më të spikatura përfshijnë një qasje bazuar në sektorë, nxitjen e prodhimit dhe orientim të fortë të tregut. Nga ana tjetër, është më pak i zakonshëm adresimi i defiçiteve strukturore dhe teknologjike, varfëria rurale, si dhe çështjet e fermave të vogla dhe zonave me kushte të vështira të bujqësisë. Ka një orientim të fortë të politikës ndaj prodhimit, ndërkohë që çështjet mjedisore adresohen vetëm shkurtimisht, ecila në një farë mënyre është e kuptueshme duke marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe nivelin e ndërgjegjësimit mjedisor në këto vende.

Niveli i financimit të politikës bujqësore?

Shuma e përgjithshme e fondeve për politikën bujqësore në vendet e SEE-së tregon më së shumti një prirje pozitive, edhe pse pas fillimit të krizës ekonomike në vitin 2008, kjo ecuri është ndalur ose kthyer në prirje negative në disa vende, duke ulur buxhetin e politikave bujqësore nën nivelet që paraprinin vitin 2008. Këto buxhete janë deridiku të krahasueshme me ato të disa vendeve kandidate që u anëtarësuan në raundin e fundit të zgjerimit të BE-së në periudhën para anëtarësimit. Me përjashtim të Kroacisë, ato janë gjithashtu mjaft më të ulëta se shuma që vendet anëtare të BE-së ofrojnë për sektorët e tyre bujqësore, veçanërisht për shkak të mbështetjes historikisht të fortë në bujqësi në kuadër të CAP.

E rëndësishme për politikat bujqësore të vendeve të SEE-së është nëse fondet në dispozicion bëjnë të mundur adresimin e sfidave të shumta strukturore dhe zhvillimore diskutuar në kapitullin e mëparshëm. Kjo është një pyetje e vështirë për shkak të kompleksitetit dhe ndërlidhjes midis sfidave që duhen adresuar,duke mos përmendur se është e paqartë se deri në çfarë mase do të ketë efekt të prekshëm lloji dhe niveli i ndërhyrjevepublike aktuale.

Aktualisht, me këtë financim të kufizuar, është e pamundur të adresohen të gjitha sfidat . Kjo situatë pritet të ndryshojë ngadalë paralelisht me përparimet drejt integrimit në BE dhe disponueshmërinë e fondeve të IPARD. Në këtë kontekst, kryesorja është të sigurohet vendosja e

prioriteteve rigoroze (identifikimin e sfidave më të rëndësishme) dhe sidomos identifikimi i një kombinimi të masave të politikës, nga kushtet e kuadrit të përgjithshëm tek masat specifike sektoriale që janë projektuar për të mbështetur njëra-tjetrën për të arritur koherencë dhe përputhje.

Suksesi i kufizuar i politikave bujqësore në vendet e SEE-së vjen pjesërisht për shkak të dobësive administrative dhe mungesës së vendosmërisë për zbatimin e kësaj qasjeje rigoroze. Fondet tashmë të kufizuara janë kryesisht të orientuara tek të ardhurat dhe sektorët (orientuar drejtveprimtarive të veçanta të prodhimit). Politika bujqësore para së gjithash kuptohet si një mjet për të adresuar nevojat e grupeve të veçanta të interesit të prodhuesve bujqësorë, në mënyrë që të kompensohen për të ardhura më të ulëta dhe në mënyrë indirekte të përmirësojë konkurrueshmërinë. Ka një prirje për të orientuar rritjen e buxheteve bujqësore drejt rritjes së pagesave direkte ekzistuese së bashku me futjen e formave të reja të pagesave direkte duke synuar sektorë shtesë.

Pagesat direkte – të preferuara por të hartuara në mënyrë shumë pragmatiste

Llojet e pagesave direkte të cilat janë përdorur në vendet e SEE-së përfshijnë subvencione për inpute, mbështetje bazuar në pagesa për sasinë e produkteve të shitura per krerë dhe për sipërfaqe. Struktura e masave ndryshon sipas vendeve; politika është përgjithësisht e ndryshme krahasuar me format e mëparshme dhe aktualetë instrumenteve dhe masave të CAP.

Lloje të ndryshme subvencionesh për inpute janë zbatuar, edhe pse ato po ndërpriten ngadalë (duke gjykuar kryesisht nga ndryshimet e planifikuara në politikën bujqësore). Mbështetja bazuar në sasinë e produkteve të shitura është një masë e përbashkët, e cila gjendet veçanërisht në sektorin e bulmetit. Kjo është një prej pagesave më të rëndësishme të politikës bujqësore në vendet e SEE-së. Në disa raste, ndihma arrin në 25 përqind apo edhe më shumë të totalit të çmimit të prodhuesit.

Pagesat për krerë bagëti dhe sipërfaqe po aplikohen gjithmonë e më shumë, por masat themelore dhe zbatimi i tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga CAP. Ka një tendencë në rritje të dhënies së pagesave të drejtpërdrejta më së shumti prodhuesve të mëdhenj të orientuar nga tregu, duke lënë jashtë fermat e vogla dhe prodhuesit që nuk shesin nëpërmjet kanaleve të zakonshme të tregut. Gjatë krizës ekonomike, disa vende duket se kanë përdorur këto kritere të rrepta për të kompensuar për reduktime në buxhetin e bujqësisë duke përjashtuar prodhuesit e vegjëledhe pse në disa vende kritere të tilla janë përdorur për të orientuar ndihmën financiare vetëm për prodhuesit ekonomikisht të qëndrueshëm qëprodhojnë për tregun, orientim kypër të krijuar zhvillim strukturor.

Politika bujqësore thotë se qëllimi i pagesave direkte është të balancojë të ardhurat nga bujqësia, për të kompensuar kostot e larta të prodhimit, ose, në të kuptuarit më modern (edhe në CAP), për të paguar për të mirat publike. Si pasojë, pagesa të tilla direkte janë të destinuara për të gjithë prodhuesit që gjenerojnë prodhim ekonomik apo që nuk është mall masiv për treg.

Arsyeja e kufizimit të pagesave direkte vetëm për prodhuesit e mëdhenj të orientuar nga tregu, nga këndvështrimi i vendimmarrësve, kërkon të sigurojë stimuj për të rritur prodhimin, për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe për të krijuar zhvillimin strukturor. Nën rrethana normale kjo është një qasje e pranueshme. Megjithatë, sa më i lartë është kufiriminimal, aq më e madhe është përqindja e fondeve të akorduara për prodhuesit e mëdhenj. Si pasojë, më shumë fermerë dhe burime (tokë) përjashtohen nga mbështetja. Nga pikpamja e zhvillimit të përgjithshëm bujqësor, dhe ofrimit të të mirave publike që lidhen me bujqësinë (mjedisi, territorial/social) efikasiteti i skemave të tilla të mbështetjes është iulët, ndoshta edhe negativ, sepse prodhuesit e mëdhenj duhet të jenë të aftë për të shfrytëzuar avantazhin e tyre konkurrues (ekonomia e shkallës) për të operuar me mbështetje shumë të kufizuara ose pa mbështetje fare. Kurdo që kufizimet aplikohen në skema të tilla, qasja optimale do të ishte të vendosen kufij minimalë në nivel të një madhësie ferme ekonomikisht të qëndrueshme dhe/ose për të ofruar të mira publike (menaxhimin e

burimeve), duke vendosur ndërkohë tavane maksimale për mbështetje ndaj prodhuesve të mëdhenj (një qasje zbatuar edhe në BE).

Për shkak të numrit të madh të prodhuesve të vegjël në të gjitha vendet e SEE-së, ndikimi mjedisor (menaxhimi i burimeve natyrore, biodiversitetit, etj.), si dhe ndikimi social i përjashtimit të komuniteteve lokale nga pagesat direkte pa sigurimin e mjeteve të tjera të mbështetjes, mund të ketë pasoja të rënda derisa të vendosen masa mbështetëse alternative. Një mbështetje e tillë alternative mund të përbëhet nga mbështetje që nxisin daljen nga procesi i prodhimit (duke synuar në mënyrë të veçantë fermerët e vjetër) apo përkrahje për konvertimin në aktivitete të tjera ekonomike. Ka edhe shembuj në disa vende, të skemave të mirëqenies sociale të palidhura me bujqësinë duke ofruar një nivel të caktuar të ardhurash familjeve shumë të vogla e vulnerabëlnë fshatra. Megjithatë, për shkak të kufizimeve buxhetore dhe skemave të pazhvilluara të granteve sociale për popullsinë rurale bujqësore, këto skema nuk janë shumë realiste. Rrjedhimisht është e rëndësishme që të ketë një qasje jo-ekskluzive drejt pagesave direkte për aq kohë sa nuk janë vendosur akoma skemat alternative. Të gjithë prodhuesit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke marrë parasysh parimin e kushteve të barabarta konkurruese.

Një tendencë e zakonshme dhe kritike është mbështetja e sektorëve që nuk mbështeten në BE, siç janë sektorët e mishit të derrit dhe të shpendëve dhe siç u përmend më sipër, mbështetja e prodhimit në sektorin e bulmetit apo edhe në sektorin e grurit. Kjo mund të jetë veçanërisht kritike për vendet që janë tashmë në procesin e negociatave për anëtarësim dhe rrjedhimisht janë më pranë anëtarësimit.

Administrimi dhe kontrolli i pagesave direkte është një nga kërkesat kryesore që vendet duhet të sigurojnë para anëtarësimit. Disa vende tashmë kanë një regjistër të fermave dhe sisteme të identifikimit të kafshëve, por edhe nevoja për të rinovuar këto sisteme është bërë urgjente. Përveç kësaj, mbikëqyrja është e pamjaftueshme në identifikimin e tokës bujqësore (sistem LPIS), për të cilën prodhuesit pretendojnë pagesa direkte, dhe disa vende janë përdorur zgjidhje pragmatike të ndryshme jo gjithmonë transparente apo efikase.

Masat e tregut– asnjë rol i qartë nuk është përcaktuar

Nëvendet e SEE-së, masat e mbështetjes së çmimeve dhe tregut kanë shtrirje shumë të kufizuar. Kjo është mëse e kuptueshme duke marrë në konsideratë faktin se këto vende janë importues neto të ushqimit dhe kanë një mungesë përvoje historike në këtë drejtim. Mungesa e masave të tilla është e justifikuar në një treg importues neto i detyruar të zbatojë marrëveshje të tregtisë së lirë ku mundësitë për të përdorur masat e mbështetjes së tregut dhe çmimeve janë të kufizuara. Megjithatë, duke marrënë konsideratë luhatjen e çmimeve të ushqimit në rajon, lind nevoja për të zbatuar masa për të stabilizuar tregjet në situata me luhatje të tepruara sezonale të çmimeve.

Zhvillimi rural endenë plan të dytë

Si rregull i përgjithshëm, buxhetet bujqësore nuk janë të orientuara drejt zhvillimit. Kjo deklaratë bazohet duke iu referuar vlerave të ulëta të fondeve për zhvillimin rural, e vetmja shtyllë e politikave bujqësore me një aspekt zhvillimor. Ndër masat e politikës së zhvillimit rural mbizotëron mbështetja e investimeve për fermat bujqësore, por edhe ato janë të kufizuara për të gjithë prodhuesit dhe sektorët si në disponueshmëri ashtu dhe shtrirje kohore. Ndër çështjet kryesore, më me rëndësi është menaxhimi efikas i zinxhirit të furnizimit. Fondet e politikave bujqësore rrallë përkushtohen për këtë çështje, edhe pse fondet shpërndahen edhe për investime në industrinë e përpunimit, veçanërisht në vendet ku IPARD është i disponueshëm.

Kjo është gjithashtu e vërtetë për projekte të mëdha infrastrukturore (sistemet e ujitjes, rrugëve, menaxhimi i mbetjeve, konsolidimi i tokës, etj.), pavarësisht faktit se zbatimi i këtyre projekteve është ndër sfidat më të rëndësishme. Gjithashtu, një faktor i përbashkët për këto lloj investimesh është se ato nuk janë vetëm nën përgjegjësinë e ministrisë së bujqësisë dhe për këtë arsye zbatimi i tyre kërkon bashkëpunim dhe koordinim ndër-qeveritar.

Në disa sektorë kyç, siç janë prodhimi i verës dhe i frutave, të cilët kanë potencial për t'u bërë sektorë konkurrues si në tregun vendas edhe në tregjet e huaja, ekziston një nevojë e përgjithshme e rëndësishme për rinovimin dhe restaurimin e potencialit të prodhimit; me fjalë të tjera, zëvendësimi i plantacioneve të vjetra me varietete të reja dhe përmirësimi i sistemeve dhe metodave të prodhimit. Megjithatë, vizioni dhe planifikimi i përgjithshëm strategjik i veprimeve për zhvillimin e këtyre sektorëve shpesh mungon ose nuk është i zhvilluar mirë, dhe përkrahja e investimeve është e kufizuar.

Mbështetja agro-mjedisore është shumë e kufizuar jo vetëm për shkak të burimeve të pakta buxhetore, por edhe për shkak të prioriteteve të ndryshme sociale dhe pozitës relativisht të dobët të grupeve të interesit. Rrjedhimisht integrimi i çështjeve mjedisore në politikat bujqësore është ende në fillesat e tij. Duke marrë parasysh shtrirjen e gjerë të sipërfaqeve malore, kodrinore, dhe sipërfaqeve të tjera me kushte të kufizuara të prodhimit, mund të pritej një qëndrim më i favorshëm ndaj çështjes. Kjo fushë e politikës është shumë e rëndësishme dhe e mbështetur gjerësisht në kuadrin eCAP. Vendet e SEE-së duhet të fillojnë përgatitjet për këto masa sa më shpejt, që të jenë të gatshme për të përfituar prej tyre në momentin e anëtarësimit.

Gjendja sociale e fermave të vogla dhe prania e konsiderueshme e varfërisë rurale, veçanërisht në zonat më pak të favorizuara, janë ndër çështjet kyç të identifikuara në analizë. Politika bujqësore e vendeve të SEE-së i njeh këto probleme, por bën shumë pak për t'i trajtuar ato. Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të kompleksitetit të këtyre çështjeve, të cilat shpesh janë nën përgjegjësinë e disa autoriteteve ose institucioneve publike dhe si pasojë pjesërisht përtej sferës së politikave të zhvillimit rural. Megjithatë, politika e zhvillimit rural ofron një sërë masash, të cilat mund të ndihmojnë për të kapërcyer këto sfida.

Në BE pagesat kompensuese për zonat më pak të favorizuara (LFA) janë ndër masat më të rëndësishme për të adresuar këto probleme dhe për të ofruar një mundësi për njerëzit që të qëndrojnë në zonat përkatëse,të vazhdojnë të përdorin burimet e disponueshme e të ruajnë prodhimet tradicionale. Mbështetja për zonat më pak të favorizuara është financiarisht dhe teknikisht shumë e kërkuar dhe kërkon një kohë të caktuar për t'u zbatuar. Megjithatë, politikëbërësit bujqësorë në rajon duhet të gjejnë mënyra për të nisur përdorimin e kësaj mase të politikës për të adresuar këto probleme, si përfermerë te vegjël më pak të favorizuar në këto zona, ashtu edhe për t'u përgatitur për anëtarësimin.

Shërbimet përgjithshme – mungesë eveprimeve praktike

Shërbimet e përgjithshme bujqësore, sidomos ato që merren me zhvillimin dhe përhapjen e njohurive, në përgjithësi janë shumë pak të financuara, edhe pse inovacioni bujqësor dhe transferimi i njohurive është një sfidë e rëndësishme për të gjithë rajonin. Shërbimet këshillimore dhe transferimi i njohurive janë çështje të adresuara shpesh në nivel politik. Megjithatë, veprimet praktike për të lehtësuar zhvillimin e nevojshëm dhe modernizimin e shërbimeve mbeten të kufizuara, pa një perspektivë të qartë strategjike. Ky është, në një farë mase, rasti për fakultetet bujqësore, të cilat rrallë janë të afta për të përmbushur rolin e tyre si kontribuese për inovacionin dhe transferimin e njohurive të cilat parapprijnë procesin e zhvillimit të bujqësisë moderne.

Procesi i nevojshëm i transformimit teknologjik nuk mund të ndodhë në mënyrë spontane në një bujqësi në përgjithësi të pazhvilluar. Institucionet publike dhe private, sistemet arsimore dhe shërbimet këshillimore luajnë një rol vendimtar në zgjidhjen e kësaj sfide.

2.3 Udhëzime për orientimin e ri të politikës

Koncepti: Politikë bujqësore e orientuar drejt zhvillimit me CAP si pikë referimi

Rekomandimi më i rëndësishëm për vendet e SEE-së është miratimi dhe zgjerimi i konceptit të politikës bujqësore të orientuar drejt zhvillimit për të adresuar në mënyrë efektive objektivat kryesore të politikave të përshkruara në kapitullin A.III-2.1. Ripërcaktimi i zhvillimit në të gjitha aspektet e tij duke e bërë atë të qëndrueshëm duhet të bëhet një prioritet strategjik kyç. Bazuar në objektivat e përcaktuara, një qasje e orientuar drejt zhvillimit kuptohet në sensin e saj ekonomik si shfrytëzimi efikas i potencialeve natyrore dhe organizative, përmirësimi i produktivitetit, përmirësimi i efikasitetit të zinxhirit agro-ushqimor, nxitje e bashkëpunimit, dhe mbështetje për ndryshimet strukturore, veçanërisht reformave të tokës të cilat të gjitha së bashku sjellin rritje të ndjeshme të mirëqenies së popullsisë rurale. Zhvillimi duhet të përfshijë një perspektivë të mirë-përcaktuar mjedisore dhe sociale dhe zhvillim të balancuar rajonal.

Nuk ka alternativa të qarta për një orientim vendimtar të zhvillimit. Në këtë drejtim, integrimi evropian dhe miratimi i objektivave dhe instrumenteve të Politikës së Përbashkët Bujqësore Evropiane mund të shërbejë si një motiv i mirë dhe katalizator për ndryshimin. CAP është një objektiv i kërkuar dhe i lëvizshëm për vendet e SEE-së, pormund të prijë një qëndrim aktiv dhe pozitiv ndaj bujqësisë dhe funksionon qoftë si një model zhvillimi qoftë si pikë referimi. Integrimi gradual i elementeve të CAP do të lehtësojë modernizimin e bujqësisë dhe të administratës publike, si dhe miratimin e legjislacionit të BE-së, dhe si pasojë përshpejton procesin e integrimit në BE.

Pavarësisht nga kritikat e tyre legjitime për kompleksitetin e CAP, vendet e SEE-së mund të përfitojnë nga instrumentet e përzgjedhura të politikave të CAP edhe në periudhën e para-anëtarësimit, të cilat mund të sigurojnë stimujt e nevojshëm për ndryshime të dukshme në bujqësi dhe zonat rurale. Zgjerimi i fundit i BE-së jep dy shembuj si pozitivëdhe negativë se çfarë mund të sjellin fondet dhe praktikat evropiane për bujqësinë në vendet më pak të zhvilluara. Ato vende që e kanë përgatitur në mënyrë aktive sektorin e bujqësisë për anëtarësim përmes integrimit gradual të masave të CAP dhe që kanë aplikuar një kombinim të duhur të stimujve ekonomikë dhe fondeve publike, kanë aftësuar sektorët e tyre bujqësorë dhe ruralë për t'u integruar më shpejt dhe për të përfituar plotësisht nga mundësitë që ofron CAP. Një adaptim në kohë i kësaj qasjeje dhe të mësuarit nga këtashembuj krijon mundësinë për të nxitur zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në vendet e SEE-së.

Zbatimi i një politike të bazuar në elementet e CAP në një mënyrë të thjeshtuar mund të jetë një bazë solide për zbatimin e qasjes së orientuar drejt zhvillimit për të adresuar objektivat e identifikuara më lartë për vendet e Evropës Juglindore në periudhën e para-anëtarësimit dhe një hap i sigurt për intensifikimin e procesit të integrimit.

Pavarësisht të gjitha pasigurivetë tjera dhe dilemave të mëdha në integrimin e CAP (si një objektiv i lëvizshëm) në politikat kombëtare, kuadri aktual i CAP do të jetë në shumë pika akoma i rëndësishëm për rajonin në kohën e anëtarësimit të tij. Ky kuadër përfshin - pavarësisht objektivit të anëtarësimit - një gamë të gjerë të masave të zhvillimit rural që adresojnë të gjitha çështjet e zhvillimit të rajonit (ekonomike, mjedisore, dhe sociale). Gjithashtu, kuadri aktual i CAP siguron një kornizë për lloje të caktuara të pagesave për sipërfaqe në formën e skemës së pagesave bazë, pagesat e "gjelbërimit", "pagesat top-up[19]"për fermerët e rinj, skema për fermerët e vegjël, si dhe disa pagesa të përgjithshme për sipërfaqe dhe për krerë bagëti. Është e rëndësishme të theksohet se reformat e kaluara të këtyre skemave kanë treguar se procedurat dhe mekanizmat themelore administrative nuk do të ndryshohen në mënyrë dramatike me kalimin e kohës. Në zgjerimet e kaluara, vendet më të suksesshme kanë qenë ato që ka siguruar ndërtimin në kohë të

[19] Shënim i përkthyesit: Këto pagesa janë pagesa shtesë për nxitjen e prodhimit nga fermerët

institucioneve të nevojshme për zbatimin e CAP dhe në të njëjtën kohë prodhues të përgatitur për procedurat dhe nivelet e mbështetjes që zbatohen në anëtarësim.

Në adoptimine elementëve të CAP, duhet t'i kushtohet vëmendje politikave që do të mbeten një çështje e politikës kombëtare edhe pas anëtarësimit, të tilla si ndihma shtetërore (ose Shtylla e III-të në metodologjinë e përshkruar APM). Shërbimet e përgjithshme bujqësore shpesh injorohen dhe nuk njihen si të rëndësishme, në fakt ato janë një element i rëndësishëm i politikës bujqësore. Ato në veçanti kanë të bëjnë me zhvillimin institucional dhe mbështetjen për njohuritë bujqësore dhe sistemet e inovacionit, sigurinë ushqimore, politikat e cilësisë, dhe aspekte të tjera të rëndësishme të zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale. Në ndërtimin e një politike dhe administrimi të orientuar drejt zhvillimit, do të ishte e dobishme t'i kushtohej vëmendje e veçantë shërbimeve këshillimore dhe arsimore publike dhe rritjes së investimeve në kërkimin shkencor orientuar drejt zhvillimit.

Kur vendet e SEE-së të fillojnë zbatimin e një qasje të orientuar tek zhvillimi, me CAP si një pikë referimi - duke përjashtuar Kroacinë natyrisht, e cilatashmë është anëtare e BE-së – ato duhet tëkrijojnë një plan të qartë; një strategji për miratimin dhe zhvillimin e politikave dhe masave. Kjo nuk ndryshon shumë nga ajo që Komisioni Evropian është duke kërkuar nga vendet kandidate (p.sh. Mali i Zi); me fjalë të tjera strategjia dhe plani i veprimit për integrimin në BE duke nënvizuar sesi vendi parashikon kalimin nga masat aktuale të politikave,në miratimin e instrumenteve të CAP mbi anëtarësimin.

Kjo përqasje forcon modelin e sugjeruar të përshtatjes graduale. Një plan i qartë për zbatimin e reformave të politikave bujqësore, ku përfshihet procesi i pritshëm i integrimit në BE, duke identifikuar hapat për zbatimin sistematik të strategjive, është një parakusht për përshtatjen efikase të bujqësisë. Në vijim diskutohen disa koncepte dhe ide për mënyrat e lehtësimit të një përshtatjeje të tillë.

***

Objektivi kryesor i planit strategjik duhet të jetë një përshtatje graduale dhe racionale me CAP me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë. Prodhuesit vendas duhet të përballen gradualisht me kushtet e tregut të cilat vlejnë për prodhuesit e BE-së, gjendur edhe në afërsi të rajonit.

Bazuar në sfidat e identifikuara në Kapitullin A.III-2.1 dhe një sërë instrumentesh të disponueshme të politikave të BE-së dhe politikave vendase, më poshtë është paraqitur një matricë politike (Tabela A.III-1) që lidh objektivat kryesore me objektivat operacionale dhe masat e mundshme, për të lehtësuar zhvillimin e strategjive dhe planeve kombëtare.

***

Seksioni në vijim fokusohet në masa të caktuara politike, të cilat janë të rëndësishme për arritjen e objektivave. Në përputhje me qasjen e prezantimit të politikave të orientuara drejt zhvillimit në kuadër të procesit të integrimit në BE, ky diskutim është kryesisht i përqendruar në masat politike që janë pjesë e pikave referuese të CAP. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet rëndësia e përmirësimit të kushteve të kuadrit të përgjithshëm, i cili meriton një vëmendje të veçantë në hartimin e politikave. Këto kushte të përgjithshme diskutohen duke konsideruar fushat e politikave të përshkruara më poshtë.

Tabela A.III-1: Matrica politike e reformave të synuara dhe masave kryesore për politikat bujqësore e Evropës Juglindore në periudhën e para-anëtarësimit

Prioritetet dhe objektivat e reformës	***Objektivat operacionale***	***Masat***
a. *Përmirësimi i kushteve të kuadrit të përgjitshëm*	-Sigurimi i shtetit të së drejtës - Transparencë më e lartë në prokurimet publike - Mjedis biznesi transparent dhe i parashikueshëm - Sigurimi i kushteve të përshtatshme financiare për bizneset dhe familjet rurale - Stabilitet dhe konsistencë në zbatimin e politikës - Programim strategjik dhe përmbushje e objektivave dhe politikave të miratuara	- Përmirësimi dhe modernizimi i administratës dhe institucioneve - Politika transparente të prokurimit publik - Zbatim transparent i politikave - Fokus në edukimin e sjelljes anti-korruptive të administratës në bujqësi - Mbështetje për forcimin e financimit rural (rregulla dhe institucione) - Futja e të gjithë elementeve të ciklit të politikave në politikën bujqësore
b. *Reformat e menaxhimit të tokës*	- Konsolidimi i tokës - Rritja e madhësisë së fermave dhe bujqësi e qëndrueshme - Përmirësimi i cilësisë së tokës - Menaxhim më i mirë i ujit - Askses më i mirë ndaj tokës bujqësore	- Ligji i tokës që favorizon ndryshime strukturoredhe zgjidhje për reduktimin e fragmentimit - Mbështetje për veprime operacionale në bujqësi - Mbështetje për ujitjen - Mbështetje për rrugë tokësore dhe pyjore
c. *Përmirësimi dhe stabilizimi i të ardhurave*	- Futja graduale dhe harmonizimi i politikave të pagesave direkte me skemat e CAP për të mundësuar zbatimin e instrumentave pas anëtarësimit - Sigurimi i statusit të krahasueshëm të konkurrueshmërisë të prodhuesve bujqësorë vendas me BE - Mbështetje për zhvillimin e bujqësisë - Stabilizimi i të ardhurave - Ofrimi i të mirave publike	- Harmonizim gradual i pagesave direkte me CAP - Futja e pagesave për krerë bagëti dhe për sipërfaqe(kufizim i numrit të pagesave, trajtim i barabartë i prodhuesve) - Mbeshtetje për fermerë të vegjël - Mbështetje e LFA -ve - Futja e mjeteve të ndryshme të menaxhimit të tregut dhe riskut
d. *Inovacion dhe transferim efikas i njohurive*	- Transferimi i inovacioneve të reja ose ekzistuese përshtatur me kushtet lokale dhe rajonale - Transferimi i njohurive direkt te prodhuesit, grupet e prodhuesve dhe zinxhirët agroushimorë	- Programet e synuara kërkimore - Mbështetje për ekstension dhe trajnim - Mbështetje e rrjetit të njohurive - Krijimi i qëndrave të demonstrimit për aktiviteti agro-ushqimore - Ngritja e inkubatorëve për shpërndarjen e njohurive
e. *Modernizimi i bujqësisë dhe sektorit agro-ushqimor*	- Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe sektorët ushqimorë - Përmirësimi i strukturës së kapitalit në bujqësi (ndërtesa, mekanizim, bimët shumëvjeçare, mbarshtimi i kafshëve) - Specializimi i aktiviteteve prodhuese - Zhvillimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore	- Mbështetja e investimeve në fermë - Mbështetje për industrinë e përpunimit të ushqimit - Mbështetje e fermerëve të rinj - Mbështetje për rinovimin e bimëve të përhershme - Programet e mbështetjes së mbarshtimit të kafshëve (organizatat e mbarshtimit, insfrastrukturë shoqëruese) - Mbështetja për mbarështimin dhe blerjen e kafshëve të reja
f. *Integrim më i mirë horizontal dhe vertikal i prodhuesve dhe përpunuesve*	- Përmirësimi i vlerës së shtuar në sektorin agro-ushqimor - Përmirësimi i pozicionit në treg për prodhuesit bujqësorë (rritje e ekonomisë së shkallës) - Përmirësimi i cilësisë së produkteve agro-ushqimore - Peshë më e lartë e vlerës së shtuar të produkteve - Imazh më i mirë i produkteve vendase në tregjet vendase dhe të huaja	- Mbështetje për startimin e grupeve të prodhuesve - Rregullimi ligjor i ogranizatave të prodhuesve - Mbështetje për investime të aktiveteteve të produkteve pas korrjes, mbledhja dhe logjistika e produkteve bujqësore - Mbështetje për infrastrukturën e tregut dhe zinxhirët e shkurtër të furnizimit ushqimor - Mbështetje për politika të produkteve cilësore dhe skema cilësie - Mbështetje për aktivitete promovuese
g. *Përdorimi dhe mbrojtja më efikasee burimeve natyrore*	- Mbrojtja eLFA-ve - Mbrojtja e tokës, ujit dhe biodiversitetit - Ruajtja e peisazheve kulturore tradicionale - Përmirësimi i qëndrueshëm i teknologjive të prodhimit bujqësor	- Mbështetje për LFA-të - Masa të zgjedhura agro-mjedisore (bujqësi organike, etj.) - Futja e rregullave me përputhje ndërsektoriale për pagesat direkte - Mbështetje për përmirësimin e burimevegjenetike të kafshëve dhe bimëve
h. *Eleminimi i varfësirë rurale*	- Rritja e ndërgjegjësimit rreth varfërisë rurale dhe çështjeve të fermerëve vegjël - Kontribut për përfshirjen sociale dhe sigurinë e	- Politikë aktive gjithpërfshirëse dhe rajonale - Përmirësimi i sigurimeve shoqërore për popullsinë rurale - Mbështetje për minoritetet etnike dhe sociale

dhe problemeve të fermerëve të vegjël	populllsisë rurale - Krijimi i mundësive të reja të punës dhe burimeve të të ardhurave - Njohja dhe përmirësimi i gjendjes së minoriteteve të ndryshme dhe grupeve sociale vulnerabël; - Kërkim për mundësi zhvillimi për fermat e vogla	- Mbështetje gjinore - Diversifikimi i aktiviteteve të të ardhurave të familjeve rurale - Mbështetje për sipërmarrjen e shërbimeve sociale - Mbështje e veçantë për fermerët e vegjël - Politika investimi për fermerët e vegjël
i. *Një qasje më e balancuar territoriale*	- Sigurimi i kushteve themelore të jetesës për populllsinë rurale - Rigjallërimi i rajoneve të shpopulluara - Krijimi i mundësive të reja të punës - Sigurimi i infrastrukturës bazë (rrugë, ujë, etj.) - Sigurimi i mundësive për edukimin bazë pranë vendeve të banimit - Nxitja dhe zhvillimi i iniciativave lokale - Mbrojtja dhe shfrytëzimi i monumenteve natyrore dhe kulturore	- Programet e rishpërndarjes - Mbështetje për zonat LFA - Instrumenta të ndryshëm të politikave gjithpërfshirëse dhe rajonale - Qasja Leader - mbështetje për grupet lokale të veprimit - Mbështetje për investime në infrastrukturë - Programe të rinovimit të fshatrave - Mbështetja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Fokusi tek zhvillimi rural

Për të arritur objektivat e përcaktuara në strategjitë kombëtare, politika bujqësore e vendeve të SEE-së duhet të jetë më e përqendruar në zhvillimin rural. Në këtë drejtim, vendet e SEE-së duhet të përdorin mundësinë që ofron kuadri i politikës së IPARD për të zhvilluar konceptet e tyre për prioritetet e mbështetjes për zhvillim rural. Nga ky kuadër vendetmund të zgjedhin dhe përcaktojnë masa në përputhje me nevojat dhe prioritetet kombëtare. IPARD, meqenëse ofron një numër të kufizuar të masave të zhvillimit rural, mund të mos krijojë mundësinë e adresimit të të gjitha prioriteteve. Prandaj mund të jetë e nevojshme që masat e zhvillimit rural të mbështeten nga buxheti kombëtar për të plotësuar kështu masat e IPARD. Në zgjedhjen e masave të tilla plotësuese, do të ishte e përshtatshme të zgjidhen masat që janë në përputhje me politikën e BE-së për zhvillim rural (duke pasur parasysh procesin e integrimit në BE). Kjo gjithashtu do të lehtësojë procesin e zhvillimit të strategjive uniforme, zbatimin e strukturave dhe procedurave.

Mbështetja për modernizimin e sektorëve agro-ushqimorëduhet të bëhet prioritet i parë i politikës së zhvillimit rural për të rritur konkurrueshmërinë e sektorëve. Megjithatë, zhvillimi i një politike të shëndoshë dhe efikase për mbështetjen e investimeve do të kërkojë gjithashtu kushte optimale të kuadrit të përgjithshëm. Kjo ka të bëjë së pari me të gjitha kushtet për marrjen e kredive. Institucionet financuese nuk janë të gatshme të japin kredi për fermat e vogla dhe të mesme dhe atyre bizneseve që kanë mungesë të një kolaterali të mjaftueshëm për kredi. Për më tepër, disponueshmëria e shërbimeve moderne këshillimore dhe transferimi i njohurive në menaxhimin dhe planifikimin strategjik të biznesit është shumë i rëndësishëm për prodhuesit dhe bizneset e vogla. Këto çështje kërkojnë vëmendje të konsiderueshme në vendet e SEE-së, me qëllim që të marrin efektin e parashikuar të masave të politikës sëmbështetjes sëinvestimeve për të arritur progres real në këtë drejtim.

Pronësia e fragmentuar e tokës (duke përfshirë edhe çështjet e pazgjidhura të pronësisë), popullsia e shpërngulur, si dhe nevoja për reforma gjithëpërfshirëse të tokës janë të gjitha sfida të vështira me të cilat përballet bujqësia në vendet e SEE-së. Përpjekje të mëdha janë të nevojshme, para së gjithash institucionale në formën e ligjit të tokës dhe reformat e menaxhimit të tokës. Në veçanti, për të reduktuar fragmentimin e tokës bujqësore në shumicën e vendeve, duhet të zgjidhen çështjet komplekse në lidhje me pronësinë e tokës. Nëse këto probleme nuk mund të zgjidhen nëpërmjet reformimit tëlegjislacionit për ligjet e tokës për shkak të të drejtave themelore të përcaktuara, mund të merren në konsideratë masa të tjera të politikave brenda kuadrit ligjor për menaxhimin e politikave bujqësore. Eksperienca nga vendet e tjera ofron shembuj të mirë të detyrimeve për përdorimi të tokës bujqësore, për shembull detyrimin për pronarin që të banojë në fermë ose për të mbajtur të pandarë tokën në përdorim për qëllime bujqësore, apo përdorimin e ligjeve të përshtatshme të qiramarrjes që rregullojnë marrëdhëniet midis shumë pronarëve.

Një nga kushtet e kuadrit të përgjithshëm është prania e një infrastrukture bazë mirë funksionuese. Në disa pjesë të rajonit ka një nevojë të konsiderueshme për krijimin apo rinovimin e

infrastrukturës bujqësore si edhe infrastrukturën në përgjithësi, rrugët hyrëse, sistemet e ujitjes dhe kullimit, etj. Kjo do të kërkojë planifikimin dhe përcaktimin e fondeve të konsiderueshme publike për investime në infrastrukturë përmes përfshirjes së disa organeve qendrore dhe lokale.

Për më tepër, zhvillimi dhe transferimi i njohurive meritojnë vëmendje të veçantë. Politika e kërkimit kombëtar duhet të nxisë studimet në fushën e risive të produkteve, metodavedhe teknologjisë moderne të prodhimit, dhe duhet të themelohen sisteme efektive për transferimin e njohurive përmes një shërbimi ekstensiv efikas dhe të shërbimeve të tjera këshilluese të biznesit për fermerët dhe sektorin e përpunimit. Kjo do të kërkojë disa ndryshime institucionale si dhe përforcimin e shërbimeve publike dhe private me metoda të reja të financimit.

Është theksuar shpesh rëndësia e investimeve strategjike në kanalet e tregut dhe të përpunimit të ushqimit, të cilatmund të kontribuojnë në efikasitetin më të madh si për bujqësinë edhe për ekonominë e përgjithshme rurale. Këto masa mund të jenë të shtrenjta dhe jo pa risk. Megjithatë, investimet e synuara në krijimin e, për shembull, dhomave të përshtatshme frigoriferike për frutat dhe perimet mund të përshpejtojnë krijimin e zinxhirit agro-ushqimor konkurrues, një qendër të re logjistike për bimët, rinovimin e kapaciteteve të vjetëruara për prodhimin e kulturave të përhershme të tilla si pemëtore dhe vreshta, dhe investimet mbështetëse në përpunimin modern të produkteve blegtorale, të gjithanë bazë të prodhimit vendor. Ato gjithashtu mund të përshpejtojnë ndjeshëm modernizimin dhe zhvillimin e bujqësisë dhe të kenë një ndikim të dukshëm në zhvillimin e zonave rurale.

Shumica e sektorëve të prodhimit karakterizohen nga një numër i madh prodhuesish shumë të vegjël që akoma përfaqësojnë një pjesë relativisht të madhe të prodhimit. Prandaj është e nevojshme që të zhvillohen një sërë masash të zhvillimit rural për të mbështetur zhvillimin, ristrukturimin dhe organizimin e fermerëve të vegjël. Shpesh, problemet e prodhuesve të vegjël janë përdorur si një justifikim për rritjen e mbështetjes publike të orientuar drejt prodhimit. Megjithatë, kjo nuk zgjidh problemet e tyre dhe madje mund t'i përkeqësojë ato. Në mënyrë të pashmangshme duhet të ketë një dimension social për masat për shkak të rëndësisë së këtij grupi në strukturën shoqërore të zonave rurale. Mbështetja direkte me të ardhura për fermerët e vegjël duhet, nëse është e mundur, të plotësohet me masa që promovojnë kohezion rajonal dhe duke ndjekur konceptin e zhvillimit rural të BE-së- duke promovuar diversifikiminekonomik, si në aktivitetet në fermë edhe jashtë fermave, përmes investimeve të vogla për të përmirësuar teknologjinë dhe cilësinë e produktit. Promovimi i organizimit të prodhuesve dhe grupeve të prodhuesve apo kooperativave dhe zhvillimi i zinxhirëve të vlerave lokale për të përmirësuar pozicionin e tyre në treg është një nga elementet e rëndësishme të masave mikse për të adresuar çështjen e fermerëve të vegjël.

Në vendet kandidate një rol më të madh duhet t'i kushtohet masave agro-mjedisore dhe mbështetjes për LFA-të jo vetëm në lidhje me procesin e integrimit, por edhe për adresimin e problemeve të ndërlidhura me mbrojtjen e mjedisit, ikjen e popullsisë dhe braktisjen e burimeve natyrore. Në këto zona një kombinim i duhur i pagesave për LFA-të dhe mekanizma të tjera mbështetëse të zhvillimit rural mund të sjellin një përfitim të rëndësishëm në këto fusha si në drejtim të rritjes së aktiviteteve ekonomike, ashtu edhe të mbrojtjes së burimeve natyrore.

Siç është sugjeruar tashmë, rritja e mbështetjes nuk mund të ketë një ndikim të rëndësishëm pa një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe institucional duke ofruar kushte të favorshme për zhvillimin e zonave bujqësore dhe rurale, si dhe nxitjen e një partneriteti midis të gjitha institucioneve bujqësore publike dhe private.

Politika e pagesave direkte

Një numër skemash të ndryshme të pagesave direkte janë përdorur në vendet e SEE-së, shumica e të cilave janë pak a shumë në kundërshtim me CAP.Do të ishte e përshtatshme për të përshkruar disa parime themelore për zbatimin e politikës së ardhshme të pagesave direkte në procesin e përafrimit të politikave ndaj CAP.

Para së gjithash, skemat e pagesave direkte që janë në kundërshtim me skemat e pagesave direkte të BE-së duhet të eleminohen gradualisht. Së dyti, skemat ekzistuese që kanë disa elementë në përputhje me skemat e BE-së (p.sh. për krerë bagëti dhe për sipërfaqe) duhet të përshtaten gradualisht për të zbatuar të njëjtat kritere dhe mekanizma administrative si skemat e BE-së në përputhje me themelimin e kapaciteteve dhe instrumentave administrative (IACS, LIPS, regjistrat, etj), të nevojshme për të menaxhuar një skemë të tillë. Së treti, skemat e reja të pagesave direkte duhet të zbatojnë kritere dhe mekanizma administrative të aplikueshmenë skemat e ngjashme të BE-së.

Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i kritereve dhe mekanizmave të njëjta nuk do të thotë se kriteret e përshtatshmërisë me BE-në apo niveli i mbështetjes duhet domosdoshmërisht të jetë i njëjtë. Hapi më i rëndësishëm është që të ndërtohen kapacitete dhe përvoja në menaxhimin e skemave të tilla, ndërsa përcaktimi i përfituesve të përshtatshëm dhe nivelit të mbështetjes mund të përshtatet lehtë përgjatë ose pas anëtarësimit. Megjithatë, vendet kandidate duhet të sigurojnë që niveli i mbështetjes për çdo masë individuale nuk e kalon nivelin e BE-së, e cila në çastin e anëtarësimit mund të sjellë pasoja negative për të ardhurat e fermerëve.

Ka pasur tendencë për të futur skema direkte të pagesave të bazuara thjesht në konsiderata politike kombëtare, kjo duke injoruar papajtueshmërinë e tyre në kontekstin e procesit të integrimit në BE. Futja e masave të tilla në kohën e negociatave për anëtarësim dërgon sinjale të gabuara si për prodhuesit vendas ashtu edhe për BE-në. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme për vendet kandidate që kanë filluar tashmë negociatat e anëtarësimit.

Cilat forma të pagesave direkte do të ishin më të përshtatshme atëherë duke marrë parasysh edhe qëllimet politike kombëtare për mbështetjen e prodhuesve bujqësorë dhe objektivin e angazhimit në procesin e integrimit në BE? Rregullorja e Pagesave direkte të BE-së ofron një sërë skemash të pagesave direkte, duke përfshirë skemën bazë të pagesave, pagesat për fermerët e vegjël, për fermerët e rinj, për praktikat miqësore me mjedisin, për fermerët në zonat me kufizime natyrore, si dhe pagesa të caktuara të përgjithshme (për krerë bagëti ose për sipërfaqe). Duket se këto lloj skemash të pagesave ofrojnë një gamë mjaft të madhe instrumentesh për pagesa direkte, për të adresuar ndonjë prej nevojave për skema të tilla të identifikuara në vendet kandidate. Një zgjidhje e favorshme, e cila mund të funksionojë si një urë midis instrumenteve ekzistuese dhe skemave të harmonizuara të pagesave direkte, do të jetë futja e pagesave të përgjithshme për krerë bagëti dhe për sipërfaqe eCAP like. Futja e tyre është brenda gamës së reformave të pranueshme për themeluesit e politikave bujqësore dhe palëve të interesuara në fazën fillestare të harmonizimit. Kjo ndihmon në parandalimin e praktikave të gabuara dhe dhënien e sinjaleve të duhura për prodhuesit dhe BE-në. Së fundmi, ajo përgatit terrenin për futjen graduale dhe zbatimin e harmonizuar të konceptit të plotë të mbështetjes me pagesa direkte pas anëtarësimit. Këto vende duhet të marrin në konsideratë nisjen e zbatimit gradual të këtyre skemave, kur vendosin për reformimin e skemave ekzistuese ose futjen e skemave të reja, dhenë të njëjtën kohë duke bërë progres pozitiv drejt integrimit në BE.

Së bashku me futjen e skemave të pagesave në përputhje me BE-në, kryesisht bazuar në pagesa për krerë bagëti dhe për sipërfaqe, nevoja për krijimin e IACS (Sistemi iintegruar i administrimit dhe kontrollit) dhe mjeteve të tjera administrative si bazë për zbatimin e pagesave të tilla bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Përtej kontributit në krijimin e procedurave administrative në përputhje me rregulloret e BE-së, për aktorët vendas do të jetë i dobishëm kontrolli i duhur dhe monitorimi i pagesave .

Së fundmi, kur vendoset mbi politikën për pagesa direkte, është e rëndësishme të arrihet një balancë e arsyeshme midis skemave që adresojnë nevoja të veçanta për mbështetjen e grupeve të veçanta të prodhuesve (p.sh. fermerëve të vegjël), ose zonave (kufizimet natyrore, mbrojtjen e mjedisit etj.),duke siguruarnjë shpërndarje të drejtë të përfitimeve të politikave për të gjithë llojet e prodhuesve.

Qasja e kufizuar në mekanizmat e tregut

Mekanizmat e tregtisë së jashtme udhëhiqen nga marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe të tregtisë së jashtme. Vendet jashtë BE-së në rajon janë anëtarë të CEFTA-s, kanë marrëveshje të veçanta të tregtisë me BE-në dhe tashmë janë anëtarë të Organizatës Botërore tëTregtisë (WTO) ose do të jenë në të ardhmen. CEFTA garanton tregtinë e lirë të ushqimit në rajon; marrëveshjet e BE-së ofrojnë status preferencial për tregti për vendet e anëtarësuara në BE-në dhe WTO paraqet një kuadër politikash më pak deformuese për anëtarët e saj. Marrëveshjet e nënshkruara sigurojnë një qasje më të madhe dhe më të unifikuar të aksesit ndaj tregut, si dhe konkurrencë relativisht të fortë, pra një mundësi për rritje për të qënë më efikase.

Masat e tregut të brendshëm kanë qenë elemente të rëndësishme të politikës së kaluar të BE-së për të mbështetur çmimet e prodhuesve dhe promovimin e një rritje të prodhimit për të rritur vetë-mjaftueshmërinë. Me ndryshimin e statusit nga importues në eksportues neto dhe ndryshimin e marrëveshjeve të tregtisë ndërkombëtare, politika të tilla në BE u reduktuan në nivelin e rrjetave të sigurisë për situata kritike të tregut. Epoka e ndërhyrjeve në treg ka mbaruar (një tendencë globale tashmë), dhe futja e tyre në periudhën e para-anëtarësimit do të dërgojë sinjale të gabuara për prodhuesit, për të mos përmendur se do të ishte një investim i gabuar i fondeve tashmë të kufizuara bujqësore.

Në vendet e SEE-së, çështja e stabilizimit të tregjeve diskutohet shpesh. Disa masa, kryesisht blerja e produkteve nga shteti në kohën e korrjeve, zbatohen nga rezervat e të mirave shtetërore. Legjislacioni dhe çmimet aktuale devijojnë dukshëm nga rregulloret e BE-së. Zgjerimet e mëparshme kanë treguar se institucionet e tilla ose duhet të riorganizohen në agjensitë ndërhyrjes në treg duke ndjekur legjislacionin e BE-së ose thjesht duke supozuar një rol strategjik të menaxhimit të krizës jashtë kompetencavetë politikës bujqësore.

CAP, megjithatë, ofron masa të menaxhimit të tregut të tilla si ndihma për magazinimin në struktura private, disa lloje të ndërhyrjes publike dhe masat mbrojtëse të tregtisë të bazuar në rregullat e WTO. Sfida metë cilën do të përballen vendet e Evropës Juglindore do të jetë të marrin në konsideratë mekanizmat e menaxhimit të tregut të cilat mund të ofrojnë një rrjet të arsyeshëm të sigurisë kundër çrregullimeve të tepërta të tregut në kuadër të kufizimeve ekzistuese buxhetore duke respektuar parimet e CAP dhe marrëveshjet e tregtisë ndërkombëtare.

Masa të tjera gjithashtu mund të konsiderohen për të zbutur ndikimin e luhatjeve sezonale për prodhuesit, duke përfshirë menaxhimin e riskut të të ardhurave dhe prodhimit dhe të mekanizmave të sigurimit të prodhimit. Disa masa për të ulur primet e sigurimit të prodhimit për prodhuesit bujqësor ekzistojnë tashmë, por mund të zhvillohen edhe më tej.

Standardet e marketingut dhe masat e politikave të cilësisë janë elemente përbërëse të menaxhimit të tregut të BE-së dhe futja graduale e këtyre standardeve dhe masave të politikave cilësore dhe, harmonizimi i tyre me rregullat e BE-së është një element i rëndësishëm i procesit të integrimit në BE. Në këtë proces, mund të jetë e dobishme si për tregjet e brendshme ashtu edhe për tregtinë e jashtme futja e standardeve të marketingut dhe masave të cilësisë së BE-së për sektorët përkatës të prodhimit të cilët janë përfshirë tashmë në periudhën e para-anëtarësimit.

3. Mbështetja analitike e politikave efikase

3.1 Përvoja evropiane dhe hendeqet e Evropës Juglindore

Politika e bazuar në evidenca është një pjesë integrale e politikëbërjesmoderne. Në procesin e integrimit evropian, që nënkupton reforma radikale të politikave dhe negociata komplekse, kjo bëhetedhe më edomosdoshme. Zgjerimet e mëparshme të BE-së na kanë mësuar se kërkesa për mbështetje analitike të politikave rritet në mënyrë dramatike gjatë procesit të anëtarësimit.

Analizat e mira statistikore, vlerësimet e impaktit, si dhe mbështetja për planifikimin e reformave të politikave bujqësore, mund të përmirësojnë ndjeshëm vendimmarrjen e politikës bujqësore.

Në seksionin e mëposhtëm është bërë një hyrje e shkurtër për mënyrën se si është organizuar mbështetja analitike e politikave në Shtetet Anëtare të BE-së dhe cilët janë rolet e aktorëve individualë. Kjo shërben si bazë për vlerësimin e situatës në vendet e SEE-së dhe diskuton ndryshimet e nevojshme në formën e rekomandimeve brenda një kuadri konceptual.

Roli i mbështetjes analitike të politikave në vendet anëtare të BE-së

Në BE ministritë e bujqësisë janë përgjegjëse për ciklin e politikave në tërësidhe për të përcaktuar të gjitha fazat në veçanti. Megjithatë, mënyra se si janë të organizuara ministritë dhe mënyra se si ato operojnë i ndalon ato nga trajtimi i plotë dhe efektiv i të gjitha fazave të ciklit, duke e bërë të nevojshme mbështetjen e jashtme, sidomos nga ekonomistët bujqësorë, si institucionet ashtu edhe individët. Kjo nevojë për mbështetje mund t'i atribuohet në mënyrë të veçantë fazave të monitorimit dhe vlerësimit të ciklit të politikave me dimensione afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe të aftësive të ndryshme dhe metodave të nevojshme për të kryer analiza dhe për të formuluar propozime.

Departamente të ndryshme ministrore janë të afta për të siguruar mbështetje analitike afatshkurtër dhe afatmesme, sidomos për vendimet, ku duhet të meren parasysh konteksti politik, ndjeshmëria politike, apo ndikimet e aktorëve politikë. Një ministri zakonisht do të kërkojë ekspertizë shtesë dhe do të nënkontraktojë një pjesë të punës së saj. Për shembull, pikat e mëposhtme janë në mënyrë tipike pjesë e politikës moderne bujqësore dhe zakonisht janë të nënkontraktuara, kryesisht tek institucionet akademike:

- *Vlerësim i impaktit* të propozimeve të politikave ose mjedisit të ndryshueshëm ekonomik (regjimet tregtare, pikpamjet e tregut): vlerësime sasiore të ekonomisë bujqësore me ndihmën e mjeteve moderne bazuar nëshkencë;
- *Raportet e gjelbra*: raportet vjetore – monitorimi i situatës në bujqësi dhe politikën bujqësore bazuar në statistika bujqësore, përshkrime të politikës dhe transfertave buxhetore;
- *Kontabiliteti i fermave* (kontabiliteti, FADN): zhvillimi, ofrimi dhe përdorimi i sistemit.

Shtetet anëtare të BE-së kanë modele të ndryshme për të ofruar mbështetje analitike të jashtme në ministritë e bujqësisë. Institucionet kërkimore publike (akademike) janë duke punuar në bazë të marrëveshjeve koncesionare, kontratave afatgjata dhe afatshkurtra me qeverinë dhe përfituesit e tjerë. Ata kanë lidhje të ngushta me ministritë, të cilat shpesh mbajnë të drejtën e pronësisë së punës së bërë. Ky model është më i zakonshëm, konsistent dhe ndoshta edhe më i suksesshëm midis Shteteve Anëtare; shembujt përfshijnë LEI (Holandë), TEAGASC (Irlandë), KIS (Slloveni), VUZE (Republika e Çekisë), AKI (Hungari), LVAEI (Letoni), LAEI (Lituania). Shumica (me përjashtim të LEI) janë shtetërore, dhe një pjesë e detyrës së tyre është që ti ofrojnë ekspertiza ministrive. Institute të tilla gjithashtu trajtojnë një pjesë të madhe të aktiviteteve të monitorimit, si për shembulll dorëzimin e raporteve të gjelbra, menaxhimin e FADN dhe llogaritjen e kostove operacionale të fermës.

Marrja e shërbimeve nga studiues individualë apo grupe studiuesish (profesorë, institute) në universitete janë metoda më e përhapur e organizimit të mbështetjes analitike në vendet pa institute të kërkimit publik. Monitorimi dhe konsultimi i vazhdueshëm janë detyrat e tyre. Megjithatë, ata kryejnë matje dhe vlerësime impakti, si dhe kërkime shkencore më specifike. Ministritë tenderojnë shërbimet e tyre në bazë projektesh. Duket se ka një tendencë që universitetet humbasin gradualisht kapacitetet e tyre për kërkime teknike të avancuara shkak të

ndryshimit të orientimit drejt kërkimit më pak të avancuar i cili kryhet për t'i ofruar eskpertizë për ministritë.

Organizmat private kërkimore dhe këshillimore janë duke fituar rëndësi, por janë ende më pak përfaqësuese për mbështetje analitike. E vetmja fushë në të cilënroli i organeve këshillimore private është në rritje të konsiderueshme është vlerësimi i programeve të zhvillimit rural.

Zhvillimet e fundit në vendet e Evopës Juglindore

Bashkëpunimi për këtë punë studimore ka treguar se ministritë nga vendet e Evropës Juglindore janë të vetëdijshme për kërkesat e ciklit të politikës. Kjo kuptohet nga puna për dokumentet ligjore dhe strategjike në lidhje me politikën bujqësore, ku elementet e përafrimit janë zbatuar në mënyrë progresive, por edhe nga shprehjet e qarta të vullnetit politik. Këto të fundit përmbajnë identifikimin e problemeve, formulime të politikave, dhe kohët e fundit ndonjëherë edhe zhvillimin e planifikimit financiar të mjeteve buxhetore, ndërsa formulimet në lidhje me zbatimin e rregullave bëhen zakonisht brenda ministrive.

Monitorimi përdoret shumë rrallë, vlerësimi edhe më pak, me përjashtim të vendeve që tashmë zbatojnë IPARD-in. Pikërisht këto dy faza të ciklit të politikave janë - në vendet e zhvilluara - bazuar në mbështetje analitike të mirë-hartuara dhe të zbatuara në mënyrë profesionale, ku zakonisht mbështeten edhe nga ekspertiza e jashtme. Mungesa e rezultateve të krahasueshme të monitorimit dhe vlerësimit sugjeron se në rajon nuk janë zhvilluar akoma sistemet e mbështetjes analitike sistematike. Së fundmi, mbështetja e dobët analitike është ende një faktor i madh për cilësinë e vendimmarrjes së politikës bujqësore në vendet e SEE-së.

Gjatë kryerjes së këtij studimi bashkëpunimi midis ministrive të bujqësisë dhe institucioneve akademike në vendet e SEE-së është analizuar në detaje dhe është përforcuar. Emëruesi i përbashkët i të gjitha diskutimeve ishte njohja reciproke e rëndësisë së mbështetjes analitike për vendimmarrje të politikave bujqësore dhe të politikës së bazuar në evidenca.

Në rajonin e Evropës Juglindore mbështetja analitike sigurohet nga departamentet e ministrisë, institucioneve të caktuara të ekonomisë bujqësore, si dhe një rreth i vogël i individëve pa marrëveshje të përhershme me ministritë. Është fakt që procesi i vendim-marrjes së politikës bujqësore në rajon akoma nuk ka mbështetje analitike të mjaftueshme të ekonomisë bujqësore.

Në mënyrë që të arrihet rezultati i dëshiruar në procesin e integrimit në BE dhe për të formuar një politikë bujqësore efikase dhe të bazuar në evidenca, janë të nevojshme përmirësime në nivelet organizative dhe operative. Një sistem pa institucione, staf dhe burime financiare të përhershme nuk mund të ofrojë shërbime efikasetë vazhdueshme. Për më tepër, një model i bazuar vetëm tek studiuesit universitarë individualë nuk mund të jetë i suksesshëm për shkak të detyrimeve të tjera të këtyre studiuesve.

Ekziston një nevojë në rritje për shërbime të thella analitike të cilat departamentet e brendshme të ministrive të bujqësisë nuk do të kenë kapacitet për t'i ofruar. Rekrutimi i stafit kompetent dhe të besueshëm për ekipet e mbështetjes analitike të gatshëm për të punuar mbi çështjet e politikave është bërë gjithnjë e më e vështirë jo vetëm për institucionet publike, por edhe për institutet kërkimore dhe universitetet private.

3.2 Roli i ri i mbështetjes analitike në vendet Evropës Juglindore

Për një proces të suksesshëm modernizimi dhe integrimi, duhet të forcohet më tej roli i ekonomistëve bujqësorëdhe të mbështeten aktivitetet e tyre për të siguruar nëpërmjet një mbështetje analitike efikase një politikë të bazuar në evidenca.

Aktivitetet mbështetëse analitike në fushën e bujqësisë janë rezultat i bashkëpunimit intensiv midis organeve qeveritare dhe institucioneve të jashtme, kryesisht akademike. Të dy partnerët

kanë një përgjegjësi të përbashkët për shtrirjen dhe cilësinë e mbështetjes analitike. Të dhënat solide, aftësitë analitike, si dhe mbështetja politike konsiderohen si elemente të rëndësishme të politikës së bazuar në evidencë dhe qasjes së ciklit të politikës në procesin e modernizimit dhe të integrimit, ashtu edhe në fushën e bujqësisë. Kuptimi i fakteve, ecurive dhe ndryshimeve të kaluara të fituara me anë të analizave të impaktit të politikave (ex-post apo ex-ante), është një motiv i mirëpër të mbështetur dhe për të përmirësuar vendim-marrjen. Vendimmarrësit kërkojnë mbështetje për çështje të caktuara kryesore në formën e opinioneve dhe studimeve të ekspertëve. Ekspertët në politikën bujqësore të brendshme dhe evropiane mund të ndihmojnë në kryerjen e analizave të situatës, krahasimin me gjendjen e BE-së, dhe përgatitjen e justifikimeve të shëndosha të bazuara në evidenca për politikën e reformave bujqësore.

Një aktivitet i rëndësishëm i mbështetjes analitike është që të krijohet një sistem monitorimi si pjesë e ciklit të politikave bujqësore në periudhën e para-anëtarësimit në BE. Në të kaluarën kjo çoi shumë vende kandidate të vendosnin sisteme monituruese tipike të BE-së (EU Like) gjatë këtyre periudhave, duke prodhuar të ashtuquajturat "raporte të gjelbra" për gjendjen e bujqësisë dhe politikës bujqësore për t'ju prezantuar qeverisë, parlamentit dhe publikut të gjerë. Sistemi i raporteve të gjelbralidh harmonizimin dhe krahasimin e statistikave, masave dhe transfertave buxhetore dhe procesin e negociimit me procesin e përgjithshëm të monitorimit. Gjithashtu, këto raporte mbështesin krijimin e një cikli efikas të politikës. Në disa vende, kjo lloj pune ka përbërë një hap të rëndësishëm duke e bërë më të qëndrueshme dhe transparente procesin e hartimit të politikave dhe vendim-marrjen bujqësore.

Kjo zonë e mbështetjes analitike karakterizohet edhe nga bashkëpunimi i fortë ndërkombëtar. OECD, FAO, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian të gjitha kërkojnë të dhëna dhe fakte kombëtare, si dhe disa lloje vlerësimesh të impaktit kombëtar dhe rajonal. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm për rritjen dhe standardizimin e sasinë e të dhënave, mjeteve empirike dhe shkëmbimit të njohurive, dhe për të vënë pikëpamjet kombëtare në një kontekst më të gjerë.

Reforma e nevojshme e politikës bujqësore dhe procesi i integrimit në BE në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojnë kërkesë më të madhe për mbështetje analitike. Menaxhimi efikas dhe investimi i vazhdueshëm në edukimin e profesionistëve është një pjesë e rëndësishme e modernizimit të politikës bujqësore që mund të kontribuojë në zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Mbështetja është e nevojshme në të gjitha fazat e ciklit të politikave, mbi të gjitha në monitorimin, vlerësimin dhe programimin.

Në kuadrin e diskutimeve të mësipërme, rekomandohet që vendet e pranuara të SEE-së të krijojnë një bashkëpunim të përhershëm rajonal për analizën dhe monitorimin e politikave bujqësore, duke ndjekur shembullin e forumit të OECD-së për vendet në tranzicion dhe në zhvillim dhe në sektorin e bujqësisë gjatë viteve 1990. Krijimi i një baze të dhënash rajonale dhe forumesh për shkëmbimin e mendimit të ekspertëve mbi politikën bujqësore do të lehtësojë krahasimin dhe zhvillimin e masave të politikës dhe mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në marrjen e vendimeve të politikës bujqësore dhe procesin e integrimit në rajon.

Platformat kombëtare dhe rajonale të themeluara me këtë projekt mund të shërbejnë si një bazë solide për zbatimin dhe forcimin e bashkëpunimit të tillë të vazhdueshëm dhe për forcimin e rrjetit dhe kapacitetit për analizimin dhe hartimin e politikave bujqësore në rajon.

4. Vërejtje përfundimtare për orientimin e propozuar

Prioritetet strategjike dhe objektivat e propozuara në këtë studim janë nga natyra të ngjashme me ato të identifikuara në dokumentet përkatëse të politikave bujqësore strategjike të vendeve të SEE-së, duke theksuar si thelbësore për hartimin e politikave efektive aspektin specifik dhe qasjet e konsideruara. Në këto dokumente strategjike qeveritë njohin rëndësinë e orientimit të zhvillimit përmes sfidave të identifikuara dhe të objektivave të politikës, por zbatimi praktik i këtyre objektivave mbetet i kufizuar.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale kërkon angazhim dhe përpjekje të vazhdueshme, si edhe kapital, si financiar ashtu edhe human, në formën e ekspertëve të trajnuar mirë dhe të përkushtuar të cilët kërkojnë dhe gjejnë zgjidhje si dhe koordinojnë dhe zbatojnë masat e politikave. Përgjegjësia për këtë qëndron në njërën anë në sektorin privat, me institucionet financiare të tij dhe organizatat e sektorit agro-ushqimor, dhe nga ana tjetër me vendimmarrësit publik për të krijuar ambient të përshtatshëm ligjor dhe institucional, si dhe strukturat e duhura mbështetëse.

Politikëbërja e orientuar nga zhvillimi mbështetet në planifikimin strategjik afatgjatë solid, identifikon zgjidhje të përshtatshme të politikave, përpiqet të optimizojë dhe kombinojë masa të politikës dhe promovon partneritetin privat-publik. Pra është e rekomandueshme që kjo qasje të aplikohet gjithnjë e më shumë në politikëbërjen bujqësore dhe në zhvillimin rural në vendet e SEE-së për të trajtuar sfidat e mëdha që i presin këto vende. Kjo qasje siguron mjete për zhvillimin e një sektori bujqësor të aftë për të përdorur burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme, zbulimin e potencialeve të fshehura për prodhimin e produkteve konkurruese me cilësi të lartë, si dhe nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik rural në rajon.

Integrimi në BE është një objektiv kryesor i të gjitha vendeve në rajon. Përputhshmëria me politikën CAP të BE-së është një sfidë e madhe, por edhe një mundësi për të modernizuar politikën bujqësore. Megjithatë, harmonizimi i legjislacionit dhe procedurave nuk është në vetvete një arritje për aq kohë sa nuk është e integruar plotësisht në politikëbërjen dhe zbatiminkombëtar. Deri atëherë harmonizimi mbetet thjesht një ushtrim i vështirë dhe i shtrenjtë. Kjo mund të jetë arsyeja pse shumë vende vonojnë integrimin e plotë deri në një fazë shumë të vonë në procesin e negociatave. Përvoja nga pranimet e mëparshme në BE ka treguar se vendet e pranuara nuk janë ende të gatshme për pjesëmarrje të plotë në skemat e CAP, që do të thotë se atonuk janë në gjendje të përfitojne plotësisht nga fondet e konsiderueshme në dispozicion.

Një integrim racional dhe gradual i elementeve të CAP dhe procedurave administrative që merr parasysh mundësitë dhe nevojat e ndryshme të vendeve mund të kontribuojnë në zhvillimin dhe zbatimin efektiv dhe koherent të një politike. Parimi kryesor që duhet të respektohet në këtë proces është që të fillojë zbatimi i elementëve të zgjedhur të CAP, i cili do të sigurojë një përfitim të menjëhershëm në vend. Përtej rolit më të fuqishëm të mbështetjes së fermës,modernizimin e zinxhirit agro-ushqimor dhe futjen e pagesave për krerë bagëti dhe për sipërfaqe, do tëishtee mundur në sektorët kryesorë të përfshihet zbatimi istandardeteve të harmonizuara të marketingut CAP dhe masave të politikave të cilësisë. Masa të tilla do të forcojnë pozicionin në treg të këtyre produkteve, ose zgjedhjen e elementeve të veçanta të politikave agro-mjedisore. I tillë mund të jetë prodhimi organik për të zhvilluar kështu potencialin ekzistues në këtë fushë. Ndjekja e kësaj qasjeje do të japë përvojë praktike në zbatimin e mirëfilltë të CAP, si në sektorin privat ashtu edhe në administratën publike. Kjo qasje ndihmon në dërgimin e një sinjali të qartë BE-së se vendi aplikues është serioz në lidhje me procesin e integrimit në BE.

Përveç zbulimit të mangësive dhe dhënies së sugjerimeve politike, vëmendje e veçantë i është dhënë forcimit të bashkëpunimit ndërmjet ministrive dhe ekonomistëve bujqësorëme përvojë në mbështetjen e politikave bujqësore. Ky studim është rezultat i këtij rrjeti bashkëpunimi. Angazhimi i ekspertëvenga ministritë dhe bota akademike të përfshirë në këtë rrjet ka qenë shumë intensiv. Pra është shumë e rekomandueshme që rrjeti i krijuar të bëhet një platformë e përhershme për bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e ideve dhe përvojës në fushën e analizimit dhe monitorimit të politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Një forum i tillë padyshim do të kontribuojë në përmirësimin e politikave të bazuara në evidenca, për të lehtësuar harmonizimin e politikave në rajon dhe për të forcuar procesin e integrimit në BE në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Prandaj FAO dhe SWG-jaftojnëqeveritë e SEE-së dhe donatorët ndërkombëtarë të mbështesin konsolidimin e kësaj platforme dhe forcimin e kapacitetit të saj analitik për të lehtësuar hartimin

dhe kryerjen e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural në rajon nën perspektivën e integrimit në BE. Kjo është shpresa e FAO-s dhe SWG-së se BE-ja do t'i njohë dhe mbështesë këto përpjekje.

Kapitulli B.I

BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË SHQIPËRI

Edvin Zhllima*, Grigor Gjeci, Drini Imami***

1. Hyrje

Orientimi i ardhshëm i politikës bujqësore dhe zhvillimit rural të Shqipërisë me CAP kërkon një vizion të ri për hartimin e politikave, si dhe një qasje të re në hartimin e masave të politikës, të ngjashme me transformimin e kryer nga Shtetet e reja Anëtare para anëtarësimit.

Në këtë kuadër, të kuptuarit e strukturës së larmishme dhe komplekse të politikave bujqësore kombëtare dhe krahasimi i tyre me kompleksitetin aktual të politikave bujqësore në BE është një parakusht i nevojshëm për vendim-marrje racionale në bujqësi.

Qëllimi i këtij kapitulli është të ofrojë një profil të bujqësisë dhe politikës bujqësore në Shqipëri bazuar në analizat e treguesve statistikorë krysorë dhe të dhënave të tjera lidhur me procesin eintegrimit evropian. Objektivi kryesor është vlerësimi i pikave të forta dhe pikave të dobëta të bujqësisë shqiptare si dhe diferencat kryesore në hartimin dhe zbatimin e politikës krahasuar me BE-në.

Burimet kryesore të të dhënave të përdorura në studim janë Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Analiza e të dhënave është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Bujqësisë dhe Politikave Rurale në MBZHRAU, Departamentit të Financës dhe Agjensisë Kombëtare të Pagesave. Periudha e mbulimit për analizën është 2007-2012.

Për një rishikim krahasues të politikave buxhetore është përdorur një model i përbashkët për klasifikimin e masave të politikës bujqësore- databaza APM-së (Rednak et al., 2013). DatabazaAPM është krijuar për periudhën 2007-2012.

Struktura e kapitullit përbëhet nga katër nën-kapituj, si vijon. Nën-kapitulli i dytë paraqet një përshkrim të sektorit të bujqësisë duke vlerësuar rëndësinë e bujqësisë në ekonomi, prodhimin bujqësor dhe strukturën e tij, çmimet bujqësore dhe tregtinë agro-ushqimore sipas produkteve dhe vendeve partnere. Nën-kapitulli i tretë paraqet një përmbledhje të politikës bujqësore bazuar në një analizë krahasuese të transfertave buxhetore të politikës bujqësore. Nën-kapitulli i fundit jep rekomandime kryesore që nënvizojnë çështjet në lidhje me politikat që pengojnë përpjekjet e Shqipërisë për të përshtatur politikat e saj me BE-në.

* Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit
** Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

2. Bujqësia

2.1 *Profili bujqësor*

Shqipëria është karakterizuar nga një stabilitet makroekonomik gjatë viteve të fundit. Megjithatë, rritja ekonomike u ngadalësua nga një mesatare prej 4,7 përqind në periudhën 2007-2011 në 1,5 për qind në vitin 2012. Inflacioni nuk e ka tejkaluar 3,6 përqind gjatë viteve të fundit. PBB-ja shqiptare është rreth 3 400 EUR për frymë, e cila tregon një përmirësim të ndjeshëm në 5 vjeçarin e fundit.

Tabela B.I-1: Treguesit makroekonomik, 2007-2012, Shqipëria

	Njësi	2007	2008	2009	2010	2011	2012
PBB (me çmime korente)	milionë. EUR	7 828	8 870	8 725	8 878	9 235	9 671
Rritje ekonomike	%	5.9	7.5	3.3	3.8	3.1	1.5
PBB për frymë	EUR	2 669	3 056	3 030	3 109	3 261	3 415
PBB për frymë në PPS	EUR	6 280	6 994	7 197	7 385	7 692	7 924
Inflacioni	%	2.9	3.4	2.3	3.6	3.5	2.1
Norma e papunësisë	%	13.2	12.5	13.6	13.5	13.3	13.5

Burimi: INSTAT

Bujqësia mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm në ekonominë shqiptare. Në vitin 2012 bujqësia kontribuoi me 21,3 përqind të Vlerës së Shtuar Bruto të vendit (GVA). Në këtë sektor punojnë rreth 55 përqind e totalit të të punësuarve, tregues ky shumë i lartë edhe në krahasim me vendet e rajonit (shikoni Kapitullin A.II).

Tabela B.I-2: Kontributi i bujqësisë në ekonomi, 2007-2012, Shqipëria

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Kontributi në GVA totale (%)	19.0	18.7	18.7	20.2	20.4	21.3
Kontributi në punësimin (%)	57.7	58.4	55.2	55.3	54.6	55.0
GVA/punonjës (EUR)	2 469	2 612	2 946	3 027	3 180	3 639
Norma reale e rritjes së GVA (%)	2.7	7.1	1.9	7.9	3.3	9.0

Burimi: INSTAT

Norma reale e rritjes vjetore të GVA-së së sektorit të bujqësisë ka qenë e rëndësishme që nga viti 2007, duke shënuar rritje të fortë çdo vit të dytë (3,3 për qind në 2011, 9 përqind në 2012). Megjithatë, produktiviteti i punës në bujqësi matur nga vlera e GVA-së për punonjës (rreth 3 600 EUR), mbetet i ulët në krahasim vlerën totale të të gjithë sektorëve ekonomikë(8 700 EUR për punonjës).

Nga sipërfaqja e përgjithshme e 2 875 000 ha rreth 1 204 000 ha është tokë bujqësore (MBZHRAU, 2013). Rreth 1 237 000 ha ose 43 përqind e sipërfaqes së përgjithshme është e mbuluar me pyje, dhe pjesa tjetër 437 000 ha është tokë tjetër.

Në vitin 2012 kishte rreth 350 000 ndërmarrje bujqësore në Shqipëri të cilat operonin në rreth 980 000 ha të tokës bujqësore. Në vitet e fundit ka pasur një rritje në madhësinë e fermës por sipërfaqja bujqësore për fermë në Shqipëri është akoma shumë e ulët në vetëm 2,8 ha. Sipërfaqja bujqësore në këtë rast përfshin kullotat dhe livadhet në dispozicion dhe jo kullotat dhe livadhet e përdorura të cilat tregojnë se madhësia mesatare e fermës matur nga sipërfaqja bujqësore e përdorur është dhe më e vogël. Kullotat dhe livadhet menaxhohen akoma nga shteti në pjesën më të madhe dhe janë dhënë vetëm pjesërisht me qira për fermerët blegtoralë. Një pjesë e madhe e këtyre sipërfaqeve nuk aksesohen nga fermat.

Në vitin 2012 prodhimi bujqësor arriti 1 340 milionë EUR, që është një rritje prej 8 përqind në krahasim me vlerën e prodhimit në vitin 2007. Vlera e prodhimit blegtoral ishte 10 përqind më e

ulët në 2012 se në vitin 2007, ndërsa prodhimi i bimëve të arave u rrit me 21 përqind në të njëjtën periudhë. Faktori më i madh për ruajtjen e rritjes pozitive të prodhimit bujqësor është sektori i frutave që regjistroi rritje prej 67 përqind gjatë periudhës 2007-2012. Këto tendenca shkaktuan një ndryshim në strukturën e prodhimit bujqësor. Sektori i blegtorisë ende përfaqëson gjysmën e gjithë prodhimit bujqësor, edhe pse kontributi i tij në prodhimin e përgjithshëm bujqësor është zvogëluar nga 60 përqind në vitin 2007 në 50 për qind në vitin 2012.

Tabela B.I-3:Vlera e produkteve bujqësore (në milionë EUR[1]), 2007-2012, Shqipëria

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2012/2007
Bujqësia Total	**1 239**	**1 264**	**1 159**	**1 238**	**1 283**	**1 340**	**108**
Blegtoria	745	705	639	647	664	669	90
Bimë arash	335	371	345	385	401	405	121
Pemë frutore	159	187	175	206	218	266	167
Kontributi i sektorëve							
Blegtoria	60%	56%	55%	52%	52%	50%	
Bimë arash	27%	29%	30%	31%	31%	30%	
Pemë frutore	13%	15%	15%	17%	17%	20%	

Shënim: [1] Kursi zyrtar i këmbimit nga Banka e Shqipërisë u përdor për të konvertuar vlerat nga ALL në EUR.
Burimi: INSTAT

Rendimentet bujqësore janë shumë të ndikuara nga niveli përgjithësisht i ulët teknologjik dhe infrastruktura e dobët. Gjatë vëzhgimit të rendimenteve të disa produkteve të zgjedhura të tilla si gruri, patatja dhe qumështi i lopës, janë zbuluar dallime të mëdha në krahasim me BE-në. Rendimentet e grurit (mesatare 2010-2012: 4,1 ton për ha) dhe rendimentet e patates (24,1 ton për ha) nuk kanë diferenca të mëdha nga shumica e shteteve anëtare të BE-së, ndërsa rendimenti i qumështit të lopës (2 664 kg për lopë) është më i ulët se në çdo shtet anëtar të BE-së (shikoni Kapitullin A.II).

Siç shihet nga prodhimi i qumështit, por edhe nga tregues të tjerë,prodhimi blegtoral në Shqipëri është duke performuar dobët për arsye të ndryshme, të tilla si çmimet e larta të ushqimit të importuar të kafshëve, mungesës dhe cilësisë së ulët të ushqimit të kafshëve, kjo e fundit për shkak të kostos së lartë të të ushqyerit dhe aftësive të dobëta në menaxhimin blegtoral (IPARD, 2013).

Gjithashtu çmimet e prodhimit të produkteve bujqësore janë relativisht të larta në krahasim me çmimet në BE, veçanërisht në sektorin e blegtorisë (shikoni AneksinB.I-3 dhe Kapitullin A.II).

2.2 *Tregtia agro-ushqimore*

Në periudhën 2007-2012, eksportet agro-ushqimore shqiptare janë rritur në mënyrë të konsiderueshme - me një mesatare prej 10 përqind në vit - duke arritur në 82,9 milionë EUR në 2012. Importet nga ana tjetër janë rritur mesatarisht me 4 përqind në vit. Raporti eksport/import është përmirësuar nga 10,8 përqind në vitin 2007 në 15,4 përqind në 2012, pra eksportet janë rritur më shumë se importetpër periudhën e studiuar.

Tabela B.I-4: Tregtia ndërkombëtare e produkteve agro-ushqimore (milionë EUR), 2007-2012, Shqipëria

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2012/2007
Eksportet	54.8	54.5	51.5	58.9	71.5	82.9	151
Importet	503.9	590.3	519.8	577.1	597.0	618.4	123
Bilanci tregtar	-449.1	-535.8	-468.3	-518.2	-525.5	-535.5	119
Raporti Eksport/Import	10.8%	9.2%	10.9%	11.4%	13.6%	15.4%	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Shqipëri

Në vitin 2012 importet agro-ushqimore përfaqësuan rreth 16 përqind të importeve totale të të mirave, ndërsa pjesa e produkteve agro-ushqimore në totalin e eksporteve ka qenë 5,4 përqind.

Tre produktet më të rëndësishme të eksportit janë peshku i konservuar (grupmalli Preparate mishi - CT 16), bimët mjeksore, veçanërisht sherebela (grupmalli farëra vajore - CT 12) dhe perime (grupmalli perime, bimë, rrënjë, zhardhokë të ngrënshëm - CT 7). Në vitin 2012 këto tre grupe mallrash përfaqësuan pothuajse 60 përqind të totalit të eksporteve agro-ushqimore. Jo çuditërisht, importet janë më të larmishëm sesa eksportet. Grupet më të rëndësishme të mallrave të importit janë drithërat (CT 10), sidomos gruri, pijet (CT 22), vaj vegjetal (CT 15) dhe mishi (CT 2) mbulojnë rreth 40 përqind të importeve agro-ushqimore shqiptare. Gruri është shumë i rëndësishëm për industrinë e miellit si dhe ushqim për kafshët.

Tabela B.I-5: Grupet kryesore të mallrave të eksportit/importit, 2012, Shqipëria

Eksport			Import		
Grupi i mallrave	**Milionë EUR**	**Kontributi**	**Grupi i mallrave**	**Milionë EUR**	**Kontributi**
Farëra vajore, frutat me përmbajtje vajore (12)	20.4	25.0%	Drithëra (10)	94.7	15.3%
Preparate mishi (16)	18.9	22.8%	Pije, pije alkolike, uthull (22)	69.0	11.2%
Perime, bimë, rrënjë, zhardhokë të ngrënshëm (7)	7.8	9.3%	Yndyrna dhe vajra shtazore ose vegjetale (15)	48.0	7.8%
			Mish dhe të brendshme të ngrënshme të mishit (2)	48.0	7.8%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Shqipëri

Destinacionet e eksporteve dhe importeve janë të lidhura fort me aksesin gjeografik, migrimin dhe bashkëpunimin ekonomik. Partneri kryesor i eksporteve agro-ushqimore të Shqipërisë është Italia me 32,2 përqind të totalit të eksporteve agro-ushqimore në vitin 2012. Partnerë të tjerë të rëndësishëm të eksportit janë Greqia, Kosova* dhe Gjermania; këto katër vende së bashku mbuluan 65 përqind të eksporteve agro-ushqimore shqiptare në vitin 2012. Për sa i përket importeve, Italia është përsëri partneri më i rëndësishëm, pasuar nga Greqia, Rusia dhe Brazili. Këto katër vende së bashku zënë 43 përqind të totalit të importeve agro-ushqimore në vitin 2012.

Tabela B.I-6: Partnerët kryesorë të tregëtisë agro- ushqimore , 2012, Shqipëria

Eksport			Import		
Partneri	**Milionë EUR**	**Kontributi**	**Partneri**	**Milionë EUR**	**Kontributi**
Italia	26.7	32.2%	Italia	95.5	15.4%
Greqia	10.0	12.1%	Greqia	80.0	12.9%
Kosova*	9.1	11.0%	Rusia	57.2	9.3%
Gjermania	8.0	9.7%	Brazili	32.8	5.3%

Burimi: INSTAT

3. Politika bujqësore – një pamje e përgjithshme dhe krahasime

3.1 Koncepti dhe kuadri i politikës bujqësore të vendit

Në vitin 2005, Qeveria e Shqipërisë miratoi Sistemin e Planifikimit të Integruar (GoA, 2012), një grup parimesh operacionale për të siguruar se planifikimi dhe monitorimi i politikave të qeverisë si një e tërë zhvillohet në mënyrë efikase dhe të harmonizuar. Sistemi i Planifikimit të Integruar është sistemi bazë i vendim-marrjes kombëtare për përcaktimin e drejtimit të përgjithshëm strategjik dhe shpërndarjen e burimeve.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) kryen funksionet e saj bazuar në tre dokumente kryesore të politikave: Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (NSDI) 2014-2020, Programi Buxhetor Afatmesëm, dhe strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, ku janë vendosur objektivat e detajuara të politikave afatgjata dhe afatsmesme, masat kryesore, mjetet e monitorimit dhe kostot buxhetore të zbatimit të politikave. Drafti i NSDI

2014-2020 e konsideron bujqësinë të jetë një nga sektorët kryesorë në Shqipëri dhe ajo ka qëllim të rrisë konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike nëpërmjet inovacionit. Strategjia përfshin gjithashtu treguesit e performancës që duhen përmirësuar, të tilla si rritja e produktivitetit të punës dhe vlerës së shtuar në bujqësi dhe sektorin e përpunimit të ushqimit. Në kuadër të sektorit të bujqësisë, politikat afatshkurtra të MBZHRAU janë të detajuara në programin vjetor dhe aktivitetet përkatëse në planin vjetor të veprimit.

Gjatë periudhës 2007-2013 kanë qenë dy strategji: Strategjia e Bujqësisë dhe Sektorit të Ushqimit 2007-2013 dhe Strategjia e Zhvillimit Rural 2007-2013, ndërsa ISARD 2014-2020 integron si bujqësinë edhe zhvillimin rural në një strategji. Më konkretisht, ISARD parashikon ndërhyrjet në tri fusha të politikave: (i) politika të zhvillimit rural; (ii) skema kombëtare mbështetëse për fermerët, zhvillimin e infrastrukturës rurale duke siguruar mundësi të barabarta; dhe (iii) zhvillimi institucional, zbatimi dhe forcimi i kërkesave rregullatore të BE-së.

Zbatimi i Strategjisë Ndër-sektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (ISARD) 2014-2020 koordinohet nga MBZHRAU në bashkëpunim me ministritë e tjera. Kuadri ligjor kryesor i saj është Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural i miratuar në vitin 2007 i cili rregullon programimin e masave të politikës që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin rural, ofron shërbimet këshilluese publike për bujqësinë, studime dhe trajnime, dhe shërbimet për ngritjen e një bazë të dhënash. Ai gjithashtu siguron bazën ligjore për skemat kombëtare të mbështetjes, të cilat janë të përcaktuara çdo vit në Planin Kombëtar të Veprimit dhe përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave bujqësore, përmes themelimit të Agjensisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (ARDA).

Skemat kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural u prezantuan në vitin 2007 me miratimin e Ligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Masat kombëtare janë të programuara për çdo vit në Planin Kombëtar të Veprimit dhe zbatohen me një Dekret të Këshillit të Ministrave. Plani i Veprimit përcakton masat për zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural në vitin përkatës, planin financiar, kriteret e përshtatshmërisë dhe të normës/shumës së mbështetjes. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit është përgjegjësi e ARDA-s dhe Drejtorisë së Zhvillimit Rural, brenda MBZHRAU nën mbikëqyrjen e Komitetit Ndërministror për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

MADA (Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore) është gjithashtu duke zbatuar programe të cilat janë në fazat e tyre përmbyllëse: (i) Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural i Zonave Malore 2007-2013 dhe (ii) dheProgrami i Maleve drejt tregut 2009-2014, financuar nga Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Bujqësisë, Fondi i OPEK-ut për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Qeveria e Shqipërisë. Megjithatë, institucioni është afër mbylljes dhe nuk ka qasje të qartë për të gjetur një zëvendësues për të ardhmen për arritjen e zhvillimit të balancuar rajonal me një fokus në grupet vulnerabël dhe zonatjo të favorizuara.

Në nivel lokal institucionet kryesore që përfaqësojnë MBZHRAU-n janë Drejtoritë Bujqësore Rajonale. Njësitë e qeverisjes vendore të përbëra nga Bashkitë dhe Komunat janë gjithashtu të rëndësishme pasi ato menaxhojnë marrëdhëniet fiskale dhe inspektimet veterinare në nivel lokal.

ISARD për periudhën 2014-2020 ka katër prioritete: (i) rritja e qëndrueshmërisë së fermës dhe konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe sektorit të përpunimit të ushqimit, duke u afruar në mënyrë progresive me standardet e BE-së; (ii) restaurimi, ruajtja dhe rritja e ekosistemeve të përfshira nga bujqësia dhe pylltaria; (iii) zhvillimi i balancuar territorial i zonave rurale që promovon përfshirjen sociale, reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e balancuar ekonomik në zonat rurale; dhe (iv) transferimi i dijes dhe inovacionit në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale.

ISARD 2014-2020 do të zbatohet duke përdorur dy instrumente të mbështetjes: Programi IPARD II (Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural) dhe Programi i Mbështetjes Kombëtare.

Programi aktual IPARD II mbulon periudhën 2014-2016. Sipas dispozitave aktuale, Shqipëria ka akses në fondet e siguruara nën Boshtin 1 "Rritja e konkurrueshmërisë së agrobiznesit të bujqësisë dhe pylltarisë" dhe vetëm për tri masa, përkatësisht: Masa 101: Investime në ferma bujqësore me

qëllim ristrukturimin dhe përmirësimin në linjë me standardet e Komunitetit; Masa 103: Investimet në përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit për të ristrukturuar ato veprimtari dhe për t'i përmirësuar ato në një linjë me standardet e Komunitetit dhe Masa 503: asistencë teknike (për organet institucionale menaxhuese) (MBZHRAU, 2014).

Që nga viti 2011, Shqipëria ka hartuar Programin IPARD (2011-2013) dhe ka themeluar një strukturë operative të IPARD. Agjencia e Pagesave të IPARD brenda strukturave të ARDA do të jetë organi përgjegjës për zbatimin e programit IPARD. Përpjekjet janë ende të nevojshme për të përfunduar përgatitjen për akreditimin e të gjithë Sistemit të Menaxhimit dhe Kontrollit të IPARD, duke përfshirë aktivitetet e Nëpunësit të Autorizuar Kombëtar, Fondit Kombëtar, Organeve Teknike dhe Autoritetit të Auditimit. Në vitin 2013 MBZHRAU planifikoi aktivitete për zbatimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit për të përmbushur kërkesat e BE-së, të cilat përfshijnë themelimin e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS), krijimin e një regjistri të plotë të fermave dhe zhvillimin e mëtejshëm të procedurave për të zbatuar masat e zhvillimit rural.

Një tjetër mjet financimi është projekti "Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të ullirit shqiptar" (3.0 milion EUR) financuar në kuadrin e një marrëveshje dypalëshe italo-shqiptare që është vendosur për të filluar në mes të vitit 2014. Qëllimi i projektit është të arrijë një zhvillim të integruar të ullirit dhe zinxhirit të furnizimit të vajit të ullirit, duke filluar me përmirësimin e fidanëve të ullirit, deri në menaxhimin e nën-produkteve të vajit të ullirit dhe mbetjeve. Ai gjithashtu përfshin komponentët e ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe përmirësimit të kuadrit ligjor për vajin e ullirit. Komiteti Drejtues do të përfshijë përfaqësues të Ministrive shqiptare dhe italiane të Bujqësisë, Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Gjithashtu do të marrin pjesë si vëzhgues ARDA dhe përfaqësues të Asistencës Teknike.

3.2 Transfertat buxhetore të politikës bujqësore

Pavarësisht nga fakti se bujqësia në Shqipëri kontribuon me rreth 20 përqind të PBB-së, mbështetja për këtë sektorka qenë e kufizuar në aspektin e vlerës. Megjithatë, gjatë shtatë viteve të fundit disa skema mbështetëse janë futur për të mbështetur nënsektorë të ndryshëm të bujqësisë në Shqipëri. Përpjekje janë bërë që nga viti 2007 për të hartuar një skemë të mbështetjes dhe për të krijuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional. Megjithatë, buxheti për vitin 2012 ishte vetëm 0,5 përqind e PBB-së, dhe mbështetja totale buxhetore për bujqësinë ishte vetëm 1,3 përqind e GVA-së së bujqësisë.

Buxheti në Shqipëri ka qenë gjithmonë subjekt debati për shifrat modeste në krahasim me pritshmëritë. Sipas programit të Qeverisë për periudhën 2014-2020, situata për sa i përket mbështetjes buxhetore për bujqësinë pritet të përmirësohet. Buxheti i qeverisë për zhvillimin rural pritet të rritet me 5 përqind në periudhën 2014-2020 (GoA, 2013).

Mbështetja e politikave bujqësore dhënë në vitet e fundit është karakterizuar nga luhatje vjetore. Niveli më i ulët i mbështetjes është regjistruar në vitin 2008 me 12,4 milionë EUR, e cila ishte më pak se gjysma e shifrës së vitit 2007. Viti 2007 ishte viti me nivelin më të lartë të mbështetjes gjatë periudhës 2007-2012. Në vitet pas 2008, mbështetja buxhetore u luhat nga 19 milionë EUR (2010) 27 milion EUR (2009, 2011). Mbështetja e regjistruar në vitin 2012 ishte 23,7 milionë EUR.

Figura B.I-1: Shpenzimet buxhetore për sektorin agro-ushqimor (milionë EUR), 2007-2012, Shqipëria



Burimi: Databaza APM e Shqipërisë

Në kuadër të këtij buxheti, zhvillimi rural ka qenë prioritet i parë. Mbështetja për masat e zhvillimit rural në vitin 2012 përbënte 70 përqind të mbështetjes së përgjithshme buxhetore në bujqësi (16,5 milionë EUR). Mbështetja e tregut dhe mbështetja direkte e prodhuesve kanë zënë vetëm 7 përqind të mbështetjes së përgjithshme buxhetore në bujqësi (1,5 milionë EUR), dhe 23 përqind e mbështetjes përbëhej nga masa të tjera të përgjithshme në lidhje me bujqësinë (për 5,5 milionë EUR).

Figura B.I-2: Struktura e shpenzimeve buxhetore për sektorin agro-ushqimor, 2012, Shqipëria



Burimi: Databaza APM e Shqipërisë

Numri i skemave kombëtare të mbështetjes u rrit nga 3 në vitin 2007, në 23 në vitin 2013. Deri në vitin 2010 buxhetit vjetor i skemave kombëtare kishte trend rritës, duke arritur maksimumin prej 11,5 milionë EUR në vitin 2010. Për shkak të kufizimeve buxhetore, alokimi i buxhetit u reduktua në rreth 7 milionë EUR në vitet 2012 dhe 2013. Në vitin 2012, kishte 11 340 aplikime nga të cilët 7729 përfitues.

Figura B.I-3: Aplikantët dhe përfituesit e skemave kombëtare të mbështetjes, 2007-2012, Shqipëria



Burimi: MBZHRAU, 2013

Skemat kombëtare ofrojnë lloje të ndryshme të mbështetjes – kryesisht mbështetjen e investimeve bazuar në kostot standarde, mbështetje e prodhimit dhe subvencioneve të normave të interesit. Në total, në periudhën 2007-2012 janë shpërndarë për skemat kombëtare të mbështetjes rreth 43 milionë EUR. Rreth 75 përqind e kësaj shume ishte mbështetja e investimeve, mbështetja e prodhimit 15 përqind dhe 10 përqind subvencionim i normave të interesit.

Pjesa më e madhe (87 përqind) e mbështetjes së investimeve u shpërnda për skemat e investimeve për krijimin e plantacioneve të reja të kulturave të përhershme; kryesisht, ullinj (47 përqind e mbështetjes së investimeve), pemëtore (21 përqind), vreshta (11 përqind) dhe arra (7 përqind). Përgjatë periudhës së studimit ka pasur ndryshime vjetore në lidhje me sektorët e synuar (p.sh. fillimisht prioritet i lartë i është dhënë vreshtave ndërsa mbështetja kohët e fundit është zgjeruar në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike). Mbështetja e mbetur për investime shkoi për qëllime kryesisht në përmirësimin e ujitjes në fermë (puse dhe ujitje me pika).

Mbështetja e prodhimit është dhënë kryesisht për sektorët e bulmetit, të imtave, mjaltit, përpunimit të ullirit si edhe prodhimit organik. Mbështetja për prodhimin e qumështit është dhënë për fermat në bazë të pagesave për litër për qumështin e dorëzuar në bulmetore. Mbështetja për lopë dhe dele qumështi është dhënë në formën e pagesave për kokë, mbështetja për zhvendosjen sezonale të deleve është paguar për fermë, mbështetja për prodhimin e vajit të ullirit ekstra të virgjër është paguar për litër të prodhuar, dhe mbështetja për bletarinë dhe prodhimin e mjaltit është paguar për koshere. Kapitulli A.II ofron një pamje më të detajuar të strukturës së mbështetjes të krahasuar me vendet e tjera të SEE dhe EU 27.

4. Diskutime dhe konkluzione

Analiza evidentoi disavantazhe të ndryshme strukturore dhe politike në krahasim me BE-në në kontekstin e zhvillimit të bujqësisë. Numri i madh i fermave të subsistencës dhe semi-subsistencës është një karakteristikë e theksuar e Shqipërisë. Me hapjen graduale të tregut në procesin e integrimit në BE, fermerët shqiptarë do të përballen me konkurencë në rritje në tregjet bujqësore, çka e bën politikën mbështetëse gjithëpërfshirëse akoma më të rëndësishme.

Kuadri i politikave që adreson zhvillimin e sektorit të bujqësisë është i fragmentuar dhe i shpërndarë ndër dokumente dhe institucione të ndryshme të politikës. Një hendek politik mbetet arritja e koherencës dhe përafrimit të strategjive ndër-sektoriale me njëra-tjetrën si dhe me strategjitë e zhvillimit rajonal, bazuar në Prioritetet Kombëtare të Zhvillimit.

Politika mbështetëse e bujqësisë gjatë periudhës 2007-2012 ka qenë shumë e brishtë, duke u luhatur në vlera absolute dhe në përbërje. Skemat mbështetëse nuk janë të fokusuara në mbështetjen e tregut dhe mbështetjen direkte të prodhuesve për shkak të burimeve të dobëta financiare dhe vëmendjes së paqartë ndaj çështjeve të tilla si përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, jetesës së qëndrueshme rurale dhe zhvillimit të balancuar territorial. Mbështetja e ulët buxhetore, së bashku me një infrastrukturë jo të favorshme, kostot e larta të inputeve, prodhimi shumë i fragmentuar dhe aksesi i dobët në shërbime të tilla si kreditë, tregjet dhe shërbimet këshillimore kanë rritur cënueshmërinë e fermerëve shqiptarë ndaj homologëve të BE-së si në aspektin e investimeve ashtu edhe të produktivitetit. Një strategji gjithëpërfshirëse si për bujqësinë edhe për zhvillimin rural ka munguar deri në vitin 2013.

Strategjia e Zhvillimit Rural 2014-2020, akoma e paadoptuar, është shoqëruar nga një plan veprimi në përputhje me kuadrin e strategjisë evropiane të zhvillimit rural, duke ruajtur fokusin strategjik mbi problemet e vendit. Ajo ofron një shans për të përmirësuar jetesën rurale dhe të mundësojë një shoqëri dhe infrastrukturë rurale të arritshme bazuar në zhvillim rajonal dhe punësim rural të balancuar.

Strategjia fokusohet në krijimin e një shoqërie dhe infrastrukture të qëndrueshme rurale duke përmirësuar të ardhurat dhe duke reduktuar luhatshmërinë e tyre, si dhe sigurimin e kompensimit në rastet e pengesave natyrore. Deri tani, politikat bujqësore në Shqipëri kanë qenë të fokusuara në mbështetjen e skemave të prodhimit. Megjithatë, me mbylljen e MADA-s fokusi në zonat malore dhe në zonat më pak të favorizuara do të kthehet në një sfidë për të ardhmen.

Strategjia e re është hartuar në përputhje me kuadrin e strategjisë evropiane për zhvillim rural për mirëmbajtjen e peisazheve tradicionale rurale, bio-diversitetit dhe mbrojtjes së mjedisit. Strategjia e Zhvillimit Rural 2014-2020 duhet të marrë në konsideratë reduktimin e pabarazive rurale-urbane në aspektin e të ardhurave dhe standardeve të jetesës. Një nga elementet më të rëndësishme është gjenerimi i aktiviteteve ekonomike alternative përmes nxitjes së diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, krijimit të vendeve të punës dhe krijimit të infrastrukturës dhe shërbimeve të duhura në zonat rurale. Viti 2013 dëshmoi përgatitjen e një draft-mase nga MBZHRAU me mbështetjen e FAO TCP për diversifikimin rural. Përmes kësaj mase, turizmi, aktivitet artizanale, aktivitetet kreative dhe aktivitete të tjera jashtë fermës duhet të nxirren në pah nëpërmjet ngritjes së shërbimeve dhe infrastrukturës bazë, si dhe përfshirjen e një sërë aktorëve lokalë të ngjashme me qasjen Leader.

MBZHRAU përmirësoi bazën ligjore për bashkëpunim midis fermerëve përmes Ligjit për Bashkëpunim Bujqësor të miratuar në vitin 2012. Megjithatë, politika mbështetëse ka sjellë të rezultate të dobëta deri tani në lidhje me konsolidimin e tokës dhe forcimin e veprimit kolektiv midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë.

Shqipëria ofron pagesa direkte dhe trajnime për fermat organike. Megjithatë, nevojitet një përgjigje e fortë ndaj problemeve të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike për të garantuar praktikat e qëndrueshme të prodhimit dhe futjen e metodave të reja për të nxitur përdorimin e burimeve të gjelbërta dhe për të zbutur efektet e ndryshimit të klimës.

Programet ekzistuese nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për të përfshirë gratë sipërmarrëse gjatë fazave të hartimit dhe promovimit të skemave mbështetëse.

Formulimi i skemave të subvencioneve mund të strukturohet më mirë në drejtim të nxitjes së lidhjes së prodhimit të papërpunuar bujqësor me sektorin e agro-përpunimit. Sektori i peshkimit si dhe sektori i frutave dhe perimeve kanë pjesëmarrje të ulët në skemat mbështetëse. Rishikimet e skemave mbështetëse kërkojnë konsultime sistematike paraprirëse me grupet e interesit, si grupet përfaqësuese të biznesit apo shoqatat para hartimit të skemave.

Për të lidhur më mirë politikën dhe mbështetjen buxhetore me ISARD, futja e programeve afatmesme, vlerësimi i pavarur i politikave dhe skemave të mbështetjes, si dhe përfshirja më e madhe e aktorëve gjatë procesit të hartimit të skemave mbështetëse do të forcojë qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë e politikave bujqësore. Forcimi i kapaciteteve analitike

të politikave brenda MBZHRAU për të programuar masat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural duhet të plotësohen gradualisht me harmonizimin e kuadrit ligjor dhe teknik kombëtar, të tilla si Sistemi i Informacionit Bujqësor gjithëpërfshirës, regjistri i fermave, standardet minimale, dhe institucionet e të drejtave të tokës. Monitorimi i rregullt vjetor dhe rishikimi i skemave në adresimin e nevojave prioritare aktuale dhe të ardhshme duhet të jetë i shoqëruar me lehtësimin e shërbimeve të tilla si qasja në skema të tjera të financimit, qasje në shërbime të ekstensionit dhe shërbime të tjera plotësuese pa humbur fokusin mbi gratë dhe grupet e ekspozuara.

Sfida e politikëbërësve shqiptarë mbetet shfrytëzimi i potencialit të sektorit të bujqësisë në Shqipëri duke transformuar strukturat e fragmentuara të sektorit bujqësor për tu bërë më konkuruese, duke mos shpërfillur mundësitë alternative të të ardhurave për popullsinë rurale për të ruajtur përmbajtjen sociale rurale. Përpjekjet e politikës për të arritur një mjedis përgjithsisht të favorshëm ekonomik, akses më të mirë si në fondet publike edhe në fondet private, zhvillimi i integruar i zinxhirëve të vlerave dhe aksesi ndaj tregut do të sfidohen nga financimi i ngadalësuar i donatorëve dhe kapacitetet e kufizuara buxhetore. Prioritet i duhet dhënë jo vetëm kapërcimit të pengesave strukturale por edhe rritjes së standarteve të sigurisë ushqimore, forcimit të institucioneve të tregut dhe përmirësimit të partneritetetit publik/privat për përafrimin e mëtejshëm me standardet e BE-së.

Referenca

Albania APM Database. 2014. Agricultural Policy Measures Database compiled for Albania under the FAO/SWG project "Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession" (unpublished data).

EC. 2012. Albania 2012 Progress Report, accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013. COM(2012) 600 final. Brussels: European Commission.

GoA. 2012. The Integrated Planning System, available at: http://www.dsdc.gov.al/dsdc/Integrated_Planning_System_6_2.php

GoA. 2013. The Government of Albania program 2013-2017. Tirana, Albania.

INSTAT. 2014. Albanian Institute of Statistics, available at:http://www.instat.gov.al/al/figures/statistical-databases.aspx

MARDWA. 2013. Statistical yearbooks (several years). Tirana, Albania.

MARDWA. 2014. Draft Rural Development Programme 2014 – 2020 under the Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA), Version 19/12/2013. Tirana, Albania.

Rednak, M., Volk, T. & Erjavec, E. 2013. A tool for uniform classification and analyses of budgetary support to agriculture for the EU accession countries, AgriculturalEconomics Review, 14/1, p. 76-96.

Skreli, E. & Imami, D. 2014. Analyses of the agriculture support schemes in Abania. Final report for the FAO-EU Project "Preparation of Inter-sectoral strategy for agriculture and rural development in Albania". Tirana, Albania.

Wehinger, T. & Zhllima, E. 2013. Sector analysis for the diversification of the rural economy in Albania. Tirana, Albania.

Wehinger, T. & Schäfer, B. 2011. Potential for diversification of the rural sectors in Albania and Montenegro. Project report for Tender No. AGRI-2010-EVAL-01.

World Bank. 2007. Strategic Policies for a More Competitive Agriculture Sector in Albania. Economic and Sector Work, Sustainable Development Unit, USA.

Aneksi B.I-1: Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave kryesore, 2005-2012, Shqipëria

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Sipërfaqja e prodhimit (1 000 ha)								
Total	149.0	144.1	134.4	152.0	149.2	147.0	150.5	143.0
- Grurë	82.4	77.2	70.2	83.4	82.8	73.9	69.2	73.1
- Misër	48.4	49.0	46.2	49.0	47.6	54.2	61.2	53.5
Farëra vajore	1.5	1.5	2.3	1.7	1.2	1.3	1.5	1.4
Patate	10.1	9.5	8.2	9.8	9.1	9.0	9.5	9.3
Rrush (total)	6.6	6.9	7.5	8.1	8.5	8.6	9.1	10.1
Fruta (total)	13.8	14.5	14.8	14.8	15.8	16.5	18.0	18.6
Perime (total)	33.2	31.5	28.8	30.3	31.0	32.3	32.4	30.9
Duhan	1.5	1.8	1.2	1.1	1.2	1.2	1.2	1.3
Fasule	16.1	15.1	14.6	14.3	14.0	13.7	14.4	14.6
Foragjere	191.1	195.0	200.0	194.0	213.0	418.0	421.9	208.8
Prodhimi (1 000 t)								
Total	511.2	507.5	493.6	608.5	633.0	696.0	699.0	696.8
- Grurë	260.0	230.9	249.5	335.0	333.1	294.9	292.8	300.2
- Misër	219.9	245.4	215.9	245.0	265.1	362.0	366.4	359.8
Farëra vajore	2.7	2.6	2.8	2.8	2.3	2.6	3.0	2.3
Patate	169.3	162.6	154.9	190.0	200.0	208.0	230.0	232.9
Fruta (total)	181.2	217.3	228.7	262.2	282.7	340.3	360.4	248.0
Perime (total)	684.9	687.5	671.5	715.4	730.0	860.4	890.2	914.0
Duhan	1.9	2.0	0.9	1.3	1.6	1.7	1.9	2.0
Fasule	23.6	24.3	20.8	21.8	23.0	24.0	25.3	27.2
Foragjere	5 197.0	5 222.0	4 954.0	5 333.0	5 351.0	5 456.3	5 929.9	5 949.8

Burimi: MBZHRAU

Aneksi B.I-2: Të dhënat e blegtorisë (në 1 000 krerë), 2005-2012, Shqipëria

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Gjedhë	655	634	577	541	494	493	492	498
nga të cilat lopë	430	420	396	360	353	355	354	358
Derra	147	152	147	161	160	164	163	159
Dele dhe dhi	2 701	2 770	2 729	2 620	2 540	2 581	2 517	2 619
Kuaj	149	132	122	113	102	98	99	97
Shpendë	6 432	6 200	7 135	8 100	8 313	8 437	9 292	9 494
Koshere bletësh	157	173	171	175	203	218	233	239

Burimi: MBZHRAU

Aneksi B.I-3: Çmimet e prodhuesve në fermë të disa produkteve bujqësore (EUR/t), 2005-2012, Shqipëria

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Grure i zakonshëm	226.5	293.2	197.6	210.5	292.1	278.6
Misër	:	268.7	205.2	217.8	277.9	278.6
Patate (kultura kryesore)	250.8	228.0	250.8	254.0	199.5	207.1
Speca	388.3	350.2	281.2	333.9	370.5	278.6
Domate	404.5	317.6	357.2	370.2	306.4	335.7
Shalqinj	64.7	122.1	76.0	94.4	64.1	128.6
Mollë	355.9	325.7	334.4	268.6	277.9	285.7
Vezë (1 000 kokrra)	99.0	99.0	77.5	78.8	80.6	90.7
Qumësht lope	300.0	303.0	312.3	352.0	358.4	381.6

Burimi: MBZHRAU

Kapitulli B.II

BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË BOSNJE & HERCEGOVINË

Sabahudin Bajramović*, Aleksandra Nikolić*, Jakub Butković**

1. Hyrje

Bosnje dhe Hercegovina (BiH), karakterizohet nga një strukturë komplekse qeverisëse, si rezultat i Marrëveshjes së Kuadrit të Përgjithshëm për BiH, nënshkruar në fund të vitit 1995 në Dejton. Sipas marrëveshjes, BiH është një shtet i përbërë nga dy entitete: Federata e BiH (FBiH) dhe Republika Srpska (RS), si dhe Qarku Brčko e BiH, me rregullimet kushtetuese asimetrike dhe një numri të ndryshëm nivelesh qeverisëse dhe entiteteve. Ndërsa FBiH ka katër nivele vertikale qeverisëse (komuna, qyteti, kantoni dhe Federata), RS ka vetëm dy (komuna dhe entitete). Marrëveshja e Dejtonit krijoi Zyrën e Përfaqësisë së Lartë me autoritete legjislative të konsiderueshme. Marrëveshja përcakton kompetencat e niveleve administrative, por vendosja e limiteve të tyre deri më tani nuk është përcaktuar qartë, çka ngadalëson në mënyrë të konsiderueshme proceset dhe reformat sociale dhe ekonomike (veçanërisht në procesin e afrimit me BE-në), dhe ul efikasitetin e autoriteteve ekzekutive dhe legjislative.

Që nga viti 2008 kriza sociale, politike dhe ekonomike në BiH është thellluar nën ndikimin e tendencave negative rajonale dhe globale, por edhe për shkak të mungesës së vullnetit politik për të vazhduar reformat e nevojshme. Paaftësia politike për të rënë dakord mbi respektimin e të drejtave themelore të njeriut[20] dhe krijimin e një sistemi koordinues si mekanizmi kryesor për zbatimin e IPA-s dhe programeve të tjera të ndihmës së BE-së, ka rezultuar në një përgatitjetë ulët të ekonomisë së BiH për pranimin në BE të Kroacisë, e cila është partneri më i rëndësishëm tregtar i saj. Për më tepër, pezullimi i mbështetjes IPA dhe ngadalësimi i vazhdueshëm i ndërtimit të mekanizmave qeverisëse të nevojshme për miratimin dhe zbatimin e programit IPARD kanë zgjatur ndjeshëm periudhën para së BiH të përfitojë fonde nga instrumenti IPARD.

Situata e vështirë ekonomike dhe politike në BiH është një nga pengesat më të mëdha për thithjen e kapitalit të huaj, në veçanti investimet e huaja direkte pa të cilat, sipas analizave, rritjet e konsiderueshme në prodhim dhe krijimi i punës do të jenë shumë të ngadalta. Kriza globale e bën këtë situatë komplekse, madje edhe më të vështirë. Kjo situatë ka zgjatur për një kohë të gjatë, duke ndryshuar mendjen e qytetarëve të cilët janë përshtatur ngadalë me situatën dhe e kanë pranuar atë si forcë madhore (FAFS, 2013) .

Megjithatë, pavarësisht të gjitha problemeve, stabiliteti makroekonomik është ruajtur. Edhe pse ranë në vitin 2009 dhe 2012, produkti i brendshëm bruto (PBB) dhe vlera e shtuar bruto (GVA) u rritën përkatësisht me 3.6 dhe 3.9 përqind në periudhën 2008-2012. Së bashku me një normë të

* Universiteti i Sarajevës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencës Ushqimore, Bosnje dheHercegovinë

** Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Tregtare të Bosnje dheHercegovinës, Zyra për Harmonizimin dhe Koordinimin e Sistemit të Pagesave në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural e Bosnje dheHercegovinës

[20] Kjo ka të bëjë me zbatimin e vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me diskriminimin e shtetasve të BiH në bazë të etnicitetit.

ulët të inflacionit[21], raporti i defiçitit tregtar si përqindje e PBB-së u ul nga 42 përqind (2008) në 32.9 përqind (2012) dhe defiçiti i llogarisë korente u reduktua nga 14.1 përqind (2008) në 9.6 përqind të PBB-së (2012).

Për të financuar defiçitin buxhetor vazhdimisht në rritje të BiH, njësitë qeverisëse marrin gjithnjë borxhe në tregjet e huaja financiare, dhe borxhi i jashtëm prej 17 përqind e PBB-së (2008) u rrit në 27.9 përqind e PBB-së (2012). Një nga problemet më të mëdha ekonomike në BiH është norma gjithnjë e në rritje e papunësisë (28 përqind në vitin 2012), një rënie e ndjeshme e investimeve të huaja direkte (41.6 përqind më pak në 2012 se në vitin 2008), dhe në thelb reduktimi i parave nga fondet e ndryshme zhvillimore. Çështje të tjera me interes janë se BiH mbetet në kufijtë e projekteve të mëdha infrastrukturore euroaziatike (p.sh. rryma e Jugut), se ndërtimi i infrastrukturës rrugore të parashikuar është shumë i ngadaltë (disa fonde të kredive nuk janë përdorur), dhe se investimet në sektorin e energjisë, veçanërisht rrjete shpërndarje dhe termocentrale të reja, janë të ulëta. Megjithatë, pavarësisht të gjitha problemeve të mësipërme, Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikon rimëkëmbjen e ekonomisë së BiH me një rritje prej 2 përqind të aktivitetit dhe 4 përqind të rritjes (FMN, 2013) që do të arrihet në vitin 2018. Shpallja e "qasjes së re të BE-së" dhe zhvillimi i një pakete të veçantë të ndihmës ekonomike në vend janë gjithashtu inkurajuese.

Bujqësia dhe industria ushqimore në BiH janë shumë të rëndësishme për formësimin dhe stabilizimin e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe social në vend. Vitaliteti ekonomik ikëtyre sektorëve, së bashku meperformancën e përmirësuar të eksporteve në një kohë krize dhe rënieje ekonomike, i bën këta sektorë stabilizuesit kryesorëtë shoqërisë dhe ekonomisë së BiH. Varfëria e dukshme është një problem që e komplikon situatën sociale, veçanërisht në zonat rurale të vendit. Sektori i bujqësisë mundëson gjenerimin e të ardhurave për popullsinë lokale dhe ul proceset negative shoqërore (migrimin, plakjen e popullsisë rurale, etj.) dhe mundëson ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore. Megjithatë, sektori nuk ka arritur që të angazhojë në mënyrë efikase burimet natyrore në dispozicion dhe as nuk është në gjendje t'i përdorë ato në mënyrë racionale. Kjo është arsyeja pse është shumë i rëndësishëm formulimi i politikës bujqësore të orientuar drejt forcimit të performancës së sektorit dhe veçanërisht në kuadrin rregullator dhe institucional, i cili do të mundësojë përdorimin e programeve të mbështetjes në dispozicion dhe do të sigurojë transferimin e teknologjisë dhe përmirësimin e konkurrencës në këtë sektor.

Ky punim analizon karakteristikat më të rëndësishme të bujqësisë dhe politikës bujqësore në Bosnje dhe Hercegovinë. Analiza përfshin periudhën 2002-2012, duke u përqendruar në vitet e fundit. Statistikat kombëtare janë përdorur nga niveli shtetëror në nivel njësish, si dhe të dhënat nga baza e të dhënave të Eurostat, FAO, WTO, dhe Bankës Botërore. Të dhënat mbi politikën bujqësore dhe transfertat buxhetore përkatëse janë mbledhur nga burime publikisht të disponueshme dhe dokumentetë brendshëm të Ministrisë Federale të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e Republikës Srpska, Departamenti i Bujqësisë së Qarkut Bërçko, dhe ministritë kantonale (departamentet) për bujqësinë e Federatës së BiH-së dhe të hartuara në bazën e të dhënave APM duke përdorur një format të përbashkët për klasifikimin e masave të politikës bujqësore (Rednak et al., 2013).

Në pjesën e parë të punimit paraqitet: roli i bujqësisë në ekonomi, karakteristikat themelore të përdorimit të tokës bujqësore, struktura e fermave, tendencat e prodhimit, konkurrenca dhe pikat e forta dhe të dobëta të përgjithshme të sektorit. Pjesa e dytë jep një pasqyrë të detajuar të politikës bujqësore, si në nivel kombëtar dhe në nivel entiteti/qarku dhe në aspektin e kuadrit politik, si dhe sasitë dhe struktura e mbështetjes buxhetore. Punimi përfundon me diskutime dhe

[21] Trendet inflacioniste në vitin 2012 ishin të limituara dhe të qëndrueshme, dhe çmimet u rritën me mesatarisht1.8 përqind, e cila është 1.9 përqind më pak si rritja mesatar e çmimeve në vitin 2011. Në këto rrethana inflacioni në BiH në vitin 2012 ishte 0.5 përqind më i ulët se inflacioni I BE-së, gjithashtu më i ulët se në të gjitha vendet e tjera të rajonit.

konkluzione, me pikpamjen e autorëve mbi aspektet kryesore të orientimeve politike në periudhën e ardhshme, kryesisht në funksion të integrimit Evropian.

2. Bujqësia

2.1 Roli i bujqësisë në ekonomi

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm biznesi në ekonominë e BiH si për kontributin në GVA edhe për kontributin në punësimi, dhe gjithashtu për kontributin në tregtinë e jashtme.

Edhe pse aktivitetet ekonomike në këtë sektor u tkurrën si rezultat i një krizetë thellë sociale dhe politike, kontributi i saj në GVA mbetet i lartë, rreth 8 përqind. Sektori kontribuon me 20 përqind të punësimit total, çka është veçanërisht e rëndësishme në kuadrin e problemit të dukshëm ekonomik të shkallës së lartë të papunësisë. Bujqësia është më e rëndësishme në RS sesa në FBiH. Në vitin 2012, kontributi i saj në GVA totale të RS ishte rreth 12 përqind dhe në punësimin e përgjithshëm rreth 32 përqind, ndërsa kontributi në GVA totale të FBiH ishte rreth 5 përqind dhe në punësimin e përgjithshëm rreth 13 përqind.

Megjithëse eksportet e produkteve agro-ushqimore janë rritur më shpejt se importet dhe defiçiti tregtar ka qenë relativisht i qëndrueshëm që nga viti 2008, kontributi i sektorit në defiçitin e përgjithshëm u rrit dhe arriti në 29 përqind në vitin 2012. Kjo shkakton shqetësim dhe gjithashtu sinjalizon aktivitet të ulët ekonomik në sektorët e tjerë. Duhet të theksohet se ky sektor zë një pjesë shumë të ulët të investimeve të huaja direkte (stoku i IHD-ve ishte 6.6 përqind në vitin 2012), edhe pse IHD-të u rritën në vitin 2012 me 37.8 përqind në krahasim me vitin 2008.

2.2 Burimet tokësore dhe struktura e fermës

Me disponueshmërinë, cilësinë dhe aksesin e saj, toka është përcaktues i rëndësishëm i potencialit ekonomik të sektorit bujqësor të vendit.

Sipas të dhënave statistikore për vitin 2012, BiH-jaka një total prej 2 163 000 ha tokë bujqësore, e përbërë nga 1 006 000 ha tokë e punueshme, 109 000 ha pemëtore dhe vreshtashumëvjeçare, dhe 1 048 000 ha kullota; pra, livadhe dhe kullota natyrore. Një nga problemet më të mëdha në BiH është përqindja shumë e lartë e tokës së punueshmë me cilësi të lartë të pakultivuar, e cila zë pothuajse gjysmën (47 përqind, 2012) e të gjithë tokës së punueshme. Me 132 ha tokë të punueshme dhe 431 ha tokë bujqësore për 1 000 banorë, BiH është në një situatë relativisht të mirë në lidhje me sipërfaqet minimale të tokës së nevojshme për prodhimin e ushqimit të mjaftueshëm për mbijetesën e popullsisë.

Megjithatë, nuk ka një kornizë të plotë të strukturës së fermave bujqësore në BiH për shkak se nuk është kryer akoma një census i bujqësisë, dhe i fundit u krye rreth vitit 1960. Bazuar në të dhënat e kufizuara në lidhje me fermat bujqësore dhe strukturën e tyre, të përfituara nga një census bujqësor pilot në vitin 2010[22], sipërfaqja mesatare e tokës së përdorur është 1.97 ha për fermë me një mesatare prej katër parcelash për fermë në fermat familjare, e cila është në mënyrë të konsiderueshme më pak se mesatarja e EU-2714.3 ha (EUROSTAT, 2014).

Rezultatet e studimit në kuadër të raportit të UNDP-së mbi zhvillimin human në BiH për vitin 2013 (UNDP, 2013) tregojnë se gjysma e familjeve rurale angazhohen shumë pak ose aspak në bujqësi; 36 përqind e familjeve fshatare kanë "ferma të vogla", ku ata sigurojnë një pjesë të konsiderueshme të nevojave të tyre për ushqim, dhe më pak se 1 përqind e familjeve mund të klasifikohen si ferma komerciale, çka i bën ato subjekt të masave të IPARD për përmirësimin e prodhimit bujqësor dhe aktiviteteve të marketingut.

[22] Censusi pilot i bujqësisë është kryer nga tre agjensitë statistikore të BiH (1 agjensi kombëtare dhe dy agjensi të njësive vendore) në tetor 2010 në kuadër të IPA 2007 BH AIS.

2.3 Prodhimi bujqësor

Pavarësisht potencialit relativisht të mirë natyror për zhvillimin e prodhimit bimor në BiH, prodhimi bujqësor nuk ka treguar tendenca pozitive, pasi kushtet e këqija të motit në faza kyçe të prodhimit (luhatjet e larta të temperaturës, ngricat në fund të pranverës apo fillim të vjeshtës, mungesa ose tepricë ereshjeve) shpesh reduktojnë ndjeshëm rendimentet e përgjithshme dhe mesatare.

Struktura e sipërfaqes së korrur në vitin 2012, tregon mbizotërimine drithërave, sidomos misrit me 37 përqind; një e pesta (19 përqind) është nën prodhime foragjere, patatet zënë7 përqind, dhe perimet 8 përqind. Bimët industriale akoma nuk janë shumë të rëndësishme, me një sipërfaqe simbolike nën prodhimin ekëtyre kulturave prej mesatarisht 1 përqind. Gjatë periudhës 2005-2012 sipërfaqet e mbjella me grurë të zakonëshëm shfaqënnjë trend rënës, ndërkohë që prodhimi i misrit ishte uniform, me një sipërfaqe prej rreth 200 000 ha (shikoni-AneksinB.II-1).

Figura B.II-1: Ndarja e sipërfaqes së korrur sipas bimëvë kryesore, 2012, Bosnje dhe Herzegovina



Burimi: Agjensia e Statistikave të BiH, Zyra Federale e Statistikave, Instituti i Statistikave të Republikës Srpska, Zyra Statistikore e Qarkut Brčko

Prodhimi i frutave në BiH është rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, edhe pse pemëtoret përbëjnë vetëm 5 përqind të të gjithë tokës bujqësore. Kumbullat dhe mollët kryesojnë në numrin e pemëve frutore dhe në prodhim, ndërsa dardhat, qershitë dhe pjeshkët janë më pak të përfaqësuara në prodhim. Në pesë vitet e fundit sipërfaqja e mbjellë me manaferra është rritur ndjeshëm, dhe prodhuesit kanë arritur sukses të shkëlqyer. Gjithashtu, BiH jugore tregon një interes në rritje në kultivimin e bimëve mesdhetare dhe rinovimin e kulturave të harruara si përshembull ullinjtë. Ka pasur një rritje të dukshme në pemëtoret e lashta, si në aspektin e numrit të pemëve dhe të sipërfaqes që ato zënë. Megjithatë, kjo nuk mjafton për të thënë se ky nënsektor bujqësor është zhvilluar dhe është i qëndrueshëm. Problemi që paraqet një risk për zhvillimin e këtij sektori është mungesa e shërbimit të mjaftueshëm që ka të bëjë me rritjen dhe përzgjedhjen, dhe sidomos mungesa e fidanishteve, dhe mungesa e fidanëve. Përveç kësaj, një sistem jo efikas i kontrollit të fidanëve të importuara dhe certifikimi i tyre mund të ngadalësojnë zgjerimin e këtij nën-sektori.

Pjesa që zë prodhimi blegtoral në prodhimin e përgjithshëm bujqësor është rreth 37 përqind. Kjo përqindje relativisht e ulët tregon problemet strukturore me të cilat përballet sektori.

Tabela B.II-1: Numri i bagëtive (në mijë), 2005-2012, Bosnje dhe Herzegovina

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012

Gjedhë(total)	460	515	468	459	458	462	455	445
- Lopë qumështi	298	313	307	297	293	273	264	251
Dele dhe Dhi	976	1120	1103	1101	1 125	1 110	1 086	1 070
Derra	654	710	535	502	529	590	577	539
Shpendë	10 300	13 300	15 000	16 185	18 741	21 802	18 703	19 401
Koshere bletësh	260	283	311	334	347	367	382	384

Burimi: Agjensia e Statistikave të BiH, Zyra Federale e Statistikave, Instituti Statistikave të Republikës Srpska, Zyra Statistikore e Qarkut Brčko

Krizat shoqërore, politike dhe ekonomike kanë reduktuar prodhimin blegtoral. Që nga viti 2008 numri i bagëtive është ulur me 3.1 përqind dhe numri i deleve me 2.8 përqind, edhe pse numri i derrave është rritur me 7 përqind, i shpendëve 19.9 përqind, dhe koshereve të bletëve me 15 përqind. Duhet të theksohet se prodhimi blegtoral nuk është i organizuar në përputhje me kërkesat e Direktivës së Nitrateve dhe kërkesat e BE-së për mirëqenien e kafshëve. Me fjalë të tjera, të gjithë nënsektorët e prodhimit blegtoral do të duhet të investojnë në ndërtesa dhe teknologji të reja në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e mjedisit.

Problemi kryesor për sektorin e bujqësisë së BiH janë rendimentet e saj (prodhimit për njësi të sipërfaqes apo për krerë bagëti). Rendimentet mesatare të grurit, misrit, patates dhe qumështit të lopës në BiH janë qartësisht më të ulëtakrahasuar me vendet e tjera të rajonit si edhe krahasuar me vendet e BE-së (shikoni Kapitullin A.II).

Produktiviteti i ulët është reflektim i një strukture jo të favorshme të fermës, pajisjeve të pamjaftueshme dhe varësisëpothuajse tëplotë tëbujqësisë se BiH në importin e të gjitha llojeve të inputeve, përfshirë materialet e farërave, pesticideve dhe plehrave kimike. Risku që ky sektor do të vazhdojë të përjetojë rënie të mëtejshme në teknologji është i madh. Duke pasur parasysh kërkesat për ndryshime teknologjike; dmth intensifikimi i qëndrueshëm, rezultat i ndryshimeve klimatike, gjendja bëhet më serioze. Pa një përmirësim rrënjësor të produktivitetit, pra, forcimi i kapaciteteve teknike dhe teknologjike në sektor, përmirësimi i konsiderueshëm i konkurrueshmërisë nuk mund të pritet, që përfundimisht do të thotë qëndrim në nivele modeste të këtij sektori (në krahasim me vendet e tjera në rajon, dhe në veçanti me vendet e BE-së).

2.4 Çmimet bujqësore

Prodhimi joefikas dhe i kufizuar në ferma të vogla, karakteri i prodhimit si një mjet jetese, niveli i ulët i pajisjeve bujqësore dhe njohuritë e pamjaftueshme të fermerëve në lidhje me teknikat dhe teknologjinë janë vetëm disa nga faktorët që kontribuojnë në çmimet relativisht të larta të produkteve bujqësore në BiH (shikoni AneksinB. II-2), në krahasim me vendet e rajonit dhe BE-së (shikoni Kapitullin A.II). Me fjalë të tjera, prodhimi bujqësor i BiH nuk ka qënë dhe nuk do të jetë konkurures në lidhje me çmimet, nëse nuk rritet përdorimi i tokës në dispozicion apo produktiviteti dhe efikasiteti i tokës.

2.5 Tregtia bujqësore

Siç u përmend më parë, kontributi i sektorit agro-ushqimor në tregtinë totale të BiH është i konsiderueshëm. Eksporti total i sektorit në 2012 arriti në rreth 317 milionë EUR, e cila ishte 7.9 përqind e eksporteve të përgjithshme të BiH. Importi i përgjithshëm i produkteve agro-ushqimore është dukshëm më i lartë; në vitin 2012 ai arriti në 1.43 miliard EUR e cila ishte pothuajse 18.3 përqind e totalit të importeve të BiH. Eksporti i sektorit, edhe pse mjaft i ulët, është rritur gjatë gjithë periudhës së vrojtuar. Nga ana tjetër, importet treguan disa luhatje. Importet treguan një trend rritës midis viteve 2005 dhe 2008, pastaj u ulën në vitin 2009 dhe 2010, dhe u rritën përsëri në vitin 2011 dhe 2012.

Figura B.II-2: Tregtia agro-ushqimore (më milion EUR), 2005-2012, Bosnje dhe Herzegovina



Burimi: Dhoma e Tregtisë sëBiH

Për sa i përket strukturës së eksporteve të produkteve të BiH, nga grupet e mallrave 01-24 (mesatarja për periudhën 2010-2012), sheqeri dhe ëmbëlsirat, qumështi dhe produktet e qumështit, dhe yndyrnat dhe vajrat e ndryshme (grupit të mallrave 15) janë tre grupet më të rëndësishme të produkteve. Kjo strukturë tregon se një pjesë e madhe e eksportit është ri-eksport pasi bazohet në import shumë të lartë të lëndëve të para (me përjashtim të qumështit dhe produkteve të qumështit). Rritja më e rëndësishme në pjesën e eksportit i takon grupit të produkteve të qumështit, me një rritje prej 3.1 përqind (2002) në 15 përqind (2012), ndërsa pesha ndaj eksportit u zvogëlua në rastin e grupeve të produkteve vegjetale (nga 10.9 përqind në 3.9 përqind), dhe produkteve të frutave dhe perimeve (nga 9.6 përqind deri në 3 përqind).

Figura B.II-3: Struktura e eksporteve agro-ushqimore sipas grupmallrave kryesore, mesatarja 2010-2012, Bosnje dhe Hercegovina



Shënim: Të tjera: Grup produktesh që zënë një pjesë më të vogël se5 përqind ndaj totalit; tregtia agroushqimore sipas CNCT (Nomenklatura e Kombinuar e Tarifave Doganore)
Burimi: Dhoma e tregtisë së BiH

Peshën më të madhe tek importet e zë grupi 22 (pije, pije alkoolike dhe uthull), i cili është njëkohësisht grupi i vetëm që zë më shumë se 10 përqindtë importeve (11.2 përqind në vitin 2012).

Figura B.II-4: Struktura e importeve agro-ushqimore sipas grupmallrave kryesore, mesatarja e viteve 2010-2012, Bosnja dhe Hercegovina



Shënim: Të tjera: Grup produktesh që zënë një pjesë më të vogël se5 përqind ndaj totalit; tregtia agroushqimore sipas CNCT (Nomenklatura e Kombinuar e Tarifave Doganore)
Burimi: Dhoma e tregtisë së BiH

Një pjesë e rëndësishme e importit i takon edhe drithërave (8.5 përqind), sheqernave dhe ëmbëlsirave (8.2 përqind), preparateve të ndryshme të ngrënshme (7.6 përqind), produkteve të drithërave (6.1 përqind), qumështit dhe produkteve tëqumështit (6.1 përqind), dhe yndyrnave dhe vajrave (5.3 përqind). Struktura e importit të produkteve agro-ushqimore nuk ka ndryshuar shumë gjatë periudhës së vrojtuar.

Shumica e ushqimeve të importuara në BiH vijnë nga vendet e BE-së (54.6 përqind në vitin 2012), ndjekur nga vendet e CEFTA-s (40 përqind në vitin 2012). Pjesa tjetër e botës ndjek me një pjesë të parëndësishme prej 5.4 përqind. Partnerët më të rëndësishëm të importit të BiH midis vendeve të BE-së janë Sllovenia, Austria dhe Hungaria, dhe ndiqen nga Italia, Gjermania dhe Holanda. Midis anëtarëve të CEFTA-s, Kroacia dominon me 52.6 përqind e ndjekur nga Serbia me 41.9 përqind (2012). Në vitet e fundit, pesha e Turqisë u rrit me 2 përqind (2012), dhe kështu Turqia është bërë një partner i rëndësishëm në importin e ushqimit dhe pijeve të BiH.

Struktura gjeografikee eksporteve ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, dhe pas vitit 2006 bujqësia dhe industria ushqimore ishin të orientuara kryesisht drejt tregut të CEFTA-s (76 përqind në vitin 2012), kryesisht në Kroaci dhe Serbi. Eksportet në tregjet e BE-së ishin 19.3 përqind (2012), dhe në të gjitha tregjet e vendeve të tjera vetëm 4.7 përqind.

Pavarsisht progresit në këtë sektor, si pasoje e rritjes më të madhe dhe më të shpejtë të eksporteve krahasuar me importet, që do të thotë se raporti i mbulimit të importeve nga eksportet është përmirësuar, imazhi i përgjithshëm i shkëmbimit të tregtisë së jashtme të produkteve agro-ushqimore mbetet qartësisht i varfër. Kjo tregohet nga raporti shumë i ulët i mbulimit të importeve me eksporte, vetëm 22.3 përqind në vitin 2012.

3. Politika bujqësore

3.1 Koncepti dhe kuadri i politikave bujqësore

Politikat bujqësore në BiH zbatohen në disa nivele për shkak të kompleksitetit të sistemit politik. Pa një ministri të vetme kombëtare që të mbulojë fushën e bujqësisë, menaxhimi i politikave bujqësore është trajtuar pjesërisht nga Divizioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural në kuadër të Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe Çështjeve Ekonomike (MOFTER). Niveli i entiteteve i krijimit dhe zbatimit të politikave bujqësore është i përbërë prej ministrive të veçanta të bujqësisë, menaxhimit të ujit dhe pyjeve në FBiH dhe RS dhe ato së bashku me Divizionin për Bujqësi në kuadër të Qeverisë së Qarkut të Brčko, janë institucionet më të rëndësishme kompetente për politikat bujqësore në BiH.

Përveç nivelit të entitetit, FBiH gjithashtu ka një nivel kantonal (10 ministritë kantonale), ku menaxhimi i politikave bujqësore përcakton në mënyrë të konsiderueshme pozitën e përgjithshme të prodhuesve bujqësorë si dhe sektorit në tërësi. Disa forma të përkrahjes së sektorit nga niveli komunal, karakteristikë për të dy njësitë e BiH, nuk duhet nënvlerësuar, edhe pse këto transferta nuk janë përgjithësisht të rëndësishme, pavarësiht nga pikpamja lokale. Shumat e transferuara buxhetore, masat e politikës bujqësore, politika e zhvillimit rural dhe kriteret për të mbështetur prodhuesit janë vetëm një pjesë e politikës që është në kompetencë ekskluzive të entitetit/ministrive kantonale të bujqësisë; përkatësisht Divizionit për Bujqësinë brenda Qeverisë së Qarkut të Brčko.

Ministria kombëtare e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike përdor instrumentet e disponueshme për të ndikuar në politikat bujqësore në nivel kombëtar dhe në entitete me rregullimin e tregtisë së produkteve agro-ushqimore, dhe përmes përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të sigurisë ushqimore në lidhje me politikën veterinare dhe mbrojtjen e shëndetit të bimëve. Kjo ministri dhe divizionet e saj bujqësore[23], së bashku me Zyrën për Harmonizimin e Sistemeve të Pagesave, gjithashtu koordinojnë aktivitetet midis ministrive të njësive, dhe zbatojnë dhe koordinojnë projekte ndërkombëtare në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Objektivat e kuadrit kombëtar të sektorit agro-ushqimor dhe të zhvillimit rural janë dhënë në Ligjin mbi Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural të BiH[24]. Objektivat kryesore të ligjit kanë të bëjnë me përdorimin më efikas të burimeve, sigurimin e ushqimit dhe sigurisë ushqimore, harmonizimin me politikat e BE-së, duke mundësuar diversifikimin e të ardhurave dhe përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës. Siç shihet, objektivat shkojnë përtej kuadrit të qëllimeve të sektorit dhe sigurojnë një qasje të gjerë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale. Nevoja për të harmonizuar politikat me BE çoi në procesin kombëtar të harmonizimit me miratimin e "Planit Strategjik të BiH për harmonizimin e bujqësisë, ushqimit dhe zhvillimit rural (2008-2010)" programeve operative dhe masave të përcaktuara për BiH, FBiH dhe RS[25].

Këto dokumente u përgatitën nga Divizioni Bujqësor brenda MOFTER, me mbështetjen e projektit SESMARD[26], i cili është financuar nga BE-ja. Megjithatë, për fat të keq, me përjashtim të disa të ashtuquajturave masa mbështetëse të harmonizuara pilote, masa të tjera asnjëherë nuk janë zbatuar (Rokvić, 2012). Duhet shtuar se në vitin 2012 Zyra për Harmonizimin e Sistemeve të Pagesave, si një institucion i themeluar rishtazi brenda MOFTER, mori përsipër harmonizimin e masave mbështetëse brenda vendit si dhe me EU CAP. Deri më tani dokumentet ekzistuese, të krijuara nën sponsorizimin e BE-së dhe projektit SESMARD, janë rishikuar dhe hartuar plane harmonizimi sipas grupeve të masave dhe një aktiviteti kohor. Rezultati i parë në këtë kontekst është plani për të harmonizuar masat e zhvillimit rural dhe masat e përgjithshme mbështetëse për bujqësinë e BiH, i cili ishte paraqitur në Këshillin e Ministrave të BiH-së për miratim.

---

[23] Divizioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural.

[24] Gazeta Zyrtare e BiH 50/08.

[25] Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave të BiH-së në vitin 2009; publikuar në Gazetën Zyrtare të BiH 70/09.

[26] SESMARD: Mbështetje për Zbatimin e Rekomandimeve të Rishikuara në mënyrë Funksionale.

Përderisa të dyja kornizat ligjore dhe institucionale përcaktojnë në mënyrë të qartë se masat e politikës bujqësore dhe mbështetja për zhvillimin rural janë kompetencë e entiteteve/qarqeve (në rastin e FBiH, edhe kantonet), vazhdimi i analizës së politikave në këtë punim do të jetë më i orientuar drejt analizës së niveleve të politikave të qeverisjeve përkatëse.

Politikat bujqësore në Federatën e Bosnje & Hercegovinës

Politikat bujqësore në FBiH përcaktohenpërgjithësisht në Ligjin për Bujqësinë në Federatën e BiH-së, i cili parashikon objektiva dhe masa të politikavebujqësore në këtë entitet. Ky ligj hap proceset për rritjen e konkurrueshmërisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore bujqësore, si dhe aplikimin e standarteve të nevojshme për një zhvillim më dinamik të sektorit bujqësor, përpunimin e produkteve, dhe zhvillimin rural.

Megjithatë, ligji kryesor në fushën e mbështetjes së bujqësisë në FBiH është sigurisht Ligji për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural. Ky ligj: (i) siguron masat e mbështetjes financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, modelet mbështetëse dhe mënyrat e zbatimit të tyre, (ii) thekson rëndësinë e zbatimit të mbështetjes në përputhje me detyrimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga BiH, të tilla si Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, dhe (iii) harmonizon entitetet dhe nivelet kantonale të mbështetjes në mënyrë që të shmangen mbivendosjet e bazave dhe kriteret për mbështetje (FAFS, 2010). Ky ligj u pasua nga rregullat mbi kushtet dhe mënyrat e fitimit të së drejtës për mbështetje financiare sipas modelit të zhvillimit rural[27], planet e pagesave dhe zbatimin e masave të politikave bujqësore dhe strukturore[28].

Përveç këtyre rregullave, një dokument i rëndësishëm për krijimin dhe zbatimin e politikave bujqësore në FBiH është Strategjia e zhvillimit për sektorin e bujqësisë për periudhën 2006-2010. Strategjia përcaktoi qartë qëllimet afatmesme duke filluar nga rritja e prodhimit të produkteve ushqimore bujqësore dhe garantimin e sigurisë ushqimore nëpërmjet një përdorimi më të mirë të burimeve natyrore, si dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë. Ajo përcakton edhe forcimin institucional dhe përafrimin në kontekstin e integrimit në WTO dhe BE.

Politika bujqësore në FBiH është zbatuar me sukses që prej përfundimit të luftës, dhe mund të ndahet në mënyrë të qartë në tre periudha.

Periudha e parë, 1996-2002, u karakterizua nga rimëkëmbja pas luftës, në të cilën politika bujqësore, dhe kështu bujqësia, nuk ka marrë shumë rëndësi. Tërësia e masave të politikës bujqësore të zbatuara dhe llojet e prodhimit të destinuara për mbështetje ishin shumë të kufizuara, me fonde mjaft modeste të ndara për zbatimin e tyre. Masat u miratuan pa një vizion të qartë. Financimi bujqësor erdhi nga fondet e donatorëve dhe kjo më së shumti ka pasur një karakter mbështetjeje sociale.

Periudha e dytë, 2002-2006, u karakterizua nga një vendosmëri më e qartë e qeverisë për mbështetje buxhetore për bujqësinë, përmes fondeve specifike të mbështetjes buxhetore, një gametë gjerë të produkteve të mbështetura, por endeefokusuar në lloje tradicionale kryesore të prodhimit, dhe futjen graduale të mbështetjes për investime në fermë. Kjo periudhë u karakterizua nga një buxhet i pamjaftueshëm, legjislacion i dobët, dhe mekanizma jo efikase të menaxhimit dhe të kontrollit të zbatimit të politikave.

Së fundmi, periudha e tretë, nga viti 2007 deri më sot është karakterizuar nga një qasje më serioze ndaj bujqësisë, si pjesë e ekonomisë se entiteteve, fonde më të konsiderueshme buxhetore për zhvillimin dhe përmirësimin e saj, dhe një pasqyrë më e plotë e sektorit duke i kushtuar më shumë rëndësizhvillimit të legjislacionit dhe harmonizimit të tij gradual me vendet e zhvilluara, dhe veçanërisht me BE-në. Gama e produkteve të mbështetura nëpërmjet transfertave buxhetore është zgjeruar, shpërndarjet financiare për masat e politikave strukturore janë stabilizuar, dhe

[27] Gazeta zyrtare e FBiH 109/12.

[28] Program për shpenzimin e fondeve nga stimujt bujqësore, duke përfshirë kriteret e ndarjes, Gazeta Zyrtare e FBiH 31/13.

alokime të konsiderueshme financiare për politikën e zhvillimit rural janë futur. Përfshirja e ministrive të linjës -divizioneve kantonale në mbështetje të sektorit - duhet të theksohet. Problemet e politikës bujqësore në këtë periudhë janë kryesisht të ngjashme me ato të periudhës së mëparshme dhe janë të lidhura me fonde të pamjaftueshme dhe një mungesë të dukshme të mekanizmave të zbatimit dhe të kontrollit.

Programimi i politikës bujqësore në FBiH është bërë deri tani kryesisht në baza *ad hoc,*edhe pse janë marrë parasysh dhe janë zbatuar dispozitat ligjoredhe udhëzimet e përgjithshme nga strategjia e parë. Domethënë, ligji ka qenëbazë për miratimin e një programi që parashikonndarjen e fondeve mbështetëse (me grupe të veçanta, nga llojet e prodhimit brenda grupit, dhe me njësi të produktit). Më vonë është miratuar një udhëzim, duke specifikuar kriteret që prodhuesit dhe përfituesit e tjerë duhej të plotësonin për të marrë fonde. Ky sistem ka qenë në fuqi në FBiH deri në vitin 2011. Në vitin 2012, në vend të udhëzimeve u miratuan rregulla për mbështetjen e prodhimit: Rregullorja për kushtet dhe mënyrën e fitimit të mbështetjes financiare sipas modelit të zhvillimit rural si dhe rregullorja mbi llojet e tjera të mbështetjes. Në thelb, rregulloret/udhëzimet janë miratuar në bazë të përvojës, situatës në vendet në rajon, dhe negociatave me shoqatat bujqësore, por pa një analizë të plotë të situatës. Shumë shpesh këto instrumente ligjore janë të paqarta; ato nuk kanë stabilitet dhe qëndrueshmëri dhe shpesh nuk i plotësojnë nevojat e prodhuesve bujqësorë. Masat përcaktuese nuk janë përpunuar mirë dhe nuk janë matur të gjitha ndikimet. Kështu që keqpërdorimet ishin shpesh të mundshme dhe një numër i madh i përfituesve nuk ka marrë fonde.

Një nga problemet më të mëdha në zbatimin e masave të politikës bujqësore në FBiH deri tani është financimi. Ai është shumë i paqëndrueshëm dhe plani i pagesave nuk është i përcaktuar, që shpesh do të thotë pagesa të vonuara. Gjithashtu është e padrejtë për shkak se kërkesat ndryshojnë mjaft shpesh. FBiH ende nuk i ka ndarë funksionet e politikëbërjes nga zbatimi i politikave. E gjithë procedura e aplikimit për marrjen e fondeve kërkon shumë kohëdhe është akoma e pa-automatizuar. Shumat dhe kriteret për fonde nuk janë bazuar në një analizë të të dhënave të mbledhura në terren, sepse nuk ka teknologji informacioni për ta lehtësuar atë dhe ministria e linjës nuk ka treguar asnjë interes. Sistemi ekzistues i kontrollit është jo efektiv, dhe me shumë mundësi për manipulim dhe keqpërdorim.[29] Ky sistem është gjithashtu i kushtueshëm sepse angazhon një numër të madh këshilltarësh në detyrat e kontrollit, gjë e cila është në një farë mënyrë edhe një konflikt interesi.

Politika e ardhshme bujqësore në FBiH është përcaktuar qartë në strategjinë e re të zhvillimit të sektorit për 2014-2018, versioni përfundimtar i të cilit u paraqit publikisht në fund të vitit 2013. Me përjashtim të një theksi mbi nevojën për të përmirësuar kushtet teknike dhe teknologjike në sektor, përdorim më efikas të burimeve në dispozicion, përmirësimin e të gjithë standardeve dhe të cilësisë së jetës në zonat rurale, një theks u vendos edhe për harmonizimin e kuadrit institucional dhe legjislativ dhe të politikës bujqësore në FBiH me EU CAP. Kjo do të thotë miratim i ligjeve të reja, që mungojnë aktualisht dhe që do të përputhen me rregullat bazë të CAP; pra, në përputhje me legjislacionin e BE-së (Acquis Communautaire). Në kontekstin e forcimit institucional, kjo përkthehet në ndërtimin e një sistemi modern të menaxhimit të informacionit, forcimin e mëtejshëm të institucioneve ekzistuese dhe krijimin e disa institucioneve të reja, të cilat do të

[29] Mbështetja në FBiH është zbatuar në bashkëpunim midis Kantonit - Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave Kantonale – dhe të Federatës: ministritë kantonale të bujqësisë marrin aplikimet për mbështetje, kryejnë kontrollin e shkallës së parë, përfundojnë aplikimet, bëjnë llogaritjet përmbledhëse për fermerët e përshtatshëm për mbështetje, dhe dërgojnë dokumentet e përfunduara në ministrinë e Federatës. Kjo ministri kontrollon llogaritjet, dhe aplikimet, si dhe aplikimet e dyshimta si të jetë e nevojshme, pas së cilës ajo i dërgon llogaritjet Thesarit, d.m.th., Ministria e Financave e Federatës, e cila më pas paguan fondet për përfituesit. Inspektimi i monitorimit kryhet nga Zyra për Çështjet e Inspektimit në FBiH në bashkëpunim me inspektimet kantonale. Sa për investimet dhe projektet kapitale, gjithë procedura kryhet nga ministria (kantonet përjashtohen këtu), me monitorimin e inspektimit nga ana e ministrisë dhe Zyrës për Çështje të Inspektimit në FBiH në bashkëpunim me inspektimet kantonale.

kërkojnë ndryshime të konsiderueshme administrative, financiare dhe të personelit. Përfundimisht, politika e ardhshme bujqësore në FBiH do të bazohet në qasjen graduale të masave të ngjashme me EU CAP dhe bllokimin e masave të reja të cilat nuk janë në përputhje me CAP.

Së fundmi, duhet të theksohet se programi i zhvillimit rural të FBiH për periudhën 2013-2020 është në përgatitje e sipër, i cili duhet të kontribuojë në përgatitjen më të lehtë të një strategjie të zhvillimit rural për BiH si një dokument me prioritet midis shumë dokumenteve që janë të nevojshëm për të përdorur fondet IPARD të BE-së.

Politika bujqësore në Republikën e Srpska

Kuadri ligjor për zbatimin e politikave bujqësore në RS përbëhet prej ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve strategjike që kanë të bëjnë me zhvillimin e gjithë sektorit apo zonave rurale të këtij entiteti të BiH. Ligji i RS për Administrimin e Republikës[30] përcakton rolin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave, si institucioni kompetent për punët administrative dhe profesionale në fushën e krijimit dhe implementimit të politikave bujqësore. Ligji i RS për Bujqësinë[31] parashikon objektivat dhe masat e politikës bujqësore, metodat e zbatimit dhe monitorimit të saj. Përveç këtij ligji dhe Ligjit për Sigurimin dhe Shpërndarjen e Fondeve për të mbështetur Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale[32], Rregullorjapër kushtet dhe mënyrën e marrjes së stimujve financiarëpër zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale, është i një rëndësie të madhe. Kjo rregullon zbatimin e fondeve stimuluese në më shumë detaje.

Përveç ligjeve dhe rregulloreve të mësipërme, dokumente të rëndësishëm për krijimin dhe zbatimin e politikave bujqësore në RS janë strategji afatmesme për zhvillimin e sektorit bujqësor (1999-2006 dhe 2010-2015) dhe plani strategjik i zhvillimit rural të Republikës së Srpska për periudhën 2010-2015. Këto dokumente specifikojnë objektivat e politikës bujqësore dhe japin plane të detajuara veprimi për arritjen e objektivave të përcaktuara. Objektivat më të rëndësishme në dokumentet strategjike të mësipërme janë rritja e prodhimit të përgjithshëm bujqësor, rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, sigurimi i cilësisë më të mirë ushqimore dhe aksesit në ushqim, zhvillimi integral i balancuar, duke ndaluar rënien e popullsisë në zonat rurale, dhe rivitalizimi i zonave kodrinore dhe malore.

Politika bujqësore në RS deri më tani mund të ndahet në dy periudha. Periudha e parë filloi në vitin 2000 me fillimin e shpërndarjes financiare për të mbështetur prodhuesit dhe zgjati deri në vitin 2006, kur një strategji për zhvillimin e bujqësisë u miratua si një pikë kthese për shpërndarjen strategjike të fondeve për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Në këtë periudhë një numër më i vogël i sektorëve të prodhimit u mbështet (qumësht, fara dhe duhan) duke dhënë mbështetje direkte për prodhuesit, dhe mbështetja për zhvillimin rural (infrastruktura rurale) u prezantua por pa një mekanizëm të mjaftueshëm zbatimi (Rokvić, 2012). Ashtu si në FBiH, zhvillimi i këtij sektori në RS në këtë periudhë varej kryesisht nga ndihma ndërkombëtaredhe fondet e donatorëve.

Periudha e dytë ka filluar në vitin 2006 dhe vazhdon deri në ditën e sotme. Ajo është karakterizuar nga transferta më të mëdha buxhetore, të cilat janë rezultat i rritjes së të ardhurave totale të entiteteve në sajë të futjes së TVSH-së në BiH dhe në sajë të një qasje përgjithësisht më serioze në politikën bujqësore, si një instrument për rimëkëmbjen e sektorit. Dokumenti strategjik parashikonte zhvillimin uniform të zonave rurale, gjë e cila rezultoi në tranzicion nga një qasje e thjesht sektoriale në një qasje integrale për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Përfshirja në trendet rajonale dhe botërore, veçanërisht në marrëdhënie gjithnjë e më të ngushta me BE-në, erdhi në këtë periudhë. Përveç forcimit të ndjeshëm të kuadrit strategjik dhe legjislativ, ka pasur pak progres në forcimin institucional. Ndarje të reja dhe seksione janë themeluar në kuadër të ministrisë së bujqësisë së linjës në RS, së bashku me një rritje të konsiderueshme të stafit. Një

[30] Gazeta zyrtare e RS 118/08, 11/09, 74/10, 86/10, 24/12 dhe 121/12.
[31] Gazeta zyrtare e 70/06 dhe 71/09.
[32] Gazeta zyrtare e RS 43/02 dhe 106/09

Agjensi e veçantë për Pagesat Bujqësore u krijua në RS si organi i zbatimit si për fondet vendore dhe ato të IPARD. Agjensia tani është një pjesë përbërëse e Ministrisë së Bujqësisë së RS.

Pavarësisht pajtueshmërisë me legjislacionin dhe strategjitë e miratuara afatmesme të zhvillimit të sektorit, e njëjta qasje mund të zbatohet për RS si në FbiH. Krijimi dhe zbatimi i politikave bujqësore është bërë kryesisht *ad hoc*. Shumat e stimujve dhe subvencioneve janë varur më shumë nga situata në rajon dhe negociatat me përfaqësuesit e shoqatave të prodhuesve të ndryshëmdhe shumë më pak në një sistem të zhvilluar të monitorimit dhe të vlerësimit dhe analiza të ekspertëve në përgjithësi.

Politikat e ardhshme bujqësore në RS do të përcaktohen në një strategji të re për zhvillimin e sektorit, e cila është në zhvillim e sipër. Përveç forcimit të komponentëve të zhvillimit të sektorit dhe përmirësimin e gjendjes së saj të përgjithshme teknike dhe teknologjike, është mjaft e sigurt se një nga qëllimet kryesore të strategjisë së re do të jetë harmonizimi i kuadrit institucional dhe legjislativ dhe politikës bujqësore me EU CAP. Futja graduale e masave të ngjashme me EU CAP, për të siguruar që masat të cilat nuk janë në përputhje me CAP nuk janë përfshirë – e cila është parashikuar në mënyrë të barabartë në FBiH - do të jetë një hap i rëndësishëm drejt integrimit të plotë me CAP mbi pranimin e BiH në BE.

Politika bujqësore në Qarkun Brčko

Si njësia më e vogël administrative në vend, Qarku i Brčko ka modelin më të thjeshtë të mbështetjes për prodhuesit bujqësorë. Modeli është zhvilluar që nga viti 2002, kryesisht nën ndikimin e faktorëve ndërkombëtarë, të cilët në mënyrë të konsiderueshme formojnë politikën e përgjithshme ekonomike në rajon. Ky ndikim është pasqyruar nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë ose llojeve të ndryshme të projekteve. Kjo ishte arsyeja pse qarku, si njësi administrative, ishte i pari që futi mbështetjen direkte për fermerët në formën e pagesave të bazuara në sipërfaqe/krerë bagëti aktuale, e cila që nga viti 2008 është bërë e vetmja formë e pagesave direkte.

Sot qarku zbaton politikën bujqësore bazuar në kornizën strategjike dhe legjislative të përbërë nga: Strategjia e bujqësisë, ushqimit dhe zhvillimit rural në Qarkun eBrčko të BiH-së për periudhën 2008-2013, Ligji mbi Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural të BiH-së, dhe Ligji për Stimujt për Prodhimin Bujqësor në Qakrun e Brčko të BiH. Ashtu si në dy njësitë e tjera administrative në BiH, instrumenti ligjor i zbatimit është Rregullorja për kushtet dhe mënyrën e marrjes së stimujve financiarë në prodhimin bujqësor.

3.2 Transfertat buxhetore për bujqësinë

Mbështetja totale buxhetore për bujqësinë

Buxheti bujqësor total në BiH është rritur vazhdimisht gjatëperiudhës 2002-2012, me disa luhatje të vogla. Në vitin 2002 transfertat totale buxhetore në sektorin agro-ushqimor në nivel vendi arritën në 11.1 milionë euro, dhe është rritur pothuajse tetë herë deri në vitin 2012, duke arritur në 82.7 milion EUR. Karakteristika kryesore e periudhës së vëzhguar, është fakti se fondet mbështetëse për sektorin bujqësor janë rritur ndjeshëm që nga viti 2007, si rezultat i rritjes së të ardhurave buxhetore dhe futjes së TVSH-së.

Tabela B.II-2: Ndarja e shpenzimeve buxhetore për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale (në milionë EUR), 2002-2012, Bosnje dhe Hercegovina

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
FEDERATA E BiH											

Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit	4.3	5.1	7.8	8.5	14.1	17.0	25.2	22.7	28.7	32.4	25.0
Masa të zhvillimit strukturor dhe rural	0.9	0.6	1.4	2.2	2.8	11.3	14.3	12.0	9.8	4.0	18.1
Masa të përgjithshme lidhur me bujqësinë	0.3	0.5	0.5	1.0	1.0	2.3	2.8	1.1	0.9	0.4	0.5
Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë	**5.5**	**6.2**	**9.7**	**11.8**	**18.0**	**30.6**	**42.4**	**35.8**	**39.5**	**36.7**	**43.6**
REPUBLIKA E SRPSKA											
Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit	4.0	5.3	9.2	11.5	15.0	24.7	26.1	30.2	15.6	26.4	22.1
Masa të zhvillimit strukturor dhe rural	0.0	1.0	2.6	3.9	6.8	7.8	8.8	6.7	20.3	3.9	11.2
Masa të përgjithshme lidhur me bujqësinë	0.9	1.3	1.5	2.0	2.6	3.8	5.9	4.3	4.2	1.8	2.5
Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë	**5.0**	**7.6**	**13.2**	**17.4**	**24.4**	**36.3**	**40.8**	**41.2**	**40.1**	**32.1**	**35.8**
QARKU I BRČKO											
Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit	0.4	0.4	0.6	2.6	2.6	2.3	2.2	2.8	2.3	2.0	2.9
Masa të zhvillimit strukturor dhe rural	0.3	0.3	0.1	0.8	0.1	0.2	0.1	0.4	0.3	0.3	0.4
Masa të përgjithshme lidhur me bujqësinë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë	**0.7**	**0.7**	**0.8**	**3.5**	**2.8**	**2.5**	**2.3**	**3.1**	**2.6**	**2.3**	**3.3**
BOSNJE DHE HERCEGOVINA											
Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit	8.7	10.8	17.6	22.6	31.8	44.0	53.5	55.6	46.7	60.8	50.1
Masa të zhvillimit strukturor dhe rural	1.2	1.9	4.1	7.0	9.8	19.3	23.2	19.1	30.4	8.2	29.6
Masa të përgjithshme lidhur me bujqësinë	1.2	1.8	2.0	3.1	3.6	6.2	8.7	5.4	5.1	2.2	3.1
Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë	**11.1**	**14.5**	**23.7**	**32.6**	**45.2**	**69.4**	**85.5**	**80.1**	**82.2**	**71.2**	**82.7**

Burimi: Databaza APM e BiH

Buxheti bujqësor në FBiH përjetoi një rritje të dukshme, u rrit nga 5.5 milionë EUR në vitin 2002 në 43.6 milionë EUR në vitin 2012. Ndryshime më të rëndësishme erdhën në vitin 2007, kur përkrahja buxhetore u rrit me gati 70 përqind në raport me një vit më parë, dhe qysh atëherë mbështetja e sektorit, edhe pse më e lartë se më parë, shfaqi disa lëkundje si një reflektim i krizës ekonomike, por edhe një politike të paqartë dhe jo të qëndrueshme bujqësore.

Politikat e Shtyllës I - masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve - dominojnë strukturën e transfertave buxhetore dhe zënë mesatarisht 70 përqind të totalit të buxhetit agro-ushqimor në periudhën e vëzhguar 11-vjeçare, duke përbërë edhe 90 përqind të të gjithë mbështetjes në disa vite, siç ishte rasti në vitin 2011.

Grupi i dytë më i rëndësishëm i masave janë masat e zhvillimit strukturor dhe rural. Politikat e zhvillimit rural në FBiH fituan më shumë rëndësi si në aspektin e qasjes dhe sasinë e stimujve, me një rritje të totalit të fondeve të akorduara për këtë sektor, e cila ka ndodhur në vitin 2007. Mungesa e programeve dhe dokumenteve strategjike karakterizuan politikën e zhvillimit rural si

dukshëm jo-konsistente dhe jo-koherente me luhatje të madhe të shumave të mbështetjes. Për shembull, mbështetja për Shtyllën II në vitin 2009 arriti në 12 milionë EUR, vetëm rreth 4 milionë EUR në vitin 2011, dhe 18 milionë EUR në vitin 2012.

Së fundmi, Shtylla III dhe masat e saj të përgjithshme në lidhje me bujqësinë formojnë pjesën më të vogël të mbështetjes totale të sektorit, dhe në vitet e fundit të periudhës së vrojtuar ato përbënin vetëm 1-3 përqind.

Tendenca të ngjashme pozitive në buxhetin e bujqësisë ishin gjithashtu të pranishme në RS. Transfertat totale buxhetore për sektorin agro-ushqimor prej rreth 5.0 milionë EUR në vitin 2002,janë rritur shtatë herë deri në vitin 2012, duke arritur në 35.8 milionë EUR. Transfertat më të larta ishin në vitin 2009, kur mbështetja e sektorit arriti në 41.2 milionë EUR. Përveç vitit 2010, mbështetja e sektorit ka mbuluar kryesisht shtyllën e parë dhe masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit, pjesa e të cilës ishte nga 62 në 82 përqind. Masat e zhvillimit strukturor dhe zhvillimit rural dolën të dytat në politikën e përgjithshme bujqësore në këtë entitet të BiH, me transfertat më të mëdha që filluan në vitin 2006 dhe arritën kulmin në vitin 2010, me 20.3 milionë EUR duke zënë më shumë se 50 përqind të mbështetjes totale të sektorit.

Ndryshe nga FBiH, RS i kushtoi më shumë vëmendje shtyllës së tretë,politikës së mbështetjes së përgjithshme të sektorit, e cila ka zënë më shumë se 10 përqind të mbështetjes së përgjithshme buxhetore deri në vitin 2011. Kjo është ndoshta një nga arsyet pse ky entitet i BiH ka kapacitetet më të mira institucionale në këtë sektor, duke përfshirë edhe një fushë shumë të rëndësishme të transferimit të njohurive dhe rolin e këshillimit bujqësor brenda saj.

Qarkui Brčko transferoi në mënyrë të konsiderueshme më shumë fonde buxhetore për sektorin e bujqësisë në vitin 2005 dhe që atëherë deri në fund të periudhës së analizuar (2012), transfertat varionin nga 2.3 milion EUR në 3.5 milion EUR. Mesatarisht, 90 përqind e totalit të fondeve janë shpenzuar për zbatimin e mbështetjes në kuadër të shtyllës së parë, ndërsa pjesa tjetër shkoi për masat e zhvillimit rural. Me përjashtim të shumave simbolike në vitin 2007 dhe 2008, mbështetja në kuadër të shtyllës së tretë nuk ekzistonte.

Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve

Siç u tha tashmë, shtylla më e rëndësishme e politikës bujqësore në BiH, si në total dhe në nivel entiteti/qarku, është Shtyllal me masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit.

Ndonëse fonde të caktuara janë ndarë për masat që mund të klasifikohen si masa mbështetëse të tregut, nuk është themeluar një mekanizëm aktiv dhe real i politikës së tregut në BiH dhe njësive të saj. Midis shumë arsyesh më e rëndësishmja është mungesa e një sistemi të vetëm të mbështetjes së bujqësisë në BiH, i zbatueshëm në të gjithë vendin. Grupi i masave më të rëndësishme në kuadër të politikës së çmimeve të tregut është në kompetencë të qeverisë kombëtare (politikës së tregtisë së jashtme), ndërkohë që segmentet e tjera të politikave, si të mekanizmave të ndërhyrjes, janë në nivel entiteti. Të gjitha masat nga ky grup janë *ad hoc* në natyrë, në vend që të jenë zgjidhje të sistemit që mjaftueshëm të forta për të mbajtur çmimet dhe tregun e produkteve bujqësore të qëndrueshëm. Struktura e masave të tjera në kuadër të kësaj shtylle ndryshon në varësi të entitetit.

Në FBiH mbështetja direkte për prodhuesit i përkiste më së shumti pagesave të drejtpërdrejta dhe ishte masa mbështetëse më e njohur. Kjo masë është në të njëjtën kohë edhe më e ndjeshme, dhe ishte shumë shpesh (në rastin e pagesavetë vonuara dhe proceduravetë propozimit të buxhetit) arsyeja për pakënaqësi dhe protesta sociale. Gjatë periudhës 2002-2012, një mesatare prej 68 përqind e totalit të buxhetit bujqësor të entitetit dhe buxhetit bujqësor kantonal është alokuar në këtë grup masash. Në vitet e para të periudhës së vrojtuar kjo mbështetje ka qenë mbizotëruese dhe i përkiste kryesisht pagesave për prodhuesit e qumështit. Megjithatë, në vitet e fundit pjesa relative e këtyre fondeve ka rënë (43 përqind në vitin 2012). Në vlera absolute, pagesat direkte për prodhuesit varionin nga 4.3 milionë EUR në vitin 2002 deri në 20.4 milionë EUR në vitin 2012.

Figura B.II-5: Ndarja e masave të mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve, 2002-2012, Bosnje dhe Hercegovina



Burimi: Baza e të dhënaveAPM e BiH

Ndryshe nga FBiH, mbështetjet për inputet variable në RS zënë një pjesë të rëndësishme të mbështetjes direkte për prodhuesit, përveç pagesave direkte. Veçanërisht gjatë periudhës 2009-2012 me përjashtim të vitit 2010, kur kjo mbështetje ishte 33 përqind (2009) deri në 50 përqind (2011) të buxhetit total për shtyllën e parë të politikës në këtë entitet të BiH[33]. Në Qarkun e Brčko e gjithë mbështetja në kuadër të kësaj shtylle të politikës është në formën e pagesave direkte për prodhuesit.

Në nivel kombëtar, pagesat direkte bazuar në prodhim mbizotërojnë në strukturën e pagesave direkte për prodhuesit, përgjatë gjithë periudhës së vrojtuar. Në këtë drejtim, ka një një qasje entiteti krejt ndryshe në këtë grup të masave të politikës. Pagesat direkte në bazë të prodhimit në RS ishin vetëm pagesa direkte për prodhuesit deri në vitin 2005, periudhë në të cilën u futën pagesat në bazë të sipërfaqeve dhe krerë bagëti aktuale. Pagesat e mëvonshme kishin një peshë të konsiderueshme në këtë grup të masave të politikës, duke përfshirë edhe vitin 2008, por gjatë periudhës 2009-2012 pagesat direkte në bazë të prodhimit u bënë sërisht të zakonshme duke zënë

[33] Si rezultat i buxhetit të pamjaftueshëm, asnjë fond nuk u shpërnda për këtë lloj mbështetjeje në vitin 2010. Por, sa më shpejt që të ishte e mundur në vitin 2011 u paguan borxhet në këtë bazë, çka bëri që në vitin 2011 pjesa që zinte kjo mbështetjeje të ishte shumë më e lartë, duke arritur pothuajse 50 përqind e totalit të shpërndarjeve për shtyllën e parë.

mesatarisht 85 përqind të të gjitha pagesave direkte. Shumica e këtyre pagesave janë të destinuara për prodhuesit e qumështit të cilët paguhen kryesisht në bazë të sasive të prodhuara ose të blera prej tyre, dhe midis llojeve të tjera të prodhimit duhet të përmenden mbështetje të prodhuesve të bimëve të arave, frutave dhe perimeve.

Figura B.II-6: Ndarja e pagesave direkte për prodhuesit, 2002-2012, Bosnja dhe Hercegovina



Burimi: Databaza APM e BiH

Në FBiH ka qenë i dukshëm një prirje për rritje të pagesave të bazuara në sipërfaqe/krerë bagëti aktuale në lidhje me pagesat në bazë të prodhimit. Ndërkohë që pagesat e bazuara tek prodhimi ishin në thelb lloji i vetëm i pagesave direkte gjatë viteve 2002-2004, struktura ndryshoi gjatë periudhës 2005-2012, dhe pagesat në bazë prodhimi kanë zënë një pjesë të vogël të totalit të pagesave direkte nga viti 2009. Shumica e pagesave bazuar tek prodhimi kishin për qëllim të mbështesnin prodhuesit e qumështit (shpërblime për prodhimin e qumështit) dhe, përveç kësaj, duhen përmendur transfertat e shpërblimeve për grurë, duhan, dhe disa fruta dhe perime. Në vitet e fundit mbështetja për fruta dhe perime është zhvendosur gradualisht drejt pagesave të bazuara në sipërfaqen aktuale.

Megjithëse pagesat në bazë të prodhimit zënë akoma një pjesë të madhe, është inkurajues fakti që pagesat e bazuara në sipërfaqe/krerë bagëti aktuale kanë rritur pjesën e tyre, për shkak sekjo është një masë në drejtim të harmonizimit me EU CAP dhe WTO. Mbështetja e bazuar në sipërfaqe/krerë bagëti aktuale është praktikisht hapi i parë në tranzicionin e politikës së mbështetjes ndaj EU CAP. Edhe pse format e para të pagesave të tilla u regjistruan në vitin 2002, transfertat më të rëndësishme dhe më të konsiderueshme filluan në vitin 2007 dhe arritën kulmin në vitin 2011 me 15.9 milionë EUR, shumë e cila ishte 54 përqind e totalit të pagesave direkte. Kjo masë mbështet mbarështimin e kafshëve të ndryshme, prodhimet e shpendëve, prodhimin e mjaltit, dhe disa bimëve të arave.

Pagesat direkte për prodhuesit në Qarkun e Brčko mund të ndahen dukshëm në nën-periudha brenda periudhës së vrojtuar. Periudha e viteve 2002-2006 u karakterizua nga pagesat në bazë të prodhimit të prodhuesve; vitet 2007 dhe 2008 ishin tranzitorë me futjen graduale të pagesave të bazuara në sipërfaqet dhe numrin aktual të bagëtive, e cila është shndërruar në formën e vetme të mbështetjes që nga viti 2009.

Masat e zhvillimit strukturor dhe rural

Diferencat e politikave sipas entiteteve janë veçanërisht të dukshme në rastin e masave të zhvillimit strukturor dhe rural.

Figura B.II-7: Ndarja e masave të zhvillimit strukturor dhe rural, 2002-2012, Bosnje dhe Hercegovina



Burimi: Databaza APM e BiH

Ndryshe nga RS dhe Qarku i Brčko, politika e zhvillimit rural në FBiH është kryer pa qëllime të përcaktuara dhe një dokument strategjik të nevojshëm që do të programonte dhe harmonizonte zhvillimin rural me nevojat aktuale. Kjo është arsyeja pse FBiH miraton masa *ad hoc* dhe shumë shpesh në përputhje me pikëpamjet e strukturave aktuale të qeverisë. Karakteristikë kryesore e kësaj politike është inkonsistenca , inkoherenca, mungesa e transparencës dhe e fondeve.

Fondet totale të shpërndara për masat e politikës së zhvillimit rural në FBiH kanë qenë modeste deri në vitin 2006. Një progres i konsiderueshëm si nga pikpamja strukturore edhe financiare është bërë që nga viti 2007, me shumën më të madhe të parave të përcaktuara për masat e zhvillimit rural në vitin 2012 - 18.1 milionë EUR, shifër e cila zë disi më pak se gjysmën (43.1 përqind) e buxhetit të përgjithshëm bujqësor në FBiH.

Pjesa më e madhe e mbështetjes brenda masave të zhvillimit rural ishte shpërndarë në Boshtin 1, masat që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor, dhe në shumicën e viteve të vëzhguara këto ishin transferta vetëm për zhvillimin rural. Shumica e këtyre transfertave mbështetën investimet në ferma bujqësore, ndërkohë që masa të tjera brenda këtij boshti ishin më pak të përfaqësuara. Masat që mbështesin ruajtjen e mjedisit (Boshti 2) dhe përmirësimin e ekonomisë rurale (Boshti 3) nuk kanë pasur kudo të njëjtin trajtim si Boshti 1, dhe në thelb janë simbolike. Duke marrë parasysh buxhetin bujqësor total dhe strukturën e tij në njërën anë, dhe çrregullimet "financiare" (siç është kriza ekonomike 2009-2010), në anën tjetër, hartuesit e politikave bujqësore në FBiH duket se kanë zgjedhur masa që lidhen direkt me prodhimin për sa i përket masave të zhvillimit rural.

Pavarësisht ekzistencës së dokumenteve strategjike, politika e zhvillimit rural në RS nuk mund të konsiderohet e qëndrueshme, transparente dhe e mbështeturfinanciarisht. Luhatjet e konsiderueshme të fondeve të akorduara ishin të dukshme nga viti në vit (2010 - 20.3 milionë EUR, 2011 – 3.9 milionë EUR), me dominimin e masave që mbështesin konkurrueshmërinë (Boshti 1) dhe përmirësimin e ekonomisë rurale (Boshti 3), ndërsa mbështetje përçështje të mjedisit nuk kanë ekzistuar fare gjatë gjithë periudhës së vrojtuar. Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë është zbatuar përmes mbështetjes së investimeve në fermë (blerjen e makinerive, kafshëve, ndërtimin e ndërtesave, mbjelljen, sera me plastmas, sera me xham, etj.), ndërsa mbështetja për zonat dhe popullsinë rurale është dhënë kryesisht për ndërtimin e infrastrukturës rurale. Sipas Rokvić (2012), egziston njëperpeptim i përgjithshëmpër hapa pozitive në lidhje me politikën për zhvillim rural në RS në drejtim të shpërndarjes strategjike të fondeve, në masa mbështetëse më të qëndrueshme dhe më të shumta në numër, dhe në një rritje të konsiderueshme të fondeve të shpërndara. Nga ana tjetër, reformat e zbatuara dhe masat e shumta të prezantuara kërkuan mekanizma të reja për zbatimin e politikave në terren dhe modeleve të reja të menaxhimit, e cila në thelb nuk u arrit.

Qarku Brčko shpërndau fonde modeste për masat e zhvillimit rural dhe këto kanë të bëjnë vetëm me përmirësimin e konkurrueshmërisë; pra, blerjen e aseteve fikse për prodhimin.

Masat e përgjithshme të lidhura me bujqësinë

Grupi i shtyllës së III-të të masave të politikës - mbështetja e përgjithshme për bujqësi - nuk është menduar direkt për prodhuesit bujqësor, por për të krijuar një mjedis më të mirë biznesi në bujqësi. Ai përfshin forma të ndryshme të inspektimeve dhe monitorimit, kërkimit dhe zhvillimit, dhe promovimit.

Fonde modeste janë shpërndarë për masat e mbështetjes së përgjithshme për bujqësinë në FBiH. Vetëm në vitin 2007 dhe 2008 ato ishin pak më shumë se 2 milionë EUR dhe llogariten nga 6.5 në 7.5 përqind të totalit të buxhetit bujqësor. Në vitet e fundit transfertat kanë qenë jashtëzakonisht të ulëta; si në vitin 2011 edhe në vitin 2012 kjo pjesë u reduktua në nivele simbolike prej 1 përqind. Për sa i përket mbështetjen e kësaj shtylle, transfertat kantonale janë në fakt më të rëndësishme në FBiH, sepse ato financojnë autoritetet inspektuese të cilat janë kompetente për impiantet dhe shëndetin e kafshëve (politika veterinare), shërbime këshillimi dhe ekstensioni, si dhe trajnimin e fermerëve në fusha të ndryshme.

RS i kushtoi më shumë vëmendje kësaj shtylle të mbështetjes së sektorëve, dhe deri në vitin 2010 pjesa që ajo zinte në buxhetin e përgjithshëm ka qenë vazhdimisht mbi 10 përqind. Kjo përqindje u reduktua në vitet 2011 dhe 2012 - respektivisht 5.6 dhe 7.1 përqind. Pjesa më e madhe e mbështetjes ishte parashikuar për sigurinë ushqimore; d.m.th. politika veterinare dhe kontrolli i shëndetit të bimëve, si dhe për masat në mbështetje të kërkimit dhe zhvillimit; d.m.th., shërbimet këshilluese.

Qarku i Brčko nuk shpërndan fonde për grupin e masave në fushën e shërbimeve të përgjithshme.

4. Diskutime dhe konkluzione

Potencialet e sektorit agro-ushqimor ofrojnë mundësi reale tregu të cilat, për fat të keq, nuk janë përdorur për shumë arsye, duke përfshirë ato më kryesoret: (i) struktura e pafavorshme e fermës dhe mungesa e mekanizmave efikase për të përshpejtuar procesin e ristrukturimit për të rritur ekonomitë e shkallës; (ii) menaxhimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore, duke përfshirë nënshfrytëzimin e tokës (rreth 50 përqind e tokës së punueshme është e pashfrytëzuar) dhe ujit (më pak se 2 përqind e tokës është e ujitur), mungesa e mbrojtjes së tokës dhe investimeve sistematike në përmirësimin e cilësisë së tokës; (iii) modernizimi dhe zhvillimi/kapaciteti i ulët teknologjik (duke përfshirë kompetencat e ulëta të burimeve njerëzore) dhe varësia e fortë në importe e pothuajse të gjitha inputeve, pajisjeve dhe teknologjive; (iv) akses i dobët ndaj tregut dhe aftësisë për të përshtatur pritshmëritë e konsumatorëve (në lidhje me diversitetin, cilësinë dhe sigurinë), për shkak të nivelit të ulët të integrimit dhe sofistikimit të zinxhirëve të vlerave (sipas Nikolić et al. (2014), zhvillimi i tyre është në fazë rritëse.); (v) kapitali i varfër social dhe infrastrukturë e dobët kapitale dhe institucionale; (vi) mungesë-investimesh dhe qasje e dobët ndaj "kapitalit të ri".

Rrjedhimisht, fokusi i të gjithë aktorëve të sektorit dhe politikave publike duhet të jetë në aktivitetet që sigurojnë përdorimin më të mirë të burimeve të papërdorura, si dhe përshtatjen më të mirë ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë një formë më efikase të ndryshimit të sigurimit dhe teknologjisë. Kjo do të thotë se forcimi i transferimit të teknologjisë dhe zhvillimi i ardhshëm sistematik i saj duhet të jetë një prioritet i politikave, që përfshin një rol më të fuqishëm për shkencën, por edhe OJQ-të. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i menaxhimit të integruar dhe të mirë-strukturuar të burimeve natyrore - me fokus çështjet e tokës - është gur themeli për rrugën drejt qëndrueshmërisë në bujqësinë e BiH, duke siguruar në të njëjtën kohë zhvillim më të shpejtë. Aksesi më i mirë ndaj tregut nxit rritjen e prodhimit të sektorit, është e nevojshme që të përqendrohet në përformancën e dobët ose mungesën e lidhjeve në zinxhirët e vlerave të agro-biznesit, të tilla si: furnizuesit e inputeve, kooperativat, logjistika e shpërndarjes dhe e paskorrjes/vjeljes, dhe organizatave që lehtësojnë problemet e cilësisë dhe sigurisë, përmirësimit të inovacionit dhe integrimit. Prandaj, pjesa më e madhe e sektorit duhet të jetë në gjendje për të përmbushur kërkesat e procesit të integrimit në BE. Kjo do të thotë se nëse menaxhohet ashtu siç duhet, procesi i integrimit në BE duhet të shihet si një mjet i fuqishëm për përshpejtimin e zhvillimit të sektorit. Në këtë kuadër, përgjegjësia për zhvillimin e sektorit dhe për suksesin e procesit të integrimit në BE mbështetet nga të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë të gjitha bizneset, OJQ-të dhe institucionet akademike.

Politika dhe qeverisja e sektorit të BiH duhet të ristrukturohet rrënjësisht në mënyrë që të ndjekë nevojat reale të zhvillimit të sektorit dhe të formojë një administrim bujqësor të orientuar nga sektori në të gjitha nivelet në gjendje për të ndihmuar sektorin për t'u bërë pjesë produktive e tregut të BE-së. Në këtë kontekst duhet të integrohen ndryshime vendimtare. Prandaj duhet të identifikohen dhe të kapërcehen mangësitë brenda politikës bujqësore. Përveç diferencës së krijuar në gamën dhe strukturën e masave, ka shumë boshllëqe të tjera midis politikës bujqësore të BiH/entiteteve dhe CAP, por ka edhe boshllëqe midis nevojave reale të sektorit dhe fokusit të masave të zbatuara të politikës bujqësore në të gjitha nivelet administrative.

Shtylla më e rëndësishme e politikës bujqësore në BiH, si në përgjithësi dhe në nivel entiteti/qarku, është Shtylla I me masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit. Megjithëse pagesat në bazë të prodhimit zënë akoma një pjesë të madhe, është inkurajuese që pagesat e bazuara në sipërfaqë dhe numrin aktual të bagëtive janë rritur, për shkak se ky njihet praktikisht si një hap i parë në tranzicionin e politikës së mbështetjes në drejtim të harmonizimit me EU CAP dhe WTO. Megjithatë, përveç pagesave direkte ekziston akoma mbështetja për inputet variable (në RS zënë një pjesë të rëndësishme në mbështetjen direkte për prodhuesit).

Përveç kësaj, vetëm 1-3 përqind e fondeve bujqësore i dedikohen shërbimeve të përgjithshme, e cila kërkon një transferim të teknologjisë dhe një rritje në aftësinë e sektorit për të modernizuar dhe ripërtërirë këtë sektor në ekonominë e BiH. Sa për zhvillimin rural dhe rritjen e konkurrueshmërisë në sektorin e bujqësisë, ka nevoja të qarta për mbështetje të investimeve në fermë, por për fat të keq kjo mbështetje është e pamjaftueshme. Përveç kësaj, këto fonde të pamjaftueshme po shpenzohen pa transparencë të mjaftueshme (mungesa e informacionit është veçanërisht e pranishme tek fermerët e vegjël), dhe ndonjëherë në rrethana të dyshimta. Çështjet agro-mjedisore në BiH nuk janë trajtuar në mënyrë të mjaftueshme dhe ato marrin mbështetje të ulët buxhetore. Një analizë e legjislacionit mjedisor tregon mungesën e instrumenteve ligjore, duke përfshirë problemin e mospërputhjes së legjislacionit të miratuar me standardet dhe rregulloret e BE-së, dhe mospërputhjes midis ligjeve të miratuara në nivele të ndryshme të qeverisjes (Bajramovic, 2014).

Përveç strukturës së politikës bujqësore, qasja në krijimin e politikës, menaxhimin dhe vlerësimin e zbatimit duhet të ndryshohet rrënjësisht, por duhet gjithashtu të programohet. Duke pasur parasysh se BiH është unike dhe se politika aktuale bujqësore menaxhohet në nivel entiteti, me qëllim të harmonizimit dhe të koordinimit të përpjekjeve për të mbështetur dhe lehtësuar zhvillimin e sektorit, është e nevojshme përgatitja e dokumenteve përkatëse strategjike dhe programuese për të mbështetur rrugën e integrimit evropian dhe përshtatjen e politikës bujqësore. Këto dokumente duhet të formojnë një kuadër të përshtatshëm, të pajtueshëm dhe fleksibël, të nevojshëm për të prezantuar planifikimin shumëvjeçar të masave të harmonizuara në kuadër të përshtatjes me kërkesat për anëtarësim në BE, dhe forcimin e bujqësisë në vend në periudhën e para-anëtarësimit. Përveç kësaj, qeverisja moderne dhe një qasje e re për krijimin e politikave forcon edhe rëndësinë dhe rolin e mbështetjes analitike, transferimin e teknologjive dhe infrastrukturën e zhvillimit rural. Këto zona janë të pazhvilluara.

Kuadri legjislativ i BiH duhet të ristrukturohet rrënjësisht si bazë për krijimin e një administrate bujqësore fleksible dhe të orientuar ndaj sektorit në të gjitha nivelet. Përparësi duhet t'i jepet zhvillimit të një plani të saktë operacional për futjen e *Acquis*, miratimin e ligjeve që mungojnë, si dhe zhvillimin e një plani për krijimin e institucioneve që mungojnë dhe mekanizmat që janë të nevojshme për menaxhimin efikas të sektorit dhe përkrahje për zhvillimin e mëtejshëm të tij. Kjo do të jetë mënyra për të kapërcyer pengesat në procesin e ristrukturimit; d.m.th., përafrimit me BE-në.

Zhvillimi i sektorit dhe procesi i integrimit në BE janë mjaft të kufizuar nga një kuadër institucional i pazhvilluar. Një problem parësor është zhvillimi i dobët i elementeve të IACS (Sistemi i Administrimit dhe Kontrollit të Integruar) së paku në nivel entiteti. Kjo do të thotë se sistemi i identifikimit të përdorimit të tokës dhe bazat e tjera relevante të të dhënave ekzistojnë pjesërisht ose nuk ekzistojnë fare.

Gjithashtu, standartet e marketingut dhe sistemit të sigurisë dhe cilësisë ushqimore nuk janë zhvilluar plotësisht - si bazë për zbatimin e masave të ndërhyrjes së tregut në BiH. Edhe pse institucionet kombëtare të BiH kanë miratuar një numër të konsiderueshëm standardesh, akoma ka probleme në krijimin e strukturave administrative dhe institucionale që do të jenë në gjendje për të siguruar përputhjen me standardet e sigurisë dhe cilësisë, marketingut, madhësisë dhe paketimit, rregullat e etiketimit, analizat, kontrollet dhe monitorimet e produktit.

Së dyti, për shkak të mungesës së vullnetit politik, zhvillimi i institucioneve të nevojshme kombëtare për IPARD është në fazë graduale. Në shkallë kombëtare, është Zyra për Harmonizimin dhe Koordinimin e Sistemeve të Pagesave në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, kompetencat aktuale të të cilës janë më afër me rolin e agjensisë së pagesave të IPARD. Megjithatë, politikat kombëtare, të entiteteve dhe të qarkut nuk kanë bërë një marrëveshje formale për krijimin e një strukture operative të IPARD. Dihet se krijimi i një agjensie pagesash si institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të CAP (duke përfshirë mbështetjen direkte, instrumentet e organizimit të tregjeve të përbashkëta dhe mbështetjen për zhvillimin rural), konsiderohet si një nga kërkesat më

të veçanta për t'u përmbushur për çdo vend kandidat të BE. Pezullimi i 45 milionë eurove nga fondet e IPA-s, të parashikuara për BiH në vitin 2013, është një paralajmërim i qartë se një përgjigje e shpejtë për këtë problem është e nevojshme.

Së treti, ka edhe probleme institucionale në fushën e mjedisit, veçanërisht në burimet njerëzore, si në aspektin e numrit dhe të kompetencave të tyre. Prandaj, aftësia e sektorit për të adresuar çështjet në lidhje me Direktivën e Nitratit, mirëqenien e kafshëve dhe ndryshimet klimatike është i ulët, duke nënkuptuar një sërë problemesh në lidhje me "gjelbërimin e bujqësisë", e cila është një kërkesë e theksuar fuqishëm e CAP.

Së katërti, funksionaliteti dhe efikasiteti i institucioneve ekzistuese janë të diskutueshme për shkak të qeverisjes së vjetëruar publike, mungesës së kompetencave dhe përgjegjësive, si dhe mungesës së bashkëpunimit me ekspertë dhe komunitetin akademik. Të gjitha këto probleme janë të rrënjosura në mungesë të një ndarjeje të qartë të pushtetit, rolit dhe përgjegjësive e niveleve të ndryshme administrative, të cilat në mënyrë të konsiderueshme zvogëlojnë efikasitetin e autoriteteve ekzekutive dhe legjislative.

Dobësitë e identifikuara institucionale, rënia e aftësisë për të monitoruar dhe vlerësuar transfertat buxhetore bujqësore dhe fondet e donatorëve, duke parandaluar ristrukturimineshpejtë të sektorit dhe aftësinëpër të rritur nivelin e përdorimit, mbrojtjes dhe cilësisë së burimeve natyrore, si edhe sigurimine "modernizimit dhe intensifikimit të qëndrueshëm" si një përgjigje e duhur ndaj ndryshimeve klimatike dhe sfidave të zhvillimit. Prandaj, politika dhe administrimi i fortë drejt integrimit në BE mund të japë më shumë rëndësi për bujqësinë dhe për të mundësuar zhvillim më të shpejtë të saj. Një hap i rëndësishëm do të jetë sigurisht në qoftë se politikanët dhe administrata artikulojnë një vizion të qartë dhe kuptojnë procesin. Ky hap përpara do të mund të bëhet shumë shpejt në FBiH. Një draft strategji e zhvillimit afatmesëm për sektorin e bujqësisë në këtë entitet të BiH për periudhën 2014-2018 ekziston, me përafrimin me EU CAP, si një nga qëllimet strategjike të saj, duke përfshirë edhe mekanizmat e propozuara për veprim në drejtim të forcimit institucional dhe reformën e politikave bujqësore. Një strategji për zhvillimin e sektorit bujqësor në RS është në zhvillim e sipër, dhe në bazë të informatave paraprake, një prej qasjeve në këtë dokument do të përfshijë -në dhe përafrimin me CAP.

Analiza e mësipërme e politikës bujqësore për vitet 2002-2012 në BiH dhe njësitë e saj në mënyrë të qartë tregon se si zbatimi formal dhe thelbësor i procesit të anëtarësimit dhe përshtatja e politikave bujqësore të BiH me CAP është ende i pakënaqshëm. Politika bujqësore në të dy entitetet e BiH ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga modeli i BE-së. Në të dy entitetet e BiH, pagesat direkte jepen me njësi llogaritjeje prodhimin për një pjesë më të madhe të mbështetjes direkte për prodhuesit, ndërsa ato nuk ekzistojnë në vendet e BE-së. Transfertat modeste për masat e zhvillimit rural kanë të bëjnë pothuajse tërësisht me investimet në ferma bujqësore, ndërsa masat e ruajtjes së mjedisit, si një pjesë e detyrueshme e CAP, praktikisht nuk ekzistojnë në BiH.

Harmonizimi ligjor është duke u kryer gradualisht, por institucionet janë akoma duke u zhvilluar. Defiçitet në strukturën institucionale dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore janërezultat i një motivimi të dobët dhe mungese të vullnetit politik në vitet e fundit, të cilat kanë pasur në mënyrë të pashmangshme pasoja në zhvillimin e BiH si shtet. Në fakt, politika bujqësore në BiH nuk ekziston; ajo është një bashkim i politikave të entiteteve dhe kantoneve pa shumë koordinim mes tyre. Kjo është e paqëndrueshme, dhe shpesh varet nga orientimi politik që shpesh angazhohet për t'i shërbyer një "interesi të lartë" më shumëse sa qëllimeve strategjike. Pakrahasueshmëria e politikës nuk është një problem për veten, por një fakt që dëshmon për populizmin dhe mungesën e strategjisë dhe vizionit në politikë (Bajramović et al., 2010). Në mënyrë që të përafrohen me CAP dhe duke marrë përsipër konceptin e saj, nevojiten hapa të domosdoshëm sa më shpejt të jetë e mundur për të krijuar një sistem të koordinimit të politikave ndërmjet entiteteve dhe qarkut. Në këtë situatë të ndërlikuar politike në vend, krijimiinjë platforme të përbashkët për veprim në kontekstin e integrimit në BE dhe përafrimit me CAP mund të jetë hapi i parë.

Pritet që ndalimi i përkohshëm i procesit të integrimit evropian të BiH nuk do të sjellë përjashtimin nga grupi i republikave ish-jugosllave në rrugën drejt BE-së, e cila do të sillte dëme të mëdha politike, ekonomike dhe sociale. Ndoshta njoftimi i qasjes së ndryshme të BE-së në BiH është një shenjë se BiH ka akoma shans për t'u bërë një vend kandidat i BE-së në të ardhmen e afërt dhe për të filluar procesin e negociatave, në të cilin politika bujqësore do të marrë një vend shumë të rëndësishëm.

Referenca

Agency for statistics of Bosnia and Herzegovina. 2012. Statistical Bulletins, Sarajevo

Bajramović, S., Ognjenovic D. & Nikolic A. 2010. Reviewof Agriculture and Agricultural Policy in Bosnia and Herzegovina. Agriculture in the Western Balkan Countries, Chapter 3, ed. Volk Tina, IAMO, Halle.

Bajramović, S., Butkovic, J. & Nikolic, A. 2010.Analysis of Budgetary Transfers in Agriculture Sector of Bosnia and Herzegovina Using OECD Indicators, Agro-knowledge Journal, Vol. 11, No. 1, Faculty of Agriculture University of Banja Luka, Banja Luka.

BiH APM Database. 2014. Agricultural Policy Measures Database compiled for Bosnia and Herzegovina under the FAO/SWG project "Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession" (unpublished data).

Central Bank of Bosnia and Herzegovina. 2012. Annual Bulletins, Sarajevo.

Chamber of Commerce of Bosnia and Herzegovina. 2012. Foreign Trade Database, Sarajevo.

Department for Agriculture of Goverment of Brčko District. 2008. Strategije poljoprivrede, prehrane i ruralnog razvitka u Brčko distriktu BiH za razdoblje 2008-2013, Brčko

Erjavec, E., Rednak, M. & Bajramovic, S. 2010. Common Agricultural policy of EU and Challenges that expect Bosnia and Herzegovina, Ëorks of the Faculty of Agriculture and Food Sciences University of Sarajevo, Volume LV, No 60/1, Sarajevo.

European Commission. 2013. Bosnia and Herzegovina 2013 Progress Report, Commission staff working document, SWD (2013) 415 Final, Brussels.

EUROSTAT. 2014. Statistics explained, Agricultural holdings 2000-2010.http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/themes

FAFS. 2010. Past agricultural policy and its future influence on the food sector development in the Federation of BiH – Report on the project ëork for the period 2007-2009, Sarajevo. Faculty of Agriculture and Food Sciences Sarajevo.

FAFS. 2013. The Strategy of Agricultural Sector Development in Federation of BiH for Period 2014-2018, Draft version, Faculty of Agriculture and Food Sciences Sarajevo..

Federal Office of Statistics. 2012. Statistical Yearbooks, Sarajevo.

FAO. 2012. Preparation of IPARD Sector Analyses in Bosnia and Herzegovina, Sector: Fruits and Vegetables, Project No GCP/BiH/007/EC, Sarajevo.

IMF. 2013. Central, Eastern and South-eastern Europe, Regional Economic Issues, Reports from April and October of 2013. International Monetary Fund.

Ministry of Agriculture, Water Management and Forestry of the Republika Srpska. 2006. Strategija razvoja poljoprivrede Republike Srpske do 2015, Banja Luka.

Nikolić, A., Uçar, K. & Uzunović, M. 2014. Public policies impact to the agriculture competitiveness in BIH, Proceedings of 24th Scientific-Expert Conference In Agriculture And Food Industry, Sarajevo, BiH

Rednak, M., Volk, T. & Erjavec, E. 2013. A tool for uniform classification and analyses of budgetary support to agriculture for the EU accession countries, Agricultural Economics Revieë, 14/1, p. 76-96.

Roković, G. 2012. Istraživanje modela ruralnog razvoja BiH korespodentnog sa politikom ruralnog razvoja EU, Doktorska disertacija, Poljoprivredni fakultet Banja Luka, Banja Luka.

Statistical Office of Brčko District. 2012. Statistical Review, Brčko.

Statistical Institute of the Republika Srpska. 2012. Statistical Reviews, Banja Luka

UNDP. 2013. Human Development Report of Bosnia and Herzegovina in 2013: Rural Development in Bosnia and Herzegovina: Myth and Realty, Sarajevo.

Aneksi B.II-1: Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave kryesore, 2005-2012, BosnjadheHercegovina

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Sipërfaqja e prodhimit (1 000 ha)								
Total	321.0	318.0	318.0	321.0	310.0	293.0	303.0	304.0
- Grurë	81.4	73.3	74.0	64.4	67.8	54.6	58.4	60.7
- Misër	195.6	196.4	197.4	204.3	188.7	188.8	196.0	196.5
Farëra vajore	6.3	7.9	7.2	5.3	4.7	4.7	4.7	5.6
Patate	41.4	40.8	41.3	40.4	36.7	36.2	37.1	36.8
Rrush (Verëra produktive)	10.8	10.8	11.4	12.0	10.3	11.3	11.6	13.7
Fruta (Pemë produktive)	18.0	17.7	19.1	19.8	20.7	21.6	22.1	22.7
Perime (total)	43.6	42.2	41.7	41.6	39.3	39.8	40.9	41.2
Të tjera:								
- Duhan	2.9	2.4	2.3	1.9	1.6	1.5	1.5	1.5
- Fasule	9.5	9.5	9.3	9.3	9.5	9.0	9.3	9.0
- Foragjere (misër, tërfil, jonxhë)	103.6	107.9	107.5	108.1	97.0	99.5	100.8	98.4
Prodhimi (1 000 t)								
		1	1	1	1	1	1	
Total	1 358.0	354.5	000.6	374.7	342.8	077.1	077.4	868.1
- Grurë	249.0	232.5	257.1	240.5	255.8	145.4	210.0	225.1
- Misër	1,004.2	993.8	635.3	1,004. 4	962.9	853.4	764.1	539.4
Farëra vajore	13.6	16.7	12.2	10.7	10.2	9.2	8.3	7.3
Patate	458.6	472.9	387.2	428.6	413.7	378.7	412.7	299.9
Rrush (Verëra produktive)	23.3	21.5	21.2	23.9	25.6	23.2	21.6	25.9
Fruta (Pemë produktive .)	193.3	210.8	249.5	235.3	303.0	301.0	312.5	203.8
Perime (total)	243.3	259.2	291.0	264.5	279.5	265.8	263.4	228.6
Të tjera:								
- Duhan	4.4	3.3	3.3	2.9	2.4	1.9	1.8	1.5
- Fasule	13.5	13.1	10.4	12.9	14.9	12.6	11.9	9.4
- Foragjere (misër, tërfil, jonxhë)	752.0	777.9	528.9	689.5	743.1	689.7	658.6	555.3

Burimi: Agjensia e Statistikave të BiH, Zyra Federale e Statistikave, Instituti Statistikor i Republikës së Srpska, Zyra Statistikore e Qarkut të Brčko

Aneksi B.II-2: Çmimet e prodhimit për disa produkte bujqësore (EUR/t),2005-2012, Bosnja dhe Hercegovina

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Grurë	125.5	134.6	165.4	243.4	139.3	152.7	199.7	211.3
Misër	103.4	115.3	193.8	211.2	127.4	155.9	197.1	232.6
Thekër	177.9	131.6	281.6	321.9	248.3	211.1	295.4	283.7
Elb	116.4	137.0	221.6	215.6	118.8	131.9	210.7	198.6
Sojë	214.7	209.6	281.2	363.0	255.6	306.8	332.3	524.8
Patate	122.7	168.7	148.3	173.8	245.4	260.8	260.8	260.9
Speca	281.2	250.5	260.8	301.7	363.0	357.9	260.8	267.6
Lakër	143.2	97.1	143.2	107.4	138.0	225.0	194.3	188.0
Domate	127.8	148.3	132.9	163.6	245.4	306.8	127.8	272.1
Mollë	86.9	97.1	184.1	209.6	184.1	189.2	230.1	238.3
Kumbulla	276.1	189.2	235.2	194.3	199.4	204.5	230.1	281.0
Mish gjedhi (peshë e gjallë)	1 733.3	1 477.6	1 186.2	1 595.2	1 651.5	1 329.4	1 830.4	2 126.2
Mish viçi (peshë e gjallë)	1 983.8	1 835.5	1 799.7	1 983.8	2 152.5	1 789.5	3 108.7	3 001.0
Derra majmërie për therje (peshë e gjallë)	:	:	:	:	:	:	1 462.3	1 614.9
Qingja (peshë e gjallë)	2 091.2	2 060.5	2 239.5	2 045.2	2 173.0	2 101.4	2 157.7	2 313.6
Vezë (1 000 kokrra)	76.7	81.8	102.3	66.5	97.1	97.1	107.4	112.8
Qumësht lope	256.1	251.2	271.5	333.1	282.0	261.1	278.0	287.7

Burimi: Agjensia e Statistikave të BiH, Zyra Federale e Statistikave, Instituti Statistikor i Republikës së Srpska, Zyra Statistikore e Qarkut të Brčko

KapitulliB.III

BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NE KROACI

Ornella Mikuš*

* Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Bujqësisë, Kroaci.

1. Hyrje

Edhe pse Kroacia është një vend i vogël (56 594 km^2), ajo ka topografi shumë të larmishme; nga Mesdhetare në Evropiane Qendrore, nga malore në fushore, nga bregdetare nëkontinentale. Ajo renditet si një nga pesë vendet kryesore evropiane në lidhje me biodiversitetin, me disa pjesë të saj që janë ndër zonat më të pasura të llojit të tyre në botë.

Gjatë dy dekadave të fundit, Kroacia është përballur me sfida të rëndësishme: fitimi i pavarësisë, konfliktet, dhe tranzicioni politik dhe ekonomik nga planifikimi qendror, si shtet socialist, drejt një sistemi të orientuar ndaj tregut e të fokusuar në anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE). Duke ndjekur rrjedhat midis premisave të pavarësisë së fituar dhe kërkesave të integrimit evropian, proceset kroate të modernizimit kanë qenë të bashkuara me përpjekjet për të mbajtur identitetin dhe vlerat e saj tradicionale të Evropës Qendrore dhe Mesdhetare (Franic dhe Mikuš, 2013).

Në periudhën e viteve 2000-2009, Kroacia ka përjetuar një periudhë të ekspansionit të lartë dhe të qëndrueshme të aktivitetit ekonomik, me PBB reale në rritje me një mesatare prej 4.4 përqind. Faktori kryesor i rritjes ekonomike ishte kërkesa e brendshme, e cila është rritur në më shumë se 6 përqind në vit. Për fat të keq për shkak të rritjes së borxhit të jashtëm dhe shpenzimeve publike, deindustrializimit, reduktimit të flukseve hyrëse të kapitalit, thellimi ibilancit tregtar negativ, kriza ekonomike globale dhe shumë çështje politike (korrupsionit, çështjeve të pazgjidhura politike midis Kroacisë dhe Serbisë, Sllovenisë dhe Bosnjedhe Hercegovinës), Kroacia ka përjetuar një krizë të thellë ekonomike që nga viti 2008, e cila ka rezultuar në një rënie të vazhdueshme të PBB-së reale.

Procesi është ndjekur nga problemet e kufizimit të zhvillimit të ekonomisë së përgjithshme, veçanërisht në bujqësi dhe zona rurale: sfidat e trashëguara në lidhje me përdorimin e tokës bujqësore dhe menaxhimin në kontekstin e privatizimit, regjistrat e tokës, sistemi trashëgimor, tregjet dhe sistemi i taksave bujqësore.

Që nga fillimi i procesit të pranimit të Kroacisë në BE në fund të shekullit të kaluar, niveli i ulët i zhvillimit të zonave rurale të Kroacisë u theksua fuqishëm. Kjo është kryesisht pasojë e zhvillimit specifik dhe historik; regjimi i gjatë socialist dhe ekonomia e centralizuar lanë jashtë vëmendjes zonat rurale dhe fermat familjare. Kjo shkaktoi çorientim në kuadër të ekonomisë së tregut dhe të iniciativave private të kryera pas pavarësisë, dhe stereotipet e të kaluarësu reflektuan në kuadrin legjislativ (Franic dhe Mikuš, 2013).

Procesi i anëtarësimit intensifikoi diskutimin për këto çështje. Studiuesit në Kroaci theksojnë nevojën e përshtatjeve strukturore bujqësore bazuar në konkurrueshmërinë e prodhuesve për pjesën e fermave vitale dhe ekonomikisht të suksesshme dhe qasjes rajonale në shfrytëzimin e burimeve natyrore në mënyrë më produktive (Franic et al, 2007;. Tratnik et al 2008.; Radinović dhe Žutinić, 2007). Me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e prodhimit bujqësor në kuadër të konkurrencës evropiane, këta studiues vënë theksin në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, sigurinë ushqimore dhe standardet mjedisore. Sugjerimet ishin në favor të praktikave të prodhimit bazuar në këto parime si dhe të politikave bujqësore që vendosin prioritetedukepërdorur burimet e disponueshme, përzgjedhjene modelvetë mbështetjes dhe masat e politikave në përputhje me kërkesat rajonale (Mikuš et al., 2010, Franic et al., 2011) .

Harmonizimi me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) është akoma në proproces; Hapa të mëdha janë bërë në krijimin e institucioneve të reja në bujqësi dhe përgatitjen e një kuadri të përshtatshëm ligjor. Megjithëse Kroacia është tani një shtet anëtar i BE-së, zbatimi i CAP është duke sjellë shumë sfida. Ka një debat të vazhdueshëm publik për nivelet e ulëta të vetë-mjaftueshmërisë, konkurrueshmërisë së ulët dhe importeve të pakontrolluara. Fermerët akoma presin që qeveria të organizojëprodhimin dhe të garantojë çmimet e blerjes ashtu siç bënte nën sistemin socialist.

Megjithëse Kroacia mishëron një shembull të mirë të Shteteve të reja Anëtare qoftë këto edhe vende fqinje, sidomos ato me histori të ngjashme ekonomike dhe politike (Sllovenia në përdorimin e fondeve agro-mjedisore, Polonia në përdorimin e fondeve të para-anëtarësimit dhe fondeve në kohezion me BE-në, Serbia për nga tregtia e jashtme pozitive), sigurisht e ka të pazgjidhur problemin epërcaktimit të drejtimit të ekonomisë dhe të prioriteteve në politikën kombëtare bujqësore. Qëllimi i kësaj analize është të tregojë çështjet kryesore dhe arsyet për vonesat në procesin e përshtatjes së Kroacisë me BE-në, dhe çorientimin në hartimin e objektivave të politikës bujqësore dhe masat për realizimin e tyre.

Ky dokument paraqet gjendjen dhe ecurinë e bujqësisë kroate si dhe politikat bujqësore në kontekstin e procesit të integrimit evropian. Burimet kryesore të të dhënave për analizën e bujqësisë kroate janë Eurostat dhe Byroja Kroate e Statistikave (CBS). Analizat sasiore të politikës bujqësore janë të bazuara në të dhënat mbi shpenzimet buxhetore bujqësore të siguruara nga Ministria Kroate e Bujqësisë dhe Agjensisë së Pagesave për Bujqësinë, Peshkimin dhe Zhvillimin Rural. Këto janë klasifikuar nëpërmjet formatit të Masave të politikave Agro (APM), një mjet për klasifikimin uniform të masave të politikave bujqësore (Rednak dhe al., 2013). Baza e të dhënave APM për Kroacinë u përpilua për vitet 2006-2012.

Në pjesën e parë të raportit, analizohet gjendja e bujqësisë Kroate, duke treguar rolin e bujqësisë në ekonomi, strukturën e fermës dhe karakteristikat e përdorimit të tokës, strukturën e prodhimit, çmimet bujqësore dhe çmimet e tregtisë agro-ushqimore krahasuar me EU-27 dhe vendet e Evropës Juglindore (SEE). Pjesa e dytë e raportit shpjegon konceptin dhe kuadrin e politikës bujqësore kroate dhe analizon transfertat buxhetore të politikës bujqësore vendase. Në seksionin e fundit diskutohen pikat më të forta, dobësitë, kërcënimet dhe mundësitë e bujqësisë dhe politikës bujqësore kroate.

2. Bujqësia

2.1 Roli i bujqësisë në ekonominë kombëtare

Sektori i bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit luan një rol të rëndësishëm ekonomik në Kroaci. Vlera e Shtuar Bruto (GVA) e këtij sektori u rrit nga 1 543 milionë EUR në vitin 2005, me 2 035 milionë EUR në vitin 2008. Që atëherë ajo ka rënë në 1 861 milionë EUR në vitin 2012. Megjithatë, pjesa që ajo zë nëGVA-në totale ka mbetur midis 4.2 përqind në vitin 2007 dhe 5 përqind në vitin 2012, i cili është gjithashtu një tregues se GVA-ja totale ka mbetur në të njëjtat nivele, ose ka rënë. Pjesa që zë bujqësia në punësimin epërgjithshëm është e luhatshme, me një tendencë rënëse nga 16.9 përqind në vitin 2005 në 13.7 përqind në vitin 2012.

Duke marrë parasysh këta tregues, Kroacia është më afër me mesataren e EU-12 (përkatësisht 4 përqind dhe 12.9 përqind përkatësisht, në vitin 2012), sesa me vendet e SEE-së, ku kontributi i bujqësisë në GVA-në totale dhe punësimin është shumë më i lartë (shikoni Kapitullin A.II). Megjithatë, bujqësia ka një ndikim të rëndësishëm në aktivitetet e tjera ekonomike, kryesisht në industrinë e përpunimit të ushqimit dhe të turizmit, pa lënë pas edhe sektorë të tjerë si tregtia, energjia, transporti, industria kimike e të tjera. Duke qenë se lidhet me sektorët e tjerë (nga prodhimi në përpunimin, transportin dhe tregtimin e produkteve bujqësore), efekti i bujqësisë shoqërohet nga një efekt shumëfishues, kështu që rëndësia e bujqësisë për ekonominë kroate është shumë më e lartë se sa tregojnë të dhënat.

2.2 Struktura e fermës dhe prodhimit

Një karakteristikë kryesore e shumicës së shteteve të reja anëtare, përfshirë Kroacinë, është struktura e fragmentuar e fermës me sipërfaqe të vogël për fermë bujqësore. Sipas Censusit të Bujqësisë, në vitin 2010, një numër prej 233 280 ndërmarrje bujqësore përdornin 1 316 010 ha të tokës bujqësore. Madhësia mesatare e fermave kroate është nën mesataren e BE-së. Në vitin 2010,

ferma mesatare në EU-15 përdori 24.1 ha tokë bujqësore, ndërsa sipërfaqja mesatare e tokës së përdorur të fermës kroate ishte 5.6 ha. Kur krahasohet me madhësinë mesatare të fermave në shtetet e reja anëtare (EU-12) - e cila ishte 7.1 ha në vitin 2010 - ndryshimi është më pak i dukshëm.

Kroacia ka strukturë shumë të fragmentuar dhe të polarizuar të fermave, në të cilën mbizotërojnë disa ferma të mëdha, ndërkohë që mungojnë fermate mesme të cilat përbëjnë shtyllën kurrizore të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Kjo strukturë është një trashëgimi nga e kaluara socialiste e vendit (shkatërrimi i agrobizneseve të mëdha dhe të kooperativave) e komplikuar nga zhvendosje tragjike të luftës (UNDP, 2013). Ferma më të vogla se 20 ha akoma dominojnë (95.3 përqind të totalit të fermave) strukturën e përgjithshme të fermave bujqësore. Vetëm 1.4 përqind e fermave (3 140 ferma) kanë më shumë se 50 ha tokë, duke përbërë 33 përqind të totalit të sipërfaqës bujqësore të përdorur(UAA).

Tabela B.III-1: Struktura e fermave bujqësore sipas klasave të madhësisë, 2010, Kroacia

Klasa e madhësisë (UAA për fermë)	Numri i fermave	UAA (ha)	Struktura e fermave (%)	Struktura e UAA (%)
0 ha	230		0.1	
>0 - <2 ha	122 560	100 680	52.5	8.7
2 - <5 ha	55 430	177 470	23.8	13.5
5 - <10 ha	30 240	208 860	13.0	16.9
10 - <20 ha	13 880	188 580	5.9	14.3
20 - <30 ha	4 330	103 090	1.9	8.8
30 - <50 ha	3 470	132 300	1.5	10.1
50 - <100 ha	2 290	154 230	1.0	12.7
100 ha e lartë	850	250 790	0.4	19.1
Totali	**233 280**	**1 316 000**	**100.0**	**100.0**

Burimi: EUROSTAT

Madhësia ekonomike mesatare e fermës shprehur nga prodhimi standard (SO) arrin në 9 065 EUR për fermë. Shumica e fermave janë klasifikuar në madhësi ekonomike të nivelit deri në 2 000 EUR për fermë (89 480 ferma bujqësore ose 38.3 përqind). Në përgjithësi, struktura e fermës tregon një nivel të ulët të potencialit të investimeve, nivel të ulët të modernizimit dhe zotërimit të pajisjeve teknike, dhe efikasitet energjitik dhe mjedisor të dobët.

Përdorimi i tokës bujqësore mbizotërohet nga toka e punueshme, e cila mbulon 903 508 ha (67.9 përqind të UAA), e ndjekur nga livadhe dhe kullota të përhershme me 345 561 ha (26.0 përqind) dhe kultura shumëvjeçare me 79 000 ha (5.9 përqind).

Struktura e prodhimit bujqësor në Kroaci favorizon prodhimin bimor (62.5 përqind). Mbizotërimi i prodhimit bimor tregon rëndësinë e tij relative në prodhimin e përgjithshëm bujqësor në aspektin e përdorimit të tokës, prodhimit të ushqimit dhe foragjereve (shikoni AneksinB.III-1). Prodhimi bimor dhe bimët vajore përfaqësojnë produktet bujqësore kryesore në Kroaci. Për sa i përket prodhimit bimor, kulturat kryesore janë misri (33.1 përqind të totalit të tokës së punueshme) dhe gruri (20.7 përqind), ndërsa prodhimi i thekrës, elbit dhe tërshërës zë një sipërfaqe dukshëm më të ulët. Kroacia në përgjithësi ka kushte shumë të mira për prodhimin e drithërave (në aspektin e pjellorisë së tokës, klimës dhe traditës në prodhim).

Në pesë vitet e fundit, sipërfaqja e mbjellë me bimët vajore ka qenë mesatarisht 102 000 ha (12 përqind e sipërfaqes totale të tokës së punueshme). Në dekadën e fundit, panxhari i sheqerit është bërë një nga kulturat më të rëndësishme për shkak të përmirësimit të kushteve të tregut dhe kërkesës nga industria përpunuese. Panxhari i sheqerit është rritur në 2.6 përqind të totalit të tokës së punueshme në vitin 2012 (23 502 ha).

Perimet mbulojnë 0.8 përqind të sipërfaqes totale të tokës së punueshme, dhe patatet rreth 1.1 përqind. Të gjitha së bashku, prodhimi i fragmentuar, shitja direkte tek konsumatorët nëpërmjet

tregjeve të gjelbra lokale dhe vet-konsumi, pengojnë hartimin e statistikave të sakta mbi prodhimin dhe marketingun e perimeve.

Kroacia prodhon pothuajse çdo lloj fruti, nga agrumet subtropikale dhe ullinjtë, te frutat tulore dhe frutat e buta. Sipas të dhënave statistikore, plantacionet e frutave zinin rreth 30 000 ha ose 2.3 përqind të totalit të UAA në 2012. Mollët, kumbullat, pjeshkët, dardhat, vishnjet, arrat, si dhe ullinjtë dhe mandarinat janë kulturat kryesore. Problemet u shfaqën kur prioriteti i ish-Jugosllavisë ndaj prodhimit të frutave dhe perimeve u drejtua jashtë Kroacisë (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbi). Këto probleme më vonë u shtuan nga mungesa e masave më stimuluese të politikës bujqësore dhe mungesa e organizimit të tregut, të cilat të gjitha së bashku detyruan Kroacinë të importojë sasi të konsiderueshme të të gjitha llojeve të frutave.

Shtrirja e vreshtave në sipërfaqe të fragmentuara është tipike për vreshtaritë kroate. Në vitet e fundit, prodhimi i rrushit dhe verës ka rënë. Prodhimi mesatar vjetor i verës për periudhën 2008-2012 ishte 1 367 400 hektolitra (1 293 000 në vitin 2012). Në vitin 2012, Kroacia kishte 29 240 ha vreshta (2.2 përqind e UAA), ose 10 përqind më pak se në vitin 2009. Prodhimi i rrushit në vitin 2012 arriti në 187 600 ton, i cili është 10 përqind më pak se në vitin 2009.

Prodhimi blegtoral, i cili kontribuon me 37.5 përqind të vlerës së prodhimit bujqësor në Kroaci, është një sektor me rëndësi të veçantë, në të cilin janë të përfshirë shumë prodhues. Procesi i tranzicionit në ekonominë e tregut, ndryshimet në strukturën e bujqësisë, liberalizimi i tregut të brendshëm dhe lufta, me të gjitha pasojat e saj, kanë ndikuar dukshëm në bujqësinë kroate, veçanërisht në prodhimin blegtoral. Këto kushte nuk favorizojnë përpjekje për standarte në përputhje me higjienën, mirëqenien e kafshëve ose standardet mjedisore. Mishi i gjedhit dhe qumështi zënë pjesën më të madhe të vlerës së prodhimit në nën-sektorin e blegtorisë, ndërkohë që prodhimi i mishit të derrit është më i rëndësishëm në aspektin e numrit të kafshëve (shikoni AneksinB.III-3).

Rendimentet mesatare të kulturave janë të krahasueshme me rendimentet e shumicës së vendeve të BE-së, sidomos për sa i përket drithërave (mesatarja e grurit 2010-2012: 4.9 ton/ha) dhe farërave vajore (luledielli: 2.6 ton/ha), ndërsa rendimenti mesatar i qumështit (4 252 kg/lopë) është më i lartë vetëm ndaj nivelit të Bullgarisë dhe Rumanisë (shikoni kapitullin A.II).

2.3 Çmimet bujqësore

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore treguan luhatje të mëdha gjatë periudhës 2005-2012 me një trend të dukshëm rritës. Në vitin 2007, dhe përsëri në 2010-2012, u regjistrua një rritje e ndjeshme e çmimeve të prodhimit bimor, ndërsa çmimet në sektorin e blegtorisë janë rritur në vitin 2008 dhe përsëri në vitin 2011 dhe 2012. Çmimet në Kroaci luhaten në të njëjtën mënyrë si në tregun e BE-së (shikoni kapitullin A.II).

Tabela B.III-2: Indeksi i çmimeve të prodhimit bujqësor – vlera nominale, 2005-2012 (2005=100), Kroacia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Produktet bimore	100.0	104.8	129.0	121.0	107.5	119.2	126.2	144.6
Produktet blegtorale dhe shtazore	100.0	96.1	94.7	102.6	99.4	94.6	103.2	120.9
BUJQËSIA NË TOTAL	**100.0**	**100.4**	**111.6**	**111.7**	**103.4**	**106.7**	**114.5**	**125.9**

Burimi: CBS

Niveli absolut i çmimeve të prodhimit tregon se Kroacia ka çmime relativisht të ulëta të grurit dhe misrit në krahasim me shtetet e tjera anëtare të BE-së, çka tregon avantazhin e saj në treg. Sektori i blegtorisë, sidomos i bulmetit, duket të jetë më pak çmim-konkurrues (shikoni -AneksinB.III-3 dhe Kapitulli A.II).

2.4 Tregtia agro-ushqimore

Në vitin 2012, pjesa që zinin produktet agro-ushqimore në totalin eeksportit ka qenë 12.9 përqind, ndërsa në totalin e importit ka qenë 12.2 përqind. Për fat të keq, bilanci tregtar agro-ushqimor është vazhdimisht negativme raportin e eksporteve ndaj importeve agro-ushqimore prej 62.9 përqind në vitin 2012.

Tabela B.III-3: Tregtia e produkteve bujqësore dhe ushqimore (milionë EUR), 2005-2012, Kroacia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Eksporti i produkteve agroushqimore	740.0	949.1	960.4	955.5	975.1	1 022.2	1 121.2	1 239.9
- pjesa që zë në eksportin total	10.4%	11.5%	10.7%	10.0%	13.0%	11.5%	11.7%	12.9%
Importi i produkteve agroushqimore	1 299.0	1 473.3	1 572.6	1 792.7	1 605.6	1 635.5	1 861.9	1 970.7
- pjesa që zë në importin e të gjitha produkteve	8.8%	8.7%	8.3%	8.5%	10.6%	10.8%	11.4%	12.2%
Bilanci tregtar i produkteve agroushqimore	-559.0	-524.2	-612.2	-837.2	-630.5	-613.3	-740.8	-730.9
Raporti Eksport/Import	57.0%	64.4%	61.1%	53.3%	60.7%	62.5%	60.2%	62.9%

Burimi: Dhoma Kroate e Ekonomisë

Rreth 30 përqind e totalit të eksporteve agro-ushqimore kroate shkojnë në shtetet anëtare të BE-së, ndërsa më shumë se 40 përqind shkojnë në rajonin e Evropës Juglindore. Tregjet kryesore të eksporteve kroate janë Italia, Sllovenia dhe Hungaria dhe partnerët e saj kryesorë Evropianë të importit janë Gjermania, Italia, Holanda dhe Polonia. Aktualisht, produktet më të suksesshme agro-ushqimore të eksportit të Kroacisë janë sheqeri dhe duhani, të cilat të dyja janë fitimprurëse dhe janë rritur fuqishëm në vitet e fundit. Produkte të tjera me profil të lartë, të tilla si vera ose vaji i ullirit, kanë një pjesë të vogël të tregut të BE-së. Ato mund të mbijetojnë dhe të lulëzojnë edhe në nivel firme, por jo në nivel sektori (UNDP, 2013).

Sheqeri dhe duhani janë histori suksesi para-anëtarësimit në Kroaci, por në qoftë se ata do të mbeten të suksesshëm pas anëtarësimit, qasje të reja për prodhim janë të nevojshme. Anëtarësimi në BE sjell sfida të rëndësishme në kuadrin e kuotave të sheqerit (17-18 përqind më e ulët se në periudhën e para-anëtarësimit) dhe politikave të ashpra shëndetësore në lidhje me duhanin. Si vend rival për prodhimin e sheqerit, Serbia duhet ende të gëzojë të njëjtin statusqë rriti industrinë kroate të sheqerit në vitet e fundit.

Duke marrë parasysh prodhimin dhe tregtinë e dobët agro-ushqimore, çështje të tjera përfshijnë fundin e tregtisë së lirë në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe ndryshime të rëndësishme në subvencione (nga pagesa të përgjithshme në pagesa specifike të ndara). Anëtarët e CEFTA-s ishin tregjet më të rëndësishme të eksporteve kroate, veçanërisht Bosnja & Hercegovina (30 përqind të të gjitha eksporteve agro-ushqimore kroate). Me futjen e tarifave të importit, çmimet janë rritur dhe pjesa aktuale e produkteve agro-ushqimore kroate në tregun e Bosnje & Hercegovinës është i rrezikuar, duke lënë më shumë hapësirë për eksportet serbe. Një fenomen i ngjashëm ka ndodhur me Sllovenine kur ajo u tërhoq nga CEFTA dhe u bashkua me BE-në në vitin 2004.

Shumë vende të reja anëtare, sidomos Hungaria dhe Sllovenia, përjetuan rënie të konsiderueshme në disa nga aktivitetet e tyre bujqësore e blegtorale (Sllovenia në prodhimin e derrave) pas anëtarësimit, pasi fermerët humbën përkrahjen e çmimeve dhe vuajtën rënien e çmimeve. Kjo situatë e re i inkurajoi ata për të rritur prodhimin bimor me investime minimale (UNDP, 2013). Kishte një rënie në numrin e derrave në Kroaci në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011 (1 233 000 në vitin 2011, 1 182 000 në vitin 2012), e shoqëruar nga një rënie në prodhimin e mishit tëderrit.

3. Politika bujqësore

3.1 Kuadri dhe koncepti i politikës bujqësore

Në fillim të viteve 1990, shumica e masave të politikës bujqësore kroate janë marrë nga legjislacioni i vjetër jugosllav i karakterizuar nga objektiva shumë të përgjithshme: rritja ekonomike dhe progresi përmes ofertës së ushqimeve me cilësi të lartë të ofruara me çmime të pranueshme dhe eksporti i produkteve me avantazhe krahasuese; orientimi i fermave familjare në një nivel i cili siguron një standard të përshtatshëm jetese; sigurimi i fondeve të nevojshme nëpërmjet kredisë, përfitimet nga prokurimi i të dhënave, zbatimi i teknologjive dhe informacioneve të reja përmes shërbimeve këshillimore; rritja e investimeve në bujqësi; mbrojtja nga konkurrenca e huaj; konvertimi i strukturës dhe menaxhimit të pronësisë; zhvillimin e infrastrukturës së tregut dhe përshtatjes së kuadrit institucional, në përputhje me tendencat e tregut (Mikuš et al., 2010).

Në mesin e viteve 1990 u krijua një kuadër i përshtatshëm ligjor për të qeverisur mbrojtjen dhe shpërndarjen e burimeve dhe proceseve ekonomike të privatizimit me dokumentin "Strategjia e Zhvillimit të Bujqësisë Kroate" (1995). Aktet e para të rëndësishme, Ligji për tokën bujqësore dhe Ligji për bujqësinë kanë hyrë në fuqi në vitin 2001. Ato ishin fillimi i një nisme për të rregulluar dhe harmonizuar legjislacionin e brendshëm në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural me standardet dhe parimet e BE-së (Franić,2006).

Për shkak të një vetëdije në rritje se ekonomia rurale është më shumë se vetëm bujqësia, objektivat e zhvillimit të ardhshëm u krijuan zyrtarisht përmes Strategjisë së bujqësisë dhe peshkimit të Republikës së Kroacisë në vitin 2002. Këto masa bujqësore nuk u fokusuan vetëm në përmirësimin e aktivitetit bujqësor (së bashku me gjuetinë, pyjet dhe peshkimin), por shtrihej në të gjithë zonën rurale. Përveç kësaj, është vënë një theks i ri në sigurinë ushqimore dhe bujqësinë organike si një sistem i veçantë i menaxhimit të qëndrueshëm dhe mundësitë që ky sistem ofron (Franic dhe Žimbrek, 2003).

Ligji për mbështetjen e shtetit në Bujqësi, Peshkim dhe Pyje krijoi mundësinë për zbatimin emodeleve të reja të mbështetjes në vitin 2002. Parakusht për zbatimin e tij është krijimi i i një regjistri të fermave bujqësore si bazë administrative për menaxhimin e financave bujqësore. Qëllimi ishte për ta bërë sistemin e mbështetjes në bujqësi më të thjeshtë dhe transparent, dhe për të afruar gradualisht politikat bujqësore në përputhje me CAP. Përveç modelit të ndryshuar të mbështetjes së prodhimit (i cili përbëhej nga kompensime për çmimet, pagesat epërgjithshme për sipërfaqe në prodhimin bimor dhe pagesa për krerë bagëti në prodhimin blegtoral), janë futur tre modele të reja të mbështetjes; domethënë, mbështetje e të ardhurave, investimet kapitale dhe zhvillimi rural. Qëllimi ishte ri-shpërndarja e fondeve në favor të këtyre modeleve të reja, duke kryer një rënie të pjesshme të mbështetjes së prodhimit. Për herë të parë ky ligj dallon fermat bujqësoretë orientuara nga tregu nga totali i fermave. Faktori kryesor në procesin e futjes së politikës së zhvillimit rural ishte përgatitja për, dhe zbatimi i SAPARD dhe më pas mbështetja e IPARD para anëtarësimit në BE (Franic, 2006;. Mikuš et al, 2010).

Nga viti 1999 deri në vitin 2011 janë miratuar disa akte me bazë rajonale, duke u përpjekur për të respektuar specifikat rajonale, lokale dhe territoriale (Franic, 2006). Ligji për zonat malore përcakton kushtet për rinovimin demografik, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ai gjithashtu vë prioritete për masat për mbajtjen e popullsisë në zonat e karakterizuara nga rënia e popullsisë dhe ofron kornizën për përdorim më të mirë të burimeve. Akti tjetër specifik ishte Ligji për zonat me interes të veçantë të shtetit, i cili fokusohet në zonat e dëmtuara sidomos gjatë luftës, me qëllim kapërcimin e pasojave të luftës dhe kthimin e shpejtë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur. Ligji mbi ishujt është gjithashtu i ndjeshëm nga ana rajonale, duke përcaktuar ishujt kroatë si thesare natyrore që kërkojnë vëmendje dhe mbrojtje të veçantë publike. Për shkak të këtij ligji, qeveria është e detyruar të mbështesë programet dhe aktivitetet për zhvillimin e qëndrueshëm të ishujve. Këto akte mund të kuptohen si pararendësit e rregulloreve aktuale,

meqënëse këto çështje tani janë nën fushëveprimin e mbështetjes shtetërore në bujqësi dhe legjislacionin e zhvillimit rural në lidhje me zonat më pak të favorizuara.

Kroacia nuk është shembulli më i mirë për të parë se si janë adaptuar reformat e politikave të nevojshme për anëtarësim në BE. Vendimet politike janë marrë shpesh në fazë shumë të vonë të negociatave dhe janë paraqitur dhe diskutuar rrallë në publik. Reformat kryesore për anëtarësim në BE janë realizuar me miratimin e Aktit për Mbështetjen e Shtetit në Bujqësi dhe Zhvillim Rural në vitin 2009 dhe 2010 dhe tre ndryshesat e këtij ligji hynë në fuqi me shpejtësi në tre vitet e fundit, pas një ndërprerjeje të gjatë prej shtatë vjetësh. Qëllimi i këtyre akteve ishte të ndryshonte strukturën e mëparshme të pagesave direkte dhe të fuste gradualisht fillimisht pagesat e ndryshme për sipërfaqe dhe për krerë bagëti edhe në vitin 2012 të transformonte këto pagesa në pagesa historike të krahasueshme me skemën e pagesave individuale të CAP.

Në vitin 2012 u futën për herë të parë në Kroaci të drejtat e pagesës sipas sipërfaqes. Këto pagesa u ndanë nga prodhimi aktual. Megjithatë, për disa sektorë të ndjeshëm (bulmeti, duhani, mishi i lopës, deles dhe dhisë, panxhari i sheqerit, vaji i ullirit i virgjër dhe ekstra i virgjër, dosat për mbarështim) pagesat e përgjithshme mbetën ose u reformuan.

Masat për zhvillim rural u përcaktuan nga BE-ja dhe nga programet kombëtare. Kroacia zbatoi mbështetje me fonde kombëtare për sigurimin e fermave, mbështetje për mbajtjen e specieve autoktone dhe të mbrojtura, mbështetje për investime kapitale, mbështetje me të ardhura, mbështetje për prodhim të integruar dhe organik, mbështetje dhe për zonat më pak të favorizuara në formën e shtimit të pagesave direkte ekzistuese. Teksa Kroacia po kalonte një reçesion ekonomik dhe krizë të buxhetit kombëtar, pagesat direkte u vonuan shumë, çka pati një ndikim të rëndësishëm në disponueshmërinë e financimit dhe të pagesës së masave të zhvillimit rural (Franic dhe Mikuš, 2013).

Dukëqenë e angazhuar në procesin e negociatave dhe përshpejtimin e procedurave të harmonizimit dhe reformimin e politikave në fund të procesit të integrimit, qeveria ka qenë më pak e suksesshme në shpjegimin e reformave të politikave për përdoruesit. Si rrjedhojë shumë energji, kohë dhe para janë shpenzuar në ruajtjen e paqes sociale, e cila prekej shpesh nga protestat e fermerëve.

3.2 Transfertat buxhetore të politikës bujqësore

Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë

Transfertat buxhetore totale për bujqësinë janë rritur nga 387 milionë EUR në vitin 2006 në 582 milionë EUR në vitin 2011; ndërsa në vitin 2012 ato u reduktuan në 499 milionë EUR për shkak të tkurrjes së mbështetjes direkte për prodhuesit.

Tabela B.III-4: Totali i transfertave buxhetore për bujqësinë (milionë EUR), 2006-2012, Kroacia

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve	323.7	389.9	418.4	447.7	445.1	429.4	350.0
Masat e zhvillimit strukturor dhe rural	43.3	68.5	121.1	89.5	81.5	107.1	103.0
Masa të përgjithshme të lidhura me bujqësinë	19.8	24.5	38.4	39.3	50.9	44.9	45.5
TOTALI	**386.7**	**482.8**	**578.0**	**576.5**	**577.5**	**581.5**	**498.5**

Burimi: Databaza APM e Kroacisë

Pjesa më e madhe e buxhetit bujqësor shkon për mbështetjen e tregut dhe mbështetjen direkte të prodhuesve. Në vitin 2006 dhe 2007, këto masa përfaqësuan 80 përqind të totalit të mbështetjes për bujqësinë. Me pëparimin e Kroacisë në procesin e negociatave dhe krizës ekonomike, shuma e

përgjithshme buxhetore u ul, dhe bashkë më këtë u tkurr në 70 përqind edhe pesha që zinin masat për mbështetjen e tregutdhe mbështetjen direkte për prodhuesit.

Arsyeja kryesore për peshën e madhe të mbështetjes direkte për prodhuesit në buxhetin e përgjithshëm bujqësor qëndron në presionet e forta kryesisht nga prodhuesit e mëdhenj për nivele të larta mbështetjeje. Fermat e mëdha bujqësore përdorin kryesisht këtë mbështetje në vend të masave të zhvillimit strukturor dhe rural. Në Kroaci, në vitin 2011, 15 përqind e pagesave shkuan për fermat që marrin më shumë se 500 000 EUR për fermë; vetëm 1 përqind e përfituesve ka marrë 34 përqind të të gjitha pagesave direkte dhe 0.2 përqind morën 25 përqind. Ndërsa në EU-27 vetëm 3.5 përqind e të gjitha pagesave shkojnë në fermat e mëdha që përfitojnë mbi 500 000 EUR (UNDP, 2013).

Arsye të tjera për përqindjen e lartë që zë mbështetja direkte në buxhetin total ishin më tepër të ndikuara nga politika, që mbështeste fillimisht subjekte të mëdha të biznesit me ndikim të madh në fushatat politike dhe shkallën e punësimit dhe së dyti kishte interes të arrinte paqen me popullsinë rurale.

Pjesa e mbështetjes së zhvillimit strukturor dhe rural në buxhetin bujqësor total u rrit nga 11 përqind në vitin 2006 në 21 përqind në vitin 2012. Rritja e parë e rëndësishme në këtë drejtim vërehet në vitin 2007 dhe sidomos në vitin 2008, kur rritja e përgjithshme ekonomike në Kroaci ka qenë pozitive dhe e lartë (5.1 përqind në vitin 2007), e cila ka ndikuar në arritjen e rregullsisë në transfertat buxhetore. Pjesë e rëndësishme e fondit për zhvillimin rural është e bazuar në mbështetjen e para-anëtarësimit në BE.

Figura B.III-1: Ndarja e transfertave buxhetore për bujqësinë, 2006-2012, Kroacia



Burimi: Databaza APM e Kroacisë

Mbështetjet për shërbime të përgjithshme në lidhje me bujqësinë edhe pse janë rritur përfaqësojnë pjesën më të vogël të buxhetit total, duke u luhatur nga 5 përqind në vitin 2006 në 9 përqind në vitin 2012.

Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve

Transfertat buxhetore për mbështetjen e tregut dhembështetjen direkte për prodhuesit janë rritur nga 324 milionë EUR në vitin 2006 në 429 milionë EUR në vitin 2011 dhe pastaj ranë në 350 milionë EUR në vitin 2012.

Tabela B.III-5: Totali i transfertave buxhetore për mbështetjen e tregut dhe mbështetjen direkte të prodhuesve (milionë EUR), 2006-2012, Kroacia

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Masat e mbështetjes së tregut	2.9	6.4	16.8	32.8	7.1	11.8	12.1
Masat e mbështetjes direkte për prodhuesit	320.8	383.5	401.7	414.9	438.0	417.6	337.9
Pagesa direkte për prodhuesit	272.7	297.0	330.1	355.6	389.9	367.4	291.0
Pagesa direkte bazuar tek prodhimi (kompensimi i çmimeve)	83.7	91.3	94.6	98.1	115.5	82.7	24.3
Pagesa direkte bazuar tek sipërfaqja/krerë bagëtie aktuale	189.1	205.7	235.5	257.6	274.4	284.7	248.4
Pagesa direkte të ndara (specifike)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	18.3
Subvencione për inpute variable	46.3	48.5	67.0	59.2	48.1	49.9	46.9
Pagesat e fatkeqësive dhe kompensime të tjera për prodhuesit	1.8	38.0	4.5	0.0	0.0	0.3	0.0
MASAT E MBËSHTETJES SË TREGUT DHE MBËSHTETJES DIREKTE PËR PRODHUESIT	**323.7**	**389.9**	**418.4**	**447.7**	**445.1**	**429.4**	**350.0**

Burimi: Databaza APM e Kroacisë

Në vitin 2012, Kroacia reduktoi pagesat direkte në lidhje me prodhimin (garantimi i çmimeve, pagesat direkte bazuar në sipërfaqe ose krerë bagëti) dhe filloi të zbatojë mbështetje specifike me qëllim të përshtatjes së politikave të saj me CAP përpara anëtarësimit. Megjithatë, pagesat direkte në bazë të sipërfaqes dhe numrit të bagëtive kanë peshën më të madhe në masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte (71 përqind në vitin 2012).

Masat e zhvillimit strukturor dhe rural

Transfertat buxhetore për masat e zhvillimit strukturor dhe rural kanë filluar të rriten pas vitit 2005, kur u prezantua dhe u promovua Urdhëresa për zbatimin e programit të zhvillimit rural në komunat lokale, broshura dhe faqet e internetit.

Sasia më e madhe e transfertave të subvencioneve për politikën e zhvillimit strukturor dhe rural i përket masave që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor. Në periudhën 2006-2011 ajo pjesë ishte rreth 95 përqind. Masat më të përhapura ishin mbështetja e investimeve në fermë (blerja e kafshëve, makineri dhe pajisje të reja, ndërtimi, rinovimi, rindërtimin e objekteve, rivitalizimi i plantacioneve të bimëve shumëvjeçare), mbështetje për fermat dhe përpunimin jo-komercial si dhembështetjae magazinimit dhe marketingut.

Tabela B.III-6: Totali i transfertave buxhetore për masat e mbështetjes së zhvillimit strukturor dhe rural (milionë EUR), 2006-2012, Kroacia

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor	**41.4**	**63.3**	**104.7**	**84.4**	**77.7**	**103.8**	**82.6**
Mbështetja e investimeve në fermë	24.8	30.2	45.4	35.4	42.7	75.1	49.6
Mbështetje të tjera ristrukturimi në fermë	11.7	9.7	18.0	17.1	22.1	17.5	14.8
Përmirësimi i infrastrukturës në lidhje me bujqësinë(ujitje)	4.0	11.9	17.1	12.3	10.8	8.6	1.1
Mbështetje e përpunimit të ushqimit, marketingu dhe promovim	0.9	11.5	24.2	19.5	2.1	2.6	17.1
Përmirësimi i mjedisit dhe i zonave rurale	**1.9**	**2.8**	**3.5**	**3.5**	**3.4**	**3.3**	**20.1**
Pagesa për fermerët në zona të pafavorizuara (LFA)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	8.3
Pagesat agro-mjedisore për fermerët (AE)	1.9	2.8	3.5	3.5	3.4	3.3	11.8
Mbështetja e ekonomisë dhe popullsisë rurale	**0.0**	**2.4**	**12.9**	**1.6**	**0.4**	**0.0**	**0.3**
Mbështetje e diversifikimit në fermë	0.0	0.1	2.7	1.0	0.0	0.0	0.3
Infrastruktura rurale dhe zhvillimi i fshatit	0.0	2.3	10.2	0.6	0.4	0.0	0.0
MASAT E MBËSHTETJES SË TREGUT DHE MBËSHTETJES DIREKTE TË PRODHUESVE	**43.3**	**68.5**	**121.1**	**89.5**	**81.5**	**107.1**	**103.0**

Burimi: Databaza APM e Kroacisë

Në vitin 2012, pjesa që zinin masat e boshtit të parë u reduktua në 80 përqind për shkak të rritjes së transfertave në zonat më pak të favorizuara (LFA) dhe të prodhimit organik të integruar. Megjithatë, prodhimit në LFA dhe bujqësisë organike i është dhënë përkrahje shtesë prej vitit 2002, si pjesë e skemës së subvencionit të prodhimit, por dokumentet e kontabilitetit nga Agjensia nuk mundësojnë ndarjen e pagesave të LFA-ve apo të prodhimitorganik nga pagesat e rregullta. Pagesat shtesë të parashikuara për zonat më pak të favorizuara ishin 35 përqind më të larta për vreshtarinë, pemëtarinë dhe në një masë më të vogël për blegtorinë. Si rregull, subvencionet për prodhimin organik ishin rreth 30 përqind më të larta se subvencionet për prodhimin e zakonshëm. Nga viti 2012 subvencionet për prodhimin organik, prodhimin e integruar dhe pagesat ndaj LFA-ve janë të përfshira në boshtin e dytë të masave për zhvillim rural së bashku me subvencione për ruajtjen e burimeve gjenetike bimore dhe shtazore autoktone dhe të mbrojtura.

Masat e përgjithshme mbështetëse në lidhje me bujqësinë

Financimi i masave dhe shërbimeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me bujqësinë u rrit nga 20 milionë EUR në vitin 2006 në 46 milionë EUR në vitin 2012. Pjesa më e madhe e fondeve për këtë shtyllë të politikës ishin të destinuara për masat e sigurisë ushqimore, sidomos në fushën e veterinarisë.

Tabela B.III-7: Totali i transferave buxhetore totale për masa të përgjithshme (milionë EUR), 2006-2012, Kroacia

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Shërbime kërkimore, zhvillimore, këshillimore dhe ekspertësh	**8.5**	**9.3**	**12.2**	**11.7**	**11.6**	**8.4**	**9.3**
Projektezhvillimore dhe kërkimore	0.6	0.4	0.7	0.4	0.2	0.2	0.4
Shërbime këshillimi dhe ekstensioni	4.5	4.9	5.3	5.6	5.6	5.2	5.1
Infrastrukturë në lidhje me edukimin profesional	0.0	0.3	0.5	0.3	0.0	0.0	0.0
Shërbime ekspertësh	3.4	3.7	5.6	5.3	5.7	3.1	3.8
Kontrolli i sigurisë dhe cilësisë ushqimore	**9.8**	**13.8**	**24.1**	**25.5**	**37.1**	**34.7**	**34.6**
Kontrolli veterinar	8.9	12.6	21.1	20.5	28.5	28.3	28.5
Kontrolli i shëndetit të bimëvë	0.3	0.4	0.3	0.3	0.5	0.3	0.3
Kontrolli i cilësisë	0.6	0.8	2.8	4.7	8.1	6.2	5.8
Masa të tjera të përgjithshme mbështetëse	1.6	1.5	2.1	2.1	2.2	1.8	1.6
MASA TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME BUJQËSINË	**19.8**	**24.5**	**38.4**	**39.3**	**50.9**	**44.9**	**45.5**

Burimi: Databaza APM e Kroacisë

4. Diskutime dhe konkluzione

Bujqësia dhe politika bujqësore kroate janë në udhëkryq.Me anëtarësimin në BE, ky sektor ka mundësi që të përfitojë nga rritja e financimit, që përqëndrohet veçanërisht në sektorin e bujqësisë dhe ekonomisë rurale në përgjithësi. Për më tepër, një periudhë e gjatë e përgatitjes dhe të të mësuarit nga përvoja e Shteteve Anëtare të cilat hynë në BE në vitin 2004 dhe 2007 do të ndihmojnë Kroacinë për t'u përballur me sfidat e anëtarësimit. Megjithatë, Kroacia hyri në BE në momentin e krizës ekonomike globale dhe kombëtare që solli rënien e ritmit të rritjes së përgjithshme ekonomike kombëtare, dhe dobësim të prodhimit bujqësor. Kjo ka çuar në një situatë ku sektori i bujqësisë nuk ishte i përgatitur sa duhet për t'u përballuar me konkurrencën e fortë të BE-së. Kjo rriti frikën e fermerëve për të ardhmen, dhe kritika të forta ndaj qeverisë për dështimin në sigurimin e përgatitjes së duhur dhe zbatimin e masave të CAP të cilat mund të zbusin situatën për fermerët.

Të dhënat për bujqësinë kroate tregojnë se produktet agro-ushqimore kroate në përgjithësi nuk janë konkurruese në tregjet ndërkombëtare, edhe pse ka disa produkte agro-ushqimore me

çmime më të ulëta dhe bilanc pozitiv të tregtisë (grurë i butë, misër, sheqer, farëra vajore, duhani, mishi, peshku, pijet dhe uthulla). Arsyet për konkurrueshmërinë e ulët në tregjet e BE-së dhe tregjet ndërkombëtare janë të lidhura kryesisht me kostot e larta të prodhimit, strukturën e pafavorshme bujqësore me një dominim të fermave me madhësi të vogël ekonomike, mungesa e bashkëpunimit midis fermerëve, menaxhimi i dobët i riskut prej ndikimit të lartë të kushteve klimatike mbi prodhimin, dhe infrastruktura e dobët fizike e tregjeve (kapacitetet e magazinimit apo instalimi i dhomave frigoriferike). Një tjetër arsye për konkurrueshmërinë e ulët janë zinxhirët e dobët agro-ushqimorë me shumë çështje të tilla si: mbledhja dhe logjistika e inputeve bujqësore për përpunimin, mos-përputhje me afatet e pagesës, çmimet e larta të blerjes së lëndëve të para dhe produkteve të gatshme, luhatjet në cilësinë e produktit, përgatitje e dobët e produkteve për tregun dhe investimet e pamjaftueshme në pajisje dhe në promovimin e produktit (Mesić, 2014).

Politika bujqësore kroate thith një mesatare prej gjysmë milioni EUR çdo vit (2006-2012) në formën e subvencioneve për administrimin bujqësor, por në publik perceptohet që nuk ka pasur sukses në përmbushjen e sfidave që kanë sjellë rrethana të reja ekonomike. Politika bujqësore nuk merret sa duhet me ndikimet negative të strukturës bimodale bujqësore me pronat e mëdha nga njëra anë dhe numrit të lartë të fermave të vogla në anën tjetër, e cila është një pengesë për konkurrueshmërinë dhe rritjen. Ristrukturimi pozitiv i bujqësisë mungon dhe nuk udhëhiqet prej instrumenteve politike, çka mund të pengojnë zhvillimin e ardhshëm të bujqësisë kroate.

Kjo analizë mund të shërbejë si një sfond i mirë për të gjithë ekspertët dhe vendimmarrësit që të njohin hendeqet e gjendjes bujqësore në kuadrin e BE-së dhe në kuadrine SEE-së. Krijimi i bazës së të dhënave APM zbuloi se ka mospërputhje midis të dhënave nga Ministria e Bujqësisë dhe të dhënave që ofron nga Agjencia Kroate e Pagesave, i cili është një argument i fortë për përditësimin e vazhdueshëm dhe kontrollin e dyfishtë të subvencioneve të paguara. Bazat e të dhënave të rregulluara në mënyrë të tillë mund të tregojnë një pasqyrë të qartë të strukturës së subvencioneve dhe të ndihmojnë për të përmirësuar komunikimin e të gjitha palëve të interesuara në kontekstin e analizës së ndikimit dhe procesin e vendosjes së prioriteteve.

Referenca

CBS. 2014. Central Bureau of Statistics. Various publications, Zagreb, http://www.dzs.hr

Croatia APM Database. 2014. Agricultural Policy Measures Database compiled for Croatia under the FAO/SWG project "Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession" (unpublished data).

Croatian Chamber of Economy. External trade data, CCE, Zagreb, http://www.hgk.hr

EUROSTAT Database. 2013. Statistics, Eurostat, Luxemburg, http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/themes

Franić, R. & Žimbrek, T. 2003. Premises for the inclusion of agriculture in the process of Croatian accession to the European Union. In: Croatian Accesion to the European Union; Economic and legal challenges (Katarina Ott, ed.). Institute of Public Finance and Fredrich Ebert Stifung, Zagreb, p. 159-179

Franić, R. 2006. Politika ruralnog razvoja – nova prilika za Hrvatsku/Rural development policy – new opportunity for Croatia. Agronomski glasnik 3(2006): 221-235.

Franić, R., Tratnik, M., Bašić, F. & Svržnjak, K. 2007. Sustainable allocation of land and capital resources: the case of wheat production in Croatia. Cereal Research Communication 35(2): 397-400

Franić, R., Mikuš, O. & Andabak, A. 2011. Optimistički pogled na ulazak u EU: poljoprivrednicima može biti bolje/Optimistic view on the entrance to the EU: things could be better to farmers. In: Proceedings of the 46th Croatian & 6th International Symposium on Agriculture (Pospišil, M., ed.). Opatija, February 14-18, p. 3-10.

Franić, R. & Mikuš, O. 2013. Transformations in Croatian Agriculture and Agricultural Policy: Challenges and Opportunities within the European Context. In: Agriculture in Mediterranean Europe: Betëeen Old and New Paradigms Ortiz-Miranda, D., Moragues-Faus, A., Arnalte-Alegre, E. (ed.)Emerald Group Publishing Limited, pp. 233-261

Mesić, Ž. 2014.Supply chain performance of traditional agri-food products – chain members perception. Doctoral thesis. Defended on 15th May 2014 at University of Zagreb, Faculty of Agriculture.

Mikuš, O., Mesić, Ž. & Cerjak, M. 2010. Review of Agriculture and Agricultural Policy in Croatia. In: Agriculture in the Western Balkan Countries, Volk, Tina (ed.), Halle (Saale): Leibniz-Institut fur Agrarentëicklung in Mittel- und Osteuropa, Vol 57 page 93-121.

Radinović, S. & Žutinić, Đ. 2007. Može li Hrvatska imati konkurentnu obiteljsku poljoprivredu? Prilog istraživanju agrarne structure/Can Croatia Have Competitive Family Farming? A contribution to Research of Agrarian Structure. Društvena istraživanja, 16(1-2): 175-197.

Rednak, M., Volk, T. & Erjavec, E. 2013. A tool for uniform classification and analyses of budgetary support to agriculture for the EU accession countries. *Agricultural Economics Review*, vol. 14, no. 1, p. 76-96.

Tratnik, M., Franić, R., Svržnjak, K. & Bašić, F. 2008. Land rents as criterion for regionalization – The case of wheat growing in Croatia. Land Use Policy, 26(1): 104-111.

UNDP. 2013. Fertile ground for development – Making the most of EU membership for Croatia's rural areas, Vinton, Louisa (ed.), Zagreb.

Aneksi B.III-1: Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave kryesore, 2005-2012, Kroacia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Sipërfaqa e prodhimit (1 000 ha)								
Total	557.2	570.1	558.6	562.5	562.7	529.4	529.4	586.1
- Grurë	146.3	176.0	175.0	156.5	180.4	168.5	149.8	186.9
- Misër	319.0	296.2	288.5	314.1	296.9	296.8	305.1	299.2
Farëra vajore	119.8	109.0	82.1	98.0	102.0	102.7	110.0	97.5
Panxhar sheqeri	29.0	32.0	34.3	22.0	23.1	23.8	21.7	23.5
Patate	19.0	17.0	17.4	15.0	14.0	11.0	10.9	10.2
Rrush (total)	29.7	30.8	32.5	33.7	34.0	33.0	32.0	29.0
Fruta (prodhim për treg)	25.0	26.8	27.8	28.2	28.9	28.7	28.3	:
Ullinj	12.4	13.4	14.3	15.0	15.3	17.0	17.2	18.1
Perime (prodhim për treg)	8.9	10.0	11.0	11.4	11.0	6.6	7.4	7.4
Duhan	5.1	4.9	6.0	5.9	6.1	4.1	5.9	6.0
Foragjere	93.4	100.0	104.9	118.7	122.0	120.7	120.9	122.8
Prodhimi (1 000 t)								
Total	3 038.8	3 034.6	2 534.2	3 725.5	3 441.8	2 925	2 821.4	2 686.5
- Grurë	601.7	804.6	812.3	858.3	936.1	681.0	782.5	999.7
- Misër	2 206.7	1 934.5	1 424.6	2 504.9	2 182.5	2 067.8	1 733.7	1 297.6
Farëra vajore	240.4	278.3	186.7	292.1	281.0	252.8	280.6	213.1
Panxhar sheqeri	1 337.8	1 559.7	1 582.6	1 269.5	1 217.0	1 249.2	1 168.0	919.2
Patate	273.4	274.5	296.3	255.6	270.3	178.6	167.5	151.3
Rrush (total)	181.0	179.4	198.0	185.3	206.4	207.7	204.4	187.6
Fruta (prodhim intensiv)	101.8	140.4	150.5	144.6	146.7	189.7	197.9	121.4
Ullinj	36.6	27.5	34.5	36.0	32.6	38.0	31.4	50.9
Perime (prodhim intensiv)	171.0	181.8	186.4	201.6	232.3	154.1	154.9	133.4
Duhan	10.3	10.9	12.6	12.9	13.3	8.5	10.6	11.8

Aneksi B.III-2: Numri i bagëtive (1 000 krerë), 2005-2012, Kroacia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Gjedhë	485	482	467	454	447	444	446	452
nga të cilat lopë qumështi	239	235	236	213	212	207	185	177
Derra	1 205	1 230	1 348	1 104	1 250	1 231	1 233	1 182
Dele dhe shi	903	783	738	727	695	705	709	751
Shpend	10 640	10 045	10 053	10 015	10 787	9 470	9 523	10 161
Koshere bletësh	167	255	314	310	304	308	328	:

Aneksi B.III-3: Çmimet bujqësore të prodhimit në fermë(EUR/t), 2005-2012, Kroacia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Grurë i zakonshëm	126.5	115.8	144.1	210.5	114.4	158.8	188.1	185.6
Misër	89.9	101.1	200.1	96.5	91.8	143.0	161.7	209.5
Luledielli	179.9	187.9	379.3	315.2	214.0	340.4	341.0	450.5
Soja	210.0	209.7	330.6	355.6	276.6	314.7	327.6	470.2
Panxhar sheqeri	34.0	33.7	32.0	32.8	34.9	29.6	39.8	39.3
Patate(kultura kryesore)	154.1	191.2	191.1	200.7	168.9	194.9	217.9	158.3
Speca (capsicum)	477.0	651.4	663.8	783.6	696.2	823.5	581.1	738.3
Domate	525.7	637.7	569.8	650.7	686.7	879.7	563.6	798.2
Viça (peshë e gjallë)	1 888.7	1 725.2	1 735.3	1 933.5	1 914.2	1 733.4	1 950.4	2 038.0
Derra(peshë e gjallë)	1 424.3	1 341.0	1 190.0	1 326.3	1 407.4	1 196.8	1 252.3	1 392.8
Qingja (peshë e gjallë)	4 032.6	4 715.6	4 562.1	4 774.2	4 498.6	3 910.1	4 167.2	4 376.5
Pula (të gjalla; Zgjedhja e parë)	1 088.2	1 081.6	1 004.1	1 045.7	995.9	993.7	1 015.6	1 017.6
Vezë (1 000 copë)	90.9	85.7	90.0	101.1	89.9	89.2	91.5	98.4
Qumësht lope	270.1	265.5	276.8	330.8	277.8	302.5	357.5	329.9

Burimi: CBS

Kapitulli B.IV

BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË KOSOVË*[34]

Iliriana Miftari[*], Halit Hoxhaj[**]

[34] Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozicionit mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe opinionin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

[*] Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Departamenti i Ekonomiksit Bujqësor.

[**] Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural.

1. Hyrje

Një objektiv afatgjatë i Qeverisë së Kosovës* është integrimi në BE. Në vitin 2010, Kosova* themeloi Ministrinë e Integrimit Evropian (MEI), ecila luan rol kyç në koordinimin dhe zbatimin e reformave për anëtarësimin në BE. Pasi Komisioni Evropian vlerësoi se Kosova* kishte arritur me sukses prioritetet afatshkurtra të identifikuara në studimin e Fizibilitetit të kryer në vitin 2012, në Qershor të vitit 2013, Këshilli i BE-së shpalli planet për të nisur negociatat mbi marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (SAA). SAA-ja paraqet marrëdhënien e parë të plotë kontraktuale midis Kosovës* dhe BE-së në procesin e integrimit.

Gjatë zbatimit të marrëveshjes, BE-ja dhe Kosova* do të krijojnë zonën e tregtisë së lirë dypalëshe për lëvizjen e lirë të të mirave, shërbimeve dhe kapitalit. Do të bëhen përpjekje për të përshtatur legjislacionin e vendit me atë të BE-së. Legjislacioni përmban rregulla për konkurrencën, prokurimin publik, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe kushtet e punës. Gjatë viteve të fundit Kosova* ka bërë progres të mirë në rrugën drejt integrimit në BE. Kosova* është përfituese e Instrumentit Evropian për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) dhe përfiton ndihmë nën komponentin I (Asistenca në Tranzicion dhe Themelimi i Institucioneve) dhe II (Bashkëpunimi ndërkufitar).

Objektivi i këtij studimi është të prezantojë situatën dhe zhvillimet e fundit të sektorit bujqësor në Kosovë* me fokus mbi politikën bujqësore dhe të nxjerrë rekomandime në kuadrin e procesit të integrimit në BE.

Analiza e sektorit të bujqësisë është bërë duke përdorur të dhëna statistikore zyrtare të publikuara nga Agjencia Kosovare e Statistikave (KAS), të dhënat statistikore të siguruara nga Departamenti i Analizës Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural (MAFRD). Për nevojat e analizës së politikave bujqësore është krijuar një databazë gjithëpërfshirëse e masave të politikave bujqësore (APM) duke përdorur një format të përbashkët APM (Rednak & Volk, 2010). Baza e të dhënave APM për Kosovën* mbulon periudhën 2007-2012.

Punimi është i strukturuar si vijon: pas hyrjes, prezantohet profili i bujqësisë dhe karakteristikat e saj kryesore të tilla si sipërfaqja e kultivuar, prodhimi, çmimet dhe tregtia ndërkombëtare. Në pjesën e tretë ofrohet një pasqyrë e konceptit dhe kuadrit të politikave bujqësore si edhe transfertavebuxhetore totale të ndara sipas grupeve të masave. Pjesa e fundit përmbledh konkluzionet mbi faktet kryesore të vëzhguara dhe jep disa rekomandime për reformat e politikave bujqësore të nevojshme për procesin e integrimit në BE.

2. Profili i Bujqësisë

2.1 Roli i bujqësisë në ekonomi

Kosova* është një vend i vogël me sipërfaqe totale prej 10 908 km^2, që është vetëm 0.2 përqind e sipërfaqes së BE-së. Sipas censusit të fundit të popullsisë të kryer në vitin 2012, popullsia e vendit është 1 815 606. Dendësia e popullsisë është 177.4 banorë për km^2. Shumica e popullsisë së Kosovës (61 përqind) jeton në zonat rurale. Në 2012, rritja reale e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ishte 2.5 përqind dhe PBB-ja për frymë 2 721 EUR. Norma e inflacionit në 2012 ishte 2.5 për qind. Edhe pse norma e papunësisë tregon një rënie të konsiderueshme në 2012, ajo mbetet një problem serioz për ekonominë e vendit. Norma e papunësisë në vitin 2012 ishte 30.9 përqind.

Bujqësia në Kosovë* ka qenë historikisht një sektor i rëndësishëm për ekonominë kombëtare. Përqindja mesatare e sektorëve të bujqësisë, pyjeve, gjuetisë dhe të peshkimit në vlerën e shtuar bruto (GVA) është rreth 17 përqind (2011). Sektori bujqësor i Kosovës* ofron gjithashtu një rrjetëtësigurisë sociale për një numër të madh të familjeve në zonat rurale.

Ekonomia rurale në Kosovë* karakterizohet akoma nga infrastruktura e dobët (edhe pse janë vënë re disa përmirësime në vitet e fundit), përdorimi i papërshtatshëm i tokës, konsolidim i kufizuar i tokës, dhe privatizimi jo i plotë i tokës me pronësi dhe të drejta përdorimi të paqarta (MAFRD, 2013a).

2.2 Burimet e tokës dhe struktura e fermës

Sipas statistikave të fundit, Kosova* ka një total prej 357 748 ha tokë bujqësore, nga e cila 253 563 ha (71 përqind) është tokë e punueshme, 7 071 ha (2 përqind) është tokë e mbjellë me kultura shumëvjeçare (pemëtoret dhe vreshtat) , dhe 97 114 ha (27 përqind) janë livadhe dhe kullota.

Në vitin 2012, 277 364 ha e tokës bujqësore përdorej nga 185 765 ferma, nga e cila 185 424 (99 përqind) janë ferma të vogla (MAFRD, 2013a). Sektori i bujqësisë ka strukturë jo të favorshme ferme, me një sipërfaqe mesatare të tokës bujqësore të përdorur për fermë prej 1.5 ha, e ndarë deri në shtatë parcela.

Tabela B.IV-1: Struktura e fermës sipas klasave të madhësisë, 2012, Kosova*

Madhësia e fermës	Numri i fermave	% e fermave	Sipërfaqja (ha)	% esipërfaqes
0.01 – 0.5 ha	45 818	24.7	13 300	4.8
0.51 – 1.0 ha	51 665	27.8	39 385	14.2
1.01 - 1.5 ha	35 589	19.2	43 772	15.8
1.51 - 2.0 ha	15 719	8.5	27 830	10.0
2.01 – 3.0 ha	19 995	10.8	49 340	17.8
3.01 – 4.0 ha	5 777	3.1	20 009	7.2
4.01 – 5.0 ha	3 748	2.0	16 646	6.0
5.01 – 6.0 ha	2 317	1.2	12 622	4.6
6.01 – 8.0 ha	2 582	1.4	17 847	6.4
8.01 – 10 ha	1 007	0.5	8 972	3.2
> 10 ha	1 547	0.8	27 641	10.0
Totali	**185 765**	**100.0**	**277 364**	**100.0**

Burimi: MAFRD, 2013a

Një fermë familjare mesatare kultivon shtatë lloje të ndryshme kulturash bujqësore. Diversifikimi i kulturave është një strategji e zakonshme e përdorur nga fermat familjare për të minimizuar risqet që lidhen me dështimin e kulturave, duke stabilizuar të ardhurat e familjes për subsistencë.

2.3 Prodhimi bujqësor

Në përgjithësi, në periudhën 2005-2012 prodhimi total i bujqësisë ishte relativisht i qëndrueshëm, me një vlerë mesatare prej 576 milionë EUR. Kontributi i prodhimit bimor ndaj vlerës totale të prodhimit bujqësor ishte më i lartë (mesatarisht 54 përqind) krahasuar me prodhimin blegtoral (46 përqind).

Kulturat më të rëndësishme në Kosovë* janë drithërat, kryesisht grurë dhe misër (Aneksi B.IV-1). Në 2012, drithërat u kultivuan në mbi 137 214 ha, nga të cilat 75 përqind i përkisnin grurit dhe 23 përqind misrit. Një sipërfaqe e konsiderueshme bujqësore kultivohet edhe me perime (8 405 ha). Perimet më të rëndësishme të kultivuara janë domatja, speci, kastraveci, shalqini, kungulli, lakra, dhe qepa. Në 2012, sipërfaqja totale me fruta ishte 3 852 ha dhe frutat më të rëndësishme në aspektin e sipërfaqes ishin mollët, kumbullat, vishnjet, luleshtrydhet, dhe dardhat. Rrushi prodhohet në një sipërfaqe 3 219 ha, patatet 3 198 ha dhe fasulet 2 954 ha.

Një objektiv i politikve është rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së prodhimit bujqësor afatgjatë në Kosovë*. Megjithatë, rendimentet mesatare mbeten të ulëta në krahasim me BE-në (shikoniKapitullin A.II).

Për sa i përket prodhimit blegtoral, gjedhi, si dhe delet dhe dhitë janë nën-sektorët më të rëndësishëm (Aneksi B.IV-2). Krahasuar me bagëtitë e tjera, numri total i deleve dhe dhive tregoi një rritje të konsiderueshme në periudhën 2006-2012. Sektori i rritjes së shpendëve është karakterizuar nga njësi prodhuese të vogla dhe të mesme, të orientuara kryesisht tek prodhimi i vezëve, ndërsa prodhimi i mishit të pulës është në fazë konsolidimi. Duke marrë parasysh kushtet e përshtatshme mjedisore, mjalti dhe produkte të tjera të bletarisë konsiderohen me potencial të mirë për prodhim dhe eksport.

2.4 Çmimet bujqësore

Në përgjithësi, çmimet e prodhimeve bujqësore treguan një rritje të konsiderueshme por me luhatje mjaft të lartë gjatë periudhës 2005-2012. Në krahasim me produktet bujqësore, çmimet për produktet blegtorale janë rritur në mënyrë më të rregullt.

Në të njëjtën periudhë, u rritën gjithashtu edhe çmimet e inputeve bujqësore, me një normë rritjeje më të lartë se rritja e çmimeve të produkteve bujqësore.

Tabela B.IV-2: Indekset e çmimeve të inputeve dhe produkteve bujqësore - nominale, 2005-2012 (2005=100), Kosova*

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Çmimet e produkteve bujqësore	100.0	107.0	118.1	124.6	112.6	109.2	114.5	126.1
- Produktet bujqësore	100.0	109.5	125.8	128.9	112.3	108.3	112.6	125.5
- Produkte blegtorale dhe shtazore	100.0	101.7	102.4	115.6	113.3	111.1	118.5	127.3
Çmimet e inputeve bujqësore	100.0	102.2	111.1	137.3	125.4	120.0	134.5	141.9

Burimi: KAS

Mesatarisht, çmimet e prodhimit bujqësor janë shumë më të larta në Kosovë* se në BE (shikoni AneksinB.IV-2 dhe Kapitullin A.II). Kjo tregon që Kosova* është akoma duke u përballur me konkurrueshmërinë e dobët në lidhje me çmimet.

2.5 Tregtia bujqësore

Në korrik të vitit 2007 Kosova* u bë anëtare e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA), e cila bazohet në konceptin e tregtisë së lirë midis vendeve që synojnë të anëtarësohen në BE. Për vite me radhë Kosova* është përballur me bilanc negativ të tregtisë agro-ushqimore. Tregtia është e karakterizuar nga importet dhe nivel shumë i ulët i eksporteve duke rezultuar në një defiçit të lartë tregtar, i cili është akoma në rritje. Kontributi i eksporteve agro-ushqimore në totalin e eksporteve të të mirave ka rënë vazhdimisht gjatë periudhës 2005-2012 dhe arriti 7.5 përqind në vitin 2012. Kontributi i importeve agro-ushqimore në importet totale të të mirave arriti në 22.8 përqind në vitin 2012, çka është dukshëm më i lartë se kontributi i eksporteve. Tregtia e lirë ka shkaktuar thellim të defiçitit tregtar veçanërisht për produktet agroushqimore.

Figura B.IV-1: Tregtia e produkteve bujqësore dhe ushqimore (milionë EUR), 2005-2012, Kosova*

Burimi: MAFRD

Vlera e importeve të produkteve agro-ushqimore në 2012 arriti në 572.7 milionë EUR dhe vlera e eksporteve në 20.6 milionë EUR. Rreth 50 përqind e vlerës së importeve të produkteve agro-ushqimore përbëhet nga duhani (CT 24), pijet, pijet alkoolike dhe uthulla (CT 22), mish dhe të brendshme të ngrënshme të mishit (CT 2), preparate drithërash (CT 19) dhe drithëra (CT 10) dhe produkte bulmetore (CT 4). Grupet më të rëndësishme të eksporteve të produkteve agro-ushqimore janë pijet, pijet alkoolike dhe uthull (CT 22), produktet e industrisë bluajtëse (CT 11), perime të ngrënshme (CT 7) dhe preparate perimesh, fruta dhe arra (CT 20), të cilat së bashku përbëjnë pothuajse 80 përqind të totalit të eksporteve agro-ushqimore.

Tabela B.IV-3: Grupmallrat agroushqimore kryesore të importit/eksportit, 2012, Kosova*

Importet			Eksportet		
Grupi i mallrave	**Milionë EUR**	**Përqindja**	**Grupi i mallrave**	**Milionë EUR**	**Përqindja**
Duhan	59.5	10.3%	Pije, pije alkoolike dhe uthull	7.1	34.4%
Pije, pije alkoolike dhe uthull	57.5	10.0%	produktet e industrisë bluajtëse, malt, niseshtete	5.4	26.3%
Mish dhe të brëndshme të ngrënshme të mishit	52.2	9.1%	Perime të ngrënshme, bimë, rrënjët, zhardhokët	1.8	8.8%
Preparate drithërash	44.9	7.8%	Preparate perimesh, frutash ose arrash	1.7	8.5%
Drithëra	38.7	6.8%			
Produkte bulmetore, vezë, mjaltë	37.7	6.6%			

Burimi: KAS

Në vitin 2012, partnerët kryesorëtë eksportit për Kosovën* nga BE-ja ishin Gjermania, Italia dhe Sllovenia. Nga vendet e Evropës juglindore (SEE), Kosova* eksporton kryesisht produkte agro-ushqimore në Shqipëri dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në një masë më të vogël edhe në Serbi dhe Kroaci. Në lidhje me importet e produkteve agro-ushqimore nga BE, përsëri Gjermania, Sllovenia, Italia dhe Bullgaria janë partnerët kryesorë, që përbëjnë më shumë se 60 përqind të të gjitha importeve agro-ushqimore. Prej vendeve të Evropës Juglindore, Kosova* importon produkte agro-ushqimore kryesisht nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Figura B.IV-2: Struktura gjeografike e eksporteve dhe importeve agroushqimore, 2012, Kosova*



Burimi: KAS

3. Situata e përgjithshme e politikave bujqësore

3.1 Koncepti dhe kuadri i politikës bujqësore të vendit

Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural (MAFRD) është autoriteti përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit bujqësor në nivel kombëtar. Dokumenti i parë strategjik i hartuar për bujqësinë në Kosovë* ishte Libri i Gjelbër me titull "Zhvillimi i Qëndrueshëm Bujqësor dhe Rural në Kosovë*", i cili u botua në vitin 2003 dhe përbëhej nga një strategji afatmesme për zhvillimin e sektorit dhe politikën bujqësore. Për të përcaktuar kuadrin ligjor për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në vitin 2009, Kuvendi i Republikës së Kosovës* miratoi Ligjin për zhvillim bujqësor dhe rural. Ky ligj përcakton, objektivat, masat dhe programet për politikën e zhvillimit bujqësor dhe rural.

Programi i parë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (ARDP) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës* në vitin 2007 për periudhën 2007-2013 e cila më vonë u përditësua për periudhën 2009-2013. Duke marrë parasysh shtrirjen e zgjeruar të ARDP në drejtim të përfshirjes së pagesave direkte dhe ndjekes së objektivave komplekse në sektorin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe rural, MAFRD mbështetur nga një projekt binjakëzimi realizoi përditësimin e dytë të ARDP për periudhën 2010-2013. Në përgatitjen e këtij dokumenti të politikës ishin të përfshirë shumë aktorë kryesorë (autoriteti kombëtar kompetent i MAFRD, partnerë ekonomikë/socialë lokalë, komunat, bizneset, shoqëria civile, Komisioni Evropian, donatorët).

Vizioni për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Kosovë* është "sigurimi i një kontributi të balancuar në mirëqenien ekonomike, mjedisore, sociale dhe kulturore të zonave rurale, dhe Kosovës* në tërësi, përmes partneritetit efektiv dhe fitimprurës midis sektorit privat, qeverisë qendrore/lokale dhe komuniteteve lokale brenda kontekstit evropian" (MAFRD, 2010). Vizioni i deklaruar i ARDP 2007-2013 ishte vendosur në objektivat kryesore të mëposhtme:

- Të ardhura shtesë për fermerët dhe banorët në zonat rurale, duke çuar në përmirësimin e standardeve të jetesës dhe kushteve të punës në zonat rurale;
- Konkurrueshmëri dhe efikasitetipërmirësuar iprodhimit bujqësor primar, në mënyrë që të arrihet zëvendësimi i importeve dhe të përfitohet nga tregjet e eksportit;
- Përpunim dhe marketing i përmirësuar i produkteve bujqësore dhe pyjore, përmes rritjes së efikasitetitdhe konkurrueshmërisë;
- Përmirësimi i standardeve të higjienës në fermë/fabrikë;
- Zhvillim rural i qëndrueshëm dhe cilësi e përmirësuar e jetesës (përfshirë infrastrukturën) nëpërmjet promovimit të bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera ekonomike që janë në harmoni me mjedisin;
- Krijimi i mundësive të punësimit në zonat rurale, veçanërisht përmes diversifikimit rural;

- Përafrimi i bujqësisë së Kosovës* me atë të BE-së (MAFRD, 2010).

Për t'i bërë këto objektiva të arritshme, janë identifikuar masa specifike në të cilat u përqendruan burimet politike, financiare, ligjore, administrative dhe humane. Masat e identifikuara të politikave që synojnë objektiva të ARDP janë masa të mbështetjes direkte të prodhuesve dhe masat e mbështetjes së zhvillimit rural. Shtylla e parë mbulon pagesat direkte (për sektorin e të imtave, sektorin e qumështit, sektorin e prodhimit bimor, pagesa për bletarinë) dhe mbështetje për karburant për korrje. Shtylla e dytë përbëhet nga tetë masat e zhvillimit rural të grupuara në katër akse të paraqitura si më poshtë.

Tabela B.IV-4: Masat e zhvillimit rural në Kosovë* në periudhën 2007-2013

Akset	**Masa**
I. Konkurrueshmëria	M1. Zhvillimi i trajnimeve profesionale për të plotësuar nevojat rurale M2. Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural M3. Menaxhimi i burimeve ujore për bujqësinë M4. Përmirësimi i përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore
II. Përdorim mjedisor dhe i përmirësuar i tokës	M5. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore
III. Diversifikimi rural dhe cilësia e jetës në zonat rurale	M6. Diversifikimi i fermave dhe aktivitete alternative në zonat rurale M7. Përmirësimi i infrastrukturës rurale dhe mirëmbajtja e trashëgimisë rurale
IV. Strategjitë e zhvillimit lokal me fokus komunitetin	M8:Mbështetje për strategjitë zhvillimore të komuniteteve lokale

Në përputhje me Ligjin për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, MAFRD ka themeluar institucionepërkatëseqëjanë Komisioni i Monitorimit, Autoriteti Menaxhues si edhe Njësia e Pagesave përgjegjëse për zbatimin e ARDP 2007-2013. Mbështetur nga projekti i binjakëzimit, MAFRD përgatiti manualet mbi rregullat dhe procedurat mbi strukturën funksionale të Komisionit të Monitorimit dhe Autoriteti Menaxhues, si dhe një manual për monitorim dhe vlerësim, grafikun e organizimit dhe të strategjisë për zhvillimin e mëtejshëm të Njësisë së Pagesave. Në vitin 2012, Njësia e Pagesave u quajt Departamenti i Pagesave i cili tashmë është transformuar në Agjencinë e Pagesave në përputhje të plotë me rregullat dhe procedurat e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD). Detyra kryesore e Departamentit të Pagesave është ekzekutimi i skemave mbështetëse të hartuara nga Autoriteti Menaxhues dhe të financuara nga Qeveria e Kosovës, fondet dypalëshe dhe shumëpalëshe, BE dhe donatorë të tjerë. Dokumenti kryesor i zbatimit të masave të përcaktuara në ARDP 2007-2013 ishte programi vjetor kombëtar për zhvillim bujqësor dhe rural. Programi u mbështet nga një fushatë e gjerë informuese, që synonte rritjen e ndërgjegjësimit të fermerëve dhe nxitjen e masave në zbatim e sipër.

Dokumentet kryesore të zbatimit dhe monitorimit të ARDP janë raporti vjetor mbi Rrjetin e të Dhënave Kontabile të Fermave (FADN), dhe raportet vjetore të monitorimit dhe zbatimit të përgatitura nga MAFRD përkatësisht nga Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim dhe Agjencia e Pagesave. Në shtator 2012, MAFRD në bashkëpunim me Kastner International dhe Institutin Federal Austriak të Ekonomiksit Bujqësor në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së, hartoi një Vlerësim Afatmesëm - (MTE) për zbatimin e ARDP-së. MTE vlerëson të gjitha masat e zbatuara të ARDP gjatë periudhës 2007-2011. MAFRD, mbështetur nga projekti i binjakëzimit të BE-së, bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e nxjerra nga MTE si edhe rezultatet e nxjerra nga diskutimet intensive me partnerët socio-ekonomikë, grupet lokale të veprimit, prodhuesitbujqësorë dhe organizata të tjera, përgatiti draft-strategjinë e parë për ARDP 2014 -2020. Më 23 Maj 2013 draft strategjia iu paraqit Komisionit Drejtues dhe më vonë (në datën 3 Qershor të vitit 2013) të gjithë partnerëve të interesuar. Konferencat që u organizuan ofruan mundësi të vlefshme për të

angazhuar një grup të madh të aktorëve dhe grupeve të interesit në diskutimet dhe kontributin ndaj debatit të politikave bujqësore dhe planifikimin e strategjisë për ARDP 2014-2020.

Politika e Zhvillimit Rural të Kosovës* 2014-2020 do të orientohet sipas drejtimeve të reja strategjike të politikavetë Zhvillimit Rural të BE-së, duke marrë parasysh përvojat e fituara gjatë zbatimit të ARDP 2007-2013, si dhe Studimin Strategjik Kombëtar të Kosovës* (Shtator 2013). Objektivat e deklaruara të ARDP 2014-2020 janë bazuar në objektivat e politikave strategjike të IPA II, duke u fokusuar dhe duke reflektuar gjithashtu objektivat strategjike të vendit për zhvillimin dhe nevojat specifike të sektorit agro-ushqimor, pylltarisë dhe zonave rurale të Kosovës*.

Programi i Zhvillimit Rural të Kosovës* 2014-2020 përqendrohet në gjashtë prioritetet e mëposhtme:

1. Nxitja e transferimittënjohurive në inovacion në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale;
2. Rritja e konkurrencës në të gjitha llojet e bujqësisë dhe rritja e qëndrueshmërisë së fermës;
3. Nxitja e organizimit të zinxhirit ushqimor dhe menaxhimit të riskut në bujqësi;
4. Rivendosja, ruajtja dhe rritja e ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pyjet;
5. Promovimi i efikasitetit të burimeve dhe mbështetja e zhvendosjes drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe të përshtatshme ndaj klimës në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe pyjeve;
6. Nxitja e përfshirjes sociale, ulja e varfërisëdhe zhvillimi ekonomik në zonat rurale (MAFRD, 2013b).

Objektivat e përgjithshme të ARDP 2014-2020 ishin përcaktuar si vijon: "(i) zhvillimi i një sektori agro-ushqimor konkurrues dhe të bazuar në inovacion me një prodhim dhe produktivitet të rritur i aftë për të prodhuar produkte të cilësisë së lartë dhe që plotësojë standartet e tregut të BE-së, duke kontribuar në disponueshmërinë dhe sigurinë e furnizimit ushqimor, ndjekjen e qëllimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore duke nxitur punësimin dhe zhvillimin e kapitalit human dhe fizik; (ii) mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisit në zonat rurale, duke u fokusuar në sfidat e ndryshimeve klimatike duke siguruar përdorim të qëndrueshëm dhe efikas të tokës dhe menaxhimit të pyjeve dhe duke zbatuar metodat e prodhimit bujqësor që mbrojnë mjedisin; (iii) përmirësimi i cilësisë së jetës dhe diversifikimi i mundësive të punësimit në zonat rurale duke nxitur punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e balancuar territorial të këtyre zonave (MAFRD, 2013b).

Objektivat strategjike të ARDP 2014-2020 do të arrihen nëpërmjet zbatimit të masave dheprioriteteve të Zhvillimit Rural në kuadër të IPA II dhe masa të mbështetjes kombëtare me fokus të ardhurat, përdorimin e tokës dhe infrastrukturën e ujitjes të financuar ngabuxhetikombëtar dhe iniciativat edonatorëve. Tabela e mëposhtme paraqet masat e zgjedhura të cilat do të zbatohen në Kosovë*, të kategorizuara në katër prioritete të EU IPA II për zhvillimin rural. Nga nëntë masat e zgjedhura, më shumë se 60 përqind e burimeve të ARDP do të shpërndahen për masat e prioritetit të parë (Përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së fermës). Përqendrimi i buxhetit në këtë prioritet u bazua në analizën e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT) të sektorëve të bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit të Kosovës*.

Tabela B.IV-5: Masat e zgjedhura të zhvillimit rural për t'u zbatuar në Kosovë* në periudhën 2014-2020

Prioritetet	Masat
Nxitja e qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së fermës	Investime në asete fizike të fermave bujqësore Investime në asete fizike të përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore dhe të peshkimit
Rivendosja, ruajta, përmirësimi i ekosistemeve	Masa agro-mjedisore dhe promovimi i bujqësisë organike Mbarështimi dhe mbrojtja e pyjeve
Nxitja e përfshirjes sociale dhe ekonomike	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimin e biznesit Përgatitja dhe zbatimi i Strategjive të zhvillimit lokal -LEADER
Transferimi i njohurive dhe risive	Përmirësimi i trajnimeve Ofrimi i Shërbimeve këshillimore Ofrimi i Asistencës teknike

3.2 Transfertat buxhetore të politikës bujqësore

Nga viti 2008 deri në vitin 2012, mbështetja buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural u rrit ndjeshëm. Në vitin 2012 transfertat buxhetore totale për bujqësinë arritën në 22.7 milionë EUR, nga 5.8 milionë EUR në vitin 2008. Kjo rritje ishte rezultat i fondeve më të larta si për masat e mbështetjes direkte të prodhuesve ashtu edhe për masat e mbështetjes së ndryshimeve strukturore dhe zhvillimin rural, ndërsa fondet për financimin e shërbimeve të përgjithshme për bujqësinë nuk kanë ndryshuar shumë.

Figura B.IV-3: Shpenzime buxhetore për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale(milionë EUR), 2008-2012, Kosova*



Burimi: Databaza APM e Kosovës*

Masat e mbështetjes direkte të prodhuesve

Qëllimi i masave të mbështetjes direkte brenda ARDP ishte rritja e prodhimit bujqësor, rritja e të ardhurave të fermerëve dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit të bujqësisë në krahasim me sektorët e tjerë dhe me importet. Mbështetja direkte eprodhuesve është zbatuar në formën e subvencioneve të karburantit për korrje, si dhe pagesa direktepër sipërfaqe dhe krerë bagëti për sektorë të veçantë blegtoralëdhe bujqësorë. Shpenzimet buxhetore totale për këtë shtyllë të politikave u rritën nga më pak se 500 000 EUR në 2008 në rreth 8.7 milionë EUR në 2012.

Tabela B.IV-6: Transfertat buxhetore për pagesa direkte dhe subvencionet e inputeve (në EUR), 2008-2012, Kosovë*

	2008	2009	2010	2011	2012

Pagesa direkte për prodhuesit					
Pagesa për krerë lopë qumështi	-	562 962	1 108 380	793 872	2 104 800
Pagesa për krerë dele dhe dhi	-	1 404 800	1 276 340	619 035	1 327 450
Pagesa për sipërfaqe të mbjellë me grurë	-	2 102 731	-	3 206 956	3 795 094
Pagesa për sipërfaqe të mbjellë me misër	-	-	-	-	575 459
Pagesa për sipërfaqe me farë gruri	-	-	-	-	25 020
Pagesa për sipërfaqe me bimë vajore	-	-	-	-	73 711
Pagesa për koshere bletësh	-	-	-	-	358 610
Pagesa për sipërfaqe të mbjellë me vreshta për verë	-	-	703 056	698 712	-
Subvencioni për inputë variable					
Subvencionim i karburantit për korrje	476 470	431 967	411 912	388 820	486 522
Totali i mbështetjes direkte të prodhuesve,	**476 470**	**4 502 460**	**3 499 688**	**5 707 395**	**8 746 666**

Burimi: Databaza APM e Kosovës*

Mbështetja direkte e prodhuesve filloi në vitin 2008 me subvencionimin e karburantit për korrje. Pagesat u janë transferuar pronarëve të autokombajnave që kanë aplikuar për mbështetje. Mbështetja ishte e kufizuar duke pasur parasysh sipërfaqen e mbjellë me grurë dhe numrin e autokombajnave në dispozicion në vitin përkatës. Mesatarisht rreth 500 000 EUR u ofruan për këtë masë. Me futjen e masave të tjera të mbështetjes direkte, pjesa e fondeve për subvencionimin e karburantit ra nga 100 përqind të totalit të shpenzimeve për këtë shtyllë të politikës në vitin 2008 në 5.6 përqind në 2012.

Pagesat direkte për lopë qumështi filluan në vitin 2009 dhe janë dhënë për fermerët që zotëronin lopë qumështi të matrikulluara dhe të regjistruara në sistemin I&R. Kriteri minimal i përfitimit ishte zotërimi i një numriminimal prej i pesë lopësh për fermë. Në vitin 2012 buxheti i pagesave për lopë qumështi ishte tre herë më i lartë se në vitin e parë2009.

Pagesat direkte për të imtat (dele dhe dhi) janë ofruar vetëm për pronarët e deleve dhe dhive të matrikulluara dhe të regjistruara në sistemin I&R. Kriteri minimal i përfitimit ishte 30 dele ose 20 dhi për fermë. Përfituesit e pagesave direkte për grurë dhe misër ishin fermerë që kishin mbjellë të paktën 2 ha grurë për fermë dhe/ose 1 ha misër për fermë. Pagesat për sipërfaqe me grurë u janë dhënë fermerëve të njohur nga inspektorët e MAFRD, dhe që kanë mbjellje të paktën 10 ha për fermë. Kriteri minimal i përfitimit të pagesave për bimë vajore (luledielli, kolzë dhe sojë) ishte 0.5 ha për fermë. Qëllimi i mbështetjes për kosheret e bletëve ishte përmirësimi i cilësisë së mjaltit të prodhuar dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve për prodhimin e mjaltit. Kriteri minimal i përfitimit ishte 10 koshere për fermë.

Masat e zhvillimit strukturor dhe rural

Në vitin 2012, shpenzimet buxhetore për zbatimin e masave të zhvillimit strukturor dhe rural arritënnë 11.2 milionë EUR, nga 2.2 milionë EUR në vitin 2008. Në vitet e fundit (2011-2012), ky grup i masave ka përfaqësuar rreth 50 përqind të mbështetjes buxhetore totale për bujqësinë.

Në periudhën 2008-2012, nga buxheti total i shpenzuar për masat e zhvillimit strukturor dhe rural, rreth 99 përqind synonin rritjen e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe vetëm rreth 1 përqind për mbështetjen e ekonomisë dhe popullsisë rurale. Në vitet e para të kësaj periudhe (2008-2010) mesatarisht 87 përqind e buxhetit vjetor përbëhej nga shpenzime për rritjen e konkurrueshmërisë dhe mbështetjen e ristrukturimit të fermës (ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin bujqësor & rural, konsolidimin e tokës, menaxhimi i pasurive ujore për bujqësinë, mbështetje të tjera në fermë) dhe rreth 13 përqind për mbështetjen e pyjeve (pyllëzimi dhe menaxhimi i zonave të pyllëzuara nën masën për përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore). Struktura ndryshoi dukshëm në vitet 2011 dhe 2012, kur mesatarisht 53.5 përqind e këtyre fondeve u shpenzuan për mbështetjen e ristrukturimit të sektorit agro-ushqimor (përmirësimin e përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore, ngritjen e qendrave grumbulluese), 43.4 përqind për ristrukturimin e fermës, ndërsa vetëm 3.1 përqind u ofrua për sektorin e pyjeve.

Të gjitha fondet e shpërndara për mbështetjen e ekonomisë dhe popullsisë rurale janë shpenzuar për ndërtimin e kapaciteteve lokale (LEADER). Ndërkohë diversifikimi i fermave dhe aktivitetet alternative në zonat rurale (Masa 6) dhe përmirësimi i infrastrukturës rurale dhe mirëmbajtja e trashëgimisë rurale (Masa 7), nuk janë zbatuar në ARDP 2007-2013 për shkak të kufizimeve buxhetore.

Zbatimi fillestar i masës për ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin agro-rural (M2) filloi në vitin 2007 me nën-masë për qumështin. Kjo nën-masë mbështet ndërtimin e fermave, pajisjeve të mjeljes dhe ftohjes, ndërtimin dhe rinovimin e dhomave frigoriferike për ruajtjen e qumështit, pajisjet për përgatitjene ushqimit dhe racioneve të kafshëve, pajisjet për përgatitjen e foragjereve, traktorë shtesë (> 30 HP) dhe përmirësimin e infrastrukturës. Përfituesit potencialë ishin fermerë me 15 krerë lopë qumështi.

Në vitin 2008MAFRD filloi implementimin e nën-masave mbi vezët, perimet dhe vreshtat. Të gjithë fermerët me më shumë se 3 000 pula u mbështetën me 50 përqind të vlerës së investimit. Qëllimi i këtyre investimeve ishte përmirësimi i cilësisë së prodhimit të vezëve, përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve dhe gjithashtu përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë në tregjet e brendshme dhe të jashtme.

Tabela B.IV-7: Transfertat buxhetore totale për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor dhe mbështetja e zhvillimit rural (në EUR), 2008-2012, Kosova*

	2008	2009	2010	2011	2012
Mbështetje e investimeve në fermë					
Ristrikturimi i potencialeve fizike (M2)	1 380 040	739 350	2 162 099	1 754 853	4 847 454
Nën-masa 2 për qumështin	379 200	-	475 687	572 015	1 284 090
Nën-masa 2 për vezët	20 190	-	-	124 819	106 251
Nën-masa 2 për perimet	181 740	111 000	402 352	398 522	1 426 021
Nën-masa 2 për vreshtat	4 814	460 000	363 158	172 206	119 411
Nën-masa 2 për frutat	-	-	371 162	487 291	1 011 681
Konsolidimi i tokës bujqësore	762 160	-	549 740	-	-
Menaxhimi i burimeve ujore për bujqësinë M3)	483 005	1 544 286	1 300 368	1 270 267	475 948
Mbështetje të tjera në fermë	31 936	172.834	432 058	343 311	829 893
Mbështetja e përpunimitdhe marketingut të ushqimit					
Përmirësimi i përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore (M4)	-	-	55 295	4 984 580	4 498 625
Krijimi i qendrave të grumbullimit	-	-	-	-	900 000
Mbështetja e pylltarisë					
Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore (M5)	320 598	487 595	262 324	161 570	483 908
Mbështetje e ekonomisë dhe popullsisë rurale					
Mbështetje për strategjitë e zhvillimit të komunitetit lokal (M8)	-	40 295	60 287	100 663	90 979
Totali i Mbështetjes për zhvillimin strukturor dhe rural,	**2 183 643**	**2 816 010**	**4 272 431**	**8 615 244**	**11 226 807**

Burimi: Databaza APM e Kosovës*

Përfituesit potencialë të nën-masës për perime ishin të gjithë fermerët të cilët kishin planifikuar për të ndërtuar serra të reja nga 500 m^2 në 1 000 m^2. Ata u mbështetën me 50 përqind të vlerës së investimit. Kjo nën-masë mbuloi ndërtimin e serave të reja, zgjerimin e serave ekzistuese dhe modernizimin e pajisjeve/makinerive dhe infrastrukturës shoqëruese. Qëllimi ishte përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së prodhimit të perimeve.

Nën-masa për vreshtat kishte për qëllim përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së prodhimit të rrushit të tavolinës, si dhe zgjerimin e zonave të kultivuara me rrush tavoline. Të gjithë fermerët që kishin

mbjellë 0.5-2.0 ha rrush tavoline u mbështetën me 50 përqind të vlerës së investimit. Kjo nën-masë mbuloi investimet për krijimin e vreshtave të reja me rrush tavoline, modernizimin e pajisjeve dhe infrastrukturave të tjera të tilla si shtylla dhe gardhe mbajtës, pajisje spërkatjeje, sprucator të lëvizshëm, frezë, makineri për shpërndarjen e plehrave dhe sisteme të mbrojtjes nga breshëri.

Në vitin 2010, MAFRD-ja filloi zbatimin e nën-masës për frutat. Përfituesit potencialë të nën-masës për frutat ishin të gjithë fermerët me 0.5-2.0 ha molle dhe 0.1-0.2 ha fruta të tjera, pa përfshirë këtu frutat e thata. Qëllimi i kësaj nën-mase ishte rritja e prodhimit dhe cilësisë vendase e këtyre produkteve. Përfituesit janë mbështetur me 50 përqind të vlerës së investimit. Kjo nën-masë mbuloi investimet në ngritjen e pemëtoreve të reja, zëvendësimin e pemëtoreve të vjetra, modernizimi i pajisjeve dhe infrastrukturave të tjera të tilla si rrjetat mbrojtëse, sistemet e ujitjes, shtyllat dhe gardhet mbajtës. Pjesa e fondeve për këtë nën-masë në 2012 ishte 20.9 përqind e totalit të fondeve të akorduara për masën 2.

Në vitet 2008 dhe 2010 nëpërmjet projekteve të investimeve kapitale u zbatua masa për konsolidimin e tokës bujqësore. Qëllimi i kësaj mase ishte përmirësimi i strukturës bujqësore, ndërtimi i rrugëve/rrugicave bujqësore dhe mbrojtja e tokës me nivele të larta të biodiversitetit. Kjo masë nuk është zbatuar në vitet 2011 dhe 2012.

Zbatimi i masës që mbështet menaxhimin e pasurive ujore për bujqësinë (Masa 3) filloi në vitin 2007 dhe u zbatua gjatë gjithë periudhës. Qëllimi i kësaj mase ishte rritja e produktivitetit dhe cilësisë së produkteve bujqësore përmes rehabilitimit të sistemeve ekzistuese të ujitjes, si edhe ndërtimi i kapaciteteve të reja. Shuma e buxhetit të shpenzuar për këtë masë në vitin 2012 ishte 62.5 përqind më e ulët krahasuar me vitin e mëparshëm.

Zbatimi i mbështetjes për përmirësimin e përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore (Masa 4) filloi në vitin 2010. Nëpërmjet kësaj maseu mbështet ndërtimi iqendrave për grumbullimin, paketimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore. Kjo masë mbuloi nënsektorët e qumështit, mishit, drithërave, nënsektorin e frutave dhe perimeve, ujit të ambalazhuar, verës dhe birrës. Mbështetja ka për qëllim të përmirësojë përdorimin e produkteve bujqësore përmes përmirësimit të prodhimit me vlerë të shtuar më të lartë, krijimin e qendrave të grumbullimit, dhe futjen e HACCP në lidhje me sigurinë ushqimore, dhe mbështetje të linjës së prodhimit dhe objekteve të tjera për të përmbushur kërkesat e BE-së. Masa është financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga MAFRD dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës. Projektet e realizuara në kuadër të kësaj mase janë përzgjedhur nga një procedurë që ndjek Udhëzimet Praktike për Procedurat Kontraktuale për ndihmë të jashtme të BE-së e cila garanton pranimin e aplikimeve më të mira.

Që nga viti 2007, fondet janë shpërndarë rregullisht për përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore (Masa 5). Kjo masë u fokusua kryesisht në pyllëzimin e tokave pyjore të zhveshura, si edhe monitorimin dhe ruajtjen e zonave të pyllëzuara. Sipas raportit të MTE, duhet të adresohen në mënyrë rigoroze problemet që lidhen me të drejtat e pronësisë dhe kujdesjen për fidanët pas mbjelljes për të siguruar që paratë publike që po shpenzohen për këtë masë të japin rezultatin e duhur.

Në vitin 2009, MAFRD filloi të mbështesë projekte publike dhe private të cilat kishin ndikim në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë rurale. Përfitues ishin Grupet Lokale të Veprimit (LAG) të regjistruara në Kosovë* sipas parimeve të LEADER. Në total 30 LAG-e janë themeluar, por vetëm 21 prej LAG-ve aplikuan për projekte dhe vetëm 39 projekte u mbështetën. Menaxherët e LAG-eve ishin përgjegjës për aplikimin dhe zbatimin e projekteve që përfshijnë komunitetin rural.

Masa të përgjithshme në lidhje me bujqësinë

Mbështetja për shërbimet e përgjithshme në lidhje me bujqësinë e dhënë përmes buxhetit të MAFRD ka qenë relativisht e qëndrueshmegjatë gjithë periudhës 2008-2012 menjë vlerë mesatare rreth 3 milionë EUR. Më shumë se 95 përqind e buxhetit të shpenzuar për shërbime të

përgjithshme përbëhejnga shpenzime për kategorinë e sigurisë ushqimore (shërbimeve veterinare dhe fito-sanitare) dhe vetëm një përqindje e vogël e fondeve është shpenzuar për zhvillimin e trajnimit profesional për plotësimin e nevojave rurale (Masa 1 në ARDP 2007- 2013).

Tabela B.IV-8: Transfertat buxhetore për financimin e shërbimeve të përgjithshme në lidhje me bujqësinë (në EUR), 2008-2012, Kosova*

	2008	2009	2010	2011	2012
Zhvillimin e trajnimit profesional për të plotësuar nevojat rurale (M1)	23 495	58 738	70 485	82 233	135 560
Shërbime veterinare dhe fitosanitare	3 092 257	3 212 022	3 126 026	2 314 138	2 639 989
Totali i Mbështetjes për shërbime të përgjithshme në lidhje me bujqësinë,	**3 115 752**	**3 270 760**	**3 196 511**	**2 396 371**	**2 775 549**

Burimi: Databaza APM e Kosovës*

Masa për zhvillimin e trajnimit profesional për plotësimin e nevojave rurale ka qenë në fuqi që prej vitit 2008. Qëllimi i kësaj mase ishte futja e teknologjive të reja të prodhimit bujqësor, metodat e prodhimit miqësor ndaj mjedisit, dhe ngritja e rrjetit të bashkëpunimit midis fermerëve. Kurset e trajnimit u kryen nga kompani private të kontraktuara në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Komunale të Bujqësisë. Nga viti 2008 deri në vitin 2012 kanë marrë pjesë në kurset e trajnimit 19 000 fermerë dhe gjithashtu 900 fermerë kanë marrë pjesë në vizita të ndryshme studimore të shembujve të historive të suksesit. Në vitin 2012, buxheti i shpenzuar për trajnim profesional ishte 65 përqind më i lartë se në vitin 2011, ndërsa në krahasim me vitin 2008 ishte rreth pesë herë më i lartë. Sipas raportit të MTE masa e trajnimit profesional kontribuoi në rritjen e prodhimit bujqësor, përdorim më efikas të inputeve dhe aktivitete më të specializuara në fermë.

4. Diskutime dhe konkluzione

Për shkak të strukturës së pafavorshme të fermave dhe përdorimin joefikas të faktorëve të prodhimit, rendimentet bujqësore në Kosovë* janë shumë më të ulëta se në BE, edhe pse të ngjashme me disa vende të SEE-së (shikoniKapitullin A.II). Në përgjithësi, sektori bujqësor dhe i agro-përpunimit po përballet me vështirësi në zhvillim e zinxhirëve të shpërndarjes së ushqimit, marketingun dhecilësinë, standardet veterinare dhe fitosanitare krahasuar me standardet e BE-së. Mesatarisht, çmimet e produkteve bujqësore janë shumë më të larta në Kosovë* se sa në vendet e BE-së. Kjo tregon se prodhuesit e Kosovës* përballen akoma me konkurrueshmërinë e dobët të çmimeve. Kosova ka një bilanc negativ të tregtisë agro-ushqimore. Zhvillimi i një strategjie të tregtisë bujqësore bazuar në analizën e tregut, do të krijonte premisat për prodhuesit dhe përpunuesit vendas për një shfrytëzim më të mirë të mundësivetë tregut dhe gjithashtu të stabilizonte situatën e punësimit dhe të ardhurave.

Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale do të mbetet një sfidë kryesore për të ardhmen. Në përgjithësi, zonat rurale në Kosovë* po përballen me nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik, çka çon në një normë të lartë të papunësisë. Një nga detyrat më sfiduese mbetet aftësia për të reduktuar varësinë e fuqisë punëtore rurale nga bujqësia dhe zhvillimi i aktiviteteve për të ardhura shtesë përjetën në fshat. Për të zvogëluar emigrimin apo varfërinë në zonat rurale, duhen krijuar mundësi për punësim duke mbështetur diversifikimin e aktiviteteve bujqësore, të tilla si përpunimi i produkteve ushqimore tradicionale lokale dhe produkteve niche, si edhe duke inkurajuar iniciativa të bizneseve për t'u bërë aktive në ofrimin e shërbimeve rurale. Duhen organizuar trajnime në grupetë vogla dhe duhen inkurajuar sipërmarrëset ferma të marrin pjesë. Zhvillimi ekonomik në zonat rurale duhet të inkurajohet nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës, të tilla si energjia elektrike, rrugët, furnizimi me ujë, hedhjes së mbeturinave dhe interneti.

Shpërndarjet buxhetore dhe niveli i mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë relativisht të ulëta në krahasim me vendet e tjera të SEE-së dhe vendet e BE-së (shikoniKapitullin A.II).

Bujqësia konkurruese kërkon njohuri të përditësuara, informacion dhe shërbime menaxhimi. Trajnime të mëtejshme, këshilla teknike në menaxhimin e fermës/biznesit dhe informacioni mbi tregun bujqësor në përputhje me nevojat specifike të vendit janë parakushte për rritjen e prodhimit bujqësor dhe rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së sektorit. Promovimi i kërkimit bujqësor do të lehtësojë zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit, veçanërisht në pikëpamje të sfidave të reja të tilla si ndryshimi i klimës, biodiversiteti, rritja e çmimeve të ushqimeve dhe të bio-karburanteve.

Kosova* duhet të fillojë të zbatojë skemat e pagesave agro-mjedisore që ofrojnë mbështetje për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore; veçanërisht praktikave të qëndrueshme të përdorimit të tokës në aktivitetet bujqësore me vlera të larta natyrore (HNV). Angazhimi për të mbështetur bujqësinë HNV do të përmirësojë ofrimin e eksternaliteteve pozitive dhe shërbimeve mjedisore nga praktikat bujqësore. Më shumë vëmendje duhet t'i jepet gjithashtu zonave më pak të favorizuara.

Në vitet2011 dhe 2012 nuk u shpërndanë fonde për konsolidimin e tokës e cila është shumë problematike duke pasur parasysh situatën aktuale të fragmentimit të fermës, tregut të dobët të tokës karakterizuar nga transparenca e ulët në zotërimin e tokës, të drejta të paqarta mbi pronën dhe përdorimin e tokës shtetërore. Kjo masë mund të përdoret për të arritur disa objektiva të përcaktuara në kuadër të strategjisë së re të ARDP 2014-2020.

Duke marrë në konsideratë që shumica e fermave janë shumë të vogla, duhet të gjenden mënyra për të siguruar zhvillimin e këtyre fermave. Mbështetja për krijimin e organizatave të prodhuesve do të ishte masa e vetme më e rëndësishme për sektorin e frutave dhe perimeve me qëllim forcimin e prodhimit dhe marketingut të fermerëve të vegjël të Kosovës. Për shkak të luhatjeve të lartë në nivelet e prodhimit dhe çmimeve, Kosova* duhet të zbatojë mekanizma për parandalimin dhe menaxhimin e riskut duke mbuluar një pjesë të tarifave të sigurimit privat. Për të rritur konkurrueshmërinë e produkteve kosovare në tregjet e brendshme dhe të eksportit, duhet të mbështetet në mënyrë konstante promovimi afatgjatë i produkteve bujqësore dhe ushqimore, kombinuar me turizmin dhe gastronominë.

Referenca

KAS. 2013. Kosovo Agency of Statistics. Pristinë.

Kosovo* APM Database. 2014. Agricultural Policy Measures Database compiled for Kosovo* under the FAO/SWG project “Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession” (unpublished data).

MAFRD. 2010. Agriculture and Rural Development Program 2007-2013. Prishtine.

MAFRD. 2013a. Green Report Kosovo. Prishtine.

MAFRD. 2013b. Agriculture and Rural Development Program 2014-2020. Prishtine.

MAFRD. 2005-2012. Import of the agri-food products 2005-2012. Department of Economic Analyzes and Agriculture Statistics. Prishtina.

MAFRD. 2005-2012. Export of the agri-food products 2005-2012. Department of Economic Analyzes and Agriculture Statistics. Prishtinë.

Rednak, M. & Volk, T. 2010. Agricultural policy measures template – A tool for classifying and analysing agricultural policy measures. In: VOLK, T. (ed.). *Agriculture in the Western Balkan countries*, (Studies on the agricultural and food sector in Central and Eastern Europe, vol. 57). Halle (Saale): Leibniz-Institut für Agrarentwicklung in Mittel- und Osteuropa (IAMO), p. 219-245.

Aneksi B.IV-1:Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave kryesore, 2005-2012, Kosova*

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Sipërfaqja e prodhimit (1 000 ha)								
Totalit	153.0	110.0	102.4	115.0	120.0	119.9	121.1	137.2
- Grurë	69.3	68.6	61.2	72.1	77.9	78.4	79.9	102.9
- Misër	74.4	36.1	35.2	36.1	35.9	35.4	35.2	31.2
Patate	3.8	3.1	5.0	3.7	3.4	3.8	3.7	3.2
Rrush (total)	2.9	3.0	3.0	3.0	3.1	3.1	3.2	3.2
Fruta (total)	4.0	3.2	3.8	4.0	3.0	3.4	3.6	3.9
Perime (total)	7.9	8.1	8.3	8.6	8.4	9.0	9.2	8.4
Tjetër:								
- Fasule	5.6	4.8	4.4	4.2	4.1	3.6	3.3	3.0
- Foragjere	96.8	96.7	108.4	104.7	91.4	99	98.8	94.4
Prodhimi (1 000 t)								
Totalit	440.8	392.1	294.8	437.5	411.2	430.5	435.0	438.8
- Grurë	273.4	239.5	207.2	293.1	271.4	294.5	300.2	345.0
- Misër	142.1	138.2	74.5	126.9	125.9	120.5	119.7	86.3
Patate	87.4	71.2	95.1	104.0	58.7	87.4	87.0	33.4
Rrush (total)	26.1	28.7	28.9	29.2	26.3	28.6	16.6	29.7
Fruta (total)	23.9	24.3	18.7	29.0	23.0	24.0	24.8	30.0
Perime (total)	135.8	159.9	123.5	165.0	137.2	246.1	253.5	126.0
Tjetër:								
- Fasule	8.3	10.6	3.0	6.8	7.1	5.6	5.0	3.7
- Foragjere	339.7	314.1	283.1	331.9	257.8	398.5	396.0	259.5

Burimi: MAFRD, 2013a

Aneksi B.IV-2: Të dhënat e blegtorisë (në 000 krerë), 2005-2012, Kosova*

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Gjedhë	351	381.9	321.6	341.6	344	356.7	361.8	329.21
nga të cilat lopë qumështi	213	205.4	189.7	191.5	190.2	194.9	196.1	183.34
Derra	47	68.2	39.6	26.7	50.6	50.6	50.6	55.7
Dele edhe dhi	151	112.9	151.8	180.1	217.2	229.2	231.2	247.9

Kuaj	:	6.7	6.1	5.0	4.2	4.2	4.2	2.1
Shpendë	2 631	2 525	2 278	2 213	2 390	2 347	2 347	2 318
Koshere bletësh	:	72.2	60.9	43.3	43.1	46.9	44.6	46.5

Burimi: KAS; MAFRD, 2013a

Aneksi B.IV-3: Çmimet e prodhuesve në fermë për disa produkte bujqësore (in EUR/t), 2005-2012, Kosova*

Product	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Grurë	140	150	250	270	170	190	250	260
Misër	180	160	220	200	200	220	290	300
Patate	230	310	300	310	300	290	300	320
Speca	520	590	620	690	630	590	580	580
Domate	540	630	670	570	610	620	500	710
Viça (peshë e gjallë)	1 730	1 790	1 730	1 920	2 060	2 020	2 130	2 280
Derra (peshë e gjallë)	1 580	1 580	1 640	2 020	2 110	2 130	2 080	2 150
Qingja (peshë e gjallë)	1 890	1 790	1 830	2 040	2 150	2 220	2 310	2 430
Pula (peshë e gjallë)	1 590	1 590	1 590	1 780	1 920	1 940	2 120	2 120
Vezë (1 000 kokrra)	77.3	74.7	81.7	91.0	70.0	71.0	83.0	96.6
Qumësht lope	272	282	282	330	301	282	301	311

Burimi: KAS

Kapitulli B.V

BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË ISH REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

Dragi Dimitrievski*, Ana Kotevska*, Ivana Janeska Stamenkovska*, Emelj Tuna*, Marina Nacka*

* Ss. Cyril dhe Universiti Methodius i Shkupit, Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

1. Hyrje

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Gjatë periudhës së tranzicionit, politika bujqësore përjetoi luhatje të konsiderueshme. Edhe pse Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit u nënshkrua në vitin 2001, konsolidimi gradual i politikës bujqësore dhe përshtatja me EU CAP filloi pas marrjes së statusit të vendit kandidat në vitin 2005 (Dimitrievski & Kotevska 2008;. Dimitrievski et al, 2010).

Qëllimi i këtij punimi është që të paraqesë situatën e bujqësisë dhe politikave bujqësore. Përveç kësaj, bazuar në gjendjen e përgjithshme të sektorit, ky punim shpjegon në mënyrë të përgjithshme përgatitjen e bujqësisë së Maqedonisë për procesin e integrimit Evropian.

Analiza e sektorit bazohet në të dhënat statistikore zyrtare të ofruara nga Enti Shtetëror i Statistikave (SSO) dhe raportet vjetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural të përgatitura nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MAFWE).

Për sa i përket politikës bujqësore dhe transfertave buxhetore, analiza bazohet në të dhënat e siguruara nga Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (agjencia e Pagesave) dhe klasifikimi e masave të politikës bujqësore sipas mjetit APM (Rednak dhe Volk, 2010). Baza e të dhënave APM përfshin të gjitha fondet e paguara nëpërmjet agjencisë së pagesave duke marrë parasysh vitin e ekzekutimit të pagesave. Baza e të dhënave mund të përmirësohet akoma më tej me buxhetet e disa organeve të brendshme administrative brenda MAFWE, si dhe buxhetin e disa aktiviteteve dhe projekteve të financuara nga institucione të tjera kombëtare ose donatorë të huaj.

Ky punim ka strukturën e mëposhtëme. Pas hyrjes, përshkruhen karakteristikat kryesore të sektorit bujqësor duke patur parasysh disa tregues makroekonomik, si kapacitetet e prodhimit, çmimet dhe tregjet bujqësore. Më pasparaqitet zhvillimi i politikave bujqësore, së bashku me masat dhe transfertat buxhetore totale për bujqësinë. Së fundmi, nxirren disa përfundime dhe rekomandime në lidhje me zhvillimin e politikave bujqësore dhe krijimin e institucionevenë procesin e integrimit evropian.

2. Bujqësia

2.1 Roli i bujqësisë në ekonomi

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë është një vend relativisht i vogël si në sipërfaqe edhe në popullsi. Gjatë dekadës së fundit ka pasur një rritje të dukshme në PBB. Në vitin 2011, PBB-ja për frymë në IshRepublikën Jugosllave të Maqedonisë (në Standardin e Fuqisë Blerëse) arriti një vlerë prej rreth 8 700 EUR nga 6 400 EUR në vitin 2005. Megjithatë, mbetet problem norma e lartë e papunësisë, mbi 30 përqind, që konsiderohet si faktor vendimtar për nivelin e lartë të varfërisë në Maqedoni. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe norma e papunësisë ka ardhur duke u ulur, duke arritur në 31.0 përqind në vitin 2012 nga 37.3 përqind që ishte në vitin 2005

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë për ekonominë e Maqedonisë dhe ka kontribut të rëndësishëm në stabilitetin ekonomik dhe social të vendit. Së bashku me gjuetinë, pylltarinë dhe

peshkimin, është sektori i tretë më i madh me një kontribut prej rreth 11 përqind në vlerën e shtuar totale të të gjitha aktiviteteve, çka tregon një rënie të lehtë nga 12.6 përqind në 2005 në 10.8 përqind në vitin 2012. Rëndësia e bujqësisë për ekonominë maqedonase vërehet qartë në kontributin që ajo ka në punësim 19 përqind të popullsisë aktive. Punësimi në bujqësi konsiderohet gjithashtu një faktor i rëndësishëm social duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë së përgjithshme, ajo mundëson një ulje të varfërisë, sidomos në zonat rurale.

Performanca ekonomike e Maqedonisë është ndikuar ndjeshëm nga tregtia agro-ushqimore. Kontributi i eksporteve të produkteve agro-ushqimore në eksportet totale është rreth 16 përqind (mesatarja 2010-2012), ndërsa importet agro-ushqimore kontribuojnë me rreth 13 përqind të importeve totale. Liberalizimi, sidomos në sektorin agro-ushqimor, ka shkaktuar importe më të larta se eksportet, duke thelluar bilancin tregtar negativ.

2.2 Burimet e tokës dhe struktura e fermës

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka një sipërfaqe totale prej 25 713 km^2, e cila është vetëm 0.59 përqind e sipërfaqes së EU-27. Për sa i përket kushteve natyrore për prodhim bujqësor, vendi karakterizohet nga një përqindje e lartë e zonave kodrinore-malore dhe kushte natyrore heterogjene. Llojet kryesore të klimës janë kontinentale, malore dhe mesdhetare, me verë të ngrohtë dhe të thatë dhe dimër të ftohtë dhe të lagësht. Këto kushte klimatike karakterizohen nga sasi të pamjaftueshme reshjesh të cilat kombinuar me ngricat në fund të pranverës janë një faktor kufizues për prodhimin bujqësor intensiv në fushë të hapur (MAFWE, 2010).

Sipas statistikave të fundit vjetore (2012), afërsisht 1.3 milionë ha, ose 49 përqind e sipërfaqes totale në vend është e kategorizuar si tokë bujqësore dhe mbi 38 përqind janë pyje.

Kullotat përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqes totale të tokës bujqësore me pothuajse 60 përqind. Rreth 33 përqind e tokës bujqësore është tokë e punueshme dhe pjesa e mbetur përbëhet nga livadhe (4 përqind), vreshta (2 përqind) dhe pemëtore (1 përqind). Nga sipërfaqja totale e tokës së punueshme, rreth 33 përqind është lënë djerrë dhe e pakultivuar dhe kjo përqindje ka qenë relativisht konstante për një periudhë të gjatë.

Fermat e vogla bujqësore kanë dominuar prodhimin bujqësor si para ashtu dhe pas procesit të privatizimit në vitet 1990. Anketa e strukturës së fermës nga viti 2013 raportoi 170 885 ferma bujqësore që shfrytëzojnë 315 863 ha të sipërfaqes bujqësore, me një madhësi mesatare prej 1.85 ha (SSO, 2013). Shifër kjo pak më e lartë se madhësia mesatare e fermës regjistruar në censusin e bujqësisë në vitin 2007; pra, 1,73 ha (SSO, 2007). Megjithatë, më shumë se 58 përqind e fermave bujqësore përdorin akoma më pak se 1 ha.

Fermat e vogla dhe të fragmentizuara mbeten një nga problemet më të mëdha për bujqësinë maqedonase, duke çuar në përdorimin joefektiv të tokës bujqësore.

Figura B.V-1: Struktura e fermave sipas sipërfaqes së kultivuar, 2013, IRJe Maqedonisë



Burimi: SSO, 2013

2.3 Prodhimi bujqësor

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, prodhimi bimor ka qënë tradicionalisht dominues në strukturën e prodhimit bujqësor. Kontributi i prodhimit bimor në prodhimin total bujqësor është rreth 75 përqind (mesatarja 2010-2012), dhe vetëm 25 përqind është gjeneruar nga prodhimi blegtoral.

Në strukturën e tokës së punueshme të korrur, drithërat kryesojnë me rreth 60 përqind. Drithi kryesor është gruri (rreth 30 përqind e tokës së punueshme të korrur), ndjekur nga elbi (rreth 15 përqind), dhe misri (me rreth 10 përqind). Megjithatë, ka një rënie të dukshme të prodhimit total në periudhën nga viti 2005, kryesisht për shkak të reduktimit të sipërfaqes me drithëra (shikoni Aneksin BV-1). Sipas blerjeve mesatare të grurit në vend (2007-2011), si dhe konsumit të kërkuar nga industria e bluajtjes, vetëm 40-45 përqind e kërkesës së brendshme për grurë mbulohet nga prodhimi vendas (MAFWE, 2012).

Rendimentet mesatare të drithërave janë ende shumë më të ulëta krahasuar me rendimentet e vendeve të BE-së (shikoni Kapitullin A.II), kryesisht për shkak të përdorimit të farërave të pacertifikuara dhe praktikave të papërshtatshme agro-teknike të prodhimit (MAFWE, 2012).

Figura B.V-2: Sipërfaqja e korrur sipas kulturave kryesore, 2012, IRJe Maqedonisë



Burimi: SSO

Kultivimi i perimeve është traditë në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në vitet e fundit, perimet janë kultivuar në rreth 11 përqind të totalit të tokës së punueshme, me një prirje të lehtë rritëse të prodhimit. Shumica e prodhimit është kryer nga fermat individuale, ku perimet dominuese janë speca, shalqi dhe lakra. Patatet zënë një pjesë më të vogël të sipërfaqes së korrur (rreth 5 përqind), dhe prodhohen kryesisht në rajonet kodrinore-malore.

Midis bimëve industriale, dominon duhani aromatik me fletë të vogla. Ai është një mall i rëndësishëm i punës intensive, rritur në zona me kushte të papërshtatshme për llojetë tjera prodhimesh bujqësore. Duhani zë mbi 80 përqind të sipërfaqes totale mebimë industriale. Pjesa më e madhe e prodhimit të duhanit realizohet në rajonin e Pellagonisë dhe pjesën Juglindore, me rëndësi të madhe ekonomike dhe sociale për bujqësinë dhe për ekonominë e përgjithshme. Rritja e subvencioneve qeveritare dhe përmirësimi i organizimit të zinxhirëve sollën rritjen e prodhimit.

Bimët foragjere kultivohen në rajonet e mbarështimit të kafshëve, dhe mungesa e foragjereve (dhe kështu çmimi i lartë i tyre) është një ndër faktorët kryesorë kufizues për zhvillimin e nën-sektorit të blegtorisë dhe ndikon negativisht në prodhimin e mishit dhe qumështit (MAFWE, 2011). Bimët foragjere përbëjnë një pjesë relativisht të vogël të totalit të sipërfaqës së punueshmë të korrur (rreth 10 përqind). Pjesa më e madhe i takon sipërfaqës së mbjellë me jonxhë, ndërsa kulturat e tjera foragjere kanë kontribut shumë të ulët (*ibid*).

Vreshtaria së bashku me prodhimin e verës, kontribuojnë me rreth 17-20 përqind të prodhimit bujqësor. Vera është produkti i dytë më i rëndësishëm bujqësor në aspektin e vlerës së eksportit, pas duhanit. Megjithatë, struktura moshore e vreshtave është shumë e pafavorshme, përsëri kryesisht për shkak të fragmentimit të parcelave dhe periudhës së gjatë të investimeve të dobëta. Më shumë se 60 përqind e vreshtave janë më të vjetër se 15 vjet, dhe duhet të rinovohen në mënyrë që të ruajnë potencialet sasiore dhe cilësore të prodhimit.

Prodhimi blegtoral përbën 27.5 përqind të vlerës totale të prodhimit bujqësor në vitin 2011, me prodhimin e qumështit që kontribuoi me pothuajse 50 përqind të kësaj vlere, e ndjekur nga mishi iderrit, mishi i gjedhit, mishi i të imtave. Sipas anketës së fundit mbi strukturën e fermës (2013), fermat bujqësore kanë një total prej 365 868 njësi blegtorale (LSU), me mesatare 2.14 LSU për fermat bujqësore (SSO, 2013). Numri i gjedhit është relativisht i qëndrueshëm, ndërkohë që numri i lopëve të qumështit ka treguar një prirje të lehtë rënëse që nga viti 2007. Mbi 95 përqind e qumështit është prodhuar në fermat individuale.

Tabela B.V-1: Madhësia e tufës sëkategorivekryesore blegtorale (në 1 000), 2005-2012, IRJe Maqedonisë

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Gjedhë	248	255	254	253	253	260	265	251
nga të cilat lopë qumështi	88	94	130	130	114	125	137	123
Derra	156	167	255	247	194	191	197	177
Dele dhe dhi	1 244	1 332	944	950	755	778	767	732
Kuaj	40	41	31	31	29	27	25	22
Shpendë	2 617	2 585	2 264	2 226	2 118	1 995	1 944	1 776
Koshere bletësh	67	68	58	62	53	76	65	53

Burimi: SSO

Pavarësishtnjë rënieje të lehtë të numrit të lopëve, është regjistruarnjë rritje e vogël e rendimentit për lopë, e cila tregon një përmirësim në strukturën e mbarështimit të lopëve të qumështit. Megjithatë, rendimentet për lopë janë ende shumë më të ulëta krahasuar me vendet e BE-së dhe shumicën e vendeve të SEE-së (shikoniKapitullin A.II).

Kullotat - të cilat zënë më shumë se gjysmën e tokës bujqësore - mund të jenë bazë e fortë për zhvillimin e nënsektorit të deleve. Pavarësisht nga kushtet e favorshme gjeografike dhe klimatike, mbarështimi i deleve ka treguar një trend rënës.Trendi rënës ka ardhur për shkak të një

mënyreekstensive nomade të mbarështimit të deleve dhe të migrimit të popullsisë në zonat urbane. Rreth 95 përqind e deleve të qumështit mbahen nga familjet bujqësore individuale dhe mbarështimi i deleve kryhet pothuajse gjithmonë në fermat individuale dhe të vogla familjare, me një madhësi tufeprej 20-200 dele (MAFWE, 2012).

2.4 Çmimet bujqësore

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore tregojnë luhatje të mëdha gjatë periudhës 2005-2012, me një tendencë rritëse në terma nominalë dhe realë. Një rritje e lartë e çmimeve të prodhimit u vu re në vitin 2008, 2010 dhe përsëri në vitin 2012, ndërsa në vitin 2009 niveli i çmimeve ka qenë ndër më të ulëtat në periudhën e vëzhguar.

Tabela B.V-2: Indekset e çmimeve të inputeve dhe prodhimit bujqësor- nominale, 2005-2012 (2010=100), IRJ e Maqedonisë

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Çmimet e prodhimit	78.9	83.3	87.3	101.5	84.3	100.0	99.6	113.6
- Produktet bujqësore	76 3	82 3	86 4	88 5	84 3	100 0	96 0	112 2
- Produktet blegtorale	92 0	90 9	94 2	124 4	108 1	100 0	108 1	117 0
Çmimet e inputeve	84.7	83.3	89.4	104.5	94.0	100.0	117.3	123.8
Termat e tregtisë (çmimet e inputeve=100)	93.1	100.0	97.6	97.2	89.8	100.0	85.0	91.7

Burimi: SSO

Çmimet e inputeve bujqësore janë rritur që nga viti 2005. Në periudhën 2005-2010, termat e tregtisë në bujqësi janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, duke treguar se rritja e çmimeve të prodhimit ka qenë përgjithësisht më e lartë se rritja e çmimeve të inputeve. Megjithatë, ekziston një trend rënës në aspektin e tregtisë që nga viti 2010, duke ndikuar negativisht për të ardhurat bujqësore.

2.5 Tregtia bujqësore

Bilanci tregtar negativ gjatë periudhës 2005-2012 është një tregues i orientimit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë ndaj importeve për sa i përket tregtisë agro-ushqimore. Tregtia e përgjithshme e produkteve agro-ushqimore është në rritje. Megjithatë, importet janë duke u rritur më shpejtë se eksportet, duke sjellë një rritje pak a shumë konstante të defiçitit tregtar gjatë gjithë periudhës. Defiçiti tregtar arriti nivelin më të lartë (rreth 203 milionë EUR) në vitin 2012.

Figura B.V-3: Tregtia agro-ushqimore (milionë EUR), 2005-2012, IRJ e Maqedonisë



Burimi: SSO

Vlera mesatare e eksporteve të produkteve agro-ushqimore në periudhën 2010-2012 arriti në 449.2 milionë EUR. Në përgjithësi, duhani dhe vera janë produktet më të rëndësishme të eksporteve agro-ushqimore, për sa i përket vlerës. Duhani zë 24 përqind (106. Milionë EUR) të

vlerës totale të eksporteve të produkteve bujqësore. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë po e rrit akoma prodhimin dhe eksportin e këtij produkti. Në vitin 2012, eksporti i duhanit ishte 23 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2010. Pijet janë kategoria e dytë më e rëndësishme në aspektin e vlerës së eksportit, me një kontribut prej 14 përqind. Eksporti iverërave në shishe është rritur si në sasi, edhe në vlerë (SSO, 2014). Perimet zënë 13 përqind, dhe përjetuan një rënie prej 20 përqind në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011. Frutat, preparatet e drithërave të miellit dhe preparatet e perimeve, frutave ose arrave, janë rritur në mënyrë konstante gjatë viteve. Nga produktet blegtorale dominon mishi i qingjit.

Figura B.V-4: Përbërja e eksporteve agro-ushqimore sipas grupmallrave kryesorë, mesatarja 2010-2012, IRJ e Maqedonisë



Burimi:SSO

Vlera mesatare e importeve të produkteve agro-ushqimore për periudhën 2010-2012 arriti në 604.2 milionë EUR dhe është rritur gjatë viteve të fundit. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë është kryesisht një importuese e produkteve agro-ushqimore me origjinë shtazore, edhe pse tendencat e fundit tregojnë se produktet me origjinë bimore gjithashtu përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të importeve. Me ndryshimet pozitive në PBB-në për frymë, importet ndryshojnë në aspektin e importit të produkteve të veçanta që nuk janë prodhuar në vend, por janë të përballueshme për një segment të caktuar të konsumatorëve.

Figura B.V-5: Përbërja e importeve agro-ushqimore sipas grupmallrave kryesore, mesatarja 2010-2012, IRJe Maqedonisë



Burimi: SSO

Mishi zë pjesën më të madhe të importeve të produkteve agro-ushqimore (15.4 përqind). Ka pasur një rënie në prodhimin e mishit në vitin 2012, veçanërisht të mishit të gjedhit dhe deleve. Importet e pulave përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të totalit të të mirave të importuara agro-ushqimore, pasi prodhimi vendas mbulon vetëm 20 përqind të kërkesës së tregut. Nga ana tjetër, rreth 90 përqind e kërkesës së brendshme për mishin e derrit është mbuluar nga prodhimi i brendshëm (MAFWE, 2012). Yndyrnat dhe vajrat shtazore dhe vegjetale janë kategoria e dytë më e rëndësishme e importeve (9.4 përqind). Kategori të tjera të rëndësishme janë drithërat dhe preparatet e drithërave, si dhe pijet të cilat zënë 4.6 përqind të importeve agro-ushqimore.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë eksporton kryesisht drejt vendeve të SEE-së (mesatarja 2010-2012, 49 përqind) dhe në BE (40 përqind). Midis vendeve të BE-së, destinacionet kryesore të eksporteve janë Greqia, Gjermania dhe Belgjika (rreth 17 përqind e eksporteve të EU 27), ndjekur nga Bullgaria, Italia, Sllovenia dhe Rumania. Serbia është tregu kryesor për eksportin e produkteve agro-ushqimore maqedonase, duke zënë 39 përqind të eksporteve drejt vendeve të SEE-së, së bashku me Kroacinë dhe Bosnje &Hercegovinën me 14 përqind dhe 13 përqind, respektivisht.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, importon produktet agro-ushqimore kryesisht nga EU-27 (mesatarja 2010-2012: 44 përqind) pasuar nga vendet e SEE-së (32 përqind) dhe vendet tjera (24 përqind). Serbia është partneri më i madh tregtar midis vendeve të SEE-së me rritje të vazhdueshme të importit. Vendet e BE-së që kryejnë eksporte të rëndësishme në tregun e Maqedonisë janë Bullgaria, Gjermania, Austria dhe Greqia.

3. Politika bujqësore

3.1 Koncepti dhe kuadri i politikës bujqësore

Pas pavarësisë së saj, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë përjetoi një zhvillim të trazuar të politikës bujqësore, me shumë vendime politike *adhoc* dhe vendime që merren pasi ka ndodhur ngjarja. Që nga marrja e statusit të vendit kandidat në vitin 2005, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka filluar të përshtasë politikën kombëtare të bujqësisë me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) të BE-së. Kështu, Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (LARD, në fuqi nga viti 2008), përbëhej nga dy akte: një për rregullimin e tregjeve bujqësore dhe një tjetër për zhvillimin rural, dhe paraqet një afrim gradual drejt CAP.

Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i miratuar në vitin 2010, është një përshtatje e mëtejshme ndaj CAP, dhe aktualisht shërben si një kuadër ligjor i politikës bujqësore në vend. Përveç këtij ligji, bujqësia është e rregulluar nga dhjetra ligje të tjera; si përshembull, Ligji mbi Veprimtarinë

Bujqësore, Ligji për Tokën Bujqësore, Ligji për Duhanin, Ligji për Verën, Ligji për Mbarështimin e Kafshëve, Ligji për Kullotat, Ligjin për Prodhimin Bujqësor Organik, Ligji për Kontabilitetin në Fermë (FADN), Ligji mbi Inspektimin Bujqësor, Ligji për Ujërat, Ligji për Komunitetet e Ujit, dhe Ligji për Ndërmarrjet e Menaxhimit të Ujit.

Ministria e Bujqësisë, Pyjevedhe Ekonomisë së Ujërave (MAFWE) është autoriteti kompetent për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave dhe instrumenteve të politikave bujqësore, ndërsa Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (shpesh quajtur Agjencia e Pagesave), është përgjegjëse për zbatimin dhe kontrollin e masave të politikës bujqësore si një organ i pavarur i administratës shtetërore. Financimi i politikës bëhet nga buxheti kombëtar, si dhe nga donacionet dhe kontributet nga burime të tjera, të tilla si buxheti i BE-së.

Dokumenti kryesor strategjik për politikën bujqësore të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë është Strategjia Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (NARDS) 2007-2013 (MAFWE, 2007). Dokumentet mbështetëse shtesë janë Programi shumë-vjeçar Kombëtar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (i cili është përgatitur për një periudhë tre-vjeçare) dhe programi shumëvjeçar për përdorimin e fondeve IPARD (2007 -2013). Për zbatimin e politikës bujqësore janë të rëndësishme edhe programet vjetore për përkrahje financiare të bujqësisë dhe programet vjetore për mbështetjen financiare të zhvillimit rural.

Politika bujqësore e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë është e bazuar në pesë objektivat e saj të përcaktuara në LARD-in e parë që nga viti 2007 dhe NARDS 2007-2013: (1) ofrimin e prodhimit të qëndrueshëm, cilësor dhe të përballueshëm dhe duke siguruar sasi të mjaftueshme të ushqimit për popullsinë; (2) rritjen e konkurrueshmërisë së bujqësisë; (3) sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme të fermës; (4) zhvillimin e qëndrueshëm tëzonave rurale; dhe (5) shfrytëzimin optimal të burimeve natyrore në lidhje me parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore dhe mjedisit.

Objektivat e politikës bujqësore janë planifikuar të arrihen përmes katër grupe instrumentash dhe masash: rregullimi dhe mbështetja e tregjeve bujqësore; pagesat direkte; zhvillimi rural; dhe ndihma shtetërore si mbështetje shtesë për bujqësinë. Sipas mekanizmave të rregullimit të tregut, masat e ndërhyrjes (mbështetja e blerjeve dhe magazinimit) synojnë sektorin e grurit, si një produkt strategjik, ndërsa subvencionet e konsumit janë aplikuar për fruta dhe perime të freskëta, qumësht dhe produkte bulmetore nga prodhimi vendas. Pagesat direkte janë programuar për njësi të produkteve bujqësore, dhe për sipërfaqe të tokës bujqësore, apo krerë bagëti. Aplikimi i tyre është i kushtëzuar nga disa kërkesa për përputhje të ndryshme në të njëjtën kohë (të cilat janë duke u futur gradualisht në përputhje me rregulluesenn CAP), për të siguruar prodhimin e ushqimit të sigurt dhe të shëndetshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

Politika e zhvillimit rural është më e harmonizuar me parimet e CAP dhe ka katër fusha prioritare si dhe instrumentet për t'i mbështetur ato: rritja e konkurrueshmërisësë fermave bujqësore dhe pyjore; mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit dhe zonave rurale; përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale; dhe mbështetjae zhvillimit lokal.

Një pjesë e madhe e zhvillimit rural është financuar nga BE-ja nëpërmjet Instrumentit të Asistencës Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD). Objektivi kryesor i programit IPARD është të përmirësojë konkurrueshmërinë e fermave bujqësore dhe industrinë ushqimore, në mënyrë që t'i afrojë ato në përputhje me standardet e komunitetit dhe në të njëjtën kohë të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm mjedisor dhe socio-ekonomik të zonave rurale, duke rritur aktivitetet ekonomike dhe mundësitë e punësimit.

Programi IPARD i Maqedonisë është fokusuar në boshtin e parë dhe të tretë të prioriteteve me tri masat e mëposhtme: (1) Investime në ferma bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe përmirësimin me standardet e Komunitetit (Boshti 1, Masa 101); (2) Investimet në përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit për të ristrukturuar këto aktivitete dhe për

të përmirësuar ato me standardet e Komunitetit (Boshti 1, Masa 103); dhe (3) Diversifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike rurale (Boshti 3, Masa 302).

Midis vitit 2009 - kur agjencia e Pagesave mori akreditimin e saj - dhe 2012, janë shpallur shtatë thirrje publike për tendera. Gjatë kësaj periudhe 3.5 milion EUR u paguan në total (nga të cilat 2.65 milion EUR ishin fonde të BE-së). Masa 103 po merr pjesën më të madhe (79 përqind), ndërsa masa 302 nuk është zbatuar fare. Zbatimi i masave financiare është mjaft i ulët: 17.4 përqind për masën 103, dhe 6.8 përqind për masën101 (Komisioni i IPARD, 2013). Shumat e realizuara për sektorin gjithashtu ndryshojnë nga shpërndarjet e planifikuara në programin IPARD. Në veçanti interesi i përpunimit të verës dhe frutave, si dhe prodhimi i verës tejkaluan shpërndarjen e planifikuar në masa, ndërsa përpunimi i mishit, edhe pse ka pasur fokus të madh në program, tregoi shumë pak interes në praktikë (*ibid*).

3.2 Mbështetja buxhetore për bujqësinë

Në aspektin e mbështetjes buxhetore për këtë sektor, ka një rritje të dukshme në buxhetin total. Rritja e rëndësisë së sektorit bujqësor për qeverinë kombëtare mund të vërehet nga rritja e peshës së mbështetjes buxhetore totale për bujqësinë në lidhje me vlerën e shtuar bruto totale të gjeneruara nga bujqësia, pylltaria dhe peshkimi. Në vitin 2008, kjo peshë ishte 6.6 përqind, ndërsa në vitin 2012 arriti në 15.3 përqind.

Buxheti i bujqësisë u dyfishua nga viti 2008 deri në vitin 2012, duke arritur vlerën totale prej 101.6 milionë EUR. Rritja është e vazhdueshme dhe e planifikuar në programet kombëtare të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural (MAFWE 2009), duke paraqitur qasjen strategjike të vendit në procesin e përshtatjes me kërkesat e BE-së.

Figura B.V-6: Shpenzimet buxhetore për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale (milionë EUR), 2008-2012, IRJ e Maqedonisë



Burimi: Databaza APM e IRJe Maqedonisë

Edhe pse ka një rritje të dukshme të buxhetit total, nuk ka shumë ndryshime në strukturën e tij të përgjithshme. Pjesa më e madhe e buxhetit bujqësor shkon për mbështetjen direkte të prodhuesve (68-79 përqind), ndërsa shumë më pak për zhvillimin strukturor dhe rural (8-19 përqind) dhe mbështetjen e shërbimeve të përgjithshme (7-18 përqind).

Masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve

Pagesat direkte janë elementi kryesor i masave të mbështetjes së tregut, mbështetjes direkte të prodhuesve dhe të politikës bujqësore në përgjithësi. Për më tepër, ndërhyrjet në treg, si një instrument mbështetës për stabilizimin e tregjeve nuk janë zbatuar fare në periudhën 2008-2012.

Politika e pagesave direkte nuk është e harmonizuar plotësisht me politikën e BE-së. Pagesat për sipërfaqe/krerë bagëti dhe për prodhim ndryshojnë në mënyrë alternuese dominimin e tyre në strukturën e këtij grupi masash.

Figura B.V-7: Pagesat direkte për prodhuesit (milionëEUR) , 2008-2012, IRJ e Maqedonisë



Burimi: Databaza APM e IRJeMaqedonisë

Pagesat direkte për prodhimin (garantimi i çmimeve) janë dhënë kryesisht për duhanin e papërpunuar, rrushin dhe qumështin. Pagesat direkte për duhanin zënë pjesën më të madhe, rreth 66 përqind, ose mesatarisht 17,7 milionë EUR, ndërsa pjesa tjetër është dhënë për rrushin (3.1 milion EUR) dhe qumështin (5.5 milion EUR). Për sa i përket pagesave direkte për sipërfaqe dhe krerë bagëti, gjysma e buxhetit shkon për sektorin e blegtorisë, kryesisht për prodhimet e deleve (mesatarisht 7.8 milionë EUR) dhe mbarështimin e gjedhit (mesatarisht 4.3 milion EUR). Gjysma tjetër i takon bimëve të arave (mesatarisht 2.1 milion EUR), perimeve (1.6 milion EUR), si edhe vreshtave (4.3 milion EUR), me variacione të mëdha vjetore në buxhetin e shpenzuar për sektorin.

Subvencionet e inputeve duket të jenë më pak të rëndësishme për politikën bujqësore. Ato janë pothuajse të papërfillshme duke zënë më pak se 1 përqind të buxhetit të mbështetjes direkte përprodhuesit. Ato janë shpenzuar për blerjen e kafshëve për mbarështim (kryesisht derra, si dhe për dele në vitin 2008 dhe 2009), primet e sigurimit, analiza të tokës, si dhe subvencionet e karburantit (vetëm në vitin 2008).

Masat e zhvillimit strukturor dhe rural

Me Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga viti 2010 dhe zbatimin e programit IPARD, zhvillimi rural ka marrë më shumë rëndësi. Buxheti për masat e zhvillimit strukturor dhe rural është trefishuar, nga 5.4 milion EUR në vitin 2009 deri në 19.2 milionë EUR në vitin 2012.

Figura B.V-8: Masat e zhvillimit strukturor dhe rural (milionë EUR), 2008-2012, IRJ e Maqedonisë



Burimi: Databaza APM e IRJ eMaqedonisë

Masat për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhuesve bujqësorë në zonat rurale dominojnë masat strukturore. Buxheti është rritur në mënyrë konstante si në madhësi (nga 3.8 milion EUR deri në 18.0 milionë EUR), dhe në pjesën që zë (nga 52 përqind deri në 94 përqind). Fondet për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhuesve bujqësorë janë menduar kryesisht për modernizimin e fermave dhe plotësimin e standardeve; kështu masa më e rëndësishme është përkrahja e investimeve, si për fermat bujqësore dhe sektorin agro-ushqimor.

Buxheti për masat agro-ushqimore nuk është duke u rritur. Ai paguhet si subvencion për fermerët që jetojnë dhe operojnë në zonat më pak të favorizuara; dhe që nga viti 2011, më së shumti në lidhje me prodhimin e bujqësisë organike.

Buxheti për përmirësimin e ekonomisë rurale është pothuajse ipapërfillshem në strukturën e buxhetit (0.1-0.6 milionë EUR, për shembull më pak se 5 përqind e mbështetjes për masat strukturore). Mbështetja për popullsinë rurale është kufizuar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës bazë në zonat rurale si dhe në mbështetjen e përgjithshme për ekonominë rurale.

Masa të përgjithshme në lidhje me bujqësinë

Të dhënat aktuale tregojnë se shërbimet e përgjithshme për bujqësinë llogariten mesatarisht 7.9 milion EUR, e cila është 11 përqind e totalit të mbështetjes buxhetore për bujqësinë. Buxheti për masat e përgjithshme për bujqësinë duhet të jetë më i lartë sesa buxheti i paraqitur, pasi nuk përfshin buxhetin e organeve të tjera administrative të MAFWE të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së bimëve, të tilla si organi dhe laboratori administrativ fito-sanitar dhe Inspektoriati për bujqësinë nuk përfshin as buxhetin për arsimin bujqësor.

Buxheti aktual për shërbime të përgjithshme për bujqësinë shkon kryesisht për financimin e institucioneve publike në bujqësi (Agjencia Kombëtare e Ekstensionit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Agjencia e Shërbimeve Hidro-Meteorologjike) dhe financimin e aktiviteteve të saj si ekstensioni, kontrolli veterinar, kontrolli i cilësisë, dhe sistemet e informacionit. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shkon për sigurinë ushqimore (72-87 përqind, ose mesatarisht 6,2 milion EUR). Arsimi profesional dhe trajnimi i fermerëve, është i një rëndësie të madhe për përshpejtimin e zhvillimit bujqësor. Megjithatë, buxheti për këto aktivitete është i papërfillshëm. Shërbimet e ekstensionit, si një tjetër mënyrë për të mbështetur zhvillimin e bujqësisë, janë gjithashtu të nën-përfaqësuara në buxhet, me rreth 1 milion EUR, ose mesatarisht13 përqind.

4. Diskutime dhe konkluzione

Shumica e nënsektorëve brenda sektorit të bujqësisë së Maqedonisë tregojnëpërdorimin e pamjaftueshëm të kapaciteteve të prodhimit dhe një nivel të ulët të produktivitetit. Kjo rezulton në një nivel më të ulët të ofertës së grupeve ushqimore bazë (grurë, mish, qumësht, vaj, sheqer), duke kontribuar në rritjen e importeve dhe defiçitin e tregtisë së jashtme. Rregullimi i tregtisë së jashtme është në përputhje të plotë me rregullat e WTO (pa subvencione eksporti apo inputesh, pa ndërhyrje në treg, dhe pa garanci çmimesh), Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, CEFTA dhe marrëveshjet e tjera dypalëshe të tregtisë së lirë, të cilat e bëjnë tregun maqedonas relativisht të hapur.

Buxheti bujqësor me qëllim përkrahjen e zhvillimit tregon një rritje të vazhdueshme; dhe pagesat direkte janë elementi kryesor i politikës bujqësore kombëtare. Masat specifike dominojnë, duke përfshirë pagesat për hektar dhe për krerë bagëti, si dhe për prodhim, si forma më specifike. Rëndësia e zhvillimit rural për zhvillimin e përgjithshëm të sektorit bujqësor ka qenë e njohur nga krijuesit e politikave, por më pak nga fermerët. Mbështetja për shërbimet e përgjithshme në bujqësi është më e ulët sesa nevojat për transferimin më efikas të njohurive, sigurinë ushqimore dhe të menaxhimit të cilësisë. Krahasuar me vendet e tjera të SEE-së (shikoni kapitullin A.II), politika bujqësore maqedonase tregon nivelin më të lartë të mbështetjes së bujqësisë (me përjashtim të Kroacisë).

Bujqësia maqedonase kërkon zhvillimin dhe modernizim; dhe bujqësi moderne do të thotë ndryshime në tërë strukturën e sektorit bujqësor: prodhimin primar, në zinxhirin agro-ushqimor, tregjet funksionale, shërbimet e përgjithshme dhe institucionet mbështetëse.

Mungesa kryesore e politikës bujqësore të Maqedonisë është devijimi i shpeshtë i transfertave buxhetore të paguara nga programimi afatgjatë dhe vjetor, si dhe nga programet vjetore. Problemi qëndron në mungesën e një qasje strategjike dhe sjelljen e grupeve të interesit (shoqatave të bujqëve dhe aktorëve të tjerë), të përfshira në proces duke demonstruar rezistencë politike për shënjestrimin e problemeve reale dhe propozimin e zgjidhjeve.

Një problem tjetër serioz në politikën bujqësore të Maqedonisë është numri i madh i masave me procedura komplekse, ndërkohë që 58 përqind e fermave bujqësore operojnë në më pak se një hektar tokë bujqësore dhe shumë prej tyre janë me nivel të ulët arsimor. Numri i madh i masave, si në formën e përkrahjes direkte për prodhuesit ose masave strukturore, komplikon procedurat administrative, rrit koston e implementimit dhe çorienton përdoruesit. Duke marrë parasysh strukturën e bujqësisë së Maqedonisë, me prodhuesit e orientuar drejt tregut nga njëra anë dhe fermave të subsistencës në anën tjetër, politikëbërësit duhet të përshtasin masat dhe procedurat e politikave në mënyrë që të plotësojnë nevojat e të gjithë llojeve të fermerëve, dhe të përmbushin objektivat kombëtare. Në këtë drejtim, rekomandimet janë në përputhje me reformën e fundit CAP duke sugjeruar skema mbështetëse të thjeshtuara.

BE-ja zbaton kryesisht formën e përgjithshme të pagesave direkte. Megjithatë, rekomandimi për politikën bujqësore kombëtare është mbajtja e pagesave për sipërfaqe dhe për krerë bagëti tani për tani, pasi rritja e kapaciteteve prodhuese është e rëndësishme në këtë fazë të zhvillimit dhe këto lloj pagesash direkte duket të jenë një masë e duhur për të arritur këtë qëllim. Me qëllim të rritjes së përputhshmërisë me CAP, pagesat për prodhim si forma më specifike kanë nevojë të zëvendësohen gradualisht nga pagesat për sipërfaqe dhe krerë bagëti.

Rritjet e kapaciteteve prodhuese, sidomos në prodhimin bimor, pritet të nxitet nga riaktivizimi i tregut të tokës bujqësore në bazë të ligjit të fundit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi të shtetit dhe strategjisë për konsolidimin e tokës bujqësore. Për më tepër, ligji duhet të promovojë ndryshime në strukturën e fermës, në drejtim të rritjes së madhësisë së fermës dhe konsolidimit të tokës, duke ndryshuar strukturën e prodhimit. Ndryshimet në fermë dhe strukturën e prodhimit, së bashku me nivelin më të lartë të investimeve, pritet të shkaktojnë rritje të mëtejshme të produktivitetit në këtë sektor.

Bujqësia maqedonase kërkon nxitje të zhvillimit përmes investimeve dhe modernizimit të kapacitetetve prodhuese. Në këtë drejtim, masat e zhvillimit strukturor dhe rural janë provuar të jenë më efektive se sa pagesat direkte. Kështu, rritja e parashikuar e buxhetit bujqësor duhet të përdoret për të rritur buxhetin e zhvillimit rural, duke mbajtur nivelin e pagesave të drejtpërdrejta në vlera absolute të pandryshuar. Përveç kësaj, qeveria duhet të intensifikojë zbatimin e programeve të zhvillimit strukturor dhe rural si dhe masave nga popullsia bujqësore dhe rurale.

Së bashku me programet kombëtare për mbështetje financiare dhe financimit të IPARD, duhet të promovohet gjithashtu përdorimi i burimeve të tjera të financimit. Një mënyrë është intensifikimi i sistemit të kredive rurale nëpërmjet Bankës Maqedonase për Promovimin e Zhvillimit. Përveç kësaj, interesi i bankave tregtare për të investuar në bujqësi duhet gjithashtu të rritet. Në këtë drejtim, duhet të krijohen mekanizma për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në këtë treg, të tilla si fondet garantuese.

Shërbimet e përgjithshme në bujqësi janë gjithashtu shumë të rëndësishme. Me reformën e fundit të CAP, BE-ja e njeh inovacionin dhe transferimin e njohurive si esencën e zhvillimit bujqësor dhe rural. Duke marrë parasysh situatën e Maqedonisë, ekziston nevoja për të rritur mbështetjen financiare dhe institucionale për të forcuar më tej kapacitetet e shërbimeve kombëtare të ekstensionit dhe studimit, si dhe për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e punës së tyre. Përdorimi i shërbimeve të ekstensionit mund të stimulohet me anë të masave mbështetëse të qeverisë, si sistemi i tollonave.

Përmirësimet në zinxhirin agro-ushqimor janë gjithashtu të nevojshme. Midis masave të tjera, fokusi duhet të vihet në integrimin vertikal. Forcimi i marrëdhënieve dhe besimit midis aktorëve në zinxhirin e vlerës mund të sjellë dobi në të gjitha hallkat duke siguruar besueshmërinë në ofertën dhe kërkesën e inputeve bujqësore dhe produkteve finale. Përveç kësaj, promovimi i kooperativave dhe formave të tjera të bashkëpunimit mund të rrisë fuqinë negociuese të prodhuesve primarë bujqësorë dhe mund të forcojë pozitën e tyre në treg.

Institucionet që lidhen me bujqësinë (qeveritare, akademike dhe OJQ-të) duhet të zhvillojnë më tej kapacitetet dhe infrastrukturën analitike të tyre. Harmonizimi i mëtejshëm i të dhënave në përputhje me standardet dhe metodologjinë ndërkombëtare është i nevojshëm, siç është harmonizimi i të dhënave midis institucioneve (p.sh. midis statistikave kombëtare dhe regjistrave të brendshme në MAFWE).

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të politikave dhe analiza e impaktit janë mjete për të identifikuar argumentat pro dhe kundër masave të zbatuara. Pjesëmarrja e institucioneve akademike në procesin e hartimit të politikave mund të shërbejë si një urë midis politikëbërësve dhe aktorëve (popullsia bujqësore dhe rurale dhe industria agro-ushqimore), duke mbështetur proceset e hartimit të politikave të bashkuara për përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta, dhe për të stabilizuar politikën. Duke sjellë pikëmpamje më strategjike të të gjitha palëve të interesuara, nevoja për ndryshime të shpeshta në politikë mund të lehtësohet. Vetëm nga të menduarit strategjik të të gjitha palëve të interesuara qëllimet e përcaktuara në dokumentet strategjike mund t'i rezistojnë presioneve dhe ndryshimeve politike.

Referenca

Dimitrievski, D., Georgiev, N., Simonovska, A., Martinovska Stojceska, A. & Kotevska, A.2010. Review of agriculture and agricultural policy in FYR Macedonia. In: Volk T. (ed.): Agriculture in the Western Balkan Countries. Halle: IAMO. p. 145-164 (available at http://purl.umn.edu/96200).

Dimitrievski, D. & Kotevska, A. 2008. Challenges faced by the agro-food sector in the Republic of Macedonia regarding its integration in the EU markets. Agriculture in Western Balkans and EU integration. Ljubljana: DAES. p. 47-67.

IPARD Committee. 2013. Semi-Annual Monitoring Report on the Implementation of the IPARD Program 2007-2013 (period May 2013 - October 2013). Skopje: Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy. (In Macedonian).

Macedonia APM Database. 2014. Agricultural Policy Measures Database compiled for Macedonia under the FAO/SWG project "Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession" (unpublished data).

MAFWE. 2007. National Strategy for Agriculture and Rural Development for period 2007-2013. Skopje: Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy. (In Macedonian).

MAFWE. 2009. National Program for Agricultural Policy and Rural Development for the period 2010-2014. Skopje: Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy. (In Macedonian).

MAFWE. 2010. Annual Report for Agriculture and Rural Development. Skopje: Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy.

MAFWE. 2011. Annual Report for Agriculture and Rural Development. Skopje: Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy.

MAFWE. 2012. Annual Report for Agriculture and Rural Development. Skopje: Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy.

Rednak M. & Volk, T. 2010. Agricultural Policy Measures Template – A Tool for Classifying and Analyzing Agricultural Policy Measures. In: Volk T. (ed.): Agriculture in the Western Balkan Countries. Halle: IAMO. p. 219-246 (available at http://purl.umn.edu/96200) pp. 219-246).

SSO. Statistical Yearbooks. Skopje, State Statistical Office of Republic of Macedonia.

SSO. 2007. Census of agriculture. Skopje, State Statistical Office of Republic of Macedonia

SSO. 2013. Farm Structure Survey, 2013 – preliminary data. Skopje, State Statistical Office of Republic of Macedonia

SSO. 2014. Wine statistics. Skopje, State Statistical Office of Republic of Macedonia.

Aneksi B.V-1: Sipërfaqet dhe prodhimi i kulturave kryesore, 2005-2012, IRJ e Maqedonisë

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Sipërfaqja e prodhimit (1 000 ha)								
Total	203.2	187.9	180.6	176.7	179.4	163.4	161.3	163.0
- Grurë	108.9	99.1	92.0	86.9	88.3	80.0	79.0	79.7
- Misër	33.6	31.9	31.1	31.6	32.8	28.7	29.4	29.2
Farëra vajore	5.4	3.7	3.7	5.0	4.2	4.1	5.7	3.8
Patate	13.5	13.6	14.0	13.8	13.9	13.4	13.8	13.4
Rrush (total)	25.0	24.3	21.3	21.8	20.0	20.0	20.0	21.0
Fruta (Pemëtore totale)	13.0	13.0	13.0	13.9	14.0	14.0	14.0	15.0
Perime (total)	30.9	30.6	31.0	30.8	31.6	32.1	29.1	29.2
Tjetër:								
- Duhan	18.5	17.5	17.2	17.1	17.8	20.3	19.7	19.6
- Fasule	14.4	14.5	13.9	13.6	13.9	13.3	13.6	13.8
- Foragjere	26.4	26.5	27.5	26.7	27.6	27.5	27.2	29.0
Sipërfaqja e prodhimit (1 000 ha)								
Total	644.6	602.2	468.6	613.0	605.6	538.5	551.6	456.8
- Grurë	333.9	293.3	218.1	291.7	271.1	243.1	256.1	215.0
- Misër	148.2	147.5	118.4	127.1	154.2	129.0	126.1	115.9
Farëra vajore	6.7	6.0	3.6	5.4	7.8	7.6	8.5	115.9
Patate	190.4	189.9	180.9	189.4	204.7	200.1	192.7	168.9
Rrush (total)	265.7	254.3	209.7	236.8	253.5	253.4	235.1	277.4
Fruta (Pemëtore totale)	150.3	167.3	221.5	251.5	184.8	199.7	200.6	203.6
Perime (total)	537.8	569.5	547.0	569.2	628.5	722.3	655.6	655.1
Tjetër:								
- Duhan	27.7	25.0	22.1	17.1	24.1	30.3	26.5	28.6
- Fasule	14.2	14.9	10.9	12.8	14.8	14.2	13.0	11.0
- Foragjere	194.1	202.5	198.2	178.4	210.7	210.5	201.6	178.5

Burimi: SSO

Aneksi B.V-2: Çmimet bujqësore të prodhuesit në fermë(EUR/t), 2005-2012, IRJ e Maqedonisë

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Grurë	142.2	119.9	177.8	213.0	116.4	171.1	239.9	246.7
Misër	117.5	132.1	194.8	244.5	132.2	171.1	240.6	217.6
Elb	121.0	122.8	160.2	186.1	239.1	127.1	211.8	221.7
Patate	176.4	249.7	478.4	227.8	155.2	254.2	477.0	179.5
Speca	235.5	230.0	893.8	608.7	250.4	273.3	218.2	315.8
Domate	363.3	422.5	554.4	573.4	614.4	657.3	285.7	361.8
Gjedh i majmëruar për therje (peshë e gjallë)	1 124.3	1 108.9	1 113.6	1 498.6	922.1	904.5	1 285.6	1 070.0
Viça (peshë e gjallë)	:	:	:	:	1 963.2	1 518.5	1 676.2	1 828.0
Derra të majmëruar për therje (peshë e gjallë)	1 423.4	1 418.3	1 404.7	1 362.0	1 227.8	1 380.3	1 483.6	1 822.2
Mish qingji (peshë e gjallë)	2 184.9	2 226.4	2 087.8	2 338.4	2 431.8	2 288.6	2 573.8	2 709.0
Qumësht lope	247.1	283.2	274.7	379.3	253.6	269.6	286.2	310.1

Burimi: SSO

Kapitulli B.VI

BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË MAL TË ZI

Milan Marković*

1. Hyrje

Mali i Zi është vend kandidat për anëtarësim në BE. Në tetor të vitit 2007, Mali i Zi nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (SAA), e cila hyri në fuqi në janar të vitit 2008 si Marrëveshje e Përkohshme për Tregtinë dhe Çështjet e lidhura me Tregtinë. SAA hyri në fuqi në maj 2010. Gjithashtu në vitin 2010, Komisioni Evropian i hapi rrugën aplikimit të Malit të Zi, duke identifikuar shtatë prioritetet kyçe për të filluar negociatat, dhe Këshilli Evropian i dha vendit statusin e kandidatit. Në dhjetor 2011, Këshilli filloi procesin e anëtarësimit dhe negociatat filluan në qershor 2012.

Për bujqësinë dhe ekonominë rurale të Malit të Zi procesi i integrimit në BE është shumë kompleks
dhe i nevojshëm. Bujqësia ka trashëguar vështirësi nga e kaluara (ferma të vogla subsistence, prodhimi tradicional, nivel i ulët i produktivitetit), dhe konkurueshmëria e sektorit agro-ushqimor është një nga pikat e tij të dobëta.

Shumë detyra duhet të plotësohen përpara se Mali i Zi të mund të anëtarësohet në BE. Një detyrë e rëndësishme është përgatitja e programit IPARD dhe dokumentet e tij mbështetëse, si dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative (teknike dhe njerëzore) duke krijuar parakushte për krijimin e një agjencie të pagesave.

Një nga sfidat më të mëdha është përgatitja e strategjisë për bujqësinë dhe zhvillimin rural me planin e veprimit të harmonizimit me *acquis të BE-së*. Komisioni Evropian njohu strategjinë për periudhën 2014-2020, si një pikë referimi për fillimin e negociatave në Kapitullin 11 - Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Strategjia pritet të miratohet deri në fund të vitit 2014.

Qëllimi i këtij dokumenti është të prezantojë aspektet kryesore të sektorit të bujqësisë së Malit të Zi dhe politikën e saj bujqësore, me fokus anëtarësimin në BE.

Lidhur me metodologjinë e zbatuar, është kryer studim teorik-analitikbazuar në të dhënat dhe informacionet e grumbulluara nga disa burime. Të dhënat statistikore janë marrë nga Zyra Statistikore e Malit të Zi (MONSTAT) dhe EUROSTAT. Për analizimin e politikave bujqësore janë përdorur dokumentet ligjore dhe strategjike, studime sektoriale si dhe dokumente të tjera në dispozicion nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Duke pasur parasysh se të dhënat për pagesat e kryera nga buxheti i bujqësisë nuk janë të disponueshme, mbështetja buxhetore për bujqësinë është vlerësuar bazuar në shumat e planifikuara në programet vjetore (Agro-buxhetore). Masat e politikës bujqësore janë sistemuar në bazë të klasifikimit uniform duke përdorur formatin APM (Rednak et al., 2013).

Në pjesën e parë, analizohet sektori i bujqësisë duke u bazuar në të dhënat e përgjithshme, i cili ndiqet nga një përshkrim i karakteristikave të prodhimit dhe të tregtisë agro-ushqimore. Pjesa

* Fakulteti Bioteknik, Universiteti i Malit të Zi, Podgoricë

tjetër hedh një vështrim mbi dokumentet programuese dhe strategjike të politikës bujqësore, si dhe masate zbatuara të politikave në vitet e fundit. Seksioni i fundit shqyrton hendeqet kryesore në hartimin e politikave bujqësore dhe zbatimin në kuadrin e procesit të anëtarësimit në BE dhe nxjerr konkluzionet dhe rekomandimet kryesore për harmonizimin me CAP.

2. Bujqësia

2.1 Roli i bujqësisë në ekonomi

Mali i Zi është një vend i vogël, me një sipërfaqe prej 13 812 km^2 dhe në bazë të censusit të vitit 2011 ka 620 029 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë është 45 banor për km^2, duke e bërë Malin e Zi një nga vendet më pak të populluara në Evropë.

Sektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë malazeze. Pjesa që zinte bujqësia, gjuetia dhe pylltaria në Vlerën e Shtuar Bruto (GVA) ishte 9.5 përqind (2011).

Të dhënat e punësimit që publikohen rregullisht nga MONSTAT i referohen vetëm subjekteve të biznesit (ndërmarrjeve, kooperativave, etj.), dhe jo punësimit në fermat bujqësore familjare. Të dhënat e vetme të plota për punësimin në bujqësi janë në dispozicion nga Censusi i Bujqësisë 2010. Sipas këtyre të dhënave, 47 870 njësi pune vjetore (AWU) u angazhuan në bujqësi në 48 870 ferma bujqësore. Bazuar në këto të dhëna, dhe të dhënat mbi punësimin total në Malin e Zi (201 000 persona në vitin 2012, MONSTAT), mund të vlerësohet se kontributi i bujqësisë në punësimin e përgjithshëm në vend është rreth 24 përqind. Kontributi i bujqësisë në GVA dhe punësim në Mal të Zi është i ngjashëm me vendet e tjera të SEE-së (shikoni Kapitullin A.II).

2.2 Burimet e tokës dhe struktura e fermës

Burimet e tokës bujqësore, me sipërfaqe totale prej 515 740 ha ose rreth 0.83 ha për frymë, paraqesin atributin më të rëndësishëm ekonomik të vendit dhe mbulojnë 37.3 përqind të sipërfaqes totale. Megjithatë, kullotat zënë deri tani pjesën më të madhe të sipërfaqes totale të tokës (63 përqind), ndjekur nga livadhet natyrore (25 përqind). Këto dy kategori së bashku (450 843 ha) përbëjnë rreth 88 përqind të totalit të tokës bujqësore.

Megjithatë, këto burime të tokës janë qartësisht të mbivlerësuara. Censusi i bujqësisë 2010 tregoi një sipërfaqe shumë më të vogël bujqësore (309 241 ha).

Tabela B.VI-1: Toka bujqësore totale e disponueshme dhe e përdorur, 2010, Mali i Zi

Treguesi	2010
Tokë bujqësore e disponueshme (Total)	309 241 ha
- Tokë bujqësore në pronësi të mbajtësit	176 251 ha (57%)
- Tokë bujqësore me qira dhe kolektive	132 989 ha (43%)
Toka bujqësore për fermë (mesatare)	6.3 ha
Sipërfaqe bujqësore e përdodur (Total)	221 289 ha
- Tokë e punueshme dhe kopshte	6 460 ha (2.9%)
- Kulturat e përhershme	4 650 ha (2.1%)
- Kullotat e përhershme	210 180 ha (95.0%)
UAA për fermë (mesatare)	4.5 ha

Burimi: MONSTAT (Censusi i bujqësisë 2010)

Duke marrë parasysh vetëm sipërfaqen bujqësore të përdorur (221 289 ha UAA) pjesa që ajo zë në territorin e përgjithshëm është vetëm 16 përqind. Midis vendeve të tjera të BE-së, vetëm Finlanda (6.8 përqind), Suedia (6.9 përqind), dhe Qiproja (12.8 përqind), kanë përqindje më të ulët të UAA në

territorin total. Lidhur me pjesën e kullotave të përhershme në sipërfaqen bujqësore të përdorur totale, Mali i Zi me 95 përqind zë vendin e parë.

UAA mesatare për fermë bujqësore në Mal të Zi nuk është shumë më e ndryshme se sa në vendet e tjera të SEE-së, por edhe në disa vende të BE-së (të tilla si Qipro, Rumania, Kroacia, Sllovenia). Madhësia mesatare e fermës është 4.5 ha e UAA për fermë. Pjesa e fermave bujqësore me më pak se 1 ha të UAA është shumë e lartë (55.1 përqind). Nga ana tjetër 40 përqind e sipërfaqes bujqësore është përdorur nga 431 ferma (0.9 përqind), të cilat janë më të mëdha se 100 ha.

Tabela B.VI-2: Struktura e fermave bujqësore sipas klasës së madhësisë, 2010, Mali i Zi

	Fermat bujqësore		UAA	
Klasat e madhësisë	**Numër**	**%**	**ha**	**%**
< 0.50 ha	18 526	37.8	4 130	1.9
0.50- < 1.00 ha	8 467	17.3	6 347	2.9
1.00- < 5.00 ha	16 494	33.7	36 025	16.3
5.00- < 10.00 ha	2 712	5.6	18 532	8.4
10.00- < 20.00 ha	1 157	2.4	15 490	7.0
20.00- < 50.00 ha	642	1.3	20 207	9.1
50.00- < 100.00 ha	441	0.9	31 646	14.3
> 100 ha	431	0.9	88 912	40.2
Totali	**48 870**	**100.0**	**221 289**	**100.0**

Burimi: MONSTAT (Censusi i bujqësisë 2010)

Kur merren në konsideratë burimet e tokës, është e rëndësishme të përmendet se 2 650 ha ujiten rregullisht në zonën fushore në afërsi të Podgoricës, duke përfshirë vreshta të mëdha me më shumë se 2 300 ha. Sistemi i kullimit mbulon 1 640 ha.

2.3 Prodhimi bujqësor

Indekset e prodhimit për bimët, blegtorinë dhe bujqësinë në përgjithësi nuk tregojnë prirje të qarta - as rritje as ulje - në prodhimin për periudhën 2005-2012. Megjithatë, luhatje shumë të mëdha në prodhimin e drithrave, dhe si pasojë në blegtori dhe prodhimin e përgjithshëm, mund të vihen re, kryesisht për shkak të kushteve ekstreme të motit (thatësira të rënda në vitin 2007 dhe 2012).

Figura B.VI-1: Indekset e volumit të prodhimit bujqësor, 2005-2012 (2005=100), Mali i Zi



Burimi: MONSTAT

Në Mal të Zi, pjesa që zë prodhimi bimor ndaj prodhimit bujqësor total është më e lartë (rreth 58 përqind në vitin 2011), sesa pjesa që zë sektori i blegtorisë (42 përqind). Duke pasur parasysh strukturën e burimeve të tokës (pjesa e lartë që zënë kullotat e përhershme), mund të konkludohet se prodhimi në sektorin e blegtorisë së Malit të Zi është mjaft i ulët. Me fjalë të tjera, burimet e tokës në dispozicion nuk janë përdorur plotësisht, pasi ato mund të ofrojnë ushqim për një popullsi shumë më të madhe ripërtypësish, duke çuar në rritjen e prodhimit të qumështit dhe mishit.

Për sa i përket prodhimit bimor, kulturat kryesorejanë perimet, rrushi, patatet, frutat dhe ullinjtë, ndërsa drithërat zënë një përqindje shumë të vogël për sa i përket sipërfaqes së mbjellë (e cila është karakteristike për bujqësinë malazeze).

Vreshtat mbulojnë 4 400 ha, dhe varietetet autoktone (Vranac dhe Kratosija)dominojnëkryesisht për prodhimin e verës së kuqe, dhe prodhimi total i rrushit në vitin 2011 është 32 800 ton. Pemët frutore dhe ullishtet janë rritur në 12 007 ha, me prodhim vjetor prej 42 100 ton. Në kultivimin e ullirit, mbizotërojnë metodat tradicionale të prodhimit; ka pak më shumë se 400 000 rrënjë ullinj, me varietetin autokton Zutica që dominon, duke zën më shumë se 90 përqind.

Figura B.VI-2: Ndarja e sipërfaqes së korrur sipas kulturave kryesore, 2011, Mal i Zi



Burimi: MONSTAT

Sipërfaqja e përdorur për prodhimin e perimeve është rreth 8 000 ha, dhe prodhimi është 143 300 ton në 2011. Prodhimi i perimeve në serra (60 ha), tregon rezultate pozitive në aspektin e vëllimit, gamës së produkteve dhe zgjerimit të sezonit të kultivimit. Prodhimi i patates është shumë i rëndësishëm dhe sipërfaqja e mbjellë është10 900 ha, me prodhim total prej 180 000 ton në vitin 2011.

Sektori blegtoral i Malit të Zi është i dominuar nga mbarshtimi i imtave, kryesisht për shkak të sipërfaqes së madhe me livadhe dhe kullota. Mbarështimi i gjedhit, me 84 701 krerë (2012) është nën-sektori më i madh i prodhimit blegtoral. Mbarshtimi i deleve (me 207 047 krerë), karakterizohet nga metodat gjysëm-ekstensive të prodhimit, kryesisht në veri të vendit. Mbarshtimi i dhive është gjithashtu një sektor i rëndësishëm, sidomos në zonat karstike (Rajonet Qendrore dhe Jugore). Prodhimi i pulave dhe i derrave është i dobët, kryesisht për shkak të mungesës së prodhimit vendas të ushqimit të kafshëve.

Niveli i ulët teknologjik i prodhimit bujqësor në Mal të Zi është shkaktar i rendimenteve të ulëta mesatare. Me përjashtim të rrushit, rendimentet mesatare të kulturave të tjera janë shumë të ulëta. Vetëm patatet tregojnë trend rritës të rendimenteve.

Qumështi i lopës zë më shumë se 90 përqind të prodhimit total të qumështit.Rendimenti mesatar për lopë është shumë i ulët,më pak se 3 000 litra. Arsyeja kryesore për këtë rendiment të ulët është mbizotërimi i fermave të vogla të subsistencës, të cilat nuk janë të motivuara për të rritur prodhimin ose për të futur teknologji të reja. Struktura racore gjithashtu nuk është e favorshme, pasi rreth 50 përqind e kopeve të lopëve malazeze i përkasin kryqëzimeve që janë pak produktive. Përveç kësaj, shumica e fermave prodhojnë qumësht në zonat më pak të favorizuara kodrinore-malore.

Tabela B.VI-3: Rendimenti mesatar i grurit, patatave, rrushit dhe qumështit, 2005-2011, Mali i Zi

Produkti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Grurë i zakonshëm (t/ha)	3.10	3.09	2.50	3.50	3.81	3.52	3.06
Patate (t/ha)	12.88	13.05	10.50	13.15	15.18	14.63	16.53
Rrush (t/ha)	9.14	9.97	8.43	10.48	8.78	9.27	7.46
Qumësht lope (t/lopë)	2.40	2.35	2.38	2.28	2.21	2.18	3.30

Burimi: MONSTAT

Një nga karakteristikat strukturore të prodhimit ushqimor të Malit të Zi është niveli i ulët i finalizimit të prodhimeve bujqësore, një pjesë e rëndësishme e vetë-furnizimit, si dhe shitjet e konsiderueshme të produkteve agro-ushqimore nëpërmjet kanaleve tregtare të paregjistruara. Pavarësisht rezultateve pozitive të arritura në disa sektorë në vitet e fundit (mishit dhe verës), industria agro-ushqimore është ende e dobët dhe nuk mund të jetë një forcë shtytëse për zhvillimin e shpejtë të prodhimit primar. Përveç kësaj, ajo ka strukturë të papërshtatshme të madhësisë së fermave. Sipas Strategjisë (MARD 2006), rreth 70 përqind e ndërmarrjeve punësojnë më pak se 15 punëtorë dhe vetëm katër ndërmarrje punësojnë më shumë se 250 persona. Situata aktuale është e ngjashme dhe njësitë e vogla të përpunimit mbizotërojnë. Struktura e madhësisë së ndërmarrjeve dhe niveli i pafavorshëm teknik shkaktojnë një nivel të ulët të konkurrueshmërisë në industrinë agro-ushqimore.

2.4 Tregtia e mallrave agro-ushqimore

Mali i Zi është një importues neto i produkteve agro-ushqimore me varësi shumë të lartë nga importet ushqimore. Totali i eksporteve nuk mbulon më shumë se 13 përqind të importeve. Në vitet e fundit eksportet janë rritur lehtësisht nga 41 milionë EUR në vitin 2008 në rreth 57 milionë EUR në vitin 2012, ndërsa për të njëjtën periudhë importet përjetuan një rritje relativisht të vogël. Si pasojë, bilanci negativ tregtar ka mbetur në të njëjtin nivel, ndërsa raporti i eksporteve ndaj importeve, në terma relativë, është rritur nga 9.6 përqind në vitin 2008 në 12.8 përqind në vitin 2012.

Tabela B.VI-4: Tregtia agro-ushqimore (milionë EUR), 2005-2012, Mali i Zi

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Eksportet	68.9	70.1	37.4	41.0	40.7	46.5	52.4	56.7
Importet	199.2	228.7	312.7	426.0	397.6	406.4	438.9	443.4
Bilanci tregtar	-130.3	-158.6	-275.3	-385.0	-356.9	-359.9	-386.5	-386.7
Raporti Eksport/Import	34.6%	30.6%	12.0%	9.6%	10.2%	11.4%	11.9%	12.8%

Burimi: MONSTAT

Në vitin 2012, vetëm pijet zinin më shumë se 40 përqind të vlerës së eksporteve (23.3 milionë EUR). Vera është pija më e rëndësishme (15.4 milionë EUR, ose 2/3). Produktet e tjera të rëndësishme të eksportit janë mishi (4.4 milionë EUR); perimet (3,3 milionë EUR); frutat (4.0 milionë EUR); preparatet e mishit (3.1 milionë EUR) si dhe preparatet e drithërave, miell apo niseshte (4,1 milion EUR). Eksporti i mishit dhe preparateve të mishit është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, nga 2.0

milionë EUR në vitin 2005 në 7.5 milionë EUR në vitin 2012, si rezultat i tendencave pozitive në industrinë e re të mishit.

Brenda totalit të importeve, me vlerë 443 milionë EUR në vitin 2012, grupet kryesore të tarifave janë mishi (65.5 milionë EUR); pijet (53.6 milionë EUR); produktet e bulmetit (43.5 milionë EUR); preparatet e drithërave (28.6 milionë EUR); dhe preparate të ndryshme të ngrënshme (28 milionë EUR). Bilanci i tregtisë së jashtme të Malit të Zi është negativ për të gjitha grupet e produkteve agro-ushqimore. Bilancet më të mëdha negative janë për mishin (-61.2 milionë EUR); produktet e bulmetit (-43.4 milionë EUR) dhe pijet (-30.4 milionë EUR).

Figura B.VI-3: Përbërja e importeve dhe eksporteve agro-ushqimore sipas grupmallrave, 2012, Mali i Zi



Burimi: MONSTAT

Për sa i përket destinacioneve të eksporteve/importeve, tregu më i rëndësishëm i Malit të Zi janë vendet e Evropës Juglindore(SEE).

Figura B.VI-4: Struktura gjeografike e tregtisë agro-ushqimore, 2011, Mali i Zi



Burimi: MONSTAT

Eksportet malazeze në BE janë shumë modeste (rreth 6 milionë EUR), ndërsa importet janë mbi 100 milionë EUR. Kështu eksportet kompensojë vetëm rreth 5 përqind të importeve nga BE-ja.

Tabela B.VI-5: Tregtia agro-ushqimore sipas rajonit dhe vendeve (milionë EUR), mesatarja 2010-2012, Mali i Zi

Vendi/Rajoni	Eksport	Import	Bilanci tregtar
Vendet e Evropës Juglindore	**40.6**	**272.2**	**-231.6**
- Bosnja dhe Hercegovina	10.1	16.7	-6.6
- Kroacia	0.8	23.1	-22.4

- IRJe Maqedonisë	0.7	11.7	-11.0
- Serbia	14.1	218.7	-204.7
- Shqipëria	2.6	0.7	1.9
- Kosova*	12.5	1.3	11.1
EU-27	**5.5**	**107.1**	**-101.6**
Vendet e tjera	**5.7**	**50.2**	**-44.5**
Totali	**51.9**	**429.6**	**-377.7**

Burimi: MONSTAT

Midis vendeve të SEE-së, Serbia është partneri më i madh i importit, duke zënë 51 përqind të të gjitha importeve (ose 80 përqind të importeve drejt vendeve të SEE-së). Megjithatë, për sa i përket eksportit, Kosova* është në pothuajse në të njëjtin nivel si Serbia (13 milionë EUR dhe 14 milionë EUR, respektivisht). Ndryshe nga Serbia me të cilën Mali i Zi ka bilanc të madh negativ tregtar, bilanc i rëndësishëm pozitiv ekziston me Kosovën* (11 milionë EUR) dhe një bilanc i vogël pozitiv me Shqipërinë.

Konkluzioni i përgjithshëm është se Mali i Zi është shumë i varur nga importet me shpërndarje të konsiderueshme të asortimenteve të produkteve të importuara. Analiza e tregut të huaj i dërgon një sinjal të qartë prodhuesve agro-ushqimor vendas për të punuar në ristrukturimin e prodhimit dhe për të krijuar kushtet për reduktimin e defiçitit ose ta zvogëlojnë atë për produkte të caktuara. Numri relativisht i vogël i produkteve të eksportuara thekson problemin e konkurrueshmërisë së prodhimeve vendase, duke marrë parasysh cilësinë, çmimet dhe sasitë e mundshme që mund të dërgohen jashtë Malit të Zi.

3. Politika bujqësore

3.1 Koncepti dhe kuadri i politikës bujqësore

Politika bujqësore malazeze gjatë dy dekadave të fundit mund të konsiderohet në dy periudha të njëpasnjëshme; përkatësisht, para 2006 dhe pas 2006.

Deri në vitin 2006, u prezantuan shumë ndryshime të rëndësishme në konceptin e politikave: fermat familjare filluan të trajtohen në mënyrë të barabartë me fermat e mëdha (ish "sektori socialist"); krijimi i politikës së tregtisë së jashtme dhe harmonizimi gradual i saj me parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO); përmirësimi i nivelit profesional dhe arsimor i prodhuesve dhe shërbimeve të ekspertëve në bujqësi; forcimi i mbështetjes institucionale për sektorin e bujqësisë nëpërmjet krijimit të shërbimeve dhe laboratorëve të rinjdhe modernizimit të shërbimeve dhe laboratorëve ekzistues.

Për sa i përket përpjekjeve të rëndësishme dhe hapave të ndërmarra, nuk ka pasur politika të qëndrueshme bujqësore deri në strategjinë "Bujqësia e Malit të Zi dhe Bashkimi Evropian - prodhimi i ushqimit dhe zhvillimi rural" që u miratua në vitin 2006. Strategjia është një pikë kthese në reformën bujqësore të Malit të Zi. Ajo siguron një platformë për harmonizimin e politikave bujqësore, legjislacionin dhe mbështetje institucionale për bujqësinë me parimet dhe kërkesat e procesit të anëtarësimit në BE. Me Strategjinë, Mali i Zi zgjodhi konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor, duke krijuar një ekuilibër midis zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe aspekteve sociale. Ky koncept përdor rolin e shumëfishtë të bujqësisë si bazë për vendosjen e bujqësisë në një kontekst shumë më të gjerë se sa vetëm kontributin e saj ndaj PBB-së.

Në politikën bujqësore ndjekur sipas Strategjisë, masat e zhvillimit rural kanë rol më të rëndësishëm në vendosjen e tre objektivave kryesore: rritjen e konkurrueshmërisë, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, si dhe sigurimin e cilësisë së jetës dhe diversifikimin e veprimtarive ekonomike në zonat rurale. Strategjia ofron një kuadër për reforma të mëtejshme në bujqësi me fokus të veçantë mbi rolin e shtetit në përafrimin me BE-në.

Dokumenti më i rëndësishëm për zbatimin e Strategjisë është Programi Kombëtar për Prodhimin e Ushqimit dhe Zhvillimit Rural, i cili u miratua në vitin 2008. Si një dokument operacional Programi Kombëtarpërshkruan objektivat, afatet strategjike dhe ligjore si dhe pikat fillestare për harmonizimin e politikës bujqësore me CAP.

Masat e politikës bujqësore janë përshkruara në detaje. Çdo masë përbëhet nga elementet themelore të nevojshme për zbatimin e saj. Një plan financiar pesë-vjeçar u paraqit, pasi u krijua nëpërmjet grupeve të masave të politikës, dhe gjithashtu është përcaktuar plani për çdo masë me burime financiare.

Si një plan shumë-vjeçar i buxhetit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, programi kombëtar përbëhet nga shtyllat dhe masat e mëposhtme:

- Ndërhyrjet në treg dhe pagesat direkte (9 masa; 29.0 përqind e fondeve totale)
- Politikat e zhvillimit rural (17 masa; 39.3 përqind)
- Mbështetja e shërbimeve të përgjithshme në bujqësi (8 masa; 18.0 përqind)
- Transferta sociale për popullsinë rurale (11.2 përqind)
- Mbështetja administrative dhe teknike (2.5 përqind)

Programi Kombëtar ofroi bazën për përgatitjen e buxhetit vjetor për bujqësinë (Agro-buxhet). Praktikisht të gjitha masat sipas programit kombëtar gjenden në buxhetin e bujqësisë. Megjithatë, disa prej tyre nuk janë zbatuar.

Dokumenti kryesor ligjor për politikën bujqësore është Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, miratuar në vitin 2009. Ligji merr përsipër objektivat dhe politikat bujqësore të Strategjisë dhe u jep atyre formën e nevojshme ligjore. Politika bujqësore është e organizuar në katër grupe kryesore; përkatësisht, politikat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve, politikat e zhvillimit rural, mbështetje për shërbimet e përgjithshme në bujqësi, si dhe transfertat sociale për popullsinë rurale.

Forma më e rëndësishme e mbështetjes në grupin e parë të politikave janë pagesat direkte (bazuar në sipërfaqë ose krerë bagëti), çka është në përputhje me parimet e WTO.

Grupi i dytë është politika e zhvillimit rural e cila luan një rol kyç në politikën bujqësore të Malit të Zi. Ajo është projektuar me katër grupe themelore të masave (boshte). Boshti i parë është i orientuar drejt përforcimit të konkurrueshmërisë së prodhuesve të ushqimit nëpërmjet përkrahjes për investimet në prodhimin primar dhe industritë përpunuese, si dhe investime për realizimin e politikës së tokës, mbështetje për futjen e standardeve ndërkombëtare dhe organizatat e prodhuesve.

Boshti i dytë ka të bëjë me menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, ku është parashikuar mbështetja për zhvillimin e zonave më pak të favorizuara për masat e bujqësisë dhe masat agro-mjedisore.

Boshti i tretë përfshin masa për mbështetjen e cilësisë së jetës dhe diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale.

Boshti i katërt i masave për zhvillimin rural duhet të stimulojë dhe mbështesë komunitetet lokale dhe grupet lokale në krijimin dhe zbatimin e strategjive dhe projekteve të tyre të zhvillimit.

Grupi i tretë i masave të politikës bujqësore i referohet mbështetjes financiare për shërbime të përgjithshme për bujqësinë të cilat janë meinteres publik: fillimisht politikat veterinare dhe fitosanitare, pastaj shërbimet e ekstensionit, mbarështimit të kafshëve dhe bimëve dhe shërbime të tjera profesionale në blegtori dhe prodhimin bimor, politikat e mbështetjes së kërkimeve, infrastruktura analitike dhe edukimi në bujqësi.

Grupi i katërt i masave të politikës bujqësore i referohet transfertave sociale për familjet bujqësore.

3.2 Masat e politikës bujqësore

Masat e stabilizimit të tregut

Ndërhyrjet në treg përbëhen nga dy masa; përkatësisht, programi i ndërhyrjes në treg, dhe menaxhimi i riskut në bujqësi.

Programi i Ndërhyrjes në Treg përfshin ndërhyrje për blerjen e ushqimevedhe ndihmën me ushqime me qëllim eleminimin e disekuilibrave sezonale midis ofertës dhe kërkesës, për të nxitur konsumin e produkteve të veçanta vendase me teprica sezonale dhe për të mbështetur ofrimin e disa produkteve bujqësore me çmime të përballueshme për kategori të caktuara të popullsisë në vështirësi. Programi është zbatuar si mbështetje për mbledhjen dhe tregtimin e tepricave sezonale të perimeve dhe qingjave.

Mbështetja për menaxhimin e riskut në bujqësi përbëhet nga bashkë-financimi i shpenzimeve të sigurimit kundrejt dëmeve bujqësore dhe blegtorale; kompensim për dëmin e shkaktuar nga kafshët e egra; dhe mbështetje financiare për prodhuesit bujqësorë në rast të dëmtimeve nga moti dhe dëmeve të tjera të mëdha.

Pagesa direkte për fermerët

Mbështetja e drejtpërdrejtë për prodhimin bimor zbatohet për hektar të tokës së kultivuar për bimët kryesore të arave: drithëra, patate, bimë foragjere (bimë për prodhim silazhi, bimë foragjere vjetore dhe shumëvjeçare, përzierje bar-fasule dhe jonxhë), "buckwheat"[35] dhe bimë të tjera (përveç duhanit). Pagesat direkte janë ndarë edhe për prodhimin e farërave të bimëve të lartpërmendura. Sipërfaqja minimale e kulturave individuale që të jenë të përshtatshme për mbështetje është 0.5 ha, ndërsa për drithërat është 1 ha. Kultura të ndryshme nuk mund të mblidhen së bashku për të përmbushur këtë minimum. Një fermë mund të aplikojë për mbështetje për secilën prej kulturave të përshtatshme individuale. Në vitin 2012 dhe 2013, pagesa bazë për bimët e prodhuara për qëllime tregtare apo ushqim ishte 160 EUR për ha, për bimët foragjere 150 EUR për ha, për prodhimin e farës së drithërave 300 EUR për ha, dhe farë patatesh elite 700 EUR për ha. Mbështetja për prodhimin e duhanit ka qenë 1 000 EUR për ha në qoftë se janë mbjellë17 000 bimë për ha.

Mbështetja direkte për prodhimin blegtoral – paguar për krerë bagëti – është zbatuar për 15 vjet. Komponentët bazë janë:

- Pagesat direkte për mbarështim gjedhi (70 EUR për kokë) – vetëm mbi kufirin e katër lopëve ose mëshqerrave për fermë; kafshët duhet të matrikullohen dhe të regjistrohen në databazën kombëtare;
- Pagesa për mbarështimin e deleve (8 EUR për kokë), vetëm për kufirin mbi 40 kokë për fermë;
- Pagesa për mbarështimin e dhive (8 EUR për kokë), vetëm për kufirin mbi 30 kokë për fermë;
- Shpërblimi për viça të rinj të majmur (120 EUR për kokë), nëse plotësohen kushtet që kafshët të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në regjistrin kombëtar dhe të therura në thertore të certifikuara.

Mbështetje për prodhimin e qumështit për treg është 0,065 EUR për litër qumësht të dorëzuar në bulmetore të miratuara. Kriteri i përfitimit për këtë shpërblim është sasia e qumështit të dorëzuar

[35] Shënim i përkthyesit: *Fagopyrum esculentum:*Bimë Aziatike që prodhon fara niseshteje, përdoret gjerësisht në SHBA

për fermë (minimumi 400 litra në muaj). Një shpërblim shtesë prej 0.01 EUR për litër qumësht është dhënë për prodhimin mujor prej 5000 litra ose më shumë, dhe 0.01 EUR për litër qumështi ekstra cilësorë ose i cilësisë së klasit të parë.

Mbështetja për forcimin e rrjetit të grumbullimit të qumështit është drejtuar në sektorin e përpunimit me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së tregut për mbledhjen e qumështit të papërpunuar nga fermerët. Baza për pagesat janë litrat e mbledhura të qumështit (0.01 EUR për litër).

Zhvillimi rural

Politika e zhvillimit rural luan një rol shumë të rëndësishëm në politikën e re bujqësore malazeze. Kjo ndodh kryesisht për shkak të specifikave të sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale. Mungesa e prodhimit komercial të drithërave dhe e konkurrueshmërisë shumë të ulët të bujqësisë në njërën anë, dhe kërcënimi i shumicës dërrmuese të zonave malore në pjesën veriore të vendit nga braktisja, nga ana tjetër, kanë rezultuar në politika bujqësore të fokusuara në zhvillimin rural dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme në sektorin e bujqësisë.

Për sa kohë harmonizimi gradual i politikës bujqësore me CAP është një nga prioritetet kryesore, politika e zhvillimit rural sipas Programit Kombëtar është hartuar në përputhje me Politikën e Zhvillimit Rural të BE-së (direktivat strategjike të Komunitetit 2007-2013), që do të thotë se masat grupohen në katër boshte. Duhet përmendur se Programi Kombëtar parashikoi një bosht të katërt, edhe pse zbatimi i projekteve Lider nuk ka filluar ende. Gjithashtu, një prej masave kryesore në boshtin e dytë ishte mbështetja e zonave më pak të favorizuara (LFA); këto masa ishin paraparë për vitin 2013, por nuk janë ndërmarrë hapa konkretë deri më tani.

Grupi i parë (boshti), ka numrin më të madh të masave (11 në totalin prej 17), dhe kontribuon në shumën më të lartë (71 përqind) ndajshpërndarjes totale të politikës së zhvillimit rural. Ky bosht masash është i orientuar në forcimin e konkurrueshmërisë së prodhuesve të ushqimit përmes mbështetjes së investimeve në prodhimin primar dhe industritë e përpunimit, si dhe futjen e standardeve ndërkombëtare dhe organizatave të prodhuesve.

Investimet e pranueshme për mbështetje në sektorin primar janë: investimet në pajisje dhe mekanizma bujqësore; investimet në ferma blegtorale (ndërtimi i hambareve të reja dhe rinovimi i atyre ekzistuese, duke përfshirë blerjen e kafshëve për mbarështim); investimet në vendosjen e plantacioneve të kulturave shumëvjeçare (fruta, ullinj dhe vreshta) dhe investimet në ndërtimin dhe pajisjen e serave.

Në vijim përmendim investimet e pranueshme për mbështetje në industrinë e përpunimit: investimet në përpunimin e produkteve blegtorale (bulmetore, thertore dhe industria e mishit); investimet në ruajtje, paketim dhe përpunim të produkteve bimore dheinvestimet në përpunimin e prodhimeve bujqësore në fermat familjare. Investimet në përgjithësi janë të bashkë-financuara me 30 përqind nga burimet publike.

Grupi i dytë (boshti) i referohet një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve, ku janë zbatuar tre masa. Masa për përdorim të qëndrueshëm të kullotave malore zë pjesën më të madhe (më shumë se 50 përqind), ndjekur nga mbështetja për bujqësinë organike, ndërsa mbështetja për ruajtjen e burimeve gjenetike zë një pjesë shumë të vogël (më pak se 1 përqind të buxhetit të zhvillimit rural). Në përgjithësi, ky bosht zë një pjesë të vogël të politikës së zhvillimit rural (vetëm 10 përqind), për shkak të faktit se masa LFA nuk është zbatuar fare, ndërsa masat agro-mjedisore nuk janë të zhvilluara mirë.

Të gjitha masat në këtë grup janë praktikisht pagesa direkte kompensuese. Ruajtja e burimeve gjenetike në bujqësi i referohet pagesave për njësi blegtorale apo për ha për ruajtjen e racave autoktone dhe varieteteve të bimëve (në bazë të një plani veprimi për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike në bujqësi). Pagesat për bujqësinë organike nënkuptojnë pagesa për ha për prodhimin e bimëve dhe për njësi blegtorale në blegtori (kushte sipas rregullave

të përcaktuara nga legjislacioni). Masa për përdorimim e qëndrueshëm të kullotave malore i referohet pagesave për njësi blegtorale të ushqyera në kullotat malore.

Grupi i tretë (boshti) përbëhet nga dy masa: diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale; dhe rivitalizimi dhe zhvillimi i zonave rurale dhe ndërtimi i infrastrukturës rurale. E para, duke iu referuar punësimit të ri në sektorin jo-bujqësor, është mbështetur me sasi shumë të vogla. Masa e dytë është e lidhur me bashkë-financimin e projekteve në zonat rurale: rrugët lokale, menaxhimi i ujërave, objektet me rëndësi të përbashkëta; ka qenë zbatuar për shumë vite me pjesëmarrje të konsiderueshme në buxhetin total të bujqësisë, duke zënë më shumë se 90 përqind në boshtin e tretë apo afërsisht 20 përqind në politikën e zhvillimit rural.

Shërbime të ndryshme

Komponenti apo Shtylla e tretë e politikës bujqësore i referohet mbështetjes financiare për shërbime të ndryshme në bujqësi që janë me interes publik. Kjo shtyllë e politikës mbështet programe në arsim, kërkime dhe zhvillim, aktivitete analitike, shërbimet e ekstensionit, një program për masat veterinare dhe fito-sanitare, si edhe aktivitetet dhe programet që lidhen me kontrollin e cilësisë së produktit. Ajo përbëhet nga tetë masa, nga të cilat Programi Operativ për Mbrojtjen dhe Shëndetin e Kafshëve ka përqindjen më të lartë.

Transfertat sociale për popullsinë rurale

Përveç programeve dhe masave të paraqitura, Mali i Zi ka zbatuar një shtyllë të katërt të politikës bujqësore, e cila është një lloj i politikës sociale e orientuar drejt shoqërisë rurale. Transfertat sociale për popullsinë rurale (masa e quajtur programi i kompensimit të moshave të vjetra), në formën e pensioneve ka për qëllim sigurimin e një standardi të përshtatshëm të jetesës në zonat rurale; për shkak të ndërvarësisë së saj me familjet bujqësore, ajo synon gjithashtu menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Duke siguruar mbështetje sociale për fermat që kanë mungesë të burimeve të tjera të të ardhurave, ajo kontribuon në uljen e varfërisë në zonat rurale dhe rritjen e cilësisë së jetës në fshat, e cila është një nga prioritetet e boshtit të tretë të politikës së zhvillimit rural. Pensionet janë dhënë për pleqtë e familjeve fermere (një anëtar i vjetër për familje). Kjo masë zë një pjesë të konsiderueshme në buxhetin bujqësor total (afërsisht 20 përqind).

4. Diskutime dhe konkluzione

Kuadri makro-ekonomik në Mal të Zi është shumë i ndryshueshëm (kriza ekonomike, vështirësitë financiare etj.), duke krijuar vështirësi për zhvillimin e sektorit agro-ushqimor. Bujqësia është shumë e rëndësishme për ekonominë dhe shoqërinë në kuadrin e kontributit të saj në GVA dhe në punësimin e përgjithshëm. Konkurrueshmëria në sektorin e bujqësisë është relativisht e ulët për shkak të teknologjisë së pamjaftueshme, strukturës së papërshtatshme të fermës, rendimenteve të ulëta të prodhimit bimor dhe blegtoral dhe prodhimit në shkallë të vogël (mbizotëron bujqësia e subsistencës). Zinxhiri i vlerave ushqimore (horizontal midis prodhuesve dhe lidhje vertikale) është i dobët. Importet e larta dhe defiçiti tregtar në produktet agro-ushqimore (raporti eksport/import është vetëm 12 përqind), krijojnë probleme për qëndrueshmërinë e ekonomisë.

Në mënyrë që të kapërcehen këto dobësi dhe të përdoren mundësitë në kontekstin e anëtarësimit në BE, hartimi i politikave të mira bujqësore është një sfidë e vërtetë. Politika bujqësore duhet të sigurojë një kornizë të mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë rurale, dhe në të njëjtën kohë ajo duhet të jetë në përputhje me modelin e BE-së ose politikën CAP like.

Veprimet e mëposhtme duhet të vazhdohen dhe/ose të përforcohen:

- Harmonizimi i brendshëm i politikave sektoriale në mënyrë që të ofrohet rritje ekonomike paralelisht me përafrimin me BE-në;
- Të rritet ndjeshëm mbështetja financiare për zonat bujqësore dhe rurale, por të forcohen gjithashtu instrumentet e tjera (politika makro-ekonomike, sociale, arsimore);

- Mbështetje e gjerë dhe e rëndësishme e investimeve për të përmirësuar nivelin e teknologjisë dhe për të rritur rendimentet në të gjithë nënsektorët e bujqësisë;
- Sigurimi i arsimit të rregullt profesional dhe trajnime për fermerët;
- Mbeshtetje e ristrukturimit të tokës –Politika e zbatimit dhe konsolidimit të tokës;
- Vendosja e fokusit të politikës tek zinxhirët e vlerave ushqimorenë mënyrë që të luftohen pikat e saj të dobëta;
- Promovimi më i fortë i rëndësisë së bujqësisë në mënyrë që të sigurojë pranimin më të mirë të saj në shoqëri si një sektor shumëfunksional.

Siç është paraqitur tashmë, dokumentet kryesore në hartimin dhe zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural janë: Strategjia; Programi Kombëtar; Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe buxheti për bujqësinë.

Strategjia që nga viti 2006 ka strukturuar reformat në tri fusha kryesore: Politika bujqësore (Futja graduale e CAP); Legjislacioni (harmonizimi i legjislacionit me *Acquis Communautaire* të BE-së); dhe institucionet (modernizimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale që mundësojnë zbatimin efikas të politikës).

Strategjia e re duhet të jetë një vazhdim i asaj ekzistuese, me prioritete të riformuluara në përputhje me rrethanat. CAP i ri 2014-2020 duhet të jetë pikë referimi, ndërkohë që angazhimet ndërkombëtare duhet të respektohen. Përderisa strategjia e re është kërkuar nga KE, si një pikë referimi për hapjen e negociatave me Malin e Zi në Kapitullin 11: Bujqësi dhe Zhvillim Rural, plani i veprimit ose udhëzuesi i harmonizimit të politikës kombëtare me *acquis* të BE-së duhet të planifikohet me kujdes dhe në mënyrë realiste. Kjo kërkon përfshirjen e gjerë të të gjithë aktorëve dhe institucioneve.

Programi kombëtar për prodhimin e ushqimit dhe zhvillimin rural 2009-2013 njohu plotësisht harmonizimin gradual të politikës bujqësore me CAP, si një nga prioritetet, dhe u hartua si një dokument CAP like në aspektin e strukturës së saj (masave dhe instrumenteve). Prandaj programi kombëtar ekzistues mund të jetë një bazë e mirë dhe pikënisje për dokumentin e ri të programimit, ndërsa integrimi i instrumenteve të reja të CAP është gjithashtu i nevojshëm. Për hartimin e këtij dokumenti shumë të ndjeshëm, ekspertët e huaj dhe administrata nuk janë të mjaftueshme, prandaj pjesëmarrja e plotë e ekspertizës vendase është e pashmangshme.

Buxheti bujqësor miratohet çdo vit, bazuar në Ligjin për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural dhe Ligjin për Buxhetin e Malit të Zi. Lidhur me zbatimin e politikës së hartuar në nivel vjetor, disa veprime duhen theksuar: Pjesëmarrja më e madhe e palëve të interesuara në përgatitjen e masave; respektimi i plotë i kornizës ligjore dhe strategjike; raportimi mbi zbatimin për secilën prej masave. Për zbatimin e qetë, përgatitja dhe përshtatja e buxhetit të bujqësisë është e nevojshme para fillimit të çdo viti financiar, çka nuk ka ndodhur deri tani.

Programi IPARD është një dokument i rëndësishëm për politikën e brendshme të zhvillimit rural në periudhën e para-anëtarësimit. Ai duhet të jetë një mundësi për fermerët për të investuar në përmirësimin e performancës dhe konkurrueshmërisë së tyre. Programi IPARD është gjithashtu një mundësi e mirë për qeverinë për të përgatitur dhe për të forcuar kapacitetet thithëse dhe për zbatimin e politikës së zhvillimit rural të BE-së pas anëtarësimit. Ministria ka krijuar tashmë Sektorin për zhvillim rural të cilit i është ngarkuar menaxhimi i programit IPARD.

Programi IPARD është në përpunim e sipër; drafti i dytë u dërgua në Komisionin Evropian në maj 2014. Katër masat e zgjedhura ishin: Investime në fermat bujqësore për t'u afruar me standardet e BE-së; Investimet në përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit për të ristrukturuar dhe për t'u afruar me standardet e BE-së; Zhvillimi dhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike rurale dhe asistenca teknike.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si një organ me rol kyç në zbatimin e politikave, po përjeton reforma të gjera dhe ka qenë duke rekrutuar staf të ri. Forcimi dhe përmirësimi i kapaciteteve humane është një domosdoshmëri e vërtetë dhe ajo çfarë po bën Ministria është

shumë pozitive. Megjithatë, rekrutimi i stafit të ri pa përvojë të mjaftueshme krijon mungesa të kujtesës institucionale për Ministrinë.

Përveç Ministrisë, disa institucione, në plotësim të Ministrisë, janë të përfshira në zbatimin e politikës: disa njësi të Fakultetit Bioteknik (shërbimi i ekstensionit në prodhimin e bimëve dhe në sektorin e blegtorisë, disa laboratorë, departamenti për mbrojtjen e bimëve); Drejtoritë shtetërore dhe të tjerë. Në përgjithësi, mund të konkludohet se nuk ka mbivendosje midis këtyre institucioneve. Megjithatë, problemi është se shërbimi këshillimor është gjithnjë e më shumë i përfshirë në detyrat administrative. Për të përmirësuar performancën e përgjithshme dhe për të rritur transparencën, administrata në nivel lokal (komuna) duhet të përfshihet në zbatimin e politikave, ndërsa institucionet ekzistuese kërkimore në bujqësi duhet të jenë më të përfshira në formulimin e politikave.

Në përgjithësi, mbështetja totale për bujqësinë është shumë e vogël, madje edhe në krahasim me vendet e SEE-së (shikoni AneksinB.VI-3 dhe Kapitulli A.II). Hendeku midis buxhetit të bujqësisë, si dokument zbatues në nivel vjetor, dhe programit kombëtar, si një dokument strategjik, është në rritje (hendeqet në buxhet sipas shtyllave dhe masave, shikoni Aneksin B.VI-5).

Ka një paradoks në zbatimin e skemave të pagesave direkte. Nga njëra anë, shuma totale për mbështetjen direkte është shumë e kufizuar (sidomos pjesa që zë në buxhetin bujqësor total), por nga ana tjetër, shumat për njësi (për ha, ose për kokë e bagëti), janë mjaft të larta. Megjithatë, për shkak të niveleve minimale shumë të larta për të përfituar, numri i fermave të afta për të përfituar është shumë i vogël. Për shembull: për gjedhin, numri minimal i kafshëve për fermë që të jenë të pranueshme për mbështetje është katër lopë dhe mëshqerra, ndërsa mesatarja kombëtare e bagëtive për fermë është rreth tre kokë. Kjo përjashton shumë fermerë të vegjël. Për shkak të faktit se kafshët nën këtë prag nuk janë të përshtatshme për subvencione, fermat e vogla marrin më pak se vlera zyrtare për kafshë (një simulim i shkurtër i mbështetjes paraqitet në AneksinB.VI-4). Përderisa shumica e fermave të bagëtive zotërojnë më pak se 10 kokë, mbështetja reale për këtë sektor nuk është 70 EUR për kokë, por diku midis 30 dhe 40 EUR për kokë, ndërsa rreth 20 000 ferma të cilat zotërojnë katër kafshë ose më pak nuk kanë të drejtë për mbështetje. Në nivel ferme më shumë krerëpër tufë të ketë ferma aq më e madhe është mbështetja për kokë. Kjo krijon një progres të caktuar, ndërsa koncepti i BE-së është i kundërt - kufizime për fermat e mëdha (instrumentet si modulimi, reduktimi gradual dhe mbulimi). E njëjta logjikë, siç është përshkruar për gjedhin, është e zbatueshme edhe për skemën e pagesave në sektorin e deleve dhe dhive.

Një kufizim tjetër është fakti se nuk është i mundur konvertimi i specieve të ndryshme në njësi blegtorale dhe numërimi i tyre së bashku për të arritur financimin. Për shembull, një fermë mund të ketë katër lopë plus 35 dele dhe madje edhe disa dhi, dhe akoma nuk mund të përfitojë nga subvencionet. Një numër i konsiderueshëm i fermave, kryesisht në zonat e largëta rurale, kombinojnë mbarështimin e deleve dhe të gjedhëve. Megjithatë, kjo praktikë e mbarshtimit të të imtave është përgjithësisht e dekurajuar : një fermer i cili ka 200 dele do të marrë 1 280 EUR (8 EUR x 160), por ai që ka 100 dele dhe 10 lopë (sa është numri ekuivalent i njësive blegtorale) do marrin 900 EUR (420 EUR për lopët dhe 480 EUR për delet, pas zbritjes së minimumeve për të dyja speciet).

Në lidhje me mbështetjen direkte për prodhimin bimor, niveli minimal për të përfituar është shumë i lartë (0.5 ha për të gjitha kulturat, ndërsa 1 ha për drithërat). Minimumet janë vendosur veçmas për çdo kulturë, pa mundësinë e bashkimit për t'u bërë të përshtatshëm për mbështetje. Në kuadrin e mbështetjes mjaft të lartë për ha (150 EUR ose 160 EUR), shtrirja është shumë e vogël, dhe në këtë mënyrë paraqet një pjesë shumë të vogël të mbështetjes së përgjithshme. Pjesa që zë kjo skemë pagesash është rreth 3 përqind e mbështetjes buxhetore totale. Përveç kësaj, skemat e pagesave direkte për bimë nuk përfshijnë sipërfaqet e përdorura për prodhimin e barit (livadhet natyrore), e cila është, pas kullotave, kategoria më e madhe e sipërfaqësbujqësore të përdorur.

Në sektorin e qumështit, pagesat direkte të lidhura me prodhimin janë rritur nga 0.035 EUR në vitin 2009 në 0,065 EUR për litër qumësht të dërguar në bulmetore të certifikuara në vitin 2013 (pothuajse dyfishuar). Një aspekt i kësaj politike është se ajo është në kundërshtim me politikën e BE-së, ndërsa një tjetër problem serioz është përkeqësimi i shpërndarjes së mbështetjes direkte. Pjesa më e madhe e prodhuesve të qumështit në vend nuk kanë akses direkt ndaj tregut (bulmetoreve), qoftë për shkak të distancave të gjata me bulmetorën më të afërt, infrastrukturën e keqe rurale, ose një kombinim i të dyjave. Ndërsa mbështetja për fermerët që dërgojnë qumësht në bulmetore dhe operojnë kryesisht në zonat e favorizuara ka qenë në rritje, shumica e fermerëve që duhet të përpunojnë vetë qumështin në produktet e qumështit janë të përjashtuar nga kjo mbështetje (më shumë se 80 përqind e totalit të qumështit nuk përpunohet nga bulmetoret).

Zgjidhjet (mjetet juridike) për këto devijime në skemat e pagesave direkte duhet të jenë:

- Heqja e pragut minimal për gjedhin;
- Ulja e pragut në një njësi blegtorale për delet dhe dhitë (ekuivalente me 10 dele ose 10dhi);
- Të lejohet mbledhja/konvertimi i specieve të ndryshme për t'u kualifikuar për mbështetje;
- Reduktimi i ndjeshëm i pragut minimal për pagesat direkte për kulturat (ndoshta maksimumi0.3 ha.) duke lejuar arritjen e këtij pragu minimal duke mbledhur kultura të ndryshme;
- Përfshirja e sipërfaqes së përdorur për prodhimin e foragjereve dhe livadhet natyrore në skemën e pagesave si një hap i parë dhe më pas përfshirjen e kullotave;
- Të hiqen pagesat e lidhura me produkte të caktuar në një periudhë të arsyeshme tranzitore;
- Zhvillimi i IACS dhe LPIS si një parakusht për zbatim të plotë të skemave të pagesave direkte CAP like.

Duke pasur parasysh zbatimin e masave të zhvillimit rural, përveç mbështetjes së pamjaftueshme buxhetore, disa nga masat nuk janë zhvilluar akoma, duke përfshirë edhe skemën për zonat më pak të favorizuara. Në boshtin 1 mbështetja e investimeve është zbatuar deri diku, por më së shumti nga granti i Bankës Botërore (Midas), dhe jo në bazë të programit të rregullt të mbështetjes kombëtare. Në boshtin 2 të politikave të zhvillimit ruralmasat agro-mjedisore janë në një nivel shumë të ulët. Disa prej masave të përcaktuara nga programi kombëtar nuk janë zbatuar fare; shumë janë të nënfinancuara apo financuar simbolikisht. Projektet lider dhe disa masa të tjera nuk janë zhvilluar akoma.

Ka pasur përmirësime të ndjeshme në çështjet procedurale (tenderimet, përgatitjen e manualeve për përfituesit, promovimi i masave, etj.) dhe ky trend pozitiv në zbatimin e politikës së zhvillimit rural duhet të vazhdojë me qëllim marrjen e akreditimit të strukturave IPARD sa më shpejt të jetë e mundur.

Disa nga veprimet duhen përforcuar, duke përfshirë edhe përcaktimin më të saktë të nevojave të shoqërisë rurale, rregullimin e mbështetjes ndaj llojeve të ndryshme të bujqësisë dhe fermave, përgatitjen sa më të mirë të fermerëve dhe të aktorëve të tjerë në nivel lokal, mbështetjen më të fuqishme për grupet eprodhuesve (kooperativat, kompanitë, grupet, organizata dhe degët e tyre), dhe për të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor.

Shërbimet e përgjithshme (Shtylla e tretë e politikës bujqësore) janë zbatuar në përputhje me hartimin e programit kombëtar në drejtim të masave, objektivave dhe strukturave të tyre. Megjithatë, përkrahja buxhetore është në rënie, çka është në kundërshtim me programin kombëtar, dhe madje edhe më keq, në kundërshtim me nevojat reale. Zhvillimi më konkurrues i fermave familjare bazuar në modelin e BE-së kërkon më shumë mbështetje institucionale. Në këtë kontekst, ndërtimi i rrjeteve dhe koordinimi midis komunitetit të studiuesve, ekstensionit dhe komunitetit bujqësor duhet të përforcohet. Familjarizimi me njohuritë bujqësore dhe rolin e sistemit të inovacionit në të gjitha nivelet, dhe vendosja e tij në funksion të nevojave reale, është shumë e rëndësishme. Mbështetja analitike nuk është zhvilluar ende dhe nuk ka sinjale të qarta

për përmirësim. Nuk ka mbështetje për kërkime të aplikuara pavarësisht kërkesës reale; kjo mungesë është kompensuar pjesërisht nga mbështetja e donatorëve.

Mungesa e të dhënave të qarta mbi buxhetin e zbatuar për bujqësinë, së bashku me mospërputhjet dhe hendeqet në statistikat bujqësore dhe kapaciteti i dobët analitik, do të thotë se gjendja e sektorit nuk është plotësisht e qartë dhe identifikohen pengesa reale në formulimin dhe zbatimin e politikës bujqësore. Përmirësimi i statistikave është jo vetëm një domosdoshmëri për negociatat me BE-në, por edhe për vendimmarrjen (përveç MONSTAT, përfshirja e vendimmarrësve dhe akademikeve është e rëndësishme).

Duke marrë parasysh politikën bujqësore në përgjithësi, rekomandimet kryesore janë:

- Sigurimi i vazhdimësisë së politikëbërjes bazuar në dokumenta programues shumë-vjeçar (Programi Kombëtar);
- Përshpejtimi i ndërtimit dhe zbatimit të strukturës së politikës bujqësore të harmonizuar me CAP (Agjensia e Pagesave, Autoritet Menaxhues, IACS ...);
- Eleminimi i hendeqeve në statistika (përdorimi i tokës, statistikat e çmimeve, llogaritë ekonomike);
- Zhvillimi i kapaciteteve analitike për programimin dhe analizën e politikave bujqësore
- Edukimi i administratës për menaxhimin modern të politikave publike;
- Futja e politikave të bazuara në evidenca për të cilën raportimi i qartë mbi politikat e zbatuara dhe vlerësimet e impaktit janë parakushte esenciale.

Referenca

Annual report of livestock selection service for 2011. 2012. Biotechnical faculty, Podgorica.

MAFRD. 2006. Montenegrin agriculture and EU – Strategy of food production and rural development. Ministry of Agriculture, Forestry and Water management of Montenegro. pp 224.

MAFWM. 2008. National program for food production and rural development 2009-2013. Ministry of Agriculture, Forestry and Water management of Montenegro.

MAFWM. 2009. Low of agriculture and rural development. Ministry of Agriculture, Forestry and Water management of Montenegro, Official gazette of Montenegro, 56/09.

Marković, M & Marković, B. 2010. Review of Agriculture and agricultural policy in Montenegro. In: Volk, T. (ed.).Agriculture in the Western Balkan countries, (Studies on the agricultural and food sector in Central and Eastern Europe, vol. 57). Halle (Saale): Leibniz-Institut für Agrarentwicklung in Mittel- und Osteuropa (IAMO), p. 165–188.

Marković, M., Lazović, B. & Marković, B. 2010. Montenegro in XXI century in era of competitiveness: Environment and sustainable development – Food production, Montenegrin Academy of Science and Arts, 73/2, p. 283-313.

Marković, B., Marković, M. & Rmuš, L. 2011. Status of milk production sector in Montenegro, Biotechnology in Animal Husbandry, Vol 27; No3; p. 387-396.

MARD. 2011. Program for Agriculture and Rural Development of Montenegro under IPARD 2007-2013.

MONSTAT. Statistical yearbooks. Statistical Office of Montenegro.Podgorica.

Rednak, M., Volk, T. & Erjavec, E. 2013. A tool for uniform classification and analyses of budgetary support to agriculture for the EU accession countries. *Agricultural Economics Review*, vol. 14, no. 1, p. 76-96.

Aneksi B.VI-1: Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave kryesore, 2005-2011, Mali i Zi

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Sipërfaqja e prodhimit (1 000 ha)							
Totali	5.0	5.1	5.2	5.1	5.0	5.2	5.2
- Grurë	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.7	0.8
- Misër	3.1	2.8	2.7	2.7	2.7	2.7	2.8
Patate	10.3	10.2	10.1	10.2	10.3	10.2	10.9
Rrush (total)	4.0	4.2	4.2	4.2	4.4	4.4	4.4
Fruta (total) përfshirë pemët e ullirit	9.6	9.7	9.8	9.8	11.9	12.0	12.0
Perime (total)	6.8	6.8	6.7	6.7	8.1	8.1	8.0
Duhan	0.2	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1
Foragjere	7.8	7.5	8.0	7.9	8.1	7.6	7.3
Prodhimi (1 000 t)							
Total	14.6	14.3	10.4	15.8	16.9	16.3	17.5
- Grurë	2.6	2.5	2.0	2.8	3.0	2.5	2.4
- Misër	9.7	9.1	6.9	9.6	10.0	10.5	11.7
Patate	132.8	132.8	106.1	134.1	156.4	149.3	180.1
Rrush (total)	36.9	41.7	35.4	44.0	38.6	40.8	32.8
Fruta (total)	30.2	32.8	30.9	30.5	39.8	33.9	42.1
Perime (total)	110.9	119.9	110.2	136.5	97.4	97.4	143.3
Duhan	0.4	0.4	0.4	0.3	0.3	0.3	0.3
Foragjere	15.7	34.1	14.1	26.9	29.9	29.2	:

Burimi: MONSTAT

Aneksi B.VI-2: Të dhënat blegtorale (në 1 000 kokë), 2005-2012, Mali i Zi

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Gjedhë	117.0	118.0	115.0	106.5	101.0	96.0	87.2	84.7
nga të cilat lopë qumështi	75.0	73.7	70.5	69.0	67.7	64.3	59.5	60.0
Derra	11.0	13.0	10.0	10.0	12.0	11.0	21.4	18.5
Dele	255.0	249.0	222.0	209.0	199.8	198.2	208.8	207.0
Kuaj	7.1	6.2	5.4	5.1	5.0	4.8	4.0	3.9
Shpendë	462.1	448.5	505.4	432.0	416.7	506.5	470.0	732.1
Koshere bletësh	42.6	41.6	36.6	29.0	18.1	21.7	42.2	42.7

Burimi: MONSTAT

Aneksi B.VI-3: Mbështetja buxhetore për bujqësinë (në milionë EUR), 2005-2012, Mali i Zi

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
MASAT E MBËSHTETJES SË TREGUT DHE MBËSHTETJES DIREKTE TË PRODHUESVE	2.8	3.5	4.1	4.9	5.2	6.6	5.7	6.5
Masat e mbështetjes së tregut	0.1	0.1	0.4	0.3	0.5	0.5	0.6	0.4
Masat e mbështetjes direkte të prodhuesve	2.6	3.3	3.6	4.1	4.5	5.7	4.9	5.7
Pagesa direkte për prodhuesit	1.5	2.0	2.4	2.7	3.4	4.9	4.1	4.9
Bazuar në prodhim (ndihma e çmimit)	0.7	0.8	0.9	0.7	1.4	0.8	1.5	1.6
Bazuar në sipërfaqe/krerë bagëti aktuale	0.8	1.2	1.6	1.9	2.0	4.1	2.6	3.3
Subvencione për inpute	1.1	1.2	1.1	1.4	1.1	0.8	0.8	0.8
Pagesa të tjera direkte	0.1	0.1	0.2	0.5	0.2	0.3	0.3	0.4
MASAT E ZHVILLIMIT STRUKTUROR DHE RURAL	1.0	2.4	3.2	4.4	5.9	5.0	6.1	5.5
Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor	0.5	1.6	2.2	3.1	4.4	3.4	4.1	4.1
Përmirësimi i mjedisit dhe zonave rurale	0.0	0.0	0.0	0.2	0.5	0.9	0.4	0.4
Mbështetja e ekonomisë dhe popullsisë rurale	0.6	0.7	1.0	1.2	1.1	0.7	1.6	0.9
MASA TË NDRYSHME NE LIDHJE ME BUJQËSINË	2.0	2.1	2.7	3.8	3.9	4.5	3.4	2.9
MBËSHTETJA BUXHETORE TOTALE PËR BUJQËSINË	5.8	7.9	10.0	13.1	15.0	16.0	15.3	14.9

Burimi: Buxheti i bujqësisë

Aneksi B.VI-4: Shembuj të pagesave aktuale sipas kopesë/madhësisë së kopesë sipas skemave ekzistuese të pagesave direktepër gjedhin dhe delet, Mali i Zi

	Kopeja/madhësia e kopesë (kafshë për mbarështim)					
Gjedhë						
Madhësia aktuale e kopesë - kokë	6	10	20	30	40	50
Kufiri minimal (Nr i kafshëve përjashtuar nga pagesa)	4	4	4	4	4	4
Nr i kafshëve që kualifikohen për pagesa	2	6	16	26	36	46
Shumë totale e shpërblimit (70 EUR për kokë) - EUR	140	420	1 120	1 820	2 520	3 220
Shpërblimi mesatarë për kokë - EUR	**23**	**42**	**56**	**61**	**63**	**64**
Pjesa që zënë shpërblimet e paguara 70 EUR/kokë	33%	60%	80%	87%	90%	92%
Dele						
Madhësia aktuale e kopesë - kokë	50	80	100	150	200	250
Kufiri minimal (Nr i kafshëve përjashtuar nga pagesa)	40	40	40	40	40	40
Nr i kafshëve që kualifikohen për pagesa	10	40	60	110	160	210
Shumë totale e shpërblimit (8 EUR për kokë)	80	320	480	880	1 280	1 680
Shpërblimi mesatarë për kokë - EUR	**1.6**	**4.0**	**4.8**	**5.9**	**6.4**	**6.7**
Pjesa që zënë shpërblimet e paguara 8 EUR/kokë	20%	50%	60%	73%	80%	84%

Annex B.VI-5: Krahasimi i Programit Kombëtar (NP) dhe buxhetit të bujqësisë(AB) në 2009 dhe 2013 (në 1 000 EUR), Mali i Zi

Kodi	Emri dhe përshkrimi i masës	2009		2013		Komente/Vërejtje
		NP	AB	NP	AB	
1	**Masat e politikës së tregut dhe çmimeve**	5 307	**5 304**	**10 036**	**6 183**	
1.1	**Pagesa direkte**	4 472	**4 309**	**8 578**	**5 333**	**Vonesa në zbatimin e NP**

1.1.1	Mbështetje direkte për prodhimin blegtoral	2 472	1 604	**5 834**	2 522	Kriteret minimale vënë në nivel shumë të lartë
1.1.2	Mbështetje direkte për prodhime bulmeti për treg	560	1 191	**875**	1 561	Rritja e për litër e qumështit - në kundërshtim me parashikimin e NP
1.1.3	Mbështetje për forcimin e rrjetit të mbledhjes së qumështit	550	665	**300**	460	Asnjë progres i arritur
1.1.4	Forcimi i rrjetit të thertoreve	92	90	**144**	-	Masa është ndalur
1.1.5	Mbështetje direkte për prodhimin bimor	598	559	**1 225**	740	Pragu ose minimumi në nivel shumë të lartë për drithërat
1.1.6	Mbështetje për prodhimin e duhanit	200	200	**200**	50	Nuk ka rregulla të qarta
1.2	**Programi i zhvillimit të bletarisë**	215	**236**	258	**200**	Nuk ka rekomandime specifike
1.3	**Masat e stabilizimit të tregut**	**620**	**760**	**1 200**	**650**	**Vonesë e madhe**
1.3.1	Ndërhyrjet në treg	320	480	200	350	
1.3.2	Menaxhimi i riskut në bujqësi	**300**	280	1 000	300	Masa nuk është zhvilluar në përputhje meNP
2	**Masat e politikës së zhvillimit rural**	**7 081**	**5 946**	**15 863**	**5 615**	**Hendek i madh**
2.1	**Masa për përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit agro-ushqimor**	**4 666**	**4 241**	**7 625**	**4 815**	**Hendek i madh**
2.1.1	Investime ne pajisje dhe mekanizma bujqësore	**550**	550	1 100	3 700	Masa ekzistuese kombinon disa masa të NP
2.1.2	Investime në ferma blegtorale	**720**	670	**972**	-	Miksuar më masën e mëparshme
2.1.3	Krijimi i plantacioneve me kultura shumë-vjeçare dhe ndërtimi i serave	**994**	630	**1 485**	650	Nuk ka progres
2.1.4	Investime në sera	**-**	200		-	E përfshirë se sa e përjashtuar
2.1.5	Operacionet e tokës Bashkëfinancimi i investimeve dhe projekteve	**340**	300	**425**	-	Nuk ka zbatim
2.1.6	Investime në përpunimin e produkteve shtazore	**795**	670	**1 431**	-	Zbatimi ka ndaluar
2.1.7	Investime në paketim, magazinim dhe përpunim të produkteve bimore	**700**	670	**1 120**	-	Nuk ka zbatim
2.1.8	Investime për përpunim në fermat familjare	**50**	70	**400**	200	Është arritur progres solid
2.1.9	Organizimi i prodhuesve	**165**	145	**231**	25	Thjesht shuma simbolike
2.1.10	Përmirësimi i cilësisë së produkteve	**248**	241	**347**	100	Rënie e shpejtë
2.1.11	Aktivitete promovimi dhe informimi	**104**	95	**114**	140	Disa komponentë janë rritur
2.2	**Masa për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore**	**665**	**625**	**5 800**	**340**	**Vonesa e madhe**
2.2.1	LFA-të	**0**	0	**3 733**	-	Nuk ka klasifikim për LFA dhe nuk ka zbatim
2.2.2	Ruajtja e burimeve gjenetike në bujqësi	**100**	80	**480**	40	Shtrirje shumë simbolike
2.2.3	Prodhimi organik	**165**	165	**627**	100	Rënie
2.2.4	Përdorim i qëndrueshëm i kullotave malore	**400**	380	**960**	200	Rënie e ashpër;kriteret minimale në nivele shumë të larta, shumë për LU e reduktuar
2.3	**Masa për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale**	**1 750**	**1 080**	**2 400**	**460**	**Vonesa e madhe**
2.3.1	Diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale	**50**	80	**500**	45	Nuk kaprogresvetëm shumë simbolike
2.3.2	Rinovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së fshatit	**1 700**	1 000	**1 900**	415	Reduktim i madh

2.4	**Projekte lider**	**0**	0	**38**	**-**	I pazhvilluar
3	**Mbështetje e shërbimeve të ndryshme në bujqësi**	**4 008**	**3 442**	**5 584**	**2 714**	**Mbështetja e reduktuar në kundërshti me nevojat**
3.1	Punë analitike dhe kërkimore arsimore	**400**	195	**520**	185	Hendek i madh
3.2	Programi i përmirësimit të mbarështimit në blegtori	**372**	316	**372**	156	Mbështetje e përgjysmuar
3.3	Programi i shërbimeve profesionale dhë prodhimin blegtoral	**281**	315	**408**	322	Nuk është ndjekur NP
3.4	Programi i shërbimeve profesionale dhe prodhimit bimor	**223**	75	**323**	-	Kombinuar me masa fito-sanitare
3.5	Shërbime ekstensioni	**372**	306	**540**	334	Nuk është ndjekur NP
3.6	Programi i masave të kontrollit të cilësisë	**82**	85	**119**	177	Kompetentët nuk janë parashikuar ngaNP
3.7	Masa fito-sanitare	**287**	300	**417**	190	Rënie e shpejtë
3.8	Masa veterinare	**1 991**	1 850	**2 887**	1 350	Reduktim i shpejtë
4	**Transferta sociale për popullsinë rurale**	**2 920**	**2 900**	**3 000**	**2 720**	Rënie e lehtë;kritere të njëjta
5	**Mbështetje teknike dhe administrative**	**514**	**410**	**800**	**397**	Në të njëtin nivel
TOTALI		**19 830**	**18 035**	**35 283**	**17 629**	**Hendek i madh;shuma totale e reduktuar**

Kapitulli B.VII

BUJQËSIA DHE POLITIKA BUJQËSORE NË SERBI

Natalija Bogdanov*, Vesna Rodić**

1. Hyrje

Që nga fillimi i viteve 2000, Serbia ka përjetuar ndryshime të mëdha ekonomike dhe institucionale, me pasoja të rëndësishme për ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë, prodhimit dhe produktivitetit të saj, si edhe politikat bujqësore.

Nga fillimi i viteve 1980' Serbia kishte përjetuar një rritje të konsiderueshme në prodhimin bujqësor, i cili mbeti i pandryshuar deri në fund të viteve 1980' dhe ra ndjeshëm në vitet 1990'. Prodhimi dhe treguesit ekonomikë shumë të pafavorshëm për bujqësinë serbe në vitet 1990' u reflektuan në trendet negative të prodhimit në pothuajse të gjitha produktet bujqësore. Rënia në bujqësi u shkaktua kryesisht nga një kombinim i çrregullimeve institucionale, shkurtimeve të subvencioneve, dhe kolapsit të tregut. Është e qartë se faktorët e shumtë (subjektivë dhe objektivë), kanë shkaktuar dështimin e Serbisë për të shfrytëzuar avantazhet konkurruese që kishte mbi vendet e tjera në periudhën e para-tranzicionit (Van Berkum & Bogdanov, 2012).

Reformat themelore të sektorit të agro-biznesit Serb u prezantuan në fillim të viteve 2000, një dekadë më vonë se në vendet e tjera në tranzicion. Vitet e para të tranzicionit sollën ndryshime radikale në krahasim me politikat e viteve 1990'. Qeveria e parë e orientuar nga reformat ia kushtoi shumicën e vëmendjes së saj forcimit të kapaciteteve institucionale, sidomos në lidhje me zgjidhjet legjislative. Një sfidë e madhe në fillim të viteve 2000' ishte reduktimi i hapësirës së aktiviteteve të tregut gri dhe krijimi i një tregu të qëndrueshëm të produkteve bujqësore bazë.

Nga 2004-2007 ka pasur disa ndryshime pozitive në drejtimet strategjike dhe mekanizmat e zbatimit në politikën bujqësore, në drejtim të paraqitjes së disa elementeve të CAP-like (pagesat direkte dhe politikës së zhvillimit rural). Gjithashtu u krijua një regjistër i fermave. Që nga vitit 2008, zbatimi i politikave bujqësore ka qenë vazhdimisht në ndryshim. Programet dhe rregulloret janë ndryshuar dhe/ose shfuqizuar disa herë në të njëjtin vit; pagesat ndaj prodhuesve u vonuan, faktorë të cilët të gjithë së bashku kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi të paqëndrueshëm dhe jo të favorshëm ekonomik për bujqësinë. Për më tepër, sistemi i monitorimit të politikave bujqësore nuk është krijuar akoma, duke e bërë të vështirë vlerësimin eefekteve të saj në zhvillimin e sektorit.

Në vitin 2014 Serbia nisi një fazë të re të procesit të integrimit evropian; negociatat e pranimit për anëtarësim në BE. Procesi i negociatave për anëtarësim në WTO është gjithashtu në progres. Në këto procese, Serbia do të përballet me sfida të shumta. Reforma e rregullimeve të përgjithshme institucionale dhe politikat bujqësore do të jenë me rëndësi të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përshpejtuar të bujqësisë, si edhe përgatitjen për të absorbuar asistencën e para-anëtarësimit nga BE-ja. Kompleksiteti i sektorit të bujqësisë, sfidat me të cilat po përballet prodhimi i ushqimit dhe ndikimi shumë-dimensional i bujqësisë në strukturat shoqërore dhe

* Universiteti i Beogradit, Fakulteti i Bujqësisë, Serbi
** Universiteti i Novi Sadit, Fakulteti i Bujqësisë, Serbi

ekonomike sugjerojnë se qeveria nuk mund të shmangë rolin e saj udhëheqës në zhvillimin me përgjegjësi sociale dhe strukturalisht të qëndrueshëm.

Ky punim analizon karakteristikat më të rëndësishme të bujqësisë Serbe në disa fusha: rëndësinë e sektorit në ekonominë kombëtare, karakteristikat themelore të strukturës së fermës, tendencat e prodhimit, dhe konkurrueshmërinë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar politikës bujqësore si në aspektin e kuadrit të politikave edhe në strukturën e mbështetjes buxhetore.

Analiza përfshin periudhën 2005-2013, me fokus në vitet e fundit. Analiza e sektorit të bujqësisë është e bazuar në të dhënat statistikore kombëtare të ofruara nga Zyra Statistikore e Republikës së Serbisë (SORS), dhe disa burime të tjera. Të dhënat sekondare janë përdorur për analizën e politikave bujqësore, sidomos databaza për të cilat janë mbledhur të dhënat mbi transfertat e kryera buxhetore nga nën-llogaritë e buxhetit të Ministrisë Serbe të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MAFWM), Drejtoria e Pagesave Agrare (Agjencia e pagesave), Fondi i Zhvillimit Bujqësor dhe Drejtoria për tokën bujqësore. Mbështetja buxhetore dhënë nga organet administrative të krahinave autonome serbe dhe autoriteteve të vetë-qeverisjes vendore, të cilat gjithashtu zbatojnë programet e tyre për mbështetje të bujqësisë në territorin e tyre, nuk janë përfshirë në analizë për shkak të mungesës së të dhënave për transferta të tilla. Mbështetja për bujqësinë ka qenë e sistemuar sipas grupeve të masave me përdorimin e APM (Rednak & Volk, 2010).

Materiali është i organizuar si vijon: seksioni hapës jep një pasqyrë të kontributit të bujqësisë në agregatet kryesore makroekonomike; në pjesën e dytë analizohen elementet themelore të strukturës së fermës, duke përfshirë madhësinë e fermës, të dhënat e blegtorisë dhe të fuqisë punëtore; seksioni i tretë trajton karakteristikat dhe tendencat e prodhimit - struktura e Prodhimit Bujqësor Bruto (GAO), rendimentet dhe konkurrueshmëria e çmimeve; seksioni i katërt diskuton tregtinë ndërkombëtare të produkteve bujqësore dhe ushqimore, sipas rajoneve dhe grupeve të produkteve; pjesa e fundit fillon me një përshkrim të koncepteve dhe kuadrit të politikave bujqësore serbe, pastaj analizon shtrirjen dhe strukturën e mbështetjes buxhetore sipas shtyllave dhe grupeve të masave. Materiali përfundon me diskutime dhe konkluzione, me pikpamjen e autorëve mbi aspektet kryesore të orientimeve politike për periudhën e ardhshme, para së gjithash në funksion të integrimit evropian.

2. Bujqësia

2.1 Roli i bujqësisë në ekonominë serbe

Potencialet natyrore dhe burimet fizike e bëjnë Serbinë një vend me kapacitet të konsiderueshëm për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së sektorit të saj agro-ushqimor. Kontributi i bujqësisë në ekonominë serbe është i konsiderueshëm. Gjatë dekadës së fundit kontributi i bujqësisë në GVA ra nga mbi 12 përqind në rreth 10 përqind, ndërsa kontributii bujqësisë në punësim mbetet mbi 20 përqind.

Kontibuti relativisht i lartë i bujqësisë në GVA-në dhe punësimin e vendit është për shkak të një procesi të ngadaltë ristrukturimi të pjesës tjetër të ekonomisë, aktiviteti i ulët i investimeve të përgjithshëm dhe mundësitë e ulëta të punësimit në sektorët jo-bujqësore (Van Berkum & Bogdanov, 2012).

Bujqësia ka kontribut të rëndësishëm në bilancin tregtar të vendit. Pesha e eksporteve bujqësore dhe ushqimore në totalin e eksporteve është rreth 20 përqind. Që nga viti 2004, kur sektori agro-ushqimor kishte një bilanc tregtar negativ, eksportet janë rritur me një ritëm më të shpejtë sesa importet, si pasojë e marrëveshjes së CEFTA-s (Mirković, 2012), duke regjistruar bilanc tregtar pozitiv që nga viti 2005.

Treguesit e kontributit të bujqësisë në ekonominë kombëtare janë të lartë, krahasuar edhe me vendet e tjera të Evropës Juglindore (shikoni Kapitullin A.II).

2.2 Burimet e tokës dhe struktura e fermës

Për shkak të kushteve të saj biofizike dhe klimatike, Serbia ka kushte të favorshme natyrore për prodhim bujqësor të larmishëm. Sipas të dhënave të Censusittë bujqësisë në vitin 2012, Serbia ka 3 861 000 ha tokë bujqësore, nga e cila 3 437 000 ha (89 përqind) është tokë bujqësore e përdorur (UAA). Toka bujqësore e përdorur UAA zë rreth 44 përqind të sipërfaqes totale të Serbisë dhe rreth 2 përqind të UAA të EU-27. Toka e punueshme dominon strukturën e përdorimit të tokës. Treguesit e UAA pasqyrojnë pasuritë e burimeve të tokës: si UAA për frymë dhe toka e punueshme për frymë janë mbi mesataren e EU-27.

Tabela B.VII-1: Treguesit e përdorimit të tokës bujqësore, Serbia dhe EU-27

	Serbia (2012)	EU-27 (2010)
Pesha e UAA në sipërfaqen totale (%)	44.3	39.6
Pesha e tokës së punueshme në UAA (%)	73.1	59.8
Pesha e livadheve të përhershme nëUAA (%)	20.8	34.0
Pesha e bimëve të përhershme në UAA (%)	5.5	6.1
UAA për 1 000 banor (ha)	478.3	344.8
Tokë e punueshme për1 000 banor (ha)	353.9	206.3

Burimi: SORS (Censusi i Bujqësisë 2012); EUROSTAT

Heterogjeniteti i kushteve natyrore, pabarazitë e mëdha rajonale dhe trashëgimia historike kanë kontribuar në krijimin e një strukture shumë të larmishme të fermës (Bogdanov et al., 2012). Përveç familjeve të vogla bujqësore të subsistencës ka ferma gjysëm-subsistence, ferma të mëdha familjare, si dhe ndërmarrje të mëdha private (më parë në pronësi të shtetit), me një strukturë të përzier pronësie. Madhësia mesatare e fermës është 5.4 ha UAA, e cila është 2.7 herë nën mesataren e EU-27 (14.4 ha në vitin 2010). Megjithatë, në pjesët veriore të vendit, fushat panoniane të Provincës së Vojvodinës, struktura e fermës është më e favorshme dhe madhësia mesatare e fermës është 10.9 ha.

Në përgjithësi, përqindja më e madhe e fermave bujqësore (48.8 përqind) nuk kanë tokë, ose kanë deri në 2 ha dhe përdorin rreth 8 përqind të UAA. Në kontrast me këtë, fermat më të mëdha (mbi 50 ha) zënë vetëm 1 përqind të numrit të përgjithshëm të fermave, por përdorin rreth 1/3 e totalit të UAA.

Tabela B.VII-2: Struktura e fermave bujqësore sipas klasës së madhësisë, 2012, Serbia

Klasa e madhësië (UAA për fermë)	Ferma bujqësore		UAA	
	Numër	%	ha	%
0 ha	10 107	1.6	0	0.0
>0 - <2 ha	298 286	47.2	273 622	8.0
2 - <5 ha	182 489	28.9	596 052	17.3
5 - <10 ha	89 083	14.1	617 281	18.0
10 - <20 ha	32 313	5.1	435 499	12.7
20 - <30 ha	7 677	1.2	185 846	5.4
30 - <50 ha	5 352	0.8	203 666	5.9
50 - <100 ha	4 394	0.7	314 096	9.1
100 ha and more	1 851	0.3	811 362	23.6
Total	**631 552**	**100.0**	**3 437 423**	**100.0**

Burimi: SORS (Censusi i Bujqësisë 2012)

Kjo strukturë e fermës tregon se fermat e vogla dhe të mesme dominojnë strukturën e fermave në Serbi edhe pas liberalizimit të tregut të tokës në fund të viteve 1980. Pesha e fermave të vogla ndaj totalit të fermave është ende shumë e lartë, veçanërisht në zonat më densitet të lartë të popullsisë (Shumadi) dhe zonat malore (Serbia Juglindore). Në kontrast me shumicën e vendeve në tranzicion, privatizimi i tokës në Serbi nuk ka shkaktuar ndryshime të rëndësishme në strukturën e fermës (Bogdanov et al., 2012) pasi prona private ekzistonte që në periudhën e para-tranzicionit. Ndikimi shtesë ishte ristrukturimi i ngadaltë i sektorit jo-bujqësor, i cili nuk ka lënë hapsirë për përqendrimin e tokës në fermat e mëdha.

Prodhuesit e vegjël janë të përhapur edhe në sektorin e blegtorisë. Sipas Censusit të Bujqësisë në vitin 2012 Serbia ka 2 020 000 njësi blegtorale (LSU). Rreth 77.5 përqind e fermave kishin disa bagëti, që është përqindje më e lartë se ajo e regjistruar për EU-27 (56 përqind në vitin 2010). Megjithatë, numri mesatar i LSU për fermë (4.1) dhe për ha të UAA (0.59) janë shumë nën mesataren e vendeve të EU-27 (20 LSU për fermë, 0.75 LSU/ha të UAA).

Edhe pse të ngjashme në aspektin e strukturës së UAA, vendet që filluan procesin e tranzicionit më parë dhe kanë ristrukturuar sektorin e tyre bujqësor (p.sh. Polonia dhe Hungaria) kanë më shumë LSU për fermë dhe një pjesë më të madhe të fermave të mëdha. Ndryshe nga këto vende, Serbia ka hasur paritete të pafavorshme të çmimeve për një periudhe të gjatë, fuqia e ulët blerëse e konsumatorëve vendas, kushtet e pafavorshme në tregjet e kredive dhe tregjet financiare, mungesa e investimeve të huaja, një sistem i papërshtatshëm i stimujve dhe shpërbërja e zinxhirit të vlerës (për shkak të organizimit të dobët të procesit të privatizimit), të cilat kanë pasur në mënyrë të pashmangshme efekte negative për sektorin (Mizik 2011, Bogdanov et al., 2012).

Sipas të dhënave të Censusit në Serbi 1.440.000 njerëz punojnë në ferma bujqësore, me numrin e përgjithshëm të njësive vjetore të punës (AWU) prej 646 283. Numri i AWU-ve për fermë në Serbi është 1.02 e cila është 25 përqind më e lartë se mesatarja e EU-27 (0.81). Megjithatë, AWU për ha të UAA dhe AWU për LSU, të cilët janë të dy tregues të produktivitetit të fuqisë punëtore në bujqësi, janë shumë më të larta në Serbi (0.19 AWU/ha UAA, 0.32 AWU/LSU) se mesatarja e EU-27 (0.06 AWU/ha UAA, 0.07 AWU/LSU). Këto vlera tregojnë produktivitetin e ulët të punës, veçanërisht në prodhimin blegtoral, dhe sugjerojnë ekzistencën e papunësisë së fshehur.

2.3 Prodhimi bujqësor

Që nga fillimi i viteve 2000' progres i rëndësishëm është regjistruar në prodhimin bimor, si në aspektin e ndryshimeve në strukturën e prodhimit, edhe në rritjen e vëllimit të përgjithshëm në krahasim me vitet 1990'. Është vënë re një rritje në nënsektorët e farërave vajore, panxhar sheqerit dhe perimeve. Në kontrast me këtë, sektori i blegtorisë nuk ka treguar përparim të dukshëm, dhe tendencat negative në madhësinë e kopesë kanë vazhduar. Trendi negativ në prodhimin blegtoral është ngadalësuar në fillim të viteve 2000' dhevazhdoi rënien e tij pas vitit 2007.

Megjithatë, Serbia është një nga prodhuesit bujqësorë më të rëndësishëm të Evropës, sidomos për misër (11 përqind të prodhimit të EU-27), sojë (35 përqind), luledielli (6 përqind) dhe panxhar sheqeri (2.5 përqind). Nga ana tjetër, pesha e produkteve blegtorale është shumë më e ulët, duke tejkaluar 1 përqind të prodhimit të EU-27 vetëm për qumësht lope, mish qingji dhe derri.

Figura B.VII-1: Ndarja e Prodhimit Bujqësor Bruto sipas mallrave, mesatarja 2010-2012, Serbia



Burimi: SORS

Rreth 2/3 e GAO-s së Serbisë vjen nga prodhimi bimor, dhe një e treta nga prodhimi blegtoral. Drithërat, sidomos misri dhe gruri, kanë pozitë dominuese në strukturën e GAO-s, duke zënë 30-35 përqind. Prodhimi i frutave dhe perimeve zë rreth 20 përqind të GAO-s, ndërsa bimët industriale kontribuojnë me 9 përqind të totalit të GAO-s.

Kontributi i blegtorisë në GAO ka rënë, kryesisht për shkak të zhvillimeve negative në sektorin e mishit, ku kontributi i prodhimit të mishit të derrit dhe viçit tregojnë një prirje rënëse gjatë viteve të fundit. Nga të gjitha produktet blegtorale, mishi i derrit (11-14 përqind) dhe qumështi i lopës (8-10 përqind) kanë kontributin më të lartë në GAO.

Periudha 2005-2013 u karakterizua nga luhatshmëri të larta të prodhimit ndikuar nga kushtet e motit. Pas 2010-2011 (vite në të cilat u regjistruan rendimente rekord), një rënie e rëndë e prodhimit pasoi në vitin 2012, si pasojë e një të ftohti ekstrem. Rënia e prodhimit në vitin 2012 është më e madhja e regjistruar ndonjëherë dhe kulturat dominante në GAO-n Serbe (misër, panxhar sheqeri, luledielli dhe soja) u prekën në mënyrë të veçantë. Varësia e lartë nga kushtet e motit është pasojë e bujqësisë jo intensive, tipike për fermat e vogla serbe (Bošnjak & Rodić, 2006, Lalić et al., 2011).

Tabela B.VII-3: Ndryshimi i volumit të Prodhimit Bujqësor Bruto(viti i mëparshëm=100), 2005-2013, Serbia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Totali	-3.4%	-2.6%	-11.7%	13.7%	1.3%	1.1%	-1.1%	-21.4%	25.6%
Bujqësi	-5.7%	-3.0%	-18.0%	23.0%	3.6%	1.1%	-1.8%	-30.6%	40.6%
Blegtori	1.1%	-3.0%	0.0%	-3.0%	-3.5%	1.1%	0.2%	0.2%	2.9%

Burimi: SORS

Bimët dominuese në prodhimin e Serbisë kanë rendimentet mesatare më të ulëta se ato të prodhuesve kryesorë të BE-së (shikoni Kapitullin A.II). Farërat vajore dhe panxhar sheqeri janë përjashtime, me rendimente të barabarta me ato të BE-së. Kjo kryesisht për shkak të prodhimit të madh të bimëve industriale në fushat veriore serbe, në ferma të mëdha, me pajisje moderne.

Tabela B.VII-4: Rendimentet mesatare të bimëve (t/ha), 2005-2013, Serbia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Grurë	3.56	3.47	3.33	4.3	3.64	3.37	4.21	3.98	4.94
Misër	5.81	5.14	3.25	4.83	5.29	5.86	5.15	2.78	4.78
Panxhar sheqeri	48.21	44.55	40.58	47.88	45.56	50.04	50.73	35.95	47.80
Luledielli	1.77	2.06	1.90	2.42	2.40	2.23	2.48	2.19	2.73
Sojë	2.81	2.74	2.07	2.44	2.42	3.18	2.67	1.72	2.41
Bimë vajore	1.93	1.96	2.29	2.88	2.45	2.03	2.9	2.43	2.79
Duhan	1.57	1.58	1.38	1.52	1.61	1.79	1.59	1.36	1.62

Burimi: SORS

Prodhimi i qumështit për lopë është gjithashtu i ulët (3 100 litra për lopë në vit), si pasojë e intensitetit të ulët të prodhimit në fermat e vogla bujqësore. Rendimentet variojnë në mënyrë të konsiderueshme midis rajoneve dhe sipas madhësisë së fermës. Në rajonin e Vojvodinës, prodhimi mesatar i qumështit është 30 përqind më i lartë se në Serbinë qendrore, dhe në pjesën e kontrolluar të tufës (që është 28 përqind e numrit të përgjithshëm të lopëve dhe mëshqerrave) rendimenti mesatar i qumështit është nga 4 700-7 700 litra për lopë. Arsyet për rendimentet e ulëta mesatare të qumështit lidhen pjesërisht me strukturën e rracave (në Serbinë qendrore rraca Simmental i gjedhit janë akoma të përhapura), por edhe me cilësinë e ulët të ushqimit të kafshëve, sidomos në zonat e thella malore.

2.4 Çmimet e bujqësisë

Indekset e çmimeve të produkteve bujqësore në Serbi tregojnë rritje dinamike me disa luhatje. Çmimet e produkteve janë rritur vazhdimisht përveç vitit 2009, kur një rënie e madhe u regjistrua në krahasim me vitin 2008, vit në të cilin u regjistruan çmime rekord edhe në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e produkteve blegtorale janë rritur ngadalë, duke qëndruar në të njëjtat nivele gjatë dekadës së fundit, dhe që kur filloi kriza, pabarazia në rritjen e çmimeve të blegtorisë dhe bujqësisë ka qenë më e dukshme.

Tabela B.VII-5: Indekset e çmimit të prodhimit bujqësor - nominale, 2005-2013 (2010=100), Serbia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
BUJQËSIA TOTAL	56.6	61.8	72.1	91.0	87.0	100.0	118.1	148.6	146.2
Produkte bimore	49.5	57.5	77.5	85.3	71.5	100.0	123.5	159.3	150.3
Produkte shtazore dhe blegtorale	73.0	73.1	72.9	97.8	104.5	100.0	118.0	135.6	141.9

Burimi: SORS

Në krahasim me vendet fqinje dhe EU-27, çmimet e produkteve bimore në Serbi janë në përgjithësi të ulëta (shikoni AneksinB.VII-3 dhe Kapitullin A.II). Veçanërisht evidente është konkurrueshmëria e çmimeve të drithërave dhe bimëve industriale.

Edhe pse Serbia është një prodhues i rëndësishëm i drithërave (sidomos misër), me sipërfaqe të mëdha livadhesh dhe kullotash, sektori i saj blegtoral është shumë më pak konkurrues në çmim. Korrelacioni i lartë midis ndryshimeve të çmimeve të misrit dhe derrit është mjaft i dukshëm. Rritja e çmimeve të misrit në tregun ndërkombëtar çoi në një rënie të çmimeve të produkteve të derrave në Serbi, pasi prodhuesit u përpoqën të reduktojnë mbarështimin e derrave duke shitur misër me çmime të favorshme. Kjo paqëndrueshmëri në tregun serb tregon mungesën e mekanizmave të nevojshëm për të parandaluar dështimet e tregut në sektorin e blegtorisë.

Konkurrueshmëria e çmimeve relative të prodhimit bimor në Serbi mund të shpjegohet nga kostot më të ulëta të punës dhe numri i faktorëve të tregut. Kjo i referohet kryesisht pozicionit monopol të blerësve dhe të industrisë ushqimore, e cila është akoma e bazuar tek importet. Përveç kësaj,

duhet theksuar se në Serbi nuk ka një praktikë të pagesave bazuar në cilësi, por i gjithë prodhimi shitet me të njëjtin çmim (më të ulët).

2.5 Tregtia bujqësore

Tregtia e produkteve bujqësore dhe ushqimore është karakterizuar nga një rritje si e importeve edhe e eksporteve, si edhe një sufiçit tregtar. Një ndryshim i rëndësishëm në rritjen e tregtisë së jashtme u vu re në vitin 2006. Tregtia më e lartë e përgjithshme e produkteve bujqësore, si eksporte dhe importe, ishte në vitin 2012 (3.35 miliardë EUR), ndërsa teprica tregtare arriti kulmin e saj në vitin 2013 (919 milionë EUR).

Figura B.VII-2: Tregtia agro-ushqimore (milionë EUR), 2005-2013, Serbia



Burimi: SORS

Vlerat e eksportit janë përgjithësisht më të ulëta se ato të importit, si në total edhe sipas grupeve të prodhimit (me përjashtim të peshkut dhe produkteve të peshkimit). Kjo nënkupton se lëndët e para dhe produktet më pak të përpunuara bujqësore janë dominuese në totalin e eksporteve të Serbisë, ndërsa produktet e një shkalle më të lartë finalizimi dominojnë importet.

Grupmallrat dominuese të eksporteve serbe janë drithërat, frutat, pijet, yndyrnat dhe vajrat dhe sheqeri dhe produktet sheqerore. Për sa i përket importeve, grupet kryesore të mallrave janë frutat, preparatet e ndryshme ushqimore, kafe, çaj dhe erëza, duhan, kakao dhe preparate të saj si edhe farërat vajore.

Figura B.VII-3: Përbërja e importeve dhe eksporteve agro-ushqimore sipas grupeve kryesore të mallrave , mesatarja 2010-2013, Serbia



Burimi:SORS

Grupet kryesore të mallrave përbënin 60 përqind të totalit të eksporteve agro-ushqimore (mesatarja 2010-2013) dhe 53 përqind të totalit të importeve agro-ushqimore. Kjo strukturë e tregtisë tregon një shumëllojshmëri të lartë të mallrave të importuara dhe eksportuara. Produktet e importuara janë kryesisht ato produkte të cilat nuk mund të prodhohen në Serbi, ndërsa eksportet bujqësore janë të fokusuara në grupe të caktuara produktesh, të cilat kanë konfirmuar konkurrueshmërinë e tyre në tregun ndërkombëtar.

Rreth 50 përqind e eksporteve agro-ushqimore totale shkojnë në tregun e BE-së, rreth 41 për qind në tregun e CEFTA-s dhe 9 përqind në vendet e tjera. Produktet e importuara ushqimore vijnë kryesisht nga BE-ja (rreth 48 përqind), tregu i CEFTA (22 përqind), dhe të gjitha tregjet e tjera përbëjnë më pak se 1/3 e totalit të importeve (31 përqind). Federata Ruse është bërë një treg gjithnjë e më i rëndësishme për produktet bujqësore serbe, dhe akoma më shumë me Bashkimin e sapo krijuar Doganor të Federatës Ruse, Bjellorusia dhe Kazakistani.

Afërsia e tregut dhe marrëdhëniet tradicionale tregtare i bëjnë vendet e Evropës Juglindore një treg shumë të rëndësishëm për produktet bujqësore serbe. Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) ka kontribuar në rritjen e shkëmbimit tregtar dhe një bilanc pozitiv tregtar të bujqësisë serbe, pasi vendi është shumë konkurrues në këtë treg. Rajoni i CEFTA-s është një nga disa tregjet në të cilët Serbia regjistron vazhdimisht bilanc tregtar pozitiv. Partneri më i madh i eksporteve të Serbisë është Bosnja dhe Hercegovina (gati 1/4 e vlerës së eksportit). Një sasi e konsiderueshme e eksporteve shkojnë edhe në Ish Repulbikën Jugosllave të Maqedonisë (rreth 8 përqind).

Eksportet serbe në shtetet e BE-së kanë një trend rritës, vlera më e lartë është regjistruar në vitin 2012 (978 milionë EUR). Vendet kryesore janë: Rumania (misër), Gjermania, Italia dhe Greqia. Importet nga vendet e BE-së arritën kulmin në vitin 2013 (704 milionë EUR). Eksportuesit kryesorë të BE-së në Serbi janë Gjermania, Italia, Hungaria, Greqia dhe Polonia. Bilancet e larta pozitive të tregtisë serbe janë me Italinë, Austrinë dhe Greqinë, si dhe defiçitet e saj më të larta janë me Poloninë dhe Holandën. Grupet kryesore të mallrave të eksportuara janë produktet (të papërpunuara) bujqësore primare (rreth 95 përqind). Midis grupeve të importuara dominojnë produktet primare/bazë, edhe pse me një përqindje më të vogël (rreth 55 për qind). Produktet e përpunuara agro-ushqimore përbëjnë vetëm 5 përqind të eksporteve agro-ushqimore serbe në vendet e BE-së, ndërsa këto produkte zënë pak a shumë 40 përqind të totalit të importeve nga BE-ja.

Ndër vende të tjera, importuesi më i rëndësishëm i produkteve agro-ushqimore serbe është Federata Ruse, me një trend në rritje të eksporteve në këtë vend. Eksportuesit kryesorë në Serbi

janë Brazili me një pjesë prej 8 përqind (kafe), Argjentina dhe Turqia (fruta dhe perime të freskëta). Bilanci tregtar është në përgjithësi më pak i pafavorshëm se në vitet e fundit, por është akoma negativ, kryesisht për shkak të importeve të konsiderueshme nga vendet me të cilat Serbia nuk ka nënshkruar marrëveshjet e tregtisë, dhe për shkak se shumica e mallrave të importuara nuk mund të prodhohen në Serbi (kafe, kakao, agrume, etj).

3. Politika bujqësore

3.1 Koncepti dhe kuadri i politikës bujqësore serbe

Gjatë dekadës së fundit ka pasur përmirësime të konsiderueshme në kuadrin institucional të sektorit bujqësor në Serbi. Gjatë viteve 2000' janë miratuar një sërë strategjish kombëtare dhe dokumentesh programuese, dhe është intensifikuar puna legjislative në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Kuadri ligjor i politikave bujqësore ka qenë i përcaktuar me Ligjin mbi Stimujt për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i cili rregullon kriteret e përshtatshmërisë dhe llojet e stimujve. Miratimi i këtij ligji është një parakusht i rëndësishëm për krijimin e një politike të qëndrueshme dhe të parashikueshme bujqësore për një periudhë afatgjatë.

Drejtimet themelore të zhvillimit të Serbisë dhe kuadri i zhvillimit bujqësor dhe rural, përcaktohen nëpërmjet "ombrellës" së dokumenteve strategjike kombëtare të tilla si Programi Kombëtar për Integrim në BE të Serbisë, Strategjia e Reduktimit të Varfërisë së Serbisë, Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm Kombëtar, Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik, etj. Shumica e këtyre dokumenteve strategjike theksojnë rëndësinë e bujqësisë dhe zonave rurale për ekonominë serbe dhe për ruajtjen e mjedisit natyror. Ato gjithashtu theksojnë nevojat dhe sfidat specifike me të cilat po përballet popullsia rurale.

Dokumenti strategjik kryesor i sektorit - Strategjia e Zhvillimit të Bujqësisë - u miratua në vitin 2005. Në vitin 2013 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MAFWM) përgatiti Draft Strategjinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2014-2024. Aktualisht janë në proces konsultime publike për dokumentin e propozuar, ndërkohë që paralelisht janë duke u përgatitur Programi i Zhvillimit Kombëtar për Bujqësinë dhe Zonat Rurale dhe programi IPARD. Me miratimin e këtij grupi dokumentesh do të përcaktohen drejtimet e zhvillimit afatmesëm, si dhe mekanizmat më të hollësishme për zbatimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Gjatë dekadës së fundit, politika bujqësore në Serbi ka qenë subjekt i presioneve heterogjene dhe komplekse: paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike, kushtet jashtëzakonisht të këqija të motit me ndikimin e tyre shkatërrues mbi të ardhurat e fermës dhe nga gjysma e dytë e viteve 2000 trazirat e tregut global. Në një mjedis të tillë, prioritetet dhe mekanizmat e politikës bujqësore janë përzgjedhur në mënyrë kryesisht pragmatike, dhe jo në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare. Ambienti i paqëndrueshëm ekonomik dhe konsistenca e pamjaftueshme e kuadrit të politikës ishin arsyet pse mbështetja buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural nuk ka pasur një drejtim të qartë gjatë periudhës së analizuar. Megjithatë, në lidhje me reformat e politikave bujqësore serbe që nga fillimi i viteve 2000, tre faza mund të veçohen:

1) Në fillim të viteve 2000', reformat ishin të fokusuara në ndërtimin insitucional dhe ndërhyrjet legjislative që synojnë krijimin e strukturave efikase në ato pjesë të sektorit të cilat janë më të prekura nga ekonomia gri. Janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të rigjallëruar disa nënsektorë konkurrues të cilët u shkatërruan gjatë sanksioneve ekonomike (mish, sheqer, fruta dhe perime). Stimujt e politikës janë të orientuara drejt masave mbështetëse të tregut, me një theks të fortë në sektorët që kontribuojnë për rivitalizimin e sektorit të përpunimit të ushqimit dhe rritjen e eksporteve. Hapja e tregjeve të jashtme dhe tregtia autonome preferenciale e BE-së, së bashku me privatizimin e industrisë ushqimore (veçanërisht sheqerit dhe rafineritë e vajit ushqimor) patën ndikim pozitiv në rritjen e

mundësive për eksport.

2) Midis viteve 2004 dhe 2007, janë bërë ndryshime të forta në qëllimet strategjike dhe mekanizmat e zbatimit të politikës bujqësore nëpërmjet miratimit të Strategjisë së Zhvillimit Bujqësor. Qëllimi i tij kryesor ishte rritja e konkurrueshmërisë së fermave familjare komerciale, dhe në aspektin e mekanizmave zbatuese ajo ishte e fokusuar në inkurajimin e investimeve në fermë. Strategjia nuk është mbështetur nga dokumente shumëvjeçare të programimit dhe kuadrit buxhetor. Gjatë viteve, parimet e politikave të përcaktuara në Strategji janë shoqëruar vetëm pjesërisht me skema operacionale, masat dhe fondet e duhura. Masat mbështetëse që u zbatuan pasqyruan përpjekjet që synonin adresimin e çështjeve thelbësore të zhvillimit, por koncepti i përgjithshëm politik ishte në kundërshtim dhe i paplotë. Është krijuar një sistem i pagesave direkte dhe janë prezantuar masat e zhvillimit rural. Gjithashtu, u aktivizua tregu financiar, duke siguruar kredi me kushte më të favorshme se sa kreditë e tregut, u mbështet dhënia me qira e tokës bujqësore dhe u krijua Regjistri i fermave bujqësore (Bogdanov et al., 2008 Erjavec et al., 2009).

3) Që nga viti 2008 zbatimi i politikave bujqësore ka qenë në ndryshim të vazhdueshëm. Programet dhe rregulloret janë ndryshuar dhe/ose shfuqizuar disa herë gjatë vitit, dhe pagesat për përfituesit janë vonuar, fakte që kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi të paqëndrueshëm dhe jo të favorshëm ekonomik për prodhuesit. Pagesat e drejtpërdrejta janë bërë forma kryesore e mbështetjes, por mekanizmat e zbatimit, procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes janë ndryshuar shpesh. Nga njëra anë kjo tregon mungesën e një vizioni të qartë për bujqësinë, dhe nga ana tjetër ndikimet e një politike të tillë janë relativisht të ulëta. Mbështetja buxhetore në lidhje me masat agro-mjedisore ka qenë tepër e ulët, dhe shumat e mbështetjes për zhvillimin rural kanë qënë të vogla dhe janë reduktuar akoma më tej. Prandaj, i gjithë sistemi i mbështetjesështë duke marrë drejtimin e gabuar krahasuar me ndryshimin e dëshiruar.

Krijimi i Drejtorisë për Pagesat Agrare (e cila në të ardhmen duhet të marrë përsipër rolin e Agjencisë së Pagesave për IPARD dhe më vonë për EU CAP) ka kontribuar në transparencën dhe llogaridhënien e të gjithë sistemit dhe politikës. Megjithatë, ka akoma mungesë të procedurave të vazhdueshme dhe të burimeve njerëzore për kontrollin efektiv të përkrahjes së zbatuar. I gjithë procesi i aplikimit, procedurat e miratimit dhe operacioneve mbeten një punë e rëndësishme për t'u bërë, si për aplikantët dhe për administratën e përfshirë në zbatimin.

3.2 Mbështetja buxhetore për bujqësinë

Mbështetja buxhetore totale për bujqësinë

Gjatë periudhës 2005-2013, mbështetja buxhetore për bujqësinë serbe është luhatur si në vlerë edhe në strukturë. Midis viteve 2005 dhe 2008, buxheti bujqësor u rrit nga 150 milionë EUR në 279 milionë EUR, e cila ishte rekord për të gjithë periudhën 2005-2013.

Arsyet kryesore për kufizimet buxhetore kanë qenë ndryshimet e shpeshta të strukturave menaxhuese dhe mungesa e fondeve në disa vite (e cila shkaktoi shkurtime në financimin e masave të caktuara). Si rezultat, ndryshimet radikale në programet dhe skemat mbështetëse erdhën së bashku me ndryshimet në strukturat qeverisëse.

Struktura e mbështetjes buxhetore për bujqësinë ka ndryshuar shumë nga viti në vit. Në përgjithësi, në vitet kur prodhimi u godit nga kushtet e pafavorshme të motit dhe/ose luhatjet e shpeshta të tregut, shumica e fondeve u rishpërndanë drejt subvencioneve për inpute apo pagesave direkte për ha.

Figura B.VII-4: Ndarja e mbështetjes buxhetore për bujqësinë sipas shtyllave të politikës, 2005-2013, Serbia[1]



Shënim: [1] të dhënat për vitin 2009 nuk janë të plota

Burimi: Databaza APM e Serbisë

Pjesa dërrmuese e mbështetjes buxhetore është e fokusuar në masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve. Masat e mbështetjes në këtë shtyllë të politikës llogariten për më shumë se 77 përqind të financimit total të shpërndarë mesatarisht për bujqësinë serbe.

Pjesa e masave të zhvillimit rural (Shtylla e dytë) ka qenë në rënie që nga viti 2006. Një rritje e konsiderueshme u vu re vetëm në vitin 2006, kur fonde të konsiderueshme u dhanë për fermat ("e moshuara") jo-komerciale. Kjo mbështetje u hoq menjëherë vitin e ardhshëm, dhe fondet e akorduara në shtyllën e dytë vazhduan të ulen.

Transfertat për shërbime të ndryshme në bujqësi ishin vazhdimisht të ulëta. Në fillim të periudhës janë shpenzuar relativisht më shumë burime , kur ndihma e donatorëve për këto qëllime ishte më e lartë.

Pjesa e shumave ta pa-klasifikuara të buxhetit ishte shumë e madhe në vitet 2008 dhe 2009, si pasojë e informacionit të pamjaftueshëm sistematik dhe të qëndrueshëm për realizimin e mbështetjes buxhetore.

Masat e mbështetjes së tregut dhe pagesat direkte

Gjatë periudhës 2005-2013, masa të ndryshme të mbështetjes së tregut u zbatuan në Serbi, të tilla si rimbursimi i eksportit, ndërhyrjet e blerjeve, financimi i shpenzimeve operative të rezervave publike dhe bashkë-financimi i magazinimit. Vetëm mbështetja e eksporteve u zbatua vazhdimisht (deri në 2011), ndërsamagazinimet private dhe blerjet emergjente janë financuar herë pas here (në vitet kur kushtet e kërkija të motit shkaktuan trazira të tregut).

Pesha që zënë masat mbështetëse të tregut në totalin e shpenzimeve të shtyllës së parë është ulur vazhdimisht, nga 15.5 përqind në vitin 2007 në vetëm 4.5 përqind në vitin 2011. Pas vitit 2011 këto masa u hoqën dhe u zëvendësuan nga pagesat direkte.

Masat e mbështetjes direkte të prodhuesve të zbatuara në Serbi në periudhën 2007-2013 përfshinë pagesat direkte bazuar në prodhim (garantimi i çmimeve), pagesat për hektarë dhe krerë bagëti dhe subvencionet e inputeve (rimbursimet, normat e interesit të subvencionuara dhe primet e sigurimit, etj.). Mesatarisht 70 përqind e mbështetjes buxhetore totale për bujqësinë (42 përqind në vitin 2006 dhe 91 përqind në vitin 2013) është shpërndarë për pagesat direkte dhe

subvencione për inputet variable. Duke pasur parasysh që këto mënyra të mbështetjes kanë traditë të gjatë dhe efekt të drejtpërdrejtë mbi prodhimin dhe të ardhurat e fermës, prodhuesit i konsiderojnë ato më të rëndësishme dhe komode, dhe treguan ndjeshmëri të lartë ndaj luhatjeve të tyre.

Figura B.VII-5:Ndarja e masave të mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte të prodhuesve, 2005-2013, Serbia



Burimi: Databaza APM e Serbisë

Masat e mbështetjes direkte të prodhuesve kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme nga viti në vit. Në shumicën e rasteve kjo ka ndodhur për shkak të dështimeve të tregut që rrjedhin nga kushtet e pafavorshme të motit dhe luhatjet e çmimeve, por edhe për shkak të mungesës së udhëzimeve të duhura strategjike dhe kuadrit të mirëpërcaktuar të politikave dhe prioriteteve. Në këtë kuptim mund të thuhet se politika është nxitur përgjithësisht nga shqetësimet pragmatike dhe nga përpjekjet për të stabilizuar të ardhurat e fermerëve në rrethana të jashtëzakonshme.

Trendi i përgjithshëm ishte një reduktim në kompensimin e çmimeve, si në aspektin e vëllimit të fondeve dhe në pjesën që zë në mbështetjen totale. Pjesa e pagesave direkte të bazuara në prodhim (kompensimi içmimeve) në totalin e transfertave buxhetore për masat e mbështetjes së tregut dhe mbështetjes direkte për prodhuesit (masat e shtyllës së parë) u zvogëluan nga 47 përqind në vitin 2005 në 16.1 përqind në vitin 2013. Përveç reduktimeve absolute dhe relative në kompensimin e çmimeve, gjithashtu numri i produkteve sipas këtij regjimi u reduktua. Shpërblimet për farërat vajore u aplikuan vetëm në vitin 2005, ato për grurë të magazinuar deri në 2006, për duhan deri në vitin 2010, ndërsa shpërblimet për qumështin vazhdojnë akoma të zbatohen. Kompensimet e qumështit janë kompensimet më të rëndësishme të çmimeve; pjesa që ato zinin në mbështetjen e përgjithshme buxhetore në fillim të periudhës së vrojtuar ishte 20 përqind. Në vitet e fundit ka rënë në rreth 12 përqind (më pak se 2 përqind në vitin 2010) dhe forma e pagesës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Në vend të shpërblimeve të larta për qumështin e prodhuar në rajonet kodrinore ose malore, që nga viti 2009 është praktikuar një pagesë fikse për litër me kushtin e prodhimit minimal 3 000 litra qumësht lope në tremujor ose të paktën 1 500 litra në tremujor në zonat me kushte më pak të favorshme për bujqësinë.

Orientimi drejt pagesave direkte për sipërfaqe dhe për krerë bagëti po reflekton gatishmërinë e politikës kombëtare për të pranuar praktikën e CAP. Pagesat direkte për sipërfaqe apo për krerë bagëti u prezantuan në fillim të periudhës së vrojtuar, por më vonë ato u reduktuan gradualisht, derisa pothuajse u zhdukën. Në vitin 2012 dhe 2013 këto masa janë zbatuar sërish, kryesisht në prodhimin bimor (me përjashtim të perimeve dhe foragjereve) dhe sektorin e qumështit.

Megjithatë, zbatimi i kësaj lloj pagese nuk është i lidhur me përputhshmërinë e standardeve themelore që kanë të bëjnë me mjedisin, sigurinë ushqimore, menaxhimin e burimeve natyrore dhe mirëqenien e kafshëve.Në një farë mase kjo pasqyron paaftësinë e politikëbërësve për të ndërmarrë hapa radikalë dhe për të futur masa të cilat nuk do të jenë as populloree as të pranuara me dëshirë nga prodhuesit.

Pjesa e subvencioneve për inpute është rritur vazhdimisht gjatë periudhës së analizuar. Që prej vitit 2007 subvencionet e inputeve janë bërë një skemë dominuese e mbështetjes buxhetore për bujqësinë, duke zënë 45 përqind të buxhetit bujqësor total (në vitin 2010, arriti në 72 përqind). Megjithatë, struktura e subvencioneve për inpute ka ndryshuar në mënyrë dinamike, me një tendencë për t'u përqendruar tek nafta për karburant dhe plehra minerale në vitet e fundit . Ndryshimet e shpeshta në mënyrën e zbatimit të këtyre masave karakterizojnë këtë praktikë. Për shembull, në fillim të periudhës subvencionet për naftë ishin në formën e një pagese fikse për litër, ndërsa më vonë ato u llogaritën si përqindje e shpenzimeve të karburantit të blerë në bazë të një volumi maksimal të litrave për hektar. Mënyrat e pagesës varen gjithashtu nga fakti nëse një fermë është nën ose mbi 10 ha. Modele të ngjashme janë zbatuar në subvencionimin e plehrave.

Të gjitha metodate mësipërme tregojnë se masat më të rëndësishme janë zbatuar nga zgjidhje *ad-hoc*. Subvencionet për blerjen e kafshëve për mbarështim ishin relativisht modeste para 2011 (2-3 përqind të buxhetit bujqësor total), vit në të cilin u rritën në 9 përqind. Një masë tjetër që duhet të përmendet është subvencionimi i kredive afatshkurtra. Në fillim të periudhës së analizuar këto subvencione zinin rreth 10 përqind të mbështetjes buxhetore totale për bujqësinë, dhe në vitin 2008 u reduktuan në një përqindje të parëndësishme dhe në vitin 2010 u përjashtuan nga sistemi i mbështetjes.

Masat e zhvillimit rural

Mbështetja për zhvillimin rural ka qenë dukshëm më e lartë në fillim të periudhës, si dhe masat dhe programet nëpërmjet të cilave ajo u zbatua ishin shumë më të larmishme. Megjithatë, rëndësia e masave për zhvillim rural u margjinalizua gradualisht, në mënyrë të atillë që mbështetja financiare u rishpërnda në programe të ndryshme brenda departamenteve të tjera të Ministrisë, dhe për bashkë-financimin e programeve të qeverive lokale.

Figura B.VII-6:Ndarja e masave të zhvillimit rural, 2005-2013, Serbia



Burimi: Databaza APM e Serbisë

Pjesa më e madhe e mbështetjes për zhvillimin rural synonte përmirësimin e konkurrueshmërisë (mesatarsisht mbi 77 përqind). Masat më të rëndësishme ishin mbështetja e investimeve në fermë,

zbatuar përmes granteve për rinovimin e objekteve, mekanizmat e fermës dhe blerja e pajisjeve, rimbjellja dhe zgjerimi i pemëtoreve dhe vreshtave. Kushtet e përzgjedhjes ndryshuan shpesh. Parimi i përgjithshëm ishte se fermave në zona të largëta kodrinore dhe malore dhe fermave në pronësi të personave nën moshën 40 vjeç duhet t'u jepen subvencione më të larta. Përveç kësaj, ka pasur vite kur kriteret kishin një theks të fortë social, duke favorizuar fermat në pronësi të grave apo masa të veçanta u projektuan për grupet e ekspozuara sociale (romëve dhe refugjatëve). Mbështetja për zgjerimin e madhësisë së fermës dhe konsolidimin e fermave u dha nëpërmjet formave të ndryshme, duke përfshirë edhe stimuj për qiranë dhe konsolidimin e tokës.

Aktivitetet e marketingut dhe promovimit, krijimi i grupeve të prodhuesve dhe forcimi i zinxhirit të furnizimit ushqimor nuk ishin pjesë e skemave të rregullta mbështetëse dhe u shfaqën rrallë, duke zënë pjesë të vogla në strukturën e mbështetjes buxhetore. Më shpesh këto aktivitete janë mbështetur nëpërmjet projekteve të donatorëve dhe nga qeveritë lokale.

Masat që synojnë përmirësimin e mjedisit dhe zonave rurale janë zbatuar shumë pak, përveç përkrahjes për mirëmbajtjen e burimeve gjenetike bujqësore dhe për bujqësinë organike. Vlen të përmendet se nevojat specifike të prodhuesve në zonat më pak të favorizuara për bujqësinë janë të njohura, por nuk janë përcaktuar masa konkrete që nga viti 2006. Kjo mund të konsiderohet si një nga dështimet më të mëdha të politikave bujqësore, duke pasur parasysh shpërndarjen e pabarabartë rajonale në ndarjen e subvencioneve.

Nxitja e zhvillimit të ekonomisë rurale duke mbështetur diversifikimin e të ardhurave të fermës dhe përmirësimet në infrastrukturë kanë pasur përfaqësim modest në strukturën e buxhetit. Shuma të konsiderueshme janë shpenzuar në përmirësimin e infrastrukturës rurale vetëm në vitin 2007 (nga buxheti kombëtar i planit të investimeve). Mbështetja për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë rurale është operacionalizuar përmes stimujve për zejtarinë, rinovimi i pajisjeve për turizëm rural, etj. Këtu duhet theksuar se disa nga aktivitetet që lidhen me zhvillimin e turizmit dhe infrastrukturën rurale kanë qenë të financuar nga fondet e tjera (buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, projekte të donatorëve dhe qeverive lokale).

Masa të ndryshme mbështetëse në lidhje me bujqësinë

Sipas politikës së masave dhe shërbimeve të ndryshme në lidhje me bujqësinë janë zbatuar programe tërregullta të Ministrisë, për shembull ato që lidhen me zgjedhjen dhe mbarështimin e bagëtive, shërbimet e ekstensionit, kontrolli i pjellorisë së tokës, menaxhimi i dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimi i raportimit dhe parashikimit, etj.Pjesa më e madhe e mjeteve financiare shkoi për shërbimet e ekstensionit. Nuk ka pasur luhatje të mëdha në shumat dhe strukturën e mbështetjes financiare, pasi si fondet dhe aktivitetet janë përcaktuar në programet afatgjata të cilat mund të ndryshohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Mbështetja financiare për këto qëllime varioji midis 3 dhe 5.8 milionë EUR, e cila nuk përfshin një sërë aktivitetesh të financuara nga nën-llogaria e Drejtorisë Veterinare (rreth 15-20 milionë EUR në vit në periudhën 2010-2013).

Mbështetja buxhetore për bujqësinë serbe është mjaft modeste në krahasim jo vetëm me mesataren e EU 27, por edhe me ato të vendeve fqinje (shikoni Kapitullin A.II).

4. Diskutime dhe konkluzione

Analiza tregon se kontributi i bujqësisë së Serbisë në totalin e GVA-së dhe punësimit është një nga më të lartat në Evropë (shikoni Kapitullin A.II). Nga ana tjetër, raporti relativ i këtyre treguesve është më i favorshëm krahasuar me shumë vende të tjera (dhe edhe në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë serbe), çka sugjeron se produktiviteti në bujqësinë serbe mund të konsiderohet si mjaft i kënaqshëm. Në strukturën e fermës, fermat e vogla janë mbizotëruese, si në aspektin e UAA dhe LSU për fermë edhe AWU. Ky konstatim tregon papunësinë e fshehur të anëtarëve të

fermës dhe potencial të lartë për të rritur produktivitetin bujqësor. Sa i përket rendimenteve mesatare Serbia renditet nën mesataren e vendeve evropiane. Përjashtimet janë misri, farërat vajore dhe panxhar sheqeri. Serbia është një prodhues i mirë- pozicionuar i këtyre kulturave, me çmime shumë konkurruese në tregun ndërkombëtar. Prodhimi blegtoral është në rënie të vazhdueshme, çka kontribuon në konkurrencën e saj më të ulët në tregjet e huaja në krahasim me prodhimin bimor. Serbia ka një bilanc pozitiv tregtar të produkteve bujqësore, dhe ka tendencë rritëse. Bilanci tregtar është pozitiv me vendet e BE-së dhe CEFTA-s, dhe negativ kryesisht me vende që prodhojnë produkte të cilat nuk mund të prodhohen në Serbi.

Koncepti dhe kuadri i politikës bujqësore janë theksuar fort nga tranzicioni i përgjithshëm politik dhe ekonomik të cilit Serbia i është nënshtruar për dy dekada. Rregulloret nuk ishin të lidhura mjaftueshëm me dokumentet dhe programet strategjikë, kuadri buxhetor dhe grupi i treguesve për vlerësimin e zbatimit të politikave nuk ishin përcaktuar, ndërsa kapaciteti institucional për operacionalizimin e masave mbështetëse ishte i pamjaftueshëm. Shuma, struktura dhe zbatimi i mekanizmave të mbështetjes buxhetore ishin të paqëndrueshme, duke mos reflektuar asnjë drejtim strategjik apo mesazh të qartë për përdoruesit. Një nga pikat më të dobëta ishte fokusi i pamjaftueshëm në disa nga problemet kyçe të sektorit, si produktiviteti i ulët, integrimi i dobët agro-ushqimor vertikal dhe horizontal dhe qëndrueshmëriae një numri të madh të prodhuesve të vegjël në zonat e thella. Një qasje e tillë ndaj politikëbërjes drejt sektorit agro-ushqimor është një kërcënim serioz për konkurrueshmërinë e tij, qëndrueshmërinë afatgjatë dhe mirëqenien e popullsisë rurale.

Gjatë periudhës së analizuar mbështetja direkte u zbatua kryesisht në formën e subvencioneve për inpute. Në vitet e fundit kanë dominuar pagesat për hektarë, por zbatimi i tyre ka qenë problematik. Pranimi i pagesave nuk është i kushtëzuar në përmbushjen e kërkesave të ndër-përputhshmërisë. Si të tilla, ato janë shumë të përshtatshme për përfituesit, por kjo praktikë nuk çon as në përmirësimin e standardeve dhe teknologjisë, as në rritjen e konkurrueshmërisë. Ngurrimi i politikëbërësve për të filluar reformimin në këtë segment të politikave dhe përshtatjen e saj më CAP, vë në pikëpyetje efektivitetin e këtyre masave, të cilat konsumojnë pjesën më të madhe të shpërndarjeve të buxhetit për bujqësinë.

Mbështetja e zhvillimit rural, në çdo aspekt (shuma, struktura dhe operacionalizimi) është një nga sfidat më të mëdha. Vlera e mbështetjes për zhvillimin rural është shumë e ulët, dhe madje tregon një trend rënës. Një përqasje e tillë zvogëlon mundësinë për zgjidhjen e disa prej problemeve kryesore strukturore në bujqësi dhe zhvillim rural, siç janë aktivizimi i tregut të tokës, rritja e produktivitetit, në veçanti në fermat e vogla familjare, aktivizimi i potencialit për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në zonat më pak të favorizuara, etj. Një qasje e pamjaftueshme në politikat e zhvillimit rural zvogëlon gjithashtu kapacitetin për thithjen e mbështetjes së ardhshme të IPARD.

Ashtu si në vendet e tjera në tranzicion, mbështetja e investimeve në fermë është lloji dominant i masave të zhvillimit rural në Serbi. Gjatë viteve të fundit edhe kjo masë ka ardhur duke u ulur, duke kërcënuar seriozisht progresin teknologjik, aftësinë për të luftuar ndryshimet klimatike, rritjen e standarteve të cilësisë dhe produktivitetit. Përveç kësaj, masat jokonsistente dhe konvergjente të mbështetjes, sidomos në prodhimin blegtoral, kanë rezultuar në luhatje të mëdha dhe reduktim të prodhimit, me një ndikim negativ në tërë zinxhirin e prodhimit dhe një numër të madh fermash.

Masat për mbrojtjen e mjedisit kanë vetëm një pjesë simbolike të mbështetjes buxhetore, por edhe ato nuk janë të orientuara për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme. Ka një nënvlerësim të qartë të çështjeve të tilla si diferencat e mëdha në kushte natyrore për prodhimin bujqësor, diversitetin e burimeve, llojet e prodhimit dhe strukturës së fermës. Edhe pse ka pasur pagesat më të larta kompensuese për fermat në zonat bujqësore më pak të favorizuara, lista e masave nuk është përshtatur për llojet e prodhimit të përhapura në zona të tilla si dhe nevojat e tyre specifike.

Shpërndarjet buxhetore për masat e ndryshme mbështetëse janë të ulëta dhe të orientuara drejt masave të përcaktuara në programet vjetore. Ato nuk reflektojnë prioritetet aktuale në drejtim të

forcimit të kapaciteteve institucionale, ngritjen dhe forcimin e të gjitha llojeve të partneriteteve, infrastrukturën e institucioneve shkencore dhe hulumtuese dhe trajnimin e tyre për zbatimin e të gjitha aspekteve të mbështetjes teknike në zbatimin e politikave dhe *acquis communautaire*.

Aspiratat drejt integrimit në BE kërkojnë përmirësime thelbësore të sistemit të ndërlikuar të rregullimit ligjor dhe një ripërcaktim të kuadrit të politikave bujqësore dhe ndërhyrjeve rregullatore publike me qëllim përgatitjen e vendit për një integrim efektiv në CAP.

Në të ardhmen vendim-marrësit duhet t'i dedikohen në mënyrë të vendosur një reforme thelbësore të politikës bujqësore dhe përmirësimeve institucionale. Parimi kryesor duhet të jetë zvogëlimi gradual dhe shkrirja e masave që nuk janë të pajtueshme me CAP, si dhe futja e masave që do të sigurojnë kushte të barabarta si ato që gëzojnë fermerët e BE-së. Në aspektin e përmbajtjes së masave, tejkalimi i pengesave me të cilat përballet sektori kërkon vëmendjen më të madhe të politikave për çështjet specifike.

Rritja e konkurrueshmërisë së sektorit agro-ushqimor dhe aftësia e tij për tu përballur me sfidat e reja varen shumë nga përpjekjet për të miratuar dhe për të përmirësuar krijimin dhe transferimin e njohurive dhe teknologjisë. Baza aktuale organizative e transferimit të njohurive dhe teknologjisë në bujqësinë serbe vuan nga mungesa e investimeve, mungesa e objekteve të informacionit dhe komunikimit, kanalet e dobëta dhe të keq-koordinuara të ofrimit të informacionit (mungesa e partneriteteve dhe rrjeteve) dhe nën-përdorimi i teknologjive ekzistuese. Përmirësimi teknologjik i sektorit, investimet në njohuri të reja dhe transferimin e tyre, janë parakushte të nevojshme për reduktimin e vonesës së zhvillimit të bujqësisë serbe dhe për adresimin e dy sfidave kryesore me të cilat përballet prodhimi ushqimor dhe bujqësor; përkatësisht rritja e konkurrueshmërisë dhe luftimi me sukses i ndryshimeve klimatike. Përmirësimi i teknologjisë, njohurive dhe sistemeve të informacionit, pritet të çojnë në prodhim më shumë konkurrues, rritje të të ardhurave, dhe përmirësim të mirëqenies për popullsinë rurale.

Përmirësimi i konkurrueshmërisë, rritjes, qëndrueshmërisë dhe elasticitetit të zinxhirit ushqimor brenda sektorit agro-ushqimor, janë faktorë me rëndësi jetike që mund të ndikojnë strukturat e tregut (të fuqisë së tregut) dhe konkurrueshmërinë e tij. Zinxhiri ushqimor në Serbi aktualisht është shumë i fragmentuar dhe i pa organizuar mjaftueshëm si në prodhim edhe përpunim. Një pjesë e madhe e sektorit të bujqësisë nuk është integruar në zinxhirët e furnizimit agro-ushqimor, qoftë me anë të kontraktimit ose me ndonjë mjet tjetër të marrëdhënieve tregtare. Kjo i referohet veçanërisht grupit të madh të fermerëve të vegjël dhe një numri të madh të njësive të vogla të përpunimit, pozita e të cilëve është shumë e rëndësishme pasi ata duhet të jenë në përputhje me kërkesat e një zinxhiri gjithnjë e më të kërkuar të shitjes me pakicë. Këto kërkesa janë nxitur nga rritja e ndergjegjësimit të konsumatorëve dhe politikat publike që synojnë krijimin e kuadrit ligjor për standardet e sigurisë dhe cilësisë ushqimore.

Ndërhyrjet e politikës për përmirësimin ose ruajtjen e formave ekzistuese të integrimit horizontal dhe vertikal duhet të përqendrohen në lehtësimin e aksesit të agro-përpunuesve në shërbimet për zhvillimin e biznesit, nxitjen e sipërmarrjes së agro-përpunuesve, rritjen e askesesit në treg për fermerët e vegjël dhe përcaktimin e standardeve të cilësisë dhe certifikimit, etj. Zhvillimi dhe përmirësimi i zinxhirëve ushqimorë rajonalë dhe lokalë duhet të kontribuojnë për përmirësimin e efikasitetit të sektorit dhe aftësinë e tij për të ofruar ushqim cilësor dhetë sigurtë për konsumatorët.

Duhet të rritet fokusi në masat agro-mjedisore, praktikat bujqësore të qëndrueshme për mjedisin dhe skemat agro-mjedisore. Vendeve në tranzicion, siç është Serbia, zakonisht u mungon një kuadër i qartë politik përmes të cilit çështjet e mjedisit integrohen në mënyrë të përshtatshme në aktivitetet ekonomike, kryesisht bujqësisë. Kjo për shkak të mungesës së traditës, në lidhje me zbatimin e politikave agro-mjedisore.

Rëndësia e problemeve agro-mjedisore dhe çështjeve të ngjashme nuk njihen dhe adresohen në mënyrën e duhur, as në dokumentet programuese, as në politikëbërjen bujqësore. Këto probleme janë lënë pas dore dhe mundësitë që ofron politika bujqësore në këtë segment nuk janë

shfrytëzuar. Një qëndrim i tillë ndaj politikave agro-mjedisore ka shkaktuar kërcënime serioze për qëndrueshmërinë dhe vitalitetin e burimeve të mjaftueshme dhe të ndryshme natyrore , dhe në disa fusha ka çuar në degradimin e rëndë të tokës, ujit dhe pyjeve. Për më tepër, ka pasoja të rënda socio-ekonomike për mirëqenien e popullsisë rurale dhe bujqësore në zonat më pak të favorizuara ekonomia e të cilave është e bazuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje fermave të vogla, për shkak të faktit se ato përbëjnë shumicën e strukturës së përgjithshme të fermës, fermat e vogla familjare janë një pjesë e pashmangshme e ekonomisë rurale që kërkon vëmendje të veçantë. Numri i tyre është vazhdimisht në rënie si pasojë e plakjes, migrimeve, procesit të globalizimit, përqendrimit dhe centralizimit të kapitalit në bujqësi dhe shumë faktorëve të tjerë. Por ato luajnë akoma një rol të rëndësishëm në tregun rural të punës, stabilitetin e prodhimit bujqësor, vetë-mjaftueshmërinë ushqimore si dhe ruajtjen e strukturës sociale të zonave rurale. Si të tilla, ato kontribuojnë në zhvillimin e balancuar territorial dhe mbrojtjen, restaurimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore dhe peizazhit rural. Duke marrë parasysh karakteristikat socio-ekonomike heterogjene të fermave të vogla, diversiteti i llojeve të tyre, praktikave të tyre bujqësore dhe të ardhurave, politikat publike duhet të zgjedhin me kujdes instrumentet për të inkurajuar këtë sektor. Politika e mëparshme nuk i adresoi mjaftueshëm këto ferma, duke thelluar tashmë dallimet e mëdha rajonale.

Përmirësimet e kapacitetit institucional janë gjithashtu të nevojshme. Mangësitë kryesore të kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural në Serbi përfshijnë nevojën për themelimin e institucioneve të reja dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve ekzistuese. Veçanërisht e rëndësishme është përmirësimi i Ministrisë së bujqësisë. Mungesa e kapaciteteve organizative dhe institucionale të mjaftueshme njerëzore, dhe procedurat e duhura për zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimine politikave, ka ndikuar negativisht në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm të politikave dhe zhvillimin e programeve të mirë-përcaktuara për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin në sektorin e bujqësisë. Forcimi i shërbimeve të ekstensionit dhe institucioneve kërkimore, për të kapërcyer hendekun midis universiteteve, institucioneve kërkimore, si dhe aktorëve zbatues dhe politikëbërës është gjithashtu i nevojshëm për të krijuar bashkëpunim dhe dialog konstruktiv me përfaqësuesit e bizneseve në kuadër të zinxhirit ushqimor.

Referenca

Bogdanov, N., Rodić, V. & Vittuari, M. 2012. Structural change in transitional agriculture: Evidence from Serbia, 132 EAAE seminar "Is transition in European agriculture really over?", Skopje 25-27 October2012 (http://purl.umn.edu/139490)

Bogdanov, N., Volk T., Rednak M., & Erjavec, E.2008. Analiza direktne podrške poljoprivredni i ruralnom razvoju Srbije, Tim podpredsednika Vlade Srbije za implementaciju Strategije za smanjenje siromaštva, Beograd; http://www.prsp.gov.rs/download/Analiza percent20direktne percent20podrske percent20poljoprivredi percent20i percent20ruralnom percent20razvoju.pdf

Bosnjak, D. & Rodic, V. 2006. Zastupljenost stoke kao jedan od faktora stabilnosti prinosa u ratarskoj proizvodnji, Savremena poljoprivreda 55(1-2):55-61.

Erjavec, E., Volk, T., Rednak, M. & Bogdanov, N. 2009. Izazovi poljoprivrede Zapadnog Balkana u perspektivi pristupa Evropskoj uniji - osvrt na agroprivredu Srbije, tematski zbornik:Agroprivreda Srbije i evropske integracije: Gde smo i kako dalje, DAES, Poljoprivredni fakultet Univeryiteta u Beogradu i RPK Novi Sad, Beograd, str. 15-32.

EUROSTAT. 2013. Statistics, Eurostat, Luxemburg, available at: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/themes

Lalić, B., Mihailović, D. & Podraščanin, Z. 2011. Buduće stanje klime u Vojvodini i očekivani uticaj na ratarsku proizvodnju, Ratar. Povrt. / Field Veg. Crop Res. 48 (2011) 403-418

Mirković, M. 2012. Poljoprivreda Srbije i sporazumi o slobodnoj trgovini, Tržište, novac, kapital, 45 (2): 63-74.

Mizik, T. 2011. Western Balkans: State of Agriculture and its Opportunities on the Eve of EU Accession – I. Acta Universitatis Danubius No. 1/2011

Rednak, M. & Volk, T. 2010. Agricultural policy measures template – A tool for classifying and analyzing agricultural policy measures Volk, T. ed.: Agriculture in the Western Balkan Countries. Studies on the Agricultural and Food Sector in Central and Eastern Europe Vol. 57, IAMO, Halle/Saale, Germany, pp. 219-244.

Serbia APM Database. 2014. Agricultural Policy Measures Database compiled for Serbia under the FAO/SWG project "Streamlining of agriculture and rural development policies of SEE countries for EU accession" (unpublished data).

SORS. 2014. Statistical Office of the Republic of Serbia. Various publications, Belgrade.

Van Berkum, S. & Bogdanov, N. 2012. Serbia on the Road to EU Accession - Consequences for Agricultural Policy and theagro-food Chain, CAB International, Oxfordshire, UK.

Aneksi B.VII-1: Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave kryesore, 2005-2013, Serbia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Sipërfaqja e prodhimit (1 000 ha)									
Totali	1 964	1 879	1 931	1 930	1 950	1 873	1 903	1 896	1 908
- Grurë	563	540	559	487	568	484	493	481	563
- Misër	1 220	1 170	1 202	1 274	1 209	1 230	1 258	1 269	1 187
Farëra vajore	331	347	315	350	320	352	355	338	358
Panxhar sheqeri	64	72	79	48	61	66	56	65	62
Patate	85	84	81	81	78	77	78	75	74
Rrush (total)	64	62	59	58	57	57	56	54	51
Gruta (total)	268	266	269	271	270	270	268	267	267
- Fruta tulore	29	28	29	29	30	30	28	29	29
Perime dhe fasule	162	163	162	161	159	157	154	150	144
Duhan i papërpunuar	7	7	8	7	6	6	7	6	6
Foragjere	453	449	450	457	448	450	448	461	436
Prodhimi (1 000 t)									
Totali	9 586	8 349	6 213	8 833	8 982	9 273	9 059	5 913	9 150
- Grurë	2 007	1 875	1 864	2 095	2 068	1 630	2 076	1 911	2 690
- Misër	7 085	6 017	3 905	6 158	6 396	7 207	6 480	3 533	5 864
Farëra vajore	722	823	629	857	772	943	918	667	925
Panxhar sheqeri	3 101	3 189	3 206	2 300	2 798	3 325	2 822	2 328	2 983
Patate	969	930	743	843	898	887	891	578	767
Rrush (total)	241	359	353	373	431	330	325	263	320
Gruta (total)	873	1 218	1 381	1 299	1 452	1 077	1 337	925	1 533
- Fruta tulore	144	145	139	154	157	150	159	123	130
Perime dhe fasule	1 289	1 348	1 128	1 277	1 309	1 314	1 275	1 040	1 266
Duhan i papërpunuar	11	11	11	11	10	10	10	9	10
Foragjere	2 705	2 582	2 138	2 480	2 675	2 736	2 509	2 148	2 388

Burimi: SORS

Aneksi B.VII-2: Të dhënat e blegtorisë (në1 000 kokë), 2005-2013, Serbia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gedhë	1 079	1 106	1 087	1 057	1 002	938	937	921	913
-*nga të cilat* lopëqumështi	624	607	584	542	501	482	477	455	429
Derra	3 165	3 999	3 832	3 594	3 631	3 489	3 287	3 139	3 144
Dele dhe dhi[1]	1 728	1 718	1 755	1 759	1 647	1 604	1 590	1 867	1 841
Shpendë	16 631	16 595	16 422	17 188	22 821	20 156	19 103	24 175	23 450
Koshere bletësh[1]	270	304	267	298	302	320	306	654	653

Shënim: [1]Të dhënat për 2012 dhe 2013 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e viteve të mëparshëm(metodologji e ndryshuar)

Burimi: SORS

Aneksi B.VII-3: Çmimete prodhuesve bujqësorënë fermë (EUR/t), 2005-2013, Serbia

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Grurë i zakonshëm	92	109	144	184	106	125	177	191	155
Misër	75	90	157	121	94	131	167	184	142
Luledielli	174	178	316	289	172	345	301	455	219
Sojë	201	192	280	307	276	280	325	527	386
Panxhar sheqeri	25	28	30	34	28	24	38	40	40
Patate	90	145	161	140	138	237	236	220	249
Domate	395	313	570	518	557	793	240	530	318
Speca	205	196	327	337	286	475	396	311	353
Mëshqerra (peshë e gjallë)	2 102	2 507	2 364	2 488	2 466	2 410	2 646	2 677	2 594
Lopë për majmërim (peshë e gjallë)	1 487	1 607	1 554	1 746	1 727	1 523	1 849	1 886	1 936
Derra (≤110kg, peshë e gjallë)	1 274	1 086	1 048	1 539	1 501	1 185	1 330	1 529	1 564
Qingja(peshë e gjallë)	1 859	2 089	2 032	2 014	1 963	1 917	2 082	1 911	1 981
Pula (peshë e gjallë)	898	832	981	1 071	954	879	1 072	1 055	1 177
Vezë (1 000 copë)	53	46	61	82	72	55	69	74	70
Qumësht lope	174	184	232	292	224	220	272	260	282

Burimi: SORS

JU LUTEMI QË KOMENTET DHE PYETJET T'I ADRESONI NË:

Food and Agriculture Organization of the United Nations

South Eastern Europe
SWG RRD
Regional Rural Development Standing Working Group

ZYRA RAJONALE
PËR EVROPË DHE AZI QENDRORE (REU)
ORGANIZATA BUJQËSORE DHE PËR USHQIM
E KOMBEVE TË BASHKUARA (FAO)
BENCZUR U.34, 1068 BUDAPEST, HUNGARI
TEL: +3614612000
FAX: +3613517029
E-MAIL: FAO-RO-EUROPE@FAO.ORG
UEBFAQA: WWW.FAO.ORG/EUROPE/ENG

SEKRETARIATI/ZYRA QENDRORE E SWG
BULEVARDI GOCE DELÇEV
NDËRTESA E RTVM, KATI 12
KUTIA POSTARE 659
1000 SHKUP, MAQEDONI
TEL: +38923217708
FAX: +38923217244
E-MAIL: SWGSECRETARIAT@SWG-SEERURAL.ORG
UEBFAQA: WWW.SEERURAL.ORG

I4166AI/1/03.15